



Funded by
the European Union



Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe rekuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar

Shkurt 2024

Falenderime

Falenderime Zëvendësdrejtueses të EU4FOCAL, **María Luisa García Iglesias**, për bashkimin e ekspertizës shqiptare dhe asaj të BE-së dhe ekspertëve afatshkurtër, **Luis Rodríguez Sol**, **Borja Jiménez Muñoz** dhe **Fernando Sanz Ayuso**, për profesionalizmin e tyre dhe ndarjen e ekspertizës së tyre të nivelit të lartë.

I jemi mirënjohës të gjitha atyre institucioneve që kanë demonstruar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe kanë përfshirë ekspertë të kualifikuar në hartimin e manualit. Vlerësimi ynë për ekspertët e përkushtuar shqiptarë që ndanë njohuritë dhe përvojat profesionale në përgatitjen e një mjeti të dobishëm për:

Kujtim Luli dhe Ervisa Hyka - Prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme;

Edmond Koloshi - Shef i Seksionit të Posaçëm për Pastrimin e Parave dhe Krimet Financiare në Prokurorinë e Rrethit Durrës;

Gentiana Kalia - Oficere e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme Shqiptare;

Fabian Zhilla - Këshilltar Ligjor i SPAK;

Artan Shiqerukaj- Drejtor i Analizave në Agjencinë Shqiptare të Inteligjencës Financiare;

Lutfi Minxhozi - Drejtor i EUROPOL-it në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shqiptar;

Amarildo Laçi - Profesor në Shkollën Shqiptare të Magjistraturë;

Diana Stillo - Përgjegjëse e Njesisë për Traktatet Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimin Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë.

Ekipi i EU4FOCAL

Deklaratë për mospranim përgjegjësie

Ky publikim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e ekspertëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Indeksi

FJALORTH.....	9
PARATHËNIE.....	11

KAPITULLI I. KONCEPTI I PASTRIMIT TË PARAVE..... 13

1. HYRJE E PËRGJITHSHME.....	15
2. PËRKUFIZIMI DHE ELEMENTËT OBJEKTIVË TË VEPRËS PENALE.....	17
A) Përkufizimi dhe format e pastrimit të parave	17
a) Konventat e Kombeve të Bashkuara	17
b) Konventat e Këshillit të Evropës	19
c) Direktivat e BE-së	20
d) E Drejta Penale e Brendshme (vendase)	21
B) Koncepti i Veprës Penale Kryesore (mëmë).....	22
C) Nuk ka nevojë për dënim të mëparshëm	23
D) Ekstraterritorialiteti.....	24
3. ANA SUBJEKTIVE E VEPRËS PENALE.....	25
A) Aktet Ndërkombëtare	25
B) Legjislacioni i BE-së.....	25
4. SUBJEKTI (AUTORI) I VEPRAVE PENALE TË PASTRIMIT TE PARAVE.....	27
A) Vetëpastrimi i parave	27
B) Roli i Disa Profesionistëve.....	28
C) Avokatët dhe pastrimi i parave.....	28
D) Përgjegjësia Penale e Personave Juridik.....	30
a) Konventat e OKB-së	30
b) Konventat e KiE.....	30
c) Legjislacioni i BE-së.....	30
d) Legjislacioni i Brendshëm	31

KAPITULLI II. REKUPERIMI I ASETETEVE..... 35

1. HYRJE.....	37
2. LLOJET E NDRYSHME TË KONFISKIMIT.....	38
A) Për sa i përket objektit	40
a) Konfiskimi 'tradicional'	40
b) Konfiskimi i vlerës.....	41
c) Konfiskimi i zgjeruar	41
d) Konfiskimi nga një pale e tretë.....	42
B) Për sa i përket referimit.....	43
C) Vëmendje e veçantë për konfiskimin pa dënim në procedimet jopenale dhe për konfiskimin e parashikuar në Ligjin Shqiptar Antimafia (LAM).....	45
a) Konventat e Këshillit të Evropës.....	45
b) Legjislacioni i BE-së.....	45
c) Ligji Shqiptar Antimafia	46

3. FAZAT E NDRYSHME TË PROCESIT TË REKUPERIMIT TË ASETETEVE	47
A) Gjetja e pasurive	47
a) Qasje të ndryshme	48
b) Zyrat e Rekuperimit të Aseteve.....	48
B) Sekuestrimi i pasurive.....	48
a) Bazat e sekuestrimit	48
b) Mënyrat e ndryshme të sekuestrimit të pasurive	49
c) Masat mbrojtëse procedurale.....	49
d) Administrimi i pasurive të sekuestruara	50
C) Konfiskimi i pasurive	50
a) Të drejtat e personave të prekur	51
D) Rekuperimi i asetëve dhe kthimi i tyre te pronarët e ligjshëm, te komuniteti, te viktimat e krimit, ose likuidimi i asetëve.....	51
a) Të drejtat e viktimës	51
b) Përdorimi i pronës së konfiskuar për interes publik ose për qëllime sociale.....	52
c) Ndarja e asetëve	53
4. PRAKTIKA GJYQËSORE E GJEDNJ-SË DHE GJED-SË.....	54
A) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut	54
B) Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European	56
5. PRAKTIKAT E MIRA NË REKUPERIMIN E ASETETEVE	57

KAPITULLI III. HETIMI FINANCIAR DHE PASUROR

HYRJE.....	61
1. OBJEKTIVAT E HETIMIT FINANCIAR DHE PASUROR.....	62
A) Hetimi pasuror	63
B) Hetimi i pastrimit të parave	63
2. TERMA TË DOBISHËM NË HETIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE	65
A) Persona kukull (straw men, front men).....	65
B) Shoqëritë guaskë, të gatshme dhe llojet e tjera të shoqërive tregtare.....	65
C) Ofruesi i shërbimit të trusteve dhe shoqërive tregtare	67
D) Pronësia përfituese	68
E) Parajsat fiskale dhe juridiskionet jobashkëpunuese	69
F) Mushkat e parave.....	70
G) KRIPTOASETET	71
H) Ofruesit e shërbimeve të asetëve virtuale (vasp)	72
3. METODOLOGJIA E HETIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE (PP).....	74
a) Fillimi i hetimit të pastrimit të parave.....	74
b) Fazat e hetimit financiar.....	75
c) Metodologjia e përdorur në hetime financiare	78
d) Strukturat e raportit në rastet e pastrimit të parave.....	85
4. TEKNIKAT E HETIMIT NË HETIMIN FINANCIAR.....	87
A) Analiza e dokumentacionit	87
B) Informacioni bankar	88
C) Informacion jobankar	88
D) Gjurmueshmëria e kriptomonedhave.....	89
E) Kërkimi dhe sekuestrimi	89
a) Provat elektronike	89
b) Dokumenta Fizike në Kontrolllet e Banesave.....	91
c) Kriptoasetet.....	91
F) Teknika e posaçme të hetimit:	92
a) Përgjimet telefonike	93
b) Dorëzime të kontrolluara	94
c) Agjentët në Mbulim	95
d) Përgjimi i posacëm.....	95
e) Kontrolllet e shumave në të holla në kufi	95

KAPITULLI IV. ÇËSHTJET PROCEDURALE	97
1. PROVAT E NEVOJSHME PËR TA DËRGUAR ÇËSHTJEN NË GJYKATË	99
A) Sa i përket veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	99
a) Provat e bazuara në indicie	99
b) Veprimi me Dashje të Tërthortë (<i>Dolus eventualis</i>) dhe neglizhenca	100
B) Sa i përket veprës penale ose 'veprimtarisë kriminale' mëmë	101
C) Llojet e ndryshme të provave	101
a) Dokumentet (konsideratë e veçantë për informacionin bankar)	102
b) Dëshmitarët (konsideratë e veçantë për sinjalizuesit)	103
c) Provat digjitale	104
d) Provat rrethimore (jo të drejtpërdrejta).....	105
2. GARANCITË PROCEDURALE DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT	107
A) E drejta për proces gjyqësor të drejtë dhe e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare	107
B) Prezumimi i pafajësisë	107
C) E drejta për të heshtur	108
3. TË DREJTAT E PALËVE TË TRETA.....	109
A) E drejta e palëve të prekura nga masat parandaluese	109
B) Të drejtat e viktimës	109
4. PRAKTIKA GJYQËSORE E GJEDNJ-SË.....	111
KAPITULLI V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	113
1. HYRJE.....	115
2. SISTEMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR TË ANALIZUARA	116
A) Parimet për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështje penale kur nuk ka mjete të disponueshme. Referenca specifike të sistemeve ligjore	117
B) Citimi i Instrumenteve të OKB-së. Kuadri i ndarjes së aseteve	119
C) Instrumentet e Këshillit të Evropës (KiE). Citimet për kuadrin e ndarjes së aseteve	119
D) Instrumentet e BE-së.....	121
a) Urdhri Evropian i Hetimit	121
b) Urdhër Arresti Evropian	121
c) Legjislacioni mbi njohjen e ndërsjelltë të urdhrave për ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve. Trajtim i posaçëm i kuadrin të BE-së për ndarjen e pasurive	121
d) Provat elektronike	123
3. KUADRI LIGJOR SHQIPTAR. REFERENCA SPECIFIKE PËR NDARJEN E ASETVE.....	126
4. SFIDAT GJATË HETIMEVE NDËRKUFITARE	128
5. MJETE TË TJERA.....	129
A) Eurojust	129
B) Skuadrat e Përbashkëta Hetimore (JIT)	130
C) Bashkëpunimi me Prokurorinë Publike Evropiane	133
6. REFERENCA PËR AGJENCITË SHTETËRORE LIGJZBATUESE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR	134
A) EUROPOL	134
B) INTERPOL	135
C) CARIN	136
D) AMON	136
E) BAMIN	137
F) SELEC.....	137
G) AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE DHE BASHKËPUNIMI ME HOMOLOGËT (GRUPI EGMONT)	138

SHTOJCA 1. BURIMET E VLEFSHME PËR KËRKIMIN E INFORMACIONIT TË HETIMIT FINANCIAR	141
HYRJE.....	143
1. SISTEMI I REGJISTRIT TË GJENDJES CIVILE	146
2. SISTEMI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	147
3. SISTEMI TIMS	147
4. REGJISTRI I NGJARJEVE KRIMINALE	148
5. REGJISTRI I PERSONAVE TË DËNUAR	148
6. REGJISTRI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT KRIMINAL (MEMEX).....	148
7. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE	149
8. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR.....	150
9. AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS (ASHK)	150
10. REGJISTRI I KAPITENERISË, DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE	151
11. REGJISTRI I MJETEVE TË TRANSPORTIT TË AVIACIONIT CIVIL	151
12. QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT.....	151
13. QENDRA KOMBËTARE E LICENCIMIT (QKL)	152
14. REGJISTRI I PRONARËVE PËRFITUES	152
15. AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIAR (AIF - ISH DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE - AIF)	152
16. REGJISTRI QENDROR I LLOGARIVE BANKARE	153
17 OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE	154
18. SISTEMI I UJËSJELLËS KANALIZIMEVE TIRANË.....	154
19. NJËSIA E KONTROLLIT TË PASAGJERËVE.....	154
20. REGJISTRI I HUAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË.....	154
21. DEKLARIMET E PERSONAVE TË EKSPOZUAR POLITIKISHT, ZYRTARËVE E FUNKSIONARËVE ME DETYRIM RAPORTIMI NË INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT (ILDKPKI).....	155
22. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE.....	155
23. ARKIVAT E SISTEMIT GJYQËSOR	155
24. NOTERËT.....	156
25. REGJISTRI I PASURIVE TË LUAJTSHME	156
26. BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE	156
27. REGJISTRI I KONTRATAVE TË SIGURIMIT TË JETËS.....	157
28. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FONDEVE TË SIGURIMIT DHE TË PENSIONIT.....	157
29. DREJTORIA E LOJRAVE TË FATIT	157
30. AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA... 157	
31. AGJENCIA E PËRPUNIMIT TË KREDIVE	158
32. KËSHILLAT BASHKIAKË APO SHOQËRITË NË NIVEL VENDOR.....	158
33. ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR.....	158
34. SHOQËRITË E SIGURIMEVE.....	158
35. NDËRMJETËSIT TREGTARË	159
36. AGJENCITË, UNIONET SHOQËRITË E TRANSFERIMIT TË PARAVE	159
37. KOMISIONI KOMBËTAR I TREGUT TË LETRAVE ME VLERË (K.K.L.V.).....	159

38. ZYRAT LIGJORE, ZYRA PROFESIONALE, KONSULENCE DHE AGJENCI.....	159
39. OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË INTERNETIT	160
40. AGJENCITË E UDHËTIMIT	160
41. AMZA, REGJISTRI I VLERËSIMIT NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE E PRIVATE	160
42. AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE (AMF)	160
43. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE	160

SHTOJCA II. TIPOLOGJITË E PASTRIMIT TË PARAVE..... 161

1. PËRDORIMI I PARAVE FIZIKE.....	163
2. PËRDORIMI I KRIPTOMONEDHAVE.....	168
3. PËRDORIMI I SEKTORIT BANKAR.....	177
4. PASTRIMI I PARAVE NËPËRMJET TREGTISË (PPNT).....	187
5. SHFRYTËZIMI I SEKTORIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME.....	194
6. SISTEMET INFORMALE TË TRANSFERIMIT TË VLERËS	200
7. PËRDORIMI I PROFESIONISTËVE LIGJORË.....	204
8. PËRDORIMI I MJETEVE KORPORATIVE NDËRKOMBËTARE KOMPLEKSE.....	209
9. PËRDORIMI I SHËRBIMEVE TË TRANSFERIMIT TË PARAVE.....	213
10. TIPOLOGJI TË TJERA.....	220
1. PËRDORIMI I "MUSHKAVE" TË PARAVE	220
2. PËRDORIMI I BIZNESEVE QË PËRDORIN INTENSIVISHT PARANË FIZIKE (FIAT).....	221
3. PËRDORIMI I HUAVE.....	221
4. SEKTORI I LOJËRAVE TË FATIT.....	222
5. BLERJA E VEPRAVE TË ARTIT, STOLIVE DHE OBJEKTEVE ME VLERË	223
6. PËRDORIMI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE OSE TË BAMIRËSISË.....	223
7. PËRDORIMI I SEKTORIT TË FUTBOLLIT	224
8. PËRDORIMI I SEKTORIT TË SIGURIMEVE.....	225

SHTOJCA III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: PARAQITJE E KONVENTAVE NË TABELË..... 227

Fjalorth

AAML	Ligji Nr. 10 192, datë 3.10.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Veprave të tjera përmes Masave Parandaluese kundër Pronës", i ndryshuar, njohur edhe si Ligji Shqiptar Anti-Mafia
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
KP	Kodi Penal i Shqipërisë
KPP	Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë
AML	Kundër Pastrimit të Parave
LPP/LFT	Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
AMLD	Direktiva 2015/849 (BE), për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ndryshuar me Direktivën 2018/843 (BE) dhe Direktivën 2019/2177 (BE)
AMLCLD	Direktiva 2018/1673 (BE) për luftën kundër pastrimit të parave përmes legjislacionit penal
AMON	Rrjeti Operacional kundër Pastrimit të Parave
PA-të	Projektet e Analizës
LPPPFT	Ligji Nr. 9917, datë 19.5.2008 Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
ARO	Zyra e Rekuperimit të Aseteve
ATM	Bankomatet
BAMIN:	Rrjeti Ndëragjencor i Ballkanit për Administrimin e Aseteve
BOL	Ligji Nr. 112.2020, Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2022
BTC	Bitcoin
CARIN	Rrjeti Ndëragjencor Camden i Rekuperimit të Aseteve
KDK	Kujdesi i Duhur për Klientin
LFT	Lufta kundër Financimit të Terrorizmit
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
UAE	Urdhër Arresti Evropian
ABE	Autoriteti Bankar Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
KEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KDSH	Kujdesi i Duhur i Shtuar

EFECC	Qendra Financiare dhe Ekonomike Evropiane
UEH	Urdhri Evropian i Hetimit
EPPO	Zyra e Prokurorisë Publike Evropiane
BE	Bashkimi Evropian
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FIU	Njësia e Inteligjencës Financiare
PP	Prokuroria e Përgjithshme
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
ICO	Ofertat Fillestare të Monedhave
IFCACC	Qendra e Krimin Financiar dhe Kundër Korrupsionit e Interpol-it
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IP	Protokolli i Internetit
JIT	Ekipet e Përbashkëta Hetimore
OPGJ	Oficeri i Policisë Gjyqësore
NJKT	Njih Klientin Tënd
AZL	Agjencitë e Zbatimit të Ligjit
LK	Letër Kërkesë
PN	Prokuror Ndërlidhës
PP	Pastrimi i Parave
PP/FT	Pastrimi i Parave/Financimi i Terrorizmit
NNJ	Ndihmë e Ndërsjellë Juridike
MD	Ministria e Drejtësisë
SHA	Shtetet Anëtare
SHTPV	Shërbimet e Transferimit të Parave ose Vlerës
NCB	Byroja Qendrore Kombëtare e Interpol-it
KKTLV	Komisioni Kombëtar i Tregut të Letrave me Vlerë
GKO	Grup Kriminal i Organizuar
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
SELEC	Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Lindore
SPAK	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
Gjykata e SPAK	Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional.
AV	Asete virtuale
OSHPV	Ofruesit e Shërbimit të Pasurive Virtuale

Parathënie

Lufta kundër pastrimit të parave (PP) është aktualisht një prioritet i lartë dhe tendencë e përbashkët e politikave kriminale të vendeve demokratike. Për këto arsye, një sërë organizatash ndërkombëtare, si Task Forca e Veprimit Financiar (FATF), monitorojnë zbatimin dhe përmirësimin e politikave Kundër Pastrimit të Parave (KPP) në vende të ndryshme, përfshirë Shqipërinë. Gjithashtu, Komisioni Evropian, në raportin e progresit të publikuar për Shqipërinë, ka adresuar rekomandime konkrete në lidhje me pastrimin e parave.

Pavarësisht se edhe organizatat e sipërpërmendura kanë pranuar progresin e bërë nga Shqipëria drejt përmirësimit të regjimit të KPP, rritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve, gjyqtarëve dhe agjencive ligjzbatuese mbetet prioritet në luftën kundër pastrimit të parave. Hartimi i këtij manuali duhet të konsiderohet si një element shtesë drejt këtij qëllimi.

Publikimi është krijuar për të mbështetur dhe forcuar kapacitetet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Policisë së Shtetit Shqiptar dhe agjencive të tjera përkatëse ligjzbatuese në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimet e organizuara nëpërmjet hetimeve financiare paralele dhe proaktive.

Manuali është projektuar dhe hartuar nga një grup pune ndërinstitucional i mbështetur nga projekti "Lufta kundër krimit të organizuar në Shqipëri nëpërmjet hetimit penal dhe financiar" (EU4FOCAL), financuar nga Komisioni Evropian. Përfaqësues me eksperiencë nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës, kanë dhënë kontribute individuale dhe kolektive për të pasqyruar në manual veçoritë e legjislacionit shqiptar, si dhe nënvizojnë nevojat aktuale dhe të ardhshme të kapaciteteve hetimore të PP në Shqipëri.

Ky dokument nuk është një punim akademik mbi PP. Qëllimi i tij është më modest, sepse është konceptuar si një manual teorik dhe praktik për t'u përdorur nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore që merren me krimet financiare dhe pastrimin e parave në punën e tyre të përditshme. Sigurisht, nga ky manual mund të përfitojnë edhe profesionistë të tjerë të përfshirë në hetime dhe gjykime penale në lidhje me PP, si gjyqtarë apo hetues financiarë.

Struktura e manualit synon të sigurojë një qasje të rrjedhshme ndaj çështjeve të analizuara.

Kapitulli i parë është hartuar si një hyrje e përgjithshme dhe për këtë arsye fokusohet në konceptin dhe përkufizimin e PP sipas instrumenteve të ndryshme ndërkombëtare në fuqi (në nivel të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian) dhe legjislacionit shqiptar, si dhe në elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të PP.

Kapitulli i dytë trajton një temë të lidhur ngushtë me PP, që është Rekuperimi i Aseteve.

Kapitujt e tretë dhe të katërt, të titulluar "Hetimet financiare" dhe "Çështjet penale dhe procedurale" i kushtohen veçanërisht oficerëve dhe prokurorëve të policisë gjyqësore.

Kapitulli i fundit fokusohet në bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet e PP dhe Rekuperimin e Aseteve.

Në të gjithë manualin, vëmendje e veçantë i kushtohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, me qëllim prezantimin dhe njohjen e lexuesit me standardet evropiane në këtë fushë.

Së fundi, manuali plotësohet me tre anekse, konkretisht: një udhëzues burimesh të dobishme në hetimet financiare duke marrë parasysh veçoritë e sistemit shqiptar; një listë me shpjegime të tipologjive më të zakonshme të PP, duke marrë parasysh situatën në Shqipëri; dhe një tabelë të instrumenteve ndërkombëtare në fuqi në aspekte të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në të tre nivelet (Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian).

Ky manual është fryt i një pune të përbashkët të përkushtuar të ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas; ne u jemi shumë mirënjohës atyre dhe shpresojmë që ky manual të jetë i dobishëm për të gjithë praktikuesit shqiptarë.

Ervisa Hyka

Prokuroria e Përgjithshme

KAPITULLI I

KONCEPTI I PASTRIMIT TË PARAVE

1.

Hyrje e përgjithshme

Komuniteti ndërkombëtar e konsideron luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si një nga prioritetet kryesore. Kjo përpjekje ka për qëllim të mbrojë integritetin dhe stabilitetin e sistemit financiar ndërkombëtar, të eliminojë burimet në dispozicion të terroristëve, dhe t'u vështirësojë sa më shumë personave të përfshirë në krime përfitimin nga veprimet të tyre kriminale.

Sipas Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF)¹, shitja e paligjshme e armëve, kontrabanda dhe veprimtaritë e krimit të organizuar, përfshirë për shembull, trafikimin e drogës dhe të qenieve njerëzore, mund të krijojnë shuma të mëdha të ardhurash. Fitime të mëdha mund të vijnë edhe si rrjedhojë e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në prokurime apo ankande publike, dhe skemave të mashtrimit kompjuterik, të cilat mund të nxisin "legjitimimin" e përfitimeve të krijuara në mënyrë të paligjshme përmes pastrimit të parave.

Kur veprimtaria kriminale krijon fitime të konsiderueshme, individit ose grupit kanë nevojë t'i kontrollojnë fondet pa tërhequr vëmendjen tek veprimtaria kriminale ose individët e përfshirë në të. Kriminelët e arrijnë këtë përmes fshehjes së burimeve, ndryshimit të formës, ose zhvendosjes së fondeve në vende që nuk evidentohen lehtë.²

Skemat e mëdha të pastrimit të parave përfshijnë elemente ndërkufitare. Pastrimi i parave është problem ndërkombëtar, ndaj dhe bashkëpunimi midis shteteve është domosdoshmëri në luftën kundër tij. Një sërë nismash janë ndërmarrë për trajtimin e këtij fenomeni në rang ndërkombëtar. Kështu, organizatat ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara ndërmorën në fund të viteve 1980 disa hapa fillestarë për trajtimin e fenomenit. Bashkimi Evropian (BE), Këshilli i Evropës (KiE), FATF-ja dhe Organizata e Shteteve Amerikane vendosën, ndër të tjera, hartuan standarde kundër pastrimit të parave për vendet e tyre anëtare. Karaibet, Azia, Evropa, Afrika dhe Amerika Latine kanë ngritur organizata rajonale kundër pastrimit të parave të ngjashme me task forcën.

Ky kapitull synon të shqyrtojë përkufizimet dhe format e pastrimit të parave, duke u nisur nga praktika të ndryshme ligjore ndërkombëtare dhe duke i krahasuar ato me kuadrin e brendshëm ligjor në këtë

1. Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) është një organ i pavarur ndërqeveritar që zhvillon dhe promovon politika për të mbrojtur sistemin financiar global kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Rekomandimet e tyre (www.fatf-gafi.org/recommendations.html) përcaktojnë një kuadër gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të masave që vendet duhet të zbatojnë për t'iu kundërvënë këtyre kërcënimeve dhe njihen si kundër pastrimit të parave globale (AML) dhe luftimit të Standardi i financimit të terrorizmit (CFT).

2. <https://www.fatf-gafi.org/faq/moneylaundering/>

fushë. Kjo metodë do të përdoret edhe për përkufizimet të cilat lidhen kryesisht me elementët objektive të veprës penale mëmë (përfshirë këtu edhe veprën penale produktet e së cilës pastrohen; kur është parashkruar ose amnistuar vepra penale produktet e së cilës pastrohen, kur ajo është kryer nga persona që nuk mund të merren si të pandehur ose që nuk mund të dënohen për veprën penale nga e cila rrjedhin produktet, dhe kur nuk ka nisur asnjëherë çështje penale, ose nuk është dhënë dënim me vendim penal të formës së prerë, si dhe kur vepra penale produktet e së cilës pastrohen është kryer, pavarësisht shtetësisë së autorit, jashtë territorit të vendit), gjithashtu edhe anën subjektive e veprës penale (dashja, dijenia/njohuria dhe qëllimi), si dhe disa aspekte që kanë të bëjnë me subjektet e veprës penale, duke u përqendruar veçanërisht tek vetëpastrimi, kryerja e veprës nga profesionistë, veçanërisht avokatët, si dhe përgjegjësia penale e personave juridikë.

2.

Përkufizimi dhe elementët objektivë të veprës penale

Në rang ndërkombëtar është rënë dakord se pastrimi i parave është procesi i fshehjes së origjinës së paligjshme të fitimeve të krijuara nga veprimet kriminale. Ky proces ka rëndësi thelbësore pasi i jep mundësinë autorit t'i gëzojë këto fitime.

Koncepti i pastrimit të parave është zhvilluar ndjeshëm në nivel ndërkombëtar, nëpërmjet konventave/traktateve të ndryshme që do të trajtohen në mënyrën të hollësishme më poshtë. Këto konventa janë përditësuar dhe plotësuar vazhdimisht me akte të reja, me qëllim nxitjen e Shteteve palë drejt përshtatjes së kuadrit të tyre ligjor me format e reja të krimit. Në këtë kontekst, procesi i pastrimit të parave ka disa tipare të përbashkëta, pavarësisht formës së veprimtarisë kriminale. Kjo vepër penale bazohet në skemën e përbërë nga vendosja (lëvizja e fondeve nga lidhja e drejtpërdrejtë me krimin në një sistem të ligjshëm financiar) shtresëzimi (fshehja e gjurmëve për të shmangur gjurmimin, ndonjëherë nëpërmjet mashtrimeve me bilancet) dhe, si hapi i fundit i integritimit (vënja e parave përsëri në dispozicion të kriminelit, nga burime në dukje të ligjshme).

A) PËRKUFIZIMI DHE FORMAT E PASTRIMIT TË PARAVE

a) Konventat e Kombeve të Bashkuara

Sipas një qasjeje të hershme, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope (Vjenë, 1988), ratifikuar me ligjin nr.8722³, datë 26.12.2000, në Nenin 3.1b), e përkufizon për herë të parë veprën penale të pastrimit të parave në kuadër të një traktati ndërkombëtar detyrues.

Konventa kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollet Shtesë (Konventa e Palermos) u miratua me Rezolutën 55/25, datë 15 nëntor 2000, të Asamblesë së Përgjithshme së Kombeve të Bashkuara dhe është mjeti kryesor ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar transnacional. Ajo hyri në fuqi më 29 shtator 2003. Shqipëria e ratifikoi këtë konventë me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.⁴

3. Ligji Nr. 8722, datë 26.12.2000 mund të akeshkohet këtu: https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_e_okb_kunder_trafikut_te_paligjshem_te_drogave_2000_copy_1_778.pdf

4. Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002 mund të akeshkohet këtu: https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_e_kombeve_te_bashkuara_kunder_krimin_te_organizuar_nderkombetar_774.pdf

Konventa plotësohet nga tre Protokolle, që mbulojnë fusha dhe forma/manifestime të veçnata të krimit të organizuar: “Protokolli kundër trafikut të emigrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare”; “Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”; dhe “Protokolli kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe elementeve përbërës të tyre dhe municioneve”.

Kjo konventë është instrument i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, dhe falë saj shtetet anëtare janë ndërgjegjësuar për rëndësinë e problemeve që shkaktohen prej tij dhe nevojën për nxitjen dhe forcimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërkombëtar për trajtimin e kësaj çështjeje.

Neni 6 i Konventës së Palermos i referohet posaçërisht pastrimit të parave, ndërsa pika 1 përcakton një përkufizim që pasqyron atë të Konventës së Vienës ku përcaktohen elementet kryesore të veprës penale të pastrimit të parave. Kështu, format e pastrimit të parave përfshijnë:

(a) (i) shkëmbimin ose transferimin e pasurisë, duke ditur që një pasuri e tillë është produkt i krimit, me qëllim fshjehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të saj ose dhënien e ndihmës çdo personi të përfshirë në kryerjen e veprës penale mëmë për t’iu shmangur pasojave ligjore të veprimit tij/saj;

(ii) fshehjen ose maskimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pronësinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i krimit;

(b) Sipas koncepteve bazë të sistemit të vet ligjor:

(i) fitimin, posedimin ose përdorimin e pasurisë, duke ditur në kohën e marrjes në dorëzim që kjo pasuri është e produkt i krimit;

(ii) pjesëmarrjen, shoqërimin ose komplotimin për të kryer, përpjekjet për të kryer dhe dhënien e ndihmës, përkrahjen, lehtësimin dhe dhënien e këshillave për kryerjen e çdonjëres prej veprave penale të cilësuar si të tilla në përputhje me këtë nen.”

Duke ndjekur strukturën e Konventës së Palermos, OKB-ja miratoi në vitin 2003 Konventën Kundër Korrupsionit (UNCAC, ose Konventën e Meridës). Në nenin 23 të kësaj Konvente jepet përkufizim i ngjashëm me atë të Palermos.⁵

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNDOC) ka zhvilluar mjete të tjera, si portalin SHERLOC, që shërben për shpërndarjen e informacionit në lidhje me zbatimin e Konventës së OKB-së. Faqja e saj e internetit përmban informacion shumë të hollësishëm mbi shtetet palë dhe kudrin e tyre ligjor, praktikën gjyqësore, bazën e të dhënave, formularët etj., informacion ky shumë i përshtatshëm për agjencitë ligjzbatuese.⁶

5. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Meridas me ligjin nr.9492, datë 13.03.2006, cili mund te aksesohet këtu: <https://www.ildk-pki.al/ep-content/uploads/2018/12/Konventa-e-OKB-kunder-Korrupsionit.pdf>

6. P.sh. kudri ligjor shqiptar mund të shihet këtu: https://sherloc.unodc.org/cld/v3/sherloc/legdb/search.html?lng=en#?c=%7B%22filters%22:%5B%7B%22fieldName%22:%22en%23legislation@country_label_s%22,%22value%22:%22Albania%22%7D%5D,%22sortings%22:%22%22%7D



b) Konventat e Këshillit të Evropës

KiE-ja ka zhvilluar qasje gjithëpërfshirëse kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke përcaktuar standarde përmes konventave dhe rekomandimeve, duke monitoruar përmbushjen e jo vetëm standardeve të KiE-së, por edhe atyre të FATF-së dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare përkatëse, si dhe duke ndihmuar për zbatimin e tyre përmes projekteve të bashkëpunimit teknik.

Në vitin 1990 u miratua Konventa për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të produktit të krimit [CETS 141]⁷ e njohur si Konventa e Strasburgut. Shqipëria e nënshkroi dhe ratifikoi këtë konventë pa deklaratë apo rezerva me ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000.⁸ Kjo Konventë thekson se bashkëpunimi dhe ndihma reciproke ndërmjet shteteve është tejet e rëndësishme për gjurmimin dhe hetimin e pastrimit të parave. Kjo Konventë u përditësua dhe u plotësua më tej në vitin 2005 me Konventën e KiE-s për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produktit të krimit dhe për financimin e terrorizmit [CETS 198]⁹ në vitin 2005 (e njohur si Konventa e Varshavës) duke marrë parasysh faktin se terrorizmi mund të financohet, jo vetëm nëpërmjet pastrimit të parave të veprimtarisë kriminale, por edhe nëpërmjet veprimtarive të ligjshme. Shqipëria e ratifikoi këtë konventë pa asnjë deklaratë apo rezervë me Ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006.¹⁰

Në këtë drejtim, një nga qasjet më të rëndësishme për përkufizimin e pastrimit të parave parashikohet në Nenin 9 të Konventës së Varshavës. Kjo e fundit është traktati i parë ndërkombëtar që trajton parandalimin dhe kontrollin e pastrimit të parave së bashku me financimin e terrorizmit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në tekst trajtohet fakti se aksesimi i shpejtë në informacionin financiar ose informacionin për pasuritë e zotëruara nga organizatat kriminale, përfshirë këtu dhe grupet terroriste, është çelësi i suksesit të masave parandaluese dhe represive, si dhe, në fund të fundit, është mënyra më e mirë për t'i ndaluar ato.

7. <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=141&CM=8&DF=2/27/2008&CL=ENG>.

8. Ligji nr. 8646 date 20.07.2000, mund të aksesohet këtu: https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_per_pastrimin_hetimin_dhe_kapjen_e_produkteve_te_krimit_1376.pdf

9. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=198>

10. Ligji nr.9646, date 27.11.2006 mund te gjendet këtu: https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_per_pastrimin_kerkimin_kapjen_dhe_konfiskimin_e_produkteve_te_krimit_dhe_financimin_e_terrorizmit_1377.pdf

Në Konventë parashikohen dispozita specifike të cilat parashikojnë shprehimisht aksesin e NJIF-ve në informacion administrativ dhe të agjencive ligjzbatuese (Neni 12)¹¹, një mekanizëm për garantimin e zbatimit të dispozitave të saj nga palët (Neni 48) dhe dispozita shumë të rëndësishme për hetimet ndërkufitare që do të analizohen në Kapitullin V të këtij manuali. Neni 9 përcakton përkufizimin e pastrimit të parave bazuar në Konventat e viteve 1988 dhe 1990, por edhe në Rekomandimet e FATF-së.

Neni 9.

1. *“Çdo Palë merr masat legjislative dhe masat e tjera të nevojshme për t’i atribuuar aktit karakterin e veprës penale, në përputhje me të drejtën e brendshme, kur akti është kryer me qëllimin e:*
 - a) *kthimit ose transferimit të pasurive, me dijeninë që kjo pasuri është produkt i krimit, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurive të tilla, ose dhënien e ndihmës çdo personi të përfshirë në kryerjen e veprës penale mëmë, për t’i shpëtuar pasojave ligjore të akteve të tij;*
 - b) *fshehjes ose maskimit të natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të të drejtave në lidhje me to, kur autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte; dhe, sipas parimeve kushtetuese dhe koncepteve themelore të sistemit juridik të vet;*
 - c) *përvetësimin, mbajtjes ose përdorimit të pasurive, të cilat ai që i fiton, i mban ose i përdor, dhe është në dijeni që ato janë produkt i veprës në momentin e përfutimit;*
 - d) *pjesëmarrjes në mënyrë të organizuar ose në bashkëpunim për kryerjen, tentativën për të kryer dhe ndihmën ose këshillimin për kryerjen e një prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë nen.”*

Qasjet e KiE-së dhe OKB-së janë shumë të ngjashme në këtë pikë; Konventa e Varshavës përfshin përkufizime të marra nga instrumentet e mëparshme të OKB-së, KiE-s dhe BE-së. Këtë model hartuesit (shih Raportin Shpjegues, l. 12 dhe shpjegimet për Nenin 9 të Konventës së Varshavës) e përdorin për disa tematika të tjera që do të analizohen më tej. Në përputhje me këtë, Neni 6 i UNTOC-it (Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar) ose Konventa e Palermos e vitit 2000, si dhe Neni 23 i UNCAC-it (Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit), ose Konventa e Meridës, 2003, janë marrë në konsideratë për Konventën e Varshavës.

c) Direktivat e BE-së

Bashkimi Evropian (BE) ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave. Ndonëse kudri ligjor parandalues i miratuar nga BE-ja nuk është objekt i këtij manuali, duhet përmendur se nga Direktiva e Këshillit 91/308/KEE, e datës 10 qershor 1991, deri në Direktivën 2018/843 (BE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 30 maj 2018, që ndryshon Direktivën 2015/849 (BE) (në fuqi, këtu e më poshtë referuar si AMLD), koncepti i pastrimit të parave, veprat penale të përfshira në të dhe profesionet e prekura u plotësuan më tej ndërkohë që u bënë përpjekje për parandalimin e veprimeve të mundshme të pastrimit të parave; për identifikimin dhe verifikimin e klientit; për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrim parash ose financim terrorizmi, për rritjen e transparencës përmes hapjes së regjistrimit të pronarëve përfitues; për zgjerimin e kompetencave të Njësive të Inteligjencës Financiare të

11. Konventa e Varshavës 2005, neni 12:

1. *“çdo palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme për krijimin e NjIF-ve siç parashikohet në këtë Konventë.*

2 *Çdo Palë do të marrë ato masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të siguruar që Njësia e saj e Inteligjencës Financiare të ketë të drejtë, drejtpërdrejt ose jo mbi bazë kohore, të marrë informacione financiare, administrative dhe për zbatimin e ligjit që i nevojitet për të kryer si duhet funksionet e saj, përfshirë analizën e raporteve të transaksioneve të dyshimta.”*

BE-së (FIU), duke i siguruar akses në informacionin e plotë të nevojshëm për përmbushjen e detyrave; për kufizimin e anonimitetit lidhur me valutat virtuale dhe ofruesit e portofoleve virtuale, por edhe për kartat me parapagesë; për shtimin e kriterëve për vlerësimin e vendeve të treta me rrezik të lartë dhe përmirësimin e masave mbrojtëse lidhur me transaksionet financiare në dhe nga këto vende; për hapjen e regjistrave të llogarive në bankat qendrore, ose ngritjen e sistemeve të rekuperimit në të gjitha Shtetet Anëtare; për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet mbikëqyrësve kundër pastrimit të parave, ndërmjet tyre dhe mbikëqyrësve kujdesëshëm dhe Bankës Qendrore Evropiane, dhe së fundi por mjaft e rëndësishme; për renditjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të gamës së veprave që lidhen me veprimtaritë e pastrimit të parave¹².

Në aspektin penal, Neni 3 i Direktivës 2018/1673 (BE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 tetor 2018, për luftën kundër pastrimit të parave nëpërmjet legjislacionit penal (këtu e më poshtë referuar si AMLCLD), përcakton një përkufizim shumë të ngjashëm me atë të konventave të analizuara e të përmendura më sipër. Gjithsesi, ai përfshin vetëm disa ndryshime të vogla në stil, dispozitë dhe strukturë.

d) E Drejta Penale e Brendshme (vendase)

Neni 122 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon disa parime kryesore të integritetit të së drejtës ndërkombëtare në sistemin e brendshëm ligjor kombëtar si më poshtë:

- a) Marrëveshjet ndërkombëtare zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.
- b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi-mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to.

Në këtë kontekst, përcaktimet e akteve ndërkombëtare duhet të ndiqen dhe zbatohen nga legjislacioni i brendshëm material dhe aktet nënligjore qoftë në kuptimin por dhe interpretimin e tyre. Për këtë arsye, analiza e konceptit dhe e elementeve të veprave penale të pastrimit të parave, bazuar në instrumentet kryesore ndërkombëtare, përbën pjesë thelbësore të këtij manuali.

Sidoqoftë, dispozitat e nenit 287 të Kodit Penal i ndryshuar¹³, për pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, janë në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj. Në paragrafin e parë të kësaj dispozite përcaktohet se:

Format e kryerjes së veprës penale të pastrimit të parave janë:

- a) këmbimi ose transferimi i pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehja ose mbulimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- c) fitimi i pronësisë, posedimi ose përdorimi i i pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

12. Lista e plotë e Direktivave që lidhen me sistemin parandalues janë: Direktiva e Këshillit 91/308/KEE e datës 10 qershor 1991 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave, Direktiva 2001/97/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 4 dhjetor 2001, Direktiva 2001/97/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 4 dhjetor 2001, Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 26 tetor 2005 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Direktiva (BE) 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, Direktiva (BE) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit

13. Ndryshuar me ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003, neni 8; germa "dh" shtuar me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, neni 24; shkronja "a" pika 1, e ndryshuar; shkronja "ç" shfuqizuar me ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007, neni 24; ndryshuar me Ligjin nr.23/2012, neni 37; pjesa që parashikon gjobë si dënim kryesor përveç burgimit, shfuqizohet me ligjin nr.144, datë 02.05.2013, neni 48).

- c) kryerja e veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;*
- d) investimi në veprimtari ekonomike ose financiare i parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;*
- dh) këshillimi, ndihma, nxitja ose thirrja publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër.*

Siç mund të nënkuptohet, germat a), b) dhe c) të këtij neni përputhen përkatësisht me formulimin e pikave a) i), a) ii) dhe b) i) të dispozitave të lartpërmendura të Konventave të OKB-së dhe pikave a) , b) dhe c) të nenit 9.1 të Konventave të KiE, ndërsa germa dh) përputhet me parashikimin e pikës b) ii) të Konventave të OKB-së dhe pikës d) të dispozitave korresponduese të Konventave të KiE-së.

Nga ana tjetër, janë bërë disa shtesa: në germën c) është kriminalizuar kryerja e veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien e raportimit sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; në germën d) dënohen veprimet e investimit të parave apo sendeve, duke ditur që janë produkte të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale.

B) KONCEPTI I VEPRËS PENALE KRYESORE (MËMË)

Vepër penale mëmë është çdo vepër që prodhon përfitim monetar ose pasuror. Qasja ndaj veprës penale me mëmë në dispozitat ligjore të analizuara më sipër ka bazë të përbashkët, por nuanca të ndryshme, veçanërisht lidhur me shkallën e natyrës së veprës penale mëmë, me disa mundësi. Sipas shënimit interpretues të Rekomandimit Nr. 3 të FATF-së (Kriminalizimi i Pastrimit të Parave), 'veprat mëmë mund të përshkruhen duke iu referuar të gjitha veprave penale; ose një pragu që lidhet me një kategori veprash të rënda, ose masës së dënimit me burgim me të cilën dënohet vepra penale mëmë (qasja e pragut); ose një liste veprash penale mëmë; ose një kombinimi të këtyre qasjeve.'

Sa i përket konceptit të veprës penale mëmë, Neni 1 i Konventës së Varshavës përcakton se "vepra mëmë" është çdo vepër penale si rezultat i së cilës krijohen të ardhura që mund të bëhen objekt i veprës penale të pastrimit të parave, sipas përcaktimeve të Nenit 9 të Konventës.

Në lidhje me veprat mëmë, Konventa e Palermos dhe Meridës në nenet 6.2.a) dhe 23.2.a) përcakton përkatësisht, se çdo Shtet Palë rreket ta lidhë veprën penale të pastrimit të parave me gamën më të gjerë të mundshme të veprave penale mëmë.

Në mënyrë të ngjashme, sipas Rekomandimit Nr. 3 të FATF-së, "vendet duhet të lidhin veprën e pastrimit të parave me të gjitha krimet e rënda, me synim përfshirjen e sa më shumë veprave mëmë".

AMLCLD në nenin 2 përcakton dy kritere për të identifikuar veprimtarinë kriminale mëmë: një prag minimal dënimi si dhe një listë veprash penale¹⁴, por po ashtu në Recitalin 5 krijon hapësirë për zgjerimin

14. Sipas Nenit 2, AMLCLD "veprimtari kriminale" nënkupton çdo lloj përfshirje kriminale në kryerjen e çdo vepre të dënueshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, me heqje lirie ose me urdhër ndalimi për një maksimum më shumë se një vit ose, si ka të bëjë me shtetet anëtare që kanë një prag minimal për shkelje në sistemet e tyre ligjore, çdo vepër të dënueshme me heqje lirie ose një urdhër ndalimi për një minimum prej më shumë se gjashtë muaj. Në çdo rast, veprat e kategorive të mëposhtme konsiderohen si veprimtari kriminale:

- (a) pjesëmarrja në grup të organizuar kriminal dhe shantazhi, duke përfshirë çdo vepër të përcaktuar në Vendimin Kuadër 2008/841/JHA;
- (b) terrorizmin, duke përfshirë çdo vepër penale të përcaktuar në Direktivën (BE) 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- (c) trafikimi i genieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Direktivën 2011/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (10) dhe në Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/946/JHA);
- (d) shfrytëzimi seksual, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Direktivën 2011/93/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

e objektit, kur thekson se veprat penale mëmë të përcaktuara nga Shtetet Anëtare duhet të konsiderohen si veprimtari kriminale duke u nisur nga qëllimet e Direktivës.

Megjantëse Kodi Penal nuk ka dispozitë të veçantë për çfarë përbën vepër penale mëmë në kontekstin e hetimeve të pastrimit të parave, nënkuptohet se të gjitha veprat penale mund të konsiderohen si vepër penale mëmë kur bëhet fjalë për veprën e pastrimit të parave.

C) NUK KA NEVOJË PËR DËNIM TË MËPARSHËM

Konventa e Varshavës përcakton një sistem në të cilin vepra penale mëmë nuk ka nevojë të jetë objekt dënimi. Vlerësohet se nevoja për dënim të tillë shpesh pengon ndjekjen penale të krimit si vepër autonome, veçanërisht pastrimin e produkteve të veprës penale nga palët e treta për llogari të të tjerëve.

Kjo është arsyeja që neni 9 i Konventës rregullon këtë aspekt duke përcaktuar:

- “5. Çdo Palë siguron që dënimi i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale mëmë nuk përbën parakusht për dënimin për pastrim parash.*
- 6. Secial Palë garantojë që dënimi për pastrim parash sipas këtij neni është i mundshëm, nëse vërtetohet që një pasuri, objekt i paragrafit 1.a ose b të këtij neni, e ka origjinën nga një vepër penale mëmë, pa qenë e nevojshme të përcaktohet saktësisht se cila vepër penale.”*

Recitali 12 i AMLCLD-së mban qëndrim të ngjashëm duke përcaktuar se me qëllim efektshmërinë kundër pastrimit të parave, dënimi duhet të jetë i mundur pa nevojën e dënimit paraprak ose të njëkohshëm për veprën penale mëmë, ndërsa në Nenin 3.3 përcakton që Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

- a) dënimi paraprak ose i njëkohshëm për veprimtarinë kriminale nga e cila vjen pasuria nuk është parakusht për dënimin për veprat e përmendura në pikat 1 dhe 2;*
- b) dënimi për veprat e përmendura në pikat 1 dhe 2 është i mundur kur vërtetohet se pasuria ka ardhur nga një veprimtari kriminale, pa qenë e nevojshme të vërtetohen të gjitha elementet faktike ose të gjitha rrethanat që lidhen me atë veprimtari kriminale, duke përfshirë identitetin e autorit;*

(e) trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe substancave psikotrope, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/757/JHA;

(f) trafiku i paligjshëm i armëve;

(g) trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera;

(h) korrupsioni, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Konventën për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian) dhe në Vendimin Kuadër të Këshillit 2003/568/JHA;

(i) mashtrimi, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/413/JHA;

(j) falsifikimi i monedhës, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Direktivën 2014/62/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

(k) falsifikimi dhe pirateria e produkteve;

(l) krimin mjedisor, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ose në Direktivën 2009/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

(m) vrasje, lëndim i rëndë trupor;

(n) rrëmbimi, kufizimi i paligjshëm dhe marrja e pengjeve;

(o) grabitje ose vjedhje;

(p) kontrabanda;

(q) krimet tatimore në lidhje me tatimet direkte dhe indirekte, siç përcaktohet në legjislacionin kombëtar;

(r) zhvatje;

(s) falsifikim;

(t) pirateria;

(u) tregtimin e brendshëm dhe manipulimin e tregut, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Direktivën 2014/57/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

(v) krimi kibernetik, duke përfshirë çdo shkelje të përcaktuar në Direktivën 2013/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit [21].

Kjo do të thotë se në përputhje me këtë Direktivë:

- Nuk ka nevojë për dënim me vendim gjyqësor të formës prerë për veprimtarinë kriminale nga e cila janë krijuar pasuritë subjekt i veprimtarisë së pastrimit
- Nuk është e nevojshme të përcaktohen të gjitha faktet që kanë të bëjnë me këtë veprimtari kriminale;
- Nuk është e nevojshme të identifikohet autori;

Ky nen ul standardet e provave të nevojshme kur bëhet fjalë për veprën penale kryesore/mëmë¹⁵. Problemet lidhur me provat e nevojshme do të trajtohen më tej në kapitullin IV.

Për sa i përket qasjes së legjislacionit të brendshëm, siç u përmend më lart, në kuadrin e standardeve ndërkombëtare Shqipëria ka ratifikuar dhe zbatuar disa marrëveshje ndërkombëtare të cilat janë pasqyruar në kuadrin ligjor penal.¹⁶ Në fakt, Neni 287, KP, paragrafi i dytë, parashikon se vepra penale e pastrimit të parave gjen zbatim edhe kur:

- a) vepra kryesore është kryer nga një person që nuk mund të ndiqet penalisht si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;*
- b) ndjekja penale për veprën kryesore është parashkruar ose është amnistuar;*
(...)
- ç) nuk ka filluar asnjëherë ndjekje penale ose nuk është caktuar dënim me vendim penal të formës së prerë për veprën kryesore;*

D) EKSTRATERRITORIALITETI

Për më tepër, germa d) e nenit 287.2 të Kodit Penal parashikon se veprat penale të pastrimit të parave dënohen edhe kur “vepra kryesore është kryer nga një person, pavarësisht nga shtetësia e tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është gjithashtu, e dënueshme si në shtetin e huaj ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.”

E njëjta dispozitë mund të gjendet në Konventat e Palermos, Meridës dhe Varshavës¹⁷, si dhe në AMLCLD, të cilat mund të shihen në tabelën përmbledhëse në fund të këtij kapitulli.

15. Recitali 12, AMLCLD: “Në mënyrë që masat e ligjit penal të jenë efektive kundër pastrimit të parave, një dënim duhet të jetë i mundur pa qenë e nevojshme të përcaktohet saktësisht se cili aktivitet kriminal ka krijuar pasurinë, ose që të ketë një dënim paraprak ose i njëkohshëm për atë veprimtari kriminale, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat përkatëse. Duhet të jetë e mundur që Shtetet Anëtare, në përputhje me sistemet e tyre ligjore kombëtare, ta sigurojnë këtë me mjete të ndryshme nga legjislacioni. Ndjekjet penale për pastrim parash nuk duhet të pengohen gjithashtu nga fakti që veprimtaria kriminale është kryer në një shtet tjetër anëtar ose në një vend të tretë, në varësi të kushteve të përcaktuara në këtë direktivë.”

16. Shihni listën e të gjitha dokumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, të cilat lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me luftën kundër pastrimit të parave, duke përfshirë faqen zyrtare të PP në seksionin “Instrumentet shumëpalëshe”, në adresën: https://www.pp.gov.al/Bashkepunime/Instrumentet_Shumepaleshe/ Lista përfshin gjithashtu dokumente kyçe si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, 1988, ratifikuar me Ligjin nr. 8920 datë 11.7.2002 [këtu dhe pas “Konventës së KB”]; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, 2000, ratifikuar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002 [këtu dhe pas “Konventës së Palermos”]; Konventa e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit, ratifikuar me ligjin nr.8646, datë 20.7.2000 [këtu dhe pas “Konventës së Strasburgut”]; Konventa e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale dhe për financimin e terrorizmit, 2005, ratifikuar me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006 [këtu dhe pas “Konventës së Varshavës”]. Duhet theksuar se ka ngjashmëri të nenit 287 të Kodit Penal me Direktivat e BE-së kundër Pastrimit të Parave.

17. Konventa e Varshavës e vitit 2005, neni 9.2: “a) Për qëllime të zbatimit ose zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni: a nuk ka rëndësi nëse vepra kryesore i ishte nënshtruar juridiksionit penal të Palës”.

3.

Ana subjektive e veprës penale

Përkufizimi dhe shtrirja e konceptit të anës subjektive dhe qëllimit të veprës penale është aspekt thelbësor i pastrimit të parave. Vepra penale e pastrimit të parave bazohet në vepër penale ose veprimtari kriminale mëmë, produkti i së cilës duhet të duket sikur ka origjinë të ligjshme dhe nga këndvështrimi subjektiv i pastrimit të parave autori duhet të ketë dijeni për këtë origjinë, pa pasur nevojë të ketë njohuri të plotë të veprës penale mëmë. Mjafton që autori të jetë i vetëdijshëm për anomalinë e veprimeve të tij dhe të arrijë në përfundimin e arsyeshëm që këto pasuri vijnë, nga veprimtari të paligjshme që përbëjnë vepër penale. Prandaj, subjekti mund të jetë i sigurt për origjinën kriminale të pasurive (dashje e drejtpërdrejtë '*dolus directus*') ose thjesht në dijeni që kjo pasuri ka shumë gjasa të jetë produkt nga burim i paligjshëm (dashje eventuale '*dolus eventualis*'). Kryerja e kësaj vepre penale nga pakujdesia parashikohet nga instrumentet ligjore ndërkombëtare (Konventa e Varshavës dhe AMLCLD). Në këtë seksion do të analizohet përkufizimi i anës subjektive dhe i qëllimit të përcaktuar në instrumente ligjore të ndryshme ndërkombëtare, ndërsa një qasje më praktike në lidhje me hetimin e kësaj vepre penale do të shqyrtohet në Kapitullin IV, duke u përqendruar në çështjet e provueshmërisë.

A) AKTET NDËRKOMBËTARE

Konventa e Varshavës përcakton në nenin 9.2 se për qëllimin e zbatimit të nenit 9.1 (elementet e veprës penale të pastrimit të parave), "dijenia/njohuria, qëllimi ose qëllimi i kërkuar si element i një vepre penale të përcaktuar në atë paragraf mund të nxirret nga rrethanat objektive, faktike". Më pas, në paragrafin 3 përcaktohet se " *Çdo Palë mund të marrë masat ligjore dhe të tjera të nevojshme për të klasifikuar si vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, të gjitha ose disa prej veprave (të pastrimit të parave)[...], në njërin ose në të dy rastet e mëposhtme, kur autori: a) dyshonte se pasuria ishte produkt i kriminit; b) duhet të kishte supozuar se pasuria ishte produkt i kriminit.*"

B) LEGJISLACIONI I BE-SË

Direktiva (BE) 2018/1673, në paragrafin (13) në lidhje me qëllimin dhe/ose dijeninë/njohurinë, përcakton qasje të zgjeruar duke parashikuar se vepra penale konsiderohet e kryer jo vetëm kur ajo është e qëllimshme, por edhe kur autori ka dijeni se pasuria është produkt i veprimtarisë kriminale, sipas përkufizimit të të ardhurave kriminale të parashikuara në Direktivën 2014/42/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian. Në të dyja rastet, ndër elemente të tjera të rrethanave objektive të faktit duhet

evidentuar se vlera e pasurive të personit në fjalë është joproportionale krahasuar me të ardhurat e tij, ose coincidenca në kohë midis veprimtarisë kriminale dhe pasurisë së përfutur. Po kështu, parashikohet se u takon shteteve anëtare të përcaktojnë si vepër penale kryerjen nga pakujdesia ose nga pakujdesia e rëndë. Kjo përcaktohet në nenin 3.2:

“Shtetet anëtare mund të marrin masat e nevojshme për të siguruar që sjellja e përmendur në paragrafin 1 të dënohet si vepër penale kur shkelësi dyshohet ose duhet të dinte se prona rrjedh nga veprimtaria kriminale.”

4.

Subjekti (Autori) i veprave penale të pastrimit të parave

Veprat e pastrimit të parave mund të kryhen nga çdo person, përfshirë edhe atë që ka kryer veprën kryesore, fomë e cila njihet si vetë-pastrim.

Një tjetër aspekt në lidhje me subjektet e kësaj vepre penale janë personat (fizik ose juridik) që i nënshtrohen nenit 3 të ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 'Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit' (**këtu e më poshtë "PPPFT"**) (për shembull, duhet të raportojnë transaksione të dyshimta) dhe që për rrjedhojë janë veçanërisht të ekspozuar ndaj kryerjes së veprave të tilla. Këta persona njihen në politikat kundër pastrimit të parave dhe veçanërisht në kuadrin ligjor të BE-së si "subjekte të detyruara". Në gjuhën bisedore, ata njihen si "mundësues profesionistë".

Në veçanti, duhet të merret parasysh roli i veçantë i avokatëve.

Gjithashtu, është i rëndësishëm edhe roli i personave të tjerë juridikë të parashikuar në Nenin 3 të PPPFT-së më sipër dhe rrjedhimisht përgjegjësia penale e tyre si subjekte të veprave të pastrimit të parave.

A) VETËPASTRIMI I PARAVE

Vetëpastrimi i parave i referohet faktit se produktet e veprës penale mund të pastrohen nga vetë personi që ka kryer ose që është përfshirë disi në veprën penale kryesore/mëmë. Kjo çështje e diskutueshme lidhet ngushtësisht me autonominë e veprës penale të pastrimit të parave. Dikush mund të mendojë se meqenëse pastrimi i parave është veprim që synon të fshehë kryerjen e një vepre penale mëmë, vetëpastrimi i parave nuk mund të ndëshkohet, pasi fshehja e krimit të kryer nga vetë personi nuk është e ndëshkueshme. Për më tepër, sipas një qasje tjetër parimi '*non bis in idem*' duhet ta përjashtojë vetëpastrimin e parave, sepse është pasojë e natyrshme dhe logjike e veprës penale mëmë.

Kjo mund të jetë arsyeja përse kriminalizimi i vetëpastrimit të parave sipas Nenit 9.2.c) të Konventës së Varshavës, është lënë në zgjedhjen e vendeve. Në mënyrë të ngjashme, sipas Nenit 6.2.e) të UNTOC-it dhe Nenit 23.2.e) të UNCAC, nënvizohet se "*nëse kërkohet nga parimet themelore të legjislacionit kombëtar të Shtetit Palë, mund të parashikohet që veprapenale [e pastrimit të parave] të mos gjejë zbatim për personat që kanë kryer veprë penale mëmë*".

Megjithatë, parimi i '*non bis in idem*' ose ndalimi i dënimit të dyfishtë nuk e ndalon kriminalizimin e vetëpastrimit të parave, duke qënë se pastrimi i parave duhet konsideruar si vepër penale autonome e ndryshme nga çdo

vepër tjetër mëmë, në natyrë dhe efekt. Në fakt, ndonëse vepra penale mëmë është akt i thjeshtë statik dhe i menjëhershëm, pastrimi i parave është fenomen dinamik, që përfshin faza dhe forma të ndryshme që zhvillohen me kalimin e kohës. Nga ana tjetër, pastrimi i parave nënkupton veprime të përsëritura të cilat janë të veçanta nga veprat penale që krijojnë produktin e veprës penale (vepra penale mëmë).

Krahas kësaj, në legjislationin e BE-së, kriminalizimi i vetëpastrimit është i detyrueshëm në çështjet e transformimit ose transferimit të pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin origjinës së paligjshme të pasurisë ose për të ndihmuar subjektin e përfshirë në kryerjen e një veprimtarie që synon shmangien e pasojave ligjore të veprimeve të atij subjekti; dhe në çështjet e fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë. Përkundrazi, vetëpastrimi i parave nuk është i ndëshkueshëm në çështjet e përvetësimit, posedimit ose përdorimit të pasurisë produkt i veprimtarisë kriminale.¹⁸

Në legjislationin e brendshëm, vetëpastrimi i parave parashikohet shprehimisht në Nenin 287 të Kodit Penal, sipas të cilit pastrimi i parave duhet ndëshkuar edhe kur *"personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet"*.

B) ROLI I DISA PROFESIONISTËVE

Neni 2.1.3.b) i AMLD¹⁹ përcakton, ndër të tjera, si subjekte të detyruara "profesionistët e pavarur juridikë, kur ata marrin pjesë, qoftë kur veprojnë në emër dhe për klientin e tyre në çdo transaksion financiar ose të pasurive të paluajtshme, ose kur ndihmojnë në planifikimin ose kryerjen e transaksioneve për klientin e tyre në lidhje me:

- (i) blerjen dhe shitjen e pronave të paluajtshme ose të subjekteve të biznesit;
- (ii) menaxhimin e vlerave monetare, letrave me vlerë ose aktiveve të tjera të klientit;
- (iii) hapjen ose menaxhimin e llogarive bankare, të kursimeve ose të letrave me vlerë;
- (iv) organizimin e kontributeve të nevojshme për themelimin, funksionimin ose menaxhimin e shoqërive;
- "(v) krijimin, funksionimin ose administrimin e trusteve, shoqërive tregtare, fondacioneve ose strukturave të ngjashme."

Për më tepër, AMLCLD përcakton si rrethanë rënduese faktin se "autori është subjekt i detyruar [...] dhe ka kryer veprën penale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale" (neni 6.1.b)).

Po kështu, Neni 287 i Kodit Penal e vlerëson si rrethanë rënduese, ndër të tjera, faktin që vepra e pastrimit të parave është kryer gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale.

C) AVOKATËT DHE PASTRIMI I PARAVE

Paragrafi 9 i AMLD thekson nevojën për të bërë dallimin midis këshillimit ligjor dhe pjesëmarrjes së avokatit në transaksione financiare ose të shoqërive tregtare, duke deklaruar se "profesionistët juridikë, të përcaktuar nga Shtetet Anëtare, duhet të jenë subjekt i dispozitave të Direktivës kur marrin pjesë në

18. Neni 3 i Direktivës së BE-së 2015/849

19. Shih Nenin 3 (gj) APLMFT.

transaksione financiare ose të shoqërive tregtare, përfshirë edhe këshillimin tatimor, ku ka më tepër rrezik që shërbimet e këtyre profesionistëve juridikë të keqpërdoren me qëllim pastrimin e produkteve të veprimtarisë kriminale ose financimin e terrorizmit. Duhet të ketë përjashtime nga çdo detyrim për të raportuar informacionet e marra përpara, gjatë ose pas proceseve gjyqësore, ose gjatë mbrojtjes së pozicionit juridik të klientit. Për këto arsye, këshillimi juridik duhet të mbetet subjekt i detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, përveç se kur profesionisti ligjor merr pjesë në pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, kur këshillimi juridik ofrohet me qëllim pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, ose kur profesionisti juridik e di se klienti po kërkon këshillim juridik me qëllim pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.

Megjithatë, kufiri midis dy veprimtarive (mbrojtja në procedime penale dhe këshillimi në veprimet financiare) nuk është gjithmonë i qartë, ashtu sikurse nuk është i qartë edhe kufiri midis detyrimit për të raportuar transaksionet e dyshimta dhe detyrimit për të ruajtur sekretin profesional në marrëdhëniet avokat-klient, veçanërisht duke pasur parasysh se sekretin profesional i avokatëve njihet nga Kushtetuta (neni 28) dhe legjisllacioni i brendshëm.²⁰ Kështu për shembull sekretin profesional i avokatëve mbrohet shprehimisht nga neni 159.1.b) i KPP-së, i cili parashikon se “avokatët nuk janë të detyruar të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t’i raportojnë autoriteteve proceduese”.

Mund të duket sikur bashkëpunimi me drejtësinë, sidomos detyrimi për të raportuar veprimtari të dyshimta, është shkelje e sekretit profesional. Megjithatë, ka kufizime edhe për këtë detyrim, të cilat justifikohen me arritjen e objektivit madhor të parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar. Për më tepër, avokatët kanë edhe detyrimin të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe luftuar krimin. Kështu, avokatët nuk janë të legjitimuar të këshillojnë rreth mënyrës se si të kryhet vepra penale e pastrimit të parave, ndonëse kryerja e një vepre të tillë mund ta vështirësojë edhe më tej provimin e kryerjes së një vepre penale mëmë, dhe rrjedhimisht të lehtësojë mbrojtjen e klientit.

Marrëdhënia midis avokatit dhe klientit në kuadër të hetimeve për pastrimin e parave është analizuar në disa vendime të GjEDNJ-së, si p.sh. në çështjen *Michaud kundër Francës* (Gjykimi Nr. 12323/11) ose *Särgava kundër Estonisë* (Çështja Nr. 698/19), përmendur më poshtë.

Në çështjen *Michaud kundër Francës*, Gjykata deklaroi se “detyrimi i avokatëve për të raportuar dyshimet në lidhje me veprimtaritë e pastrimit të parave nuk ndërhyt në mënyrë disproporcionale në privilegjin profesional.” Megjithatë, në çështjen *Särgava kundër Estonisë*, sipas mendimit të Gjykatës, mungesa e garancive procedurale, që kanë të bëjnë veçanërisht me mbrojtjen e privilegjit profesional juridik, nuk përmbushte kërkesat që buronin nga kriteri se ndërhyrja duhet të jetë në përputhje me ligjin.

Së fundi, në paragrafët [39] dhe [40] të AMLD parashikohet se “në përputhje me praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, sistemi i raportimit që fillon në shkallë të parë në organin vetërregullues është një prej garancive më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave themelore për sa u përket detyrimeve për të raportuar që zbatohen për avokatët. Shtetet Anëtare duhet të ofrojnë mjetet dhe mënyrat me të cilat do të arrihet mbrojtja e sekretit profesional, konfidencialiteti dhe privatësia. Kur vendos të caktojë një organ vetërregullues të tillë, Shteti Anëtar mund të lejojë ose kërkojë që organi të mos i japë NjIF-së informacione që janë marrë nga personat e përfaqësuar nga organi prej të cilit është marrë apo siguruar ky informacion nga një prej klientëve, gjatë mbrojtjes së pozicionit juridik të klientit, ose gjatë kryerjes së detyrës së mbrojtjes ose përfaqësimit të atij klienti në ose lidhur me procese gjyqësore, përfshirë edhe ofrimin e këshillimit për nisjen ose shmangien e këtyre proceseve, pavarësisht nëse ky informacion është përfutur ose siguruar përpara, gjatë ose pas këtyre proceseve”.

20. Ligji Nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

D) PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIK

a) Konventat e OKB-së

Nenet 10 dhe 26 të Konventave UNTOC dhe UNCAC përkatësisht, përcaktojnë se personat juridikë, pa paragjykuar përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprat penale, duhet të jenë përgjegjës për pjesëmarrjen e tyre në pastrimin e parave, por kjo përgjegjësi mund të jetë penale, civile, ose administrative. Në çdo rast, personat juridikë të përfshirë në veprimtari të pastrimit të parave duhet t'i nënshtrohen sanksioneve penale ose jopenale të efektshme, proporcionale dhe bindëse, përfshirë sanksionet monetare.

b) Konventat e KiE

Në mënyrë më përshkruese, neni 10 i Konventës së Varshavës, nën titullin "Përgjegjësia e Personave Juridik", parashikon:

1. Çdo Palë miraton masa ligjore dhe masa të tjera sipas nevojës, për të siguruar që një person juridik të mund konsiderohet përgjegjës për veprën penale të pastrimit të parave të përcaktuar sipas kësaj Konvente, të kryer me qëllim përfitimi nga një person fizik, duke vepruar individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik që ka pozicion drejtues brenda këtij personi juridik, bazuar në:

- a) prokurë nga personi juridik;*
- b) autoritet që merr vendime në emër të personit juridik; dhe*
- c) autoritet që ushtron kontroll brenda personit juridik.*

- 2. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1, çdo Palë merr masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik të mund të konsiderohet përgjegjës, kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga personi fizik referuar në pikën 1, ka bërë të mundur kryerjen e veprës penale të përcaktuar sipas pikës 1, për përfitim të atij personi juridik nga personi fizik që vepron nën autoritetin e tij.*
- 3. Kjo përgjegjësi e përcaktuar në këtë nen nuk përjashton procedimet penale kundër personave fizikë që kanë kryer, nxitur apo ndihmuar në kryerjen e veprave penale referuar në pikën 1.*
- 4. Çdo Palë siguron që personat juridikë që përgjigjen në përputhje me këtë nen janë objekt i sanksioneve ligjore të efektshme, proporcionale, penale ose jopenale, përfshirë dhe sanksionet financiare, me qëllim dhënien fund të veprimtarisë së paligjshme.*

c) Legjislacioni i BE-së

Sipas legjislacionit të BE-së, "person juridik" është çdo subjekt që ka personalitet juridik sipas legjislacionit në fuqi, përveç shteteve ose organeve publike që ushtrojnë autoritet shtetëror dhe organizatave publike ndërkombëtare.²¹

Sipas Neni 7 të AMLCLD, Shtetet Anëtare janë të detyruara "të sigurohen që personat juridikë mbajnë përgjegjësi për çdo vepër penale të pastrimit të parave të kryer në dobi të tyre nga çdo person, që vepron individualisht, ose si pjesë e një organi të personit juridik dhe që mban pozicion drejtues pranë personit juridik, bazuar në sa më poshtë:

21. Neni 2 (3) i Direktivës së BE-së, 2018/1673 ose AMLCLD

- a) tagër përfaqësimi të personit juridik;
- b) autoritet për të marrë vendime në emër të personit juridik; ose
- c) autoritet për të ushtruar kontroll pranë atij personi juridik.

Për më tepër, personat juridikë mund të mbajnë përgjegjësi “kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person i përcaktuar në pikën më lart ka bërë të mundur kryerjen e një prej veprave penale [të pastrimit të parave] në dobi të atij personi juridik nga një person nën autoritetin e tij”.

Së fundi, “përgjegjësia e personave juridikë [...] nuk e përjashton mundësinë e fillimit të procedimit penal kundër personave fizikë që janë autorë, nxitës ose ndihmës në vepra penale [të pastrimit të parave]”.²²

d) Legjislacioni i Brendshëm

Sipas legjislacionit të brendshëm personat juridikë janë gjithashtu subjekt i ligjit. Sipas nenit 45 të Kodit Penal:

“personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre”.

“Njësitë e qeverisjes vendore mbajnë përgjegjësi penale për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre që mund të ushtrohet duke deleguar shërbime publike.

“Përgjegjësia penale e subjekteve juridike nuk e përjashton atë të personave fizikë që kanë kryer vepra penale ose që janë bashkëpunëtorë në kryerjen e veprave penale të njëjta.

“Veprat penale dhe masat përkatëse ndëshkimore të marra kundër subjekteve ligjore, si dhe procedurat për marrjen dhe zbatimin e këtyre masave rregullohen me ligj të posaçëm”.

Kjo dispozitë gjendet në ligjin nr. 9754, datë 14 korrik 2007, “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë”.

Në përputhje me nenin 3, “personi juridik” ka përgjegjësi për vepra penale të kryera:

- a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;
- b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;
- c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik”.

Sipas nenit 2, dispozitat e ligjit zbatohen edhe ndaj personave juridikë të huaj. Për më tepër, sipas neneve 5, 6 dhe 7, përgjegjësia vijon edhe në rast se ka ndryshim të statusit ligjor, formës ose shndërrimit të personit juridik, ose bashkim të personave juridikë, edhe nëpërmjet përthithjes ose ndarjes së personit juridik.

22. Neni 7 (3) i Direktivës së BE-së 2018/1673 ose AMLCLD

ELEMENTËT THELBËSORË TË VEPRËS PENALE TË PASTRIMIT TË PARAVE

STANDARTET NDËRKOMBËTARE			LEGJISLACIONI I BRENDSHËM
KOMBET E BASHKUARA	KËSHILLI I EVROPËS	BASHKIMI EVROPIAN	KODI PENAL
Neni 6 i Konventës kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC ose Konventa e Palermos) & neni 23 i Konventës Kundër Korrupsionit (Konventa UNCAC OSE Mérida-s)	Neni 9 i Konventës (nr. 198) për pastrimin, kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale, datë 16.05.2005 (Konventa e Varshavës)	Neni 3 i Direktivës (BE) 2018/1673 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 23 tetor 2018, për luftën kundër pastrimit të parave sipas legjislacionit penal.	Neni 287
PËRKUFIZIMI I PASTRIMIT TË PARAVE			
<p>1: Konsiderohet Pastrim parash kur vepra penale kryhet në mënyrë të qëllimshme:</p> <p>kur kryhen në mënyrë të qëllimshme:</p> <p>a) (i) shkëmbimi ose transferimi i pasurisë, duke ditur që kjo pasuri e vjen nga krimi, me qëllim që të fshihet ose mbulohet origjina e paligjshme e saj ose dhënia e ndihmës një personi, i cili është përfshirë në kryerjen e veprës penale mëmë për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimit tij/saj;</p> <p>(ii) fshehja ose mbulimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pronësinë, duke ditur që kjo pasuri vjen nga krimi;</p> <p>b) duke iu nënshtruar koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor: (i) fitimin, posedimin ose përdorimin e pasurisë, duke ditur në kohën e marrjes në dorëzim që kjo pasuri vjen nga krimi; (ii) pjesëmarrjen, shoqërimin ose komplotimin për të kryer, tentativat për të kryer dhe dhënien e ndihmës, përkrahjen, lehtësimin dhe dhënien e këshillave për kryerjen e çdonjëres prej veprave penale të cilësuar si të tilla në përputhje me këtë nen.</p>	<p>1: Vepra penale të Pastrimit të Parave janë veprat në të cilat akti është kryer me qëllimin për:</p> <p>a) kthimin ose transferimin e pasurive, me dijeninë që kjo pasuri përbën produkt, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurive të tilla ose që ndihmon çdo person të përfshirë në kryerjen e veprës penale mëmë, për t'iu shpëtuar pasojave ligjore të akteve të veta;</p> <p>b) fshehjen ose maskimin e natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë së vërtetë të pasurive ose të drejtave në lidhje me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte; dhe, objekt i parimeve kushtetuese dhe koncepteve themelore të sistemit juridik të vet;</p> <p>c) përvetësimin, mbajtjen ose përdorimin e pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor, është në dijeni, në kohën kur i merr, se ato përbëjnë të ardhura;</p> <p>d) pjesëmarrjen në mënyrë të organizuar ose në bashkëpunim për kryerjen, tentativën për të kryer dhe ndihmën ose këshillave për kryerjen e një prej veprave penale të treguara në përputhje me këtë nen.</p>	<p>1: Veprat penale të pastrimit të parave konsiderohen ato të cilat kryhen me dashje:</p> <p>a) konvertimi ose transferimi i pasurisë, duke ditur se kjo pasuri rrjedh nga veprimtari kriminale, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë ose për të ndihmuar çdo person që është i përfshirë në kryerjen e një veprimtarie të tillë për t'iu shmangur pasojave juridike të veprimit të atij personi;</p> <p>b) fshehja ose maskimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave në lidhje me ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se kjo pronë rrjedh nga veprimtari kriminale;</p> <p>c) fitimi, posedimi ose përdorimi i pasurisë, duke ditur në momentin e marrjes se kjo pasuri rrjedh nga veprimtari kriminale.</p> <p>Përveç kësaj, sipas nenit 4, Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që ndihma dhe nxitja, nxitja dhe tentativa e një veprë penale të përmendur më sipër të dënohet gjithashtu si veprë penale.</p>	<p>Neni 287, paragrafi parë: Vepra Penale të Pastrimit të Parave janë:</p> <p>a) këmbimi ose transferimi të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;</p> <p>b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;</p> <p>c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;</p> <p>ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;</p> <p>dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër.</p>

STANDARTET NDËRKOMBËTARE			LEGJISLACIONI I BRENDSHËM
KOMBET E BASHKUARA	KËSHILLI I EVROPËS	BASHKIMI EVROPIAN	KODI PENAL
QËLLIMI I KRYERJES SË VEPRËS PENALE			
Neni 6.2. f) i UNTOC & Neni 26 i UNCAC: Njohuria ose qëllimi kërkohen si element të një veprë penale [të pastrimit të parave] dhe mund të nxirren nga rrethana faktike objektive.	2.c pasja dijeni, qëllim ose motivim, të nevojshëm si elemente të veprës penale të parashtruar nga ai paragraf, mund të nxirren nga rrethana faktike objektive. 3. Çdo Palë mund të marrë masat legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të klasifikuar si vepër penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, të gjitha ose disa prej akteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, në njërin ose në të dy rastet e mëposhtme, kur autori: a) dyshonte se pasuria ishte produkt i krimit; b) duhet të kishte supozuar se pasuria ishte produkt i krimit.	2: Shtetet Anëtare mund të marrin masat e nevojshme për të siguruar që veprimi [i pastrimit të parave] dënohet si vepër penale kur autori dyshohet ose duhet të dinte se prona rrjedh nga veprimtari kriminale.	Neni 287, pika e fundit: Dijenia dhe qëllimi, sipas pikës së parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.
LIDHJA ME VEPRËN PENALE KRYESORE			
2. a): Çdo Shtet Palë mund të zbatojë paragrafin e mësipërm për gamën më të gjerë mundshme të veprave penale mëmë.	5: Çdo Palë merr masat legislative dhe të tjera të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, bllokimin dhe konfiskimin të përfshijnë edhe: a) pasurinë në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet; b) pasurinë e përfutur nga burime të ligjshme, nëse fitimet janë përzier, pjesërisht ose tërësisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përziera; c) të ardhurat ose privilegje të tjera që rrjedhin nga fitimet, nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet e krimit ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet e krimit, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përziera, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë sa edhe fitimet.	3: Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që: a) dënimi i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprimtarinë kriminale nga e cila vjen pasuria nuk është parakusht për dënim për veprat [e pastrimit të parave]; b) dënimi për veprat [të pastrimit të parave] është i mundur kur vërtetohet se prona ka ardhur nga veprimtaria kriminale, pa qenë e nevojshme të vërtetohen të gjitha elementet faktike ose të gjitha rrethanat që lidhen me atë veprimtari kriminale, përfshirë identitetin e autorit.	Neni 287, pika e katërt: Pastrimi i parave konsiderohet vepër penale edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen është parashkruar ose amnistuar;

STANDARTET NDËRKOMBËTARE			LEGJISLACIONI I BRENDSHËM
KOMBET E BASHKUARA	KËSHILLI I EVROPËS	BASHKIMI EVROPIAN	KODI PENAL
VETË-PASTRIMI			
2. e): Nëse kërkohet nga parimet themelore të ligjislacionit të brendshëm të një Shteti Palë, mund të parashikohet që veprat [e pastrimit të parave] të mos zbatohen për personat që kanë kryer veprën mëmë.	2. b): Mund të parashikohet që veprat [e pastrimit të parave] të mos zbatohen për personat që kanë kryer veprën mëmë.	Neni 3.5: Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që kryerja [e pastrimit të parave, përveç asaj të parashikuar në germën c)] të dënohet si vepër penale kur kryhet nga persona që kanë kryer ose janë përfshirë në veprimtarinë kriminale nga e cila vjen produkti i veprës penale.	Neni 287, pika e katërt: d) Pastrimi i parave konsiderohet vepër penale edhe kur: c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;
VEPRAT PENALE TË KRYERA JASHTË VENDIT			
2. c): Veprat penale kryesore përfshijnë veprat e kryera brenda dhe jashtë juridiksionit të Shtetit Palë në fjalë. Megjithatë, veprat penale të kryera jashtë juridiksionit të një Shteti Palë përbëjnë vepra mëmë vetëm kur veprimi përkatës konsiderohet vepër penale sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit ku është kryer dhe do të konsiderohej vepër penale sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë që po e aplikon ose zbaton këtë nen, nëse vepra penale do të ishte kryer aty.	7: Secila Palë siguron që veprat kryesore të pastrimit të parave shtrihen edhe në veprime të ndodhura në një shtet tjetër, kur këto veprime përbëjnë vepër penale në atë shtet dhe që do të përbënin vepër penale kryesore edhe nëse do të ishin kryer brenda vendit. Secila Palë mund të parashikojë që parakushti i vetëm të jetë që nëse veprimi do të ishte kryer brenda vendit do të përbënte vepër penale mëmë.	3. c): Veprat [e pastrimit të parave] shtrihen në pronën që rrjedh nga veprimet e kryera në juridiksionin e një shteti tjetër anëtar ose të një vendi të tretë, ku ky veprim do të përbënte veprimtari kriminale nëse do të ishte kryer brenda vendit.	Neni 287, pika e katërt: d) Pastrimi i parave është i dënueshëm edhe kur: d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.
RRETHANAT RËNDUESE			
		Neni 6.1: Kur vepra është kryer në kuadër të një organizate kriminale. Kur shkelësi është subjekt i detyruar dhe e ka kryer veprën penale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale.	Neni 287, pika e tretë: Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda.

KAPITULLI II

REKUPERIMI I ASETERVE

1.

Hyrje

‘Qëllimi kryesor i krimit të organizuar ndërkufitar në të gjithë format e tij përfshirë edhe atë të llojit mafioz, është përfitimi financiar. Si rrjedhojë autoriteteve kompetente duhet t’iu jepen të gjitha mjetet për të gjurmuar, ngrirë, sekuestruar, konfiskuar, administruar dhe konfiskuar produktet e veprës penale.’¹

Në fjalë të tjera, ‘ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi i mjeteve dhe i produkteve të veprës penale janë ndër mjetet më të efektshme për të luftuar krimin’;² apo, e thënë më qartë, ‘të luftosh krimin në mënyrë të efektshme do të thotë të godasësh autorët aty ku i dhemb më shumë (që në rastin konkret është pasuria). Konfiskimi dhe rekuperimi i produktit të veprave penale synojnë burimet e tyre dhe janë elemente thelbësore të strategjisë së zgjeruar të BE-së kundër krimit financiar. Duhet bërë më shumë për të theksuar konfiskimin si një nga mënyrat më të efektshme në luftën kundër krimit të organizuar’.³

Përqendrimi te rekuperimi i asetëve dhe jo vetëm arrestimi dhe dënimi i autorëve me burgim për një kohë të gjatë, është një prirje e përdorur gjerësisht në luftën kundër krimit të organizuar në rang botëror.

1. Paragrafi (1) i Direktivës 2014/42/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 3 prillit 2014, mbi ngrirjen dhe konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian.

2. Paragrafi (3) i Rregullores (BE) 2018/1805 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 14 nëntor 2018, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 nëntor 2018, për njohjen e reciproke të urdhrave të ngrirjes dhe urdhrave të konfiskimit,

3. Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin - Të ardhurat nga krimi i organizuar: sigurimi që “krimi nuk paguhet” (COM/2008/0766 final).

2.

Llojet e ndryshme të konfiskimit

Konfiskimi mund të përkufizohet si dënim apo masë, e urdhëruar nga gjykata pas procedimit në lidhje me një vepër penale, që rezulton në humbjen përfundimtare të pasurisë⁴ (neni 1.d] i Konventës së KiE-së për pastrimin e parave⁴); ose, në mënyrë më të përmblodhur, si 'humbja përfundimtare e pasurisë e urdhëruar nga gjykata në lidhje me një vepër penale' (neni 2.4 i Direktivës së vitit 2014 2014/42/BE, këtu e më poshtë referuar si Direktiva e vitit 2014). Në mënyrë të ngjashme, urdhri i konfiskimit mund të përkufizohet si 'dënim ose masë përfundimtare, e vendosur nga gjykata pas procedimit në lidhje me një vepër penale, që rezulton në humbjen përfundimtare të pasurisë së personit fizik ose juridik' (neni 2.2 i Rregullores (BE) 2018/1805, këtu e më poshtë referuar si Rregullorja 2018).

Këto përkufizime nuk përfshijnë konfiskimin administrativ, i cili nuk ka të bëjë me veprat penale, por me shkeljet administrative dhe zakonisht nuk urdhërohet nga gjykata, por nga autoritetet administrative.

Më i ndërlikuar është rasti i të ashtuquajturit 'konfiskim civil', sepse ky term ndonjëherë përdoret për koncepte të ndryshme. 'Konfiskimet civile' përdoren gjerësisht në vendet e *common law* ose të drejtës zakonore, si Shtetet e Bashkuara apo Mbretëria e Bashkuar, i cili ndryshe quhet 'konfiskim *in rem*', në dallim nga konfiskimi "*in personam*", sepse ai synon pasurinë dhe jo pronarin e tyre; e për pasojë, prezumimi i pafajësisë nuk cenohet. Konfiskimi civil miratohet kur nuk ka arsye, nga këndvështrimi thjeshtë i së drejtës civile, për të justifikuar pronësinë e pasurive në fjalë. Përveç kësaj, provat vlerësohen sipas standardeve të së drejtës civile (ekuilibri i probabiliteteve) në vend të rregullave të së drejtës penale (të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm). Dallimet kryesore janë përmblodhur në tabelën e mëposhtme.

	KONFISKIMI	
	PENAL	CIVIL
SYNIMI	<i>In personam</i> (kundër personit)	<i>In rem</i> (kundër pasurisë)
BAZA	Përgjegjësi penale	Situata e pasurisë së paligjshme
STANDARDI I PROVËS	Përtej dyshimit të arsyeshëm	Ekuilibri i probabiliteteve

4. Konventa për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (Strasburg, 8 nëntor 1990) dhe Konventa për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe për financimin e terrorizmit (Varshavë, 15 maj). Kjo e fundit, e njohur edhe si Konventa e Varshavës, zëvendëson të parën, e cila është ende e zbatueshme midis atyre shteteve që nuk e kanë ratifikuar ende Konventën e Varshavës.

Në disa raste të konfiskimit civil, situata e paligjshme rrjedh nga një veprim i paligjshëm, që nuk përbën veprë penale (p.sh. mosdeklarimi i pasurisë dhe evazioni fiskal që nuk kalojnë pragun e veprës penale).

Megjithatë, problemi lind kur, gjatë procedimit pasuror pasuritë konsiderohen pronësi e paligjshme për shkak se rrjedhin nga veprimtari kriminale. Pra, kemi edhe 'zonë gri', ku konfiskimi nuk është as plotësisht penal dhe as plotësisht civil.⁵

Në fakt, disa vende kanë procese të cilat nuk janë ngushtësisht penale, por janë 'të natyrës penale', në kuadër të veprimtarive kriminale, dhe në të cilat është e mundur lëshimi i urdhrave të konfiskimit. Për shembull, ky është rasti i procedimeve të parashikuara nga Ligji Nr. 10.192, datë 03.10.2009, i ndryshuar, Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese ndaj pasurisë (i njohur edhe si Ligji Shqiptar Anti-Mafia dhe në vijim referuar si LAM, duke qenë se ato parashikojnë 'konfiskimet e pasurive të personave të cilët kanë nivel ekonomik të pajustificuar si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale (neni 2), ndërsa neni 3 i LAM parashikon veprat penale mëmë që lidhen me krimin financiar.⁶ Në vendimin e Gjykatës së Apelit të SPAK nr. 128, datë 26.05.2021, në një çështje të lidhur me konfiskimin e pasurive të një ish gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese të shkarkuar nga organi i rivlerësimit kalimtar, gjykata konsideroi si të rreme si deklaratën vjetore dhe ashtu edhe atë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe i mori si prova përtej dyshimeve të arsyeshme për të urdhëruar konfiskim të pasurisë së të akuzuarit.⁷ Gjykata e Lartë, në vendimin nr. 462, datë 29.06.2021, vë në dukje se 'ligji i ri parandalues [...] gjen zbatim edhe në mungesë të dënimit të personit të dyshuar për veprimtari kriminale ose krim të organizuar. Me fjalë të tjera, i ashtuquajtur 'konfiskim civil' është i pavarur nga fati dhe rezultati i procedimit penal. Ky lloj konfiskimi i lejon shtetet të marrin në zotërim pasuri të paligjshme duke nisur procedimin e drejtpërdrejtë juridik ndaj pasurisë së një personi të dyshuar për përfshirje në veprimtari kriminale, pa qenë nevoja që ky i fundit të jetë dënuar më parë. Konfiskimi civil synon të parandalojë përdorimin e paligjshëm dhe të rrezikshëm për shoqërinë, të pasurive, origjina e ligjshme e të cilave nuk mund të tregohet/vërtetohet [...] Ky ligj parashikon se procedura për përcaktimin dhe zbatimin e masave parandaluese është e pavarur nga situata, shkalla apo përfundimi i procedimit penal ndaj personave subjekte të këtij ligji.'⁸

Sidoqoftë, në procedurën e LAM-së, 'gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale' (neni 22.1).

Gjithsesi, kjo çështje ka aq rëndësi sa trajtohet më gjerësisht në germën C) të këtij seksioni.

Duhet cilësuar se edhe në kuadër të procedimeve penale, në kuptimin e ngushtë parashikohen shumë lloje konfiskimesh dhe është shumë e rëndësishme të njihen veçoritë dhe pasojat e secilit prej tyre.

5. Shih pronat e sekuestruara të ish-gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar si pasojë e vettingut në kundërshtim me nenin 257/a të Kodit Penal.

6. Neni 3 i LAM përfshin edhe nenin 257/a të KP-së (d.m.th. refuzimi për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë, interesave private të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që është ligjërisht i detyrueshëm për deklaratën).

7. Vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit Për Korrupsionin dhe Krimit e Organizuar nr. 128 datë 26.05.2021, fq. 11 ku GjKKO e Apelit shprehet se "Duke qenë kështu gjendemi edhe përpara dyshimit të arsyeshëm se, lidhur me burimin e krimit të kësaj pasurie subjekti deklarues {}, ka kryer deklaram të rremë si në deklaratën periodike vjetore, ashtu dhe në deklaramin në kuadër të rivlerësimit kalimtar (të vitit 2017), fakt ky i ndëshkueshëm penalisht nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, dispozitë në fushën e zbatimit të nenit 3/1 pika "d" të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009."

8. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr.462, datë 29.06.2021, paragrafët 11-12.

A) PËR SA I PËRKET OBJEKTIT

Për sa i përket objektit të konfiskimit dhe sipas Direktivës së vitit 2014, mund të bëjmë dallimin midis konfiskimit 'tradicional', konfiskimit të bazuar në vlerë, konfiskimit të zgjeruar dhe konfiskimit nga palët e treta.

a) Konfiskimi 'tradicional'

Konfiskimi 'tradicional' ka të bëjë vetëm me mjetet dhe produktin e veprës penale, që i nënshtrohen dënimit përfundimtar për një vepër penale (neni 4.1 i Direktivës 2014).

Për shumë kohë ky ishte i vetmi lloj konfiskimi i parashikuar si në instrumentet ligjore ndërkombëtare ashtu edhe në ato kombëtare.

Në nenin 36.1 të KP-së parashikohet se:

'Konfiskimi vendoset detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe transferimin në dobi të shtetit:

- 'a) të pasurive që janë përdorur ose janë përcaktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;*
- 'b) të produktit të veprës penale, duke përfshirë çdo lloj pasurie, si dhe dokumente ose instrumente juridike që përcaktojnë tituj ose interesa të tjerë lidhur me pasuritë që rrjedhin ose janë të përfituara drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;*
- 'c) shpërblimi i premtuar ose i dhënë për kryerjen e veprës penale.*

Ndërsa germa a) ka të bëjë me mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale, duke përfshirë shpërblimin e mundshëm nëse premtohet ose jepet (germa c)), germa b) ka të bëjë me produktin e veprës, pavarësisht nga transformimet e mëtejshme. Të dy konceptet janë shumë të gjera dhe përkufizimet e tyre janë nxjerrë nga instrumentet ndërkombëtare, të tilla si konventat e KiE-s për pastrimin e parave ose Direktiva e vitit 2014. Në përputhje me to:

- 'Produktet' përfshijnë çdo avantazh ekonomik që rrjedh drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga një vepër penale; mund të përbëhen nga çdo formë pasurie dhe përfshijnë çdo riinvestim ose transformim të mëvonshëm të produkteve të drejtpërdrejta dhe çdo përfitim me vlerë (neni 1.a) i Konventës së KiE-s, neni 2.1 i Direktivës së vitit 2014 dhe 2.4 i Direktivës së vitit 2018).
- 'Mjetet' përfshijnë çdo pronë të përdorur ose që synohet të përdoret, në çdo mënyrë, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një vepër penale ose disa vepra penale (neni 1.c) i Konventës së KiE-s, neni 2.3 i Direktivës së vitit 2014 dhe 2.5 i Direktivës së vitit 2018).

Nga ana tjetër, 'pasuritë' mund të jenë fizike ose jofizike, të luajtshme ose të paluajtshme dhe përfshijë dokumentet ligjore ose instrumentet që vërtetojnë titullin ose interesin mbi pronën në fjalë (nenet 1.b) të Konventave të KiE-s, 2.2 të Direktivës së vitit 2014 dhe 2.3 të Direktivës së vitit 2018).

Termi 'pasuri' në nenin 36/1 të KP përfshin: i) pasuri të çdo lloji (përfshirë pasuritë virtuale⁹ dhe mjetet financiare); ii) aksionet dhe titujt; si dhe iii) çdo aset tjetër, përdorimi dhe pozicioni i të cilit përbën vepër penale edhe pse nuk ka dënim të dhënë me vendim gjykate (germa d)).

9. 'Pasuritë virtuale' janë përkufizuar në nenin 2.25 të ligjit nr. 9917, date 19.05.2008, *Mbi Parandalimin e Pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit*, i cili mund të gjendet në: <http://fiu.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/LAW-No.9917-19.05.2008-amended.pdf>.

Si pasojë e interpretimit të gjerë të termit 'produkt', KP-ja parashikon gjithashtu konfiskimin e detyrueshëm të pasurive¹⁰ në të cilat janë shndërruar produktet e veprës penale ose janë konvertuar pjesërisht ose plotësisht (neni 36.2).

b) Konfiskimi i vlerës

Konfiskimi i vlerës nënkupton konfiskimin e pronës vlera e së cilës korrespondon me mjetet apo produktet e veprës penale (neni 4.1 i Direktivës së vitit 2014). Diçka e tillës ishte parashikuar më parë në nenin 2.1 të Konventës së KiE-së së vitit 1990, dhe më pas u përfshi në legjislacionin e BE-së¹¹, për të shmangur pasurimin e paligjshëm të autorëve kur pasuritë nuk mund të konfiskoheshin për çfarëdolloj arsye; për shembull, sepse ishin zhdukur ose ishin shpërndarë.

Ky lloj konfiskimi parashikohet në KP vetëm për sa i përket produkteve (jo mjeteve) të veprës penale, pasi në bazë të nenit 36.1.ç të tij, gjykata duhet të konfiskojë 'çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës korrespondon me produktet e veprës penale.'

Për më tepër, legjilacioni shqiptar parashikon dhe konfiskimin e:

- Pasurive të ligjshme të bashkuara me produktet e veprës penale, deri në vlerën e produkteve të veprës penale (nenet 36.3 të KP dhe 12/a.3 i LAM).
- Të ardhurat nga produktet e veprës penale të transformuara dhe të bashkuara me pasuri të ligjshme deri në vlerën e produkteve të veprës penale (nenet 36.4 të KP dhe 12/a.4 të LAM).
- Vlerave të pasurive për të cilat është vendosur konfiskimi, nëse personi ndaj të cilit kërkohet masa dorëzon, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë për të shmangur ekzekutimin e masës së konfiskimit, edhe kur pasuritë janë bashkuar ose janë përfshirë në pasuri të ligjshme dhe nuk mund të ndahen prej saj pa shkaktuar dëm thelbësor (neni 12/a.1 dhe 4 i LAM).

c) Konfiskimi i zgjeruar

Konfiskimi i zgjeruar përfshin konfiskimin e pasurisë që i përket një personi të dënuar për një vepër penale kur gjykata, në bazë të rrethanave të çështjes përfshirë faktet specifike dhe provat e disponueshme, si për shembull fakti që vlera e pronës është në përpjesëtim të zhdrejtë me të ardhurat e ligjme të personit të dënuar, është e bindur se pasuria në fjalë rrjedh nga veprimtari kriminale (neni 5 i Direktivës së vitit 2014).¹² Kjo direktivë detyron Shtetet Anëtare të BE-s të parashikojnë miratimin e konfiskimit të zgjeruar të paktën në rastin e dënimit për krimet më të rënda.

Sipas paragrafit (21) të pjesës hyrëse të Direktivës së vitit 2014, 'mund të jetë, për shembull, e mjaftueshme që gjykata të marrë në konsideratë bilancin e probabiliteteve, ose të supozojë në mënyrë të arsyeshme se ka shumë më tepër gjasa që prona në fjalë të jetë përfituar nga veprimtari kriminale sesa nga veprimtari të ligjshme. Në këtë kontekst, gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat specifike të rastit, përfshirë faktet dhe provat në dispozicion, në bazë të të cilave mund të jepet vendim për konfiskim të zgjeruar. Fakti

10. Termit aset dhe pasuri përdoren në mënyrë të ndërsjellë në këtë manual.

11. Neni 4 i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/500/JHA, i datës 26 qershor 2001, për pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprës penale.

12. Programi i punës i Komisionit për vitin 2021 shpalli rishikimin e Direktivës 2014/42/BE për ngrirjen dhe konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të krimit, si dhe një propozim për një direktivë për zyrat e rekuperimit të aseteve. Shih objektivin e politikës 35 në: https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar%3A91ce5c0f-12b6-11eb-9a54-01aa75ed71a1.0001.02/DOC_2&format=PDF.

që pasuria e personit është në përpjesëtim të zhdrejtë me të ardhurat e tij të ligjshme mund të jetë ndër ato fakte që nxisin përfundimin e gjykatës se pasuria rrjedh nga veprimtari kriminale.

Është e rëndësishme të theksohet se, megjithëse për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar nevojitet gjithmonë dënim nga gjykata për një vepër penale, nuk është e nevojshme lidhja shkakësore e pasurisë me ndonjë vepër penale konkrete, por mjafton që gjykata të shprehë se nuk mund të ketë shpjegim tjetër të arsyeshëm përveç se ato pasuri të jenë produkte të veprave penale (në përgjithësi, pa specifikime të mëtejshme) të kryera nga personi i dënuar.

Shembulli i mëposhtëm mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë si funksionon konfiskimi i zgjeruar: Kryhet një kontroll në shtëpinë e X dhe evidentohet sasi e madhe kokaine, si dhe shumë para në kartëmonedha me prerje të vogël, shumë gurë të çmuar dhe vepra arti me vlerë të konsiderueshme. Përveç kësaj, personi X zotëron një vilë luksoze dhe disa makina sportive dhe jahte, megjithëse ka qenë gjithmonë i papunë dhe nuk është në gjendje të deklarojë asnjë burim të ligjshëm të ardhurash. Prandaj, gjykata çmon se ka prova të mjaftueshme për të dënuar X për kryerjen e veprës penale të posedimit të lëndëve narkotike të paligjshme dhe, megjithëse nuk ka prova të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarive konkrete të trafikimit të drogës (është e pamundur të përcaktohet sasia e drogës së shitur, koha dhe vendi i transaksionit dhe rrethanat e tjera), gjykata është absolutisht e bindur se të gjitha paratë e gjetura dhe të gjitha pasuritë e tjera në pronësi të X rrjedhin nga veprimtaria e tij si shpërndarës droge. Prandaj, në këtë rast, gjykata duhet të konfiskojë drogën si mjet i veprës penale për të cilën X është dënuar dhe në të njëjtën kohë të shtrijë konfiskimin edhe në pasuritë e tjera (shuma të holla parash, bizhuteri, vepra arti, vila, makina, jahte) të cilat edhe pse nuk janë produkte të veprës penale konkrete për të cilën X është dënuar (thjesht posedimi i drogës nuk krijon fitime), gjykohen si produkte të veprimtarisë kriminale të X.

Konfiskimi i zgjeruar, siç përcaktohet sipas legjislacionit BE-së, nuk parashikohet në KP edhe pse një efekt i ngjashëm mund të arrihet me vendosjen e masës parandaluese të konfiskimit të rregulluar me LAM.¹³

d) Konfiskimi nga një palë e tretë

Konfiskimi nga një palë e tretë është konfiskimi i pasurive të cilat i janë transferuar palëve të treta nga një person i dyshuar ose i akuzuar, ose që janë fituar nga palët e treta nga një person i dyshuar ose i akuzuar, kur të paktën këto palë të treta e dinin ose duhej ta dinin se qëllimi i transferimit ose blerjes ishte shmangia e konfiskimit, në bazë të fakteve dhe rrethanave konkrete, duke konsideruar që transferimi ose blerja janë kryer pa pagesë ose në këmbim të një shume dukshëm më të ulët se vlera e tregut (neni 6 i Direktivës së vitit 2014).

Në realitet, konfiskimi nga një palë e tretë nuk ndryshon nga llojet e tjera të konfiskimit duke qenë se pasuritë e konfiskuara duhet të jenë mjete apo produkte të veprës penale (ose mallra të tjera që mund të konfiskohen në kuadër të konfiskimit të vlerës ose rregullave të konfiskimit të zgjeruar). Veçoria e vetme e këtij konfiskimi është fakti që pasuritë nuk janë në pronësi të të pandehurit, por të një personi tjetër fizik ose juridik.

Konfiskimi nga palët e treta është shprehimisht i parashikuar në nenet 3.2 dhe 22.3-5 të LAM. Sipas këtyre dispozitave, konfiskimi nga palët e treta zbatohet për dy grupe. Në grupin e parë përfshihen të afërmit si bashkëshortët, fëmijët, paraardhësit, pasardhësit, vëllezërit, motrat dhe bashkëjetuesit. Megjithatë, ligji

13. AAML, neni 1.1 parashikon se 'Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive, të poseduara drejt-përdrejt ose tërthorazi, në pronësi të plotë ose të pjesshme të personave. Në bazë të nenit 3 pika 1 të këtij ligji, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm, bazuar në tregues që tregojnë se personi është përfshirë në një veprimtari kriminale dhe posedon pasuri ose të ardhura joproportionale në raport me nivelin e të ardhurave ose të fitimeve, nga veprimtaritë e deklaruara të ligjshme dhe nuk justifikohen prej tyre.' Gjithashtu, neni 21.3 thotë se "personat e përmendur në nenin 3, paragrafi 1 i këtij ligji kanë barrën të dëshmojnë se veprimtaritë dhe pasuritë e sekuestruara, të poseduara plotësisht ose pjesërisht prej tyre, janë fituar në rrugë të ligjshme.'

nuk i përkufizon paraardhësit, pasardhësit dhe bashkëjetuesin.¹⁴ Në grupin e dytë përfshihen personat fizikë dhe juridikë, pasuritë apo veprimtaritë e të cilëve janë plotësisht ose pjesërisht, tërthorazi në pronësi të personave të përmendur në nenin 3.1 të LAM. Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr.10, datë 17.07.2020, në nenin 3.10 i përkufizon personat e tretë që kryejnë pastrim parash si "individë me lidhje familjare, miqësie dhe shoqërore ose persona të tjerë që fshehin, mbajnë, administrojnë, konvertojnë, tjetërsojnë ose përziejnë pasuritë në emër të individit që u ka ofruar atyre pasuri të krijuara nga veprimtaria kriminale e kryer prej tyre ose në bashkëpunim me individë të tjerë."¹⁵

Të afërmit e të akuzuarit kanë për detyrë të provojnë se pasuritë për të cilat kërkohet konfiskimi, posedohen me titull pronësie vetëm prej tyre, janë përfituar me burime të ligjshme dhe nuk janë në pronësi të tërthortë të të akuzuarit (LAM, neni 21.4). Nga ana tjetër, personat fizikë dhe juridikë për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre posedohen, tërësisht ose pjesërisht, tërthorazi nga personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, ose përdoren, kanë lehtësuar ose kanë ndikuar në një formë të caktuar në realizimin e veprimtarive të paligjshme prej tyre, kanë barrën e provës për të vërtetuar se provat e mbledhura gjatë procedimit të pasurisë janë të pamjaftueshme për të verifikuar që veprimtaritë ose pasuritë e tyre: a) zotërohen tërësisht ose pjesërisht, tërthorazi, nga personat e përmendur në nenin 3, pika 1 e këtij ligji, ose b) kanë përdorur, kanë lehtësuar ose kanë ndikuar në një mënyrë të caktuar në realizimin e veprimtarive të paligjshme nga i akuzuari. (LAM, neni 21.5). Për më tepër, në bazë të nenit 12/a.1-2 të këtij ligji, kur i dyshuari ka transferuar pasuritë për të shmangur konfiskimin dhe personi i tretë i ka marrë ato me keqbesim, pasuritë në fjalë konfiskohen.

Legjislacioni kombëtar duhet gjithashtu të përcaktojë garanci dhe mjete juridike të përshtatshme për të mbrojtur të drejtën e palëve të treta që kanë vepruar në mirëbesim (qoftë që pretendojnë se janë pronarë të pronës në fjalë, ose që pretendojnë se kanë ndonjë të drejtë tjetër pronësore, si p.sh. uzufukt), duke përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar [paragrafi [33] dhe neni 8.9 i Direktivës së vitit 2014].

Rrjedhimisht, LAM thekson se, "kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara i përkasin personave të tretë, gjykata [...] i thërret ata të marrin pjesë në procedim" (neni 22.3) dhe se "personi i tretë ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij në seancë" (neni 22.4). Përveç kësaj, ka supozime ligjore se kur transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve janë fiktive ose të simuluar, ato duhet të konsiderohen si të pavlefshme (neni 22.5).

B) PËR SA I PËRKET REFERIMIT

Lidhur me referencën dallojmë midis:

- **Konfiskimit të bazuar në dënim**, dhe
- **Konfiskimit të pa bazuar në dënim**, që mund të përdoren në procedurën penale ose në lloje procedurash të tjera.

14. Për kuptimin e paraardhësve dhe pasardhësve referojuni Kodit Civil Shqiptar në seksionin për trashëgiminë nenet 360-458, Përsa i përket bashkëjetuesve, referojuni Kodit Civil Shqiptar, nenet 163-164. Shih gjithashtu Ligjin Nr. 84/2016, datë 30.8.2016, Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (i njohur si Ligji i Vettingut) i cili përdor termin "Persona të Lidhur" duke përcaktuar se ata përkufizohen si " rrethi i personave të lidhur me të vlerësuarin, komisionerin, komisionerin publik ose gjyqtarin, i përbërë nga bashkëshorti, bashkëjetuesi, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të parashikuar nga zyra e gjendjes civile për të vlerësuarin, komisionerët, komisionerët apo gjyqtarët publikë për periudhën e rivlerësimit" (neni 3.13). Ligji Nr. 95/2016, datë 6.10.2016, Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve të Luftimit të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (i njohur si ligji SPAK) aplikon termin "Familjarë e ngushtë" që përfshin bashkëshortin e një personi, fëmijët mbi 18 vjeç, dhe çdo person të lidhur nga gjaku ose martesë që jeton, më shumë se 120 ditë në vit, në të njëjtën vendbanim" (neni 3.1).

15. Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr.10 datë 17.07.2020, neni 3.10.

Konfiskimi i pa bazuar në dënim sipas procedurës penale parashikohet shprehimisht në nenin 4.2 të Direktivës së vitit 2014, sipas të cilit, kur konfiskimi në bazë të dënimit nuk është i mundur, ose së paku kur kjo pamundësi vjen nga sëmundjeja ose arratisja e të dyshuarit ose personit të akuzuar, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të mundur konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të veprës penale në rastet kur ka filluar procedimi penal, dhe procedimet e tilla mund të kishin çuar në dënim penal nëse personi i dyshuar ose i akuzuar do të ishte në gjendje të paraqitej në gjyq.

Për më tepër, Rregullorja e vitit 2018 ka zgjeruar objektin e parimit të njohjes së ndërsjellë në të gjitha urdhrat e konfiskimit të miratuara në procedimet penale, qofshin ato të bazuara ose jo në dënim penal të dhënë nga gjykata (për shembull, kur i pandehuri ka vdekur ose vepra nuk mund të ndiqet më penalisht për shkak të parashkrimit).

Kjo dispozitë është e pranishme në terma të përgjithshëm edhe në KPP, që përcakton se gjykata duhet të konfiskojë 'pasuritë prodhimi, përdorimi, posedimi ose tjetërsimi i të cilave përbën vepër penale, edhe nëse nuk është dhënë vendim dënimi' (neni 36.1.d)]. Kjo dispozitë zbatohet për rastet kur dikush nuk mund të akuzohet (i mitur, i paaftë, amnisti, etj.).

Megjithatë, më problematike janë rastet në të cilat konfiskimi i pa bazuar në dënim zbatohet në procedura që nuk janë penale. Këtu mund të dallojmë dy grupe kryesore të procedimeve jo-penale:

- Procedurat të cilat në kuptimin e ngushtë nuk janë penale por janë të 'natyrës penale', pasi ato gjatë shqyrtimit konsiderojnë edhe veprat penale. Ky është rasti, për shembull, sipas praktikës italiane të masave parandaluese, ose procedurave të parashikuara në LAM.
- Procedurat civile ose administrative, në të cilat është e mundur të konfiskohen disa pasuri pa asnjë referencë për kryerje të mëparshme të ndonjë veprë penale.

Një skemë e përgjithshme e llojeve të ndryshme të konfiskimeve dhe se si ato parashikohen në legjislacione të ndryshme të BE-së është paraqitur më poshtë.



C) VËMENDJE E VEÇANTË PËR KONFISKIMIN PA DËNIM NË PROCEDIMET JOPENALE DHE PËR KONFISKIMIN E PARASHIKUAR NË LIGJIN SHQIPTAR ANTIMAFIA (LAM)

Siç shihet, shenja e pikëpyetjes është përdorur për të shprehur se sa e ndryshme është qasja ndaj çështjes së konfiskimit të miratuar në procedurat jo penale në legjislacionin e brendshëm dhe madje edhe në instrumentet ndërkombëtare.

a) Konventat e Këshillit të Europës

Procedurat të cilat nuk janë ngushtësisht penale, por janë 'me natyrë penale', të tilla si ato të parashikuara në LAM, janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të Konventës së KiE të vitit 1990. Në fakt, raporti i saj shpjegues thekson se 'Konventa trajton vetëm veprimtaritë kriminale ose aktet e lidhura me to, të tilla si aktet që lidhen me veprimet civile "*in rem*" dhe, për rrjedhojë, vetëm 'konfiskimi i pastër administrativ nuk përfshihet në objektin e zbatimit të Konventës.' Përveç kësaj, 'fakti që konfiskimi në disa shtete nuk konsiderohet si dënim penal, por si një masë sigurie ose masë tjetër (p.sh. parandaluese) është i parëndësishëm për atë që konfiskimi lidhet me veprimtarinë kriminale, dhe 'është gjithashtu e parëndësishme që konfiskimi ndonjëherë mund të urdhërohet nga një gjyqtar i cili është gjyqtar penal në kuptimin e ngushtë të termit.' Si pasojë, 'çdo lloj procedimi, pavarësisht nga marrëdhënia e tij me procedimin penal dhe rregullat procedurale në fuqi, është i vlefshëm për sa kohë rezulton në urdhër konfiskimi, me kusht që ai të kryhet nga autoritetet gjyqësore dhe të ketë natyrë kriminale, domethënë që ka të bëjnë me mjete ose produkte (të veprës penale).'

Konventa e Varshavës e vitit 2005 është më e qartë, duke qenë se në nenin 23.5 të saj, parashikohet se 'Palët duhet të bashkëpunojnë në sa më shumë të jetë e mundur sipas ligjislacionit të tyre të brendshëm me ato Palë të cilat kërkojnë ekzekutimin e masave të barazvlefshme me konfiskimin, që rezultojnë në humbjen e pasurisë, të cilat nuk janë sanksione penale, për atë që këto masa urdhërohen nga një autoritet gjyqësor i Palës kërkuese në lidhje me një vepër penale.' Raporti shpjegues i Konventës së vitit 2005 shpjegon se ky nen përfshihet pikërisht për të bërë të qartë në vetë traktat, dhe jo vetëm në raportin shpjegues, se bashkëpunimi në lidhje me ekzekutimin e masave që çojnë në konfiskim, të cilat nuk janë sanksione penale, duhet të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur.

Çështja e konfiskimit të pa bazuar në dënim është trajtuar në shumë vendime të GJEDNJ-së. Një përmbledhje e disa prej tyre jepet në fund të kapitullit.

b) Legjislacioni i BE-së

Për sa i përket legjislacionit të BE-së, mundësia e procedurave të konsideruara si 'të natyrës penale' është parashikuar që në Direktivën e vitit 2014, pasi në recitalin e saj [10] thuhet se 'Shtetet Anëtare janë të lira të paraqesin procedurat e konfiskimit të lidhura me një çështje penale përpara çdo gjykatë kompetente.'

Për më tepër, Rregullorja e vitit 2018 përfshin në objektin e saj të zbatimit të gjitha urdhrat e konfiskimit të lëshuara brenda kuadrit ligjor të 'procedurës penale', pasi në recitalin [13] përcakton se 'procedura në çështjet penale' është koncept autonom i legjislacionit të BE-së i interpretuar nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, pavarësisht nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, termi përfshin të gjitha llojet e urdhrave të sekuestrimit dhe urdhrave të konfiskimit të lëshuara

pas procedimeve në lidhje me një vepër penale, duke përfshirë llojet e urdhrave të lëshuara pa dënim përfundimtar gjykate përveç atyre që trajtohen nga Direktiva e vitit 2014.

Vetëm konfiskimi i pastër administrativ (jo civil) përjashtohet nga objekti i Konventave të KiE (pika Nr. 39 e Raportit Shpjegues të Konventës së Varshavës). Megjithatë, urdhrat e konfiskimit të lëshuara në kuadër të procedimeve në çështje civile apo administrative përjashtohen shprehimisht nga objekti i Rregullores së vitit 2018 (neni 1.4).

c) Ligji Shqiptar Antimafia

Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të mos thuhet se konfiskimi i zbatuar sipas LAM është konfiskim civil,¹⁶ të paktën nëse nuk jepet shpjegim i mëtejshëm. Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 4 datë 23.02.2011, pika 38, përdor termin 'gjykim parandalues'. Në nenin 4 të LAM termi i përdorur është 'masë parandaluese' që përkufizohet si 'çdo masë me karakter pasuror që gjykata urdhëron në proces gjyqësor nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe konfiskimit të tyre.' Vendimi i Gjykatës Kushtetuese sqaron edhe momentin e barrës së provës. Në fillim të hetimit dhe gjykimin pasuror, barra e provës për të provuar përpara gjykatës është e prokurorit, i cili duhet të provojë se pasuritë dyshohet se janë fituar gjatë ose si rezultat i veprimtarisë kriminale, dhe më pas barra e provës i kalon të dyshuarit për të vërtetuar para gjykatës ligjshmërinë e pasurisë.

Ngjashëm me procedurën penale, LAM në nenin 24.3 përcakton se '... gjykata vendos pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit të përmendur në pikën 1, të nenit 3, të këtij ligji, pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm, me përjashtim të rasteve kur në vendimin e pushimit ose të pafajësisë deklarohet se: a) fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale'.

16. Megjithatë, duhet theksuar se jurisprudenca shqiptare e konsideron konfiskimin bazuar në AAML si konfiskim *in rem*. Shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr.462, datë 29.06.2021, pika 11. Shih edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 23.02.2011, pika 37.

3.

Fazat e ndryshme të procesit të rekuperimit të aseteve

Rekuperimi i aseteve të lidhura me krimin është process i gjatë dhe kompleks që përfshin faza të ndryshme, konkretisht:

- a) Gjetjen e pasurive.
- b) Ngrirjen e pasurive, për të parandaluar shpërndarjen dhe menaxhimi i tyre në mënyrë që të parandalohet zhvlerësimi i tyre.
- c) Konfiskimin e pasurive me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.
- d) Rekuperimi i aseteve, nëse është e nevojshme, dhe rikthimin e tyre tek pronarët e ligjshëm.

Të gjithë këta hapa do të analizohen më hollësisht në seksionet pasardhëse. Në këtë kuadër, duhet të merret parasysh se kriminelët e sofistikuar ose grupet e krimit të organizuar nuk i ruajnë pasuritë në vendin e tyre, por zakonisht i transferojnë në vende të huaja.¹⁷ Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërkombëtar është shumë i nevojshëm. Megjithatë, duke qenë se çështja e bashkëpunimit ndërkufitar në çdo fazë të procesit të rekuperimit të aseteve trajtohet në Kapitullin V të këtij manuali, në seksionet në vijim do të shtjellohen vetëm disa ide ose konstatime të përgjithshme në lidhje me këtë temë kryesisht nga pikëpamja e brendshme, duke iu referuar në disa raste legjislacionit ndërkombëtar.

A) GJETJA E PASURIVE

Hapi i parë i procesit të rekuperimit të pasurive është gjetja e pasurive të cilat mund të konfiskohen në fund të procedimeve. Si pasojë, kjo veprimtari do të varet nga llojet e konfiskimit të parashikuara në ligj.

Në çdo rast, duke qenë se baza e çdo lloj konfiskimi është i ashtuquajturi konfiskim 'tradicionale', i cili i referohet konfiskimit si të mjeteve ashtu edhe të produkteve të veprës penale, përpjekja e parë do të përqendrohet identifikimi i këtyre të produkteve dhe mjeteve. Për sa i përket mjeteve, shpeshherë ato mund të kenë vlerë të ulët (p.sh., arma e përdorur për të kryer një vrasje ose mjetet e përdorura për

17. Fatjona Mejdini and Fabian Zhilla (2022) 'A safe haven in the Gulf: Balkan criminals, and their money, are hiding in the United Arab Emirates' Global Initiative against Transnational Organised Crime, aksesuar në available at: <https://globalinitiative.net/analysis/balkans-criminals-uae-gulf/>

të kryer një vjedhje), por në raste të tjera ato mund të jenë shumë të vlefshme (p.sh., jahti ose avioni i përdorur për të transportuar drogë ose për trafikimin e qenieve njerëzore, ose vila luksoze ku fshihej droga ose ku personat e trafikuar mbaheshin të mbyllur).

a) Qasje të ndryshme

Pasi përcaktohen mjetet dhe produktet e veprës penale, nëse ligji parashikon vetëm konfiskimin 'tradicional' edhe nëse ai parashikon shndërrimin e mëtejshëm të tyre në të mira të tjera dhe veçanërisht në vlera monetare ose çfarëdo lloj investimi, përpjekjet duhet të kufizohen në gjetjen e këtyre mjeteve ose produkteve të veprës penale dhe, në rastin e tjetërsimeve të mëtejshme, në gjurmimin e rrugën së ndjekur nga vlerat monetare që nga mallrat e origjinës deri tek të mirat përfundimtare. Nga ana tjetër, nëse ligji parashikon konfiskimin e bazuar në vlerë, domethënë konfiskimin e çdo malli që i përket të dyshuarve ose të akuzuarve, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e mjeteve ose produkteve të veprës penale, detyra e gjetjes dhe gjurmimit të pasurive që mund të konfiskohen bëhet më e lehtë. Qëllimi është kryerja e hetimit të plotë pasuror të të dyshuarve, duke përfshirë të afërmit dhe strukturat e ndryshme të biznesit që përdoren për të fshehur pronësinë reale të pasurive. Pikërisht kjo është tema e kapitullit III (Hetimet financiare), ku shpjegohen parimet, konceptet më të rëndësishme dhe teknikat më të dobishme të këtij lloj hetimi.

b) Zyrat e Rekuperimit të Aseteve

Nga ana tjetër, është shumë e nevojshme ngritja e një zyre kombëtare për gjetjen dhe rekuperimin e aseteve (në anglisht ARO) sipas Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së 2007/845/JHA të datës 6 dhjetor 2007, ku të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë të detyruara të përcaktojnë një zyrë kombëtare për rekuperimin e aseteve kriminale "për qëllime të lehtësimit të gjurmimit dhe identifikimit të produkteve të krimit dhe pasurive të tjera të lidhura me krimin, të cilat mund të bëhen objekt i një urdhri ngrirjeje, sekuestrimi ose konfiskimi të lëshuar nga një autoritet gjyqësor kompetent gjatë procedimeve penale ose, për sa e mundur sipas legjislacionit kombëtar të Shtetit Anëtar në fjalë, procedimeve civile."

B) SEKUESTRIMI I PASURIVE

Pasi identifikohen pasuritë që mund të konfiskohen, hapi i rradhës është sekuestrimi i tyre në mënyrë që të parandalohet shpërndarja, kalimi të të tretët ose tjetërsimi në pasuri të tjera vetëm për të shmangur ose të paktën për të vështirësuar konfiskimin përfundimtar të tyre.

a) Bazat e sekuestrimit

Sipas neni 274.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, 'sekuestrimi mund [...] të urdhërohet për sendet, produktet e veprës penale dhe për çdo lloj pasurie tjetër që mund të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal.'

Një parashikim i ngjashëm gjendet në LAM, në nenin 11 ku parashikohet se 'me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive [...] a) ekziston rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji [...]':

Në fakt, sekuestrimi i pasurive duhet të zbatohet që në fillim të procedimeve dhe gjithmonë sa më shpejtë të jetë e mundur. Përndryshe, sa më shumë të vonohet sekuestrimi i pasurive, aq më i madh është rreziku i shpërndarjes së tyre. Edhe pse nuk parashikohet shprehimisht, një interpretim cilësor i legjislacionit shqiptar na çon në të njëjtin përfundim. Duhet të theksohet se KPP përdor termin 'rrezik' ndërsa LAM përdor termin 'rrezik real'. Në analizat e mëparshme të këtij termi, gjyqtarët e kanë interpretuar termin 'rrezik real' si një situatë e cila do të përfshinte faktin që i dyshuari është në arrati, pasi do të përbente rrezik për zhdukjen e pasurisë.¹⁸

b) Mënyrat e ndryshme të sekuestrimit të pasurive

Lloji i pasurive që do të sekuestrohen varet nga natyra e tyre. Disa shembuj mund të gjenden në nenin 14 të LAM, i cili përcakton se sekuestrimi ekzekutohet:

- 'a) për pasuritë e luajtshme dhe shumat monetare, sipas rregullave të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile, në rastet e rizotërimit të pasurive nga debitori ose nga pala e tretë;
- 'b) për pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme në zyrat kompetente për regjistrimin e tyre;
- 'c) për pasuritë e shoqërive tregtare, përveç mënyrës të parashikuar nga ky ligj për çdo pasuri tjetër të sekuestruar, edhe me anën e regjistrimit të vendimit në regjistrin e shoqërive tregtare;
- 'ç) për kuotat dhe aksionet, me anën e publikimit në regjistrin e shoqërive tregtare dhe shënimin në regjistrat kontabël të shoqërisë'

c) Masat mbrojtëse procedurale

Në çdo rast kur urdhërohet sekuestrimi i pasurive duhet të respektohen disa masa mbrojtëse procedurale, me qëllim konfiskimin e tyre në të ardhmen. Një nga këto masa mbrojtëse është e drejta për të kundërshtuar vendimin e sekuestrimit para gjykatës (neni 8.4 i Direktivës së vitit 2014). Kjo parashikohet gjithashtu edhe në nenin 276 të KPP-së, sipas të cilit 'kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestrimit cilido që ka interes mund të bëjë ankim'; dhe sipas nenit 27.1 të LAM 'Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë [...] mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në në Kodin e Procedurës Penale.'

Legjislacioni i BE-së parashikon më shumë garanci, veçanërisht në nenin 8 të Direktivës së vitit 2014, ku përcaktohet se urdhri i ngrirjes duhet t'i komunikohet personit të cënuar sa më shpejtë që të jetë e mundur pas ekzekutimit të tij, duke treguar arsyen ose arsyet e urdhrin në fjalë; se urdhri i ngrirjes qëndron në fuqi vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për të ruajtur pasurinë për qëllimet e konfiskimit të mundshëm të mëvonshëm; dhe se pasuria e ngrirë e cila nuk konfiskohet duhet t'i kthehet menjëherë pronarit të saj më pas.

Në lidhje me këtë, neni 14.4 i LAM përcakton se urdhri i ngrirjes duhet t'u komunikohet personave të prekur nga masa. Po ashtu, në përputhje me nenin 28.2 të LAM, 'Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.' Në mënyrë të ngjashme, sipas nenit 275.1 të KPP-së, 'Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, përveç rasteve kur ato duhet të konfiskohen, sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuar për të kryer vepër penale, ose sepse kanë qenë produkt ose përfitim nga vepra penale.'

18. Pedro Perreira dhe Gent Ibrahim (2011), 'Praktika Gjyqësore Shqiptare në interpretimin dhe zbatimin e sekuestrimit të Produktive të Krimit sipas Ligjit Anti Mafia', Shkresë teknike, fq. 25, e aksesueshme në <https://rm.coe.int/16806ec88e>.

d) Administrimi i pasurive të sekuestruara

Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe administrimi i pasurive të sekuestruara, në mënyrë që të shmanget amortizimi (kjo përfshin, sipas rrethanave, mundësinë e shitjes së tyre para se të konfiskohen) dhe në disa raste, lejimin e përdorimit të tyre nga autoritetet e zbatimit të ligjit ose shpërndarjen e tyre për qëllime sociale. Siç parashikohet edhe në nenin 10 të Direktivës së vitit 2014 ku cilësohet se:

- '1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme, për shembull duke krijuar zyra në nivel qendror, një sërë zyrash të specializuara ose mekanizma të barasvlefshëm, për të siguruar menaxhimin e përshtatshëm të pronës së ngrirë me synim konfiskimin e mundshëm të mëvonshëm.
- '2. Shtetet Anëtare sigurojnë që masat e përmendura në paragrafin 1 përfshijnë mundësinë për të shitur ose transferuar prona kur është e nevojshme.
- '3. Shtetet Anëtare marrin në konsideratë zbatimin e masave që lejojnë përdorimin e pronës së konfiskuar për interes publik ose për qëllime sociale.'

Gjithashtu, në bazë të nenit 28.2 të Rregullores së vitit 2018, pasuria e sekuestruar duhet të administrohet me qëllim parandalimin e zhvlerësimit të saj; për këtë qëllim, ajo mund të shitet ose transferohet.

Administrimi i pasurive të sekuestruara shtjellohet në Kapitullin III (nenet 15-20) të LAM. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (këtu e në vijim si AAPSK) është institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e aseteve të sekuestruara me vendim të sistemit të drejtësisë ose organeve administrative, si dhe ruajtjen e provave materiale ose administrimin e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, e cila aktualisht ushtron funksionin e saj në varësi të Ministrisë së Brendshme.¹⁹

AAPSK u krijua në vitin 2004 dhe aktualisht funksionon në bazë të dy ligjeve kryesore (Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, Për parandalimin dhe luftën kundër e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë; dhe Ligji nr. 34/2019, Për administratën e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, të dyja të ndryshuara), si dhe një sërë aktesh nënligjore përkatëse.

C) KONFISKIMI I PASURIVE

Pas vlerësimit të provave, gjykata mund të vendosë konfiskimin e pasurive që konstatohet se kanë lidhje me një veprimtari kriminale.

Në bazë të nenit 480 të KPP-së, 'Në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë [...] për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara.'

Zakonisht, pasuritë e konfiskuara kanë qenë të sekuestruara paraprakisht. Sidoqoftë, 'konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit' (neni 21.2 i LAM).

19. Për më shumë info: <https://aapsk.gov.al/>

a) Të drejtat e personave të prekur

Sekuestrimi i pasurive është masë parandaluese, ndërsa konfiskimi është masë përfundimtare. Prandaj, në këtë fazë të procesit, është edhe më e rëndësishme të mbrohen pretendimet e ligjshme të çdo personi që gëzon të drejta mbi pronën e sekuestruar.

Së pari, personat e prekur [...] kanë të drejtën e një korrigjimi juridik të efektshëm dhe gjykimi të drejtë në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tyre (neni 8.1 i Direktivës së vitit 2014).

Sipas nenit 27.2 të LAM, 'kundër vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë mund të bëhet ankim në gjykatën e një shkalle më të lartë, sipas afateve dhe kushteve, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.'

Për më tepër, duhet të jepen arsyet për çdo urdhër konfiskimi, urdhri duhet t'i komunikohet personit të prekur dhe çdo person në lidhje me të cilin urdhërohet konfiskimi duhet të ketë mundësinë e efektshme për ta kundërshtuar urdhrin para gjykatës.' (neni 8.6 i Direktivës së vitit 2014). Përveç kësaj, 'personat prona e të cilët preken nga një urdhër konfiskimi kanë të drejtën e avokatit mbrojtës gjatë gjithë procedurave të konfiskimit në lidhje me përcaktimin e produktit dhe mjeteve, me qëllim që të mbrojnë të drejtat e tyre. Personat e interesuar informohen për këtë të drejtë' (neni 8.7 i Direktivës së vitit 2014). Siç parashikohet edhe në nenin 21.1 të LAM, 'gjykata vendos pas kryerjes së hetimit gjyqësor dhe pasi dëgjon diskutimin përfundimtar të palëve.'

D) REKUPERIMI I ASETEVE DHE KTHIMI I TYRE TE PRONARËT E LIGJSHËM, TE KOMUNITETI, TE VIKTIMAT E KRIMIT, OSE LIKUIDIMI I ASETEVE

Rregulli i përgjithshëm është që pas lëshimit të urdhrin të konfiskimit, pasuritë e konfiskuara i përkasin shtetit. Sipas nenit 29.3 të LAM, 'Kur vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, pasuria kalon në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme.'

Megjithatë, edhe pse mjetet monetare janë gjithmonë të dobishme për çdo pronar, shumë pasuri janë të padobishme për shtetin. Autoritetet e kanë të vështirë të gjejnë përdorim të përshtatshëm për asete si mjetet luksoze, bizhuteri apo kafsh të egra. Përveç kësaj, administrimi i disa pasurive është shumë i kushtueshëm, si për shembull kuajt e garave, jahtet sportive, nëse duhet të parandalohet amortizimi i tyre me kalimin e kohës. Kjo është arsyeja pse shumica e pasurive të konfiskuara likuidohen, zakonisht përmes ankandit publik, dhe shndërrohen në mjete monetare.

a) Të drejtat e viktimës

Është e rëndësishme që viktima e veprës penale të njihet me të drejtat e veta²⁰ që në fazën e procedimit penal dhe t'i garantohen ato, veçanërisht kur ato janë dëmtuar nga autorët e veprave penale të cilëve iu është sekuestruar ose konfiskuar pasuria, me synim ngritjen prej tyre të padive civile përkatëse.²¹ Në shumicën e krimeve ekonomike (vjedhje, grabitje dhe mashtrimet në përgjithësi) ka lidhje të drejtpërdrejtë

20. Neni 58 Kodit të Procedurës Penale.

21. Nenet 61 Kodit të Procedurës Penale.

ndërmjet përfitimit ekonomik të autorit ('produktet' e krimit) dhe dëmit financiar të shkaktuar ndaj viktimës. Prandaj, të ardhurat e konfiskuara të krimit (ose paratë e fituara nga shitja e tyre) duhet t'i kthehen viktimës.

Siç parashikohet në nenin 8.10 të Direktivës së vitit 2014, 'kur, si rezultat i një veprë penale, viktimat kanë pretendime kundër personit që i nënshtrohet masës së konfiskimit [...], Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që masa e konfiskimit nuk i pengon viktimat të kërkojnë kompensim për pretendimet e tyre.'

Rrjedhimisht, neni 30 i Rregullores së vitit 2018 parashikon se pasuria e konfiskuar i kthehet viktimës sa më shpejt të jetë e mundur nëse ka vendim për ta bërë këtë; nëse kjo nuk është e mundur, por janë siguruar para si rezultat i ekzekutimit të urdhrimit të konfiskimit, shuma përkatëse i transferohet viktimës për qëllime të kompensimit. Në mënyrë të ngjashme, nëse ka vendim për kompensimin e viktimës dhe janë siguruar para si rezultat i ekzekutimit të urdhrimit të konfiskimit, shuma përkatëse i transferohet viktimës për qëllime të kompensimit.

Nëse nuk ka viktima të drejtpërdrejta të veprës penale (për shembull, në shumicën e rasteve të trafikut të drogës), i takon autoriteteve publike kompetente të vendosin destinacionin e aseteve të konfiskuara.

b) Përdorimi i pronës së konfiskuar për interes publik ose për qëllime sociale

Legjislacioni i BE-së (neni 10 i Direktivës së vitit 2014) nxit përdorimin e pronës së konfiskuar për interes publik ose për qëllime sociale. Sipas paragrafit (35) të pjesës hyrëse të së njëjtës Direktivë, ky synim mund të arrihet duke 'e caktuar pasurinë për projekte të zbatimit të ligjit dhe parandalimit të krimit, si dhe për projekte të tjera me interes publik dhe dobi sociale', për shembull.

Në këtë drejtim, si praktika të mira duhen theksuar dispozitat e mëposhtme të parashikuara në nenin 37 të LAM:

1. Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji, shërbejnë për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor [...].
2. Ky fond shërben për:
 - 'a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe të Ministrisë së Drejtësisë;
 - 'b) përmirësimin e parandalimit të kryerjes së veprave penale, të hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar apo krimeve të tjera, që sjellin pasuri/produkte kriminale dhe zhvillimin e programeve për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke i ndarë pasuritë në administrim të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike;
 - 'c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale
 - 'ç) dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor.

'Përveç institucioneve qendrore, përfitues të financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit mund të jenë:

- 'a) njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;
- 'b) organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore [...].'
- d) për të mbuluar diferencat në vlerë që mund të lindin nga administrimi i pasurive, të cilat me vendim gjykate i kthehen pronarit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuuar.'

c) Ndarja e aseteve

Bashkëpunimi ndërkombëtar për njohjen dhe ekzekutimin e urdhrave të huaj të konfiskimit do të trajtohet në Kapitullin V të këtij manuali. Megjithatë, në këtë seksion mund të theksohet si praktikë e mirë mundësia e ndarjes së pasurive të konfiskuara (më shpesh, paratë e përfuara pas shitjes së tyre) ndërmjet shtetit që ka lëshuar urdhrin dhe shtetit që e ka ekzekutuar atë, si nxitje që të dyja vendet të bashkëpunojnë në këtë fushë. Ky është rregulli i përgjithshëm, për shembull, brenda BE-së, pasi neni 30.7 i Rregullores së vitit 2018 thotë se 50% e shumës së parave të përfituara si rezultat i ekzekutimit të një urdhri konfiskimi, i transferohen shtetit lëshues nga shteti ekzekutues.

Në përputhje me nenin 518.4-5 të KPP, pasuritë e konfiskuara ose të ardhurat monetare të ekzekutimit të një vendimi të huaj konfiskimi i përkasin shtetit shqiptar si rregull i përgjithshëm, por mund t'i jepen shtetit të huaj në bazë të reciprocitetit.

Neni 57/1 i ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009, '*Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale*', ndryshuar me ligjin nr. 97/2021, përcakton se dorëzimi dhe ndarja e pasurisë së konfiskuar rregullohet me marrëveshje dypalëshe. Kjo marrëveshje, si rregull, duhet të pasqyrojë ndarje proporcionale të pasurisë së konfiskuar me shtetin ku është kryer vepra penale e cila ka krijuar produkt, si dhe rolin dhe punën hetimore të secilit shtet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

4.

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe GJED-së

A) GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

<p>Djordjevic kundër Francës (Nr.15572/17) 7 tetor 2021</p> <p>Proporcionaliteti i konfiskimit të aseteve që nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me veprën penale</p>	<p>Konfiskimi mund të përfshijë disa nga pasuritë e një individi, ku pasuria e konfiskuar nuk është domosdoshmërisht objekt i veprës penale, mjet i kryerjes së saj ose fitim i drejtpërdrejtë prej saj. Në këtë rast, konfiskimi ishte proporcional pasi kishte për qëllim luftimin e krimit të organizuar duke penalizuar pjesëmarrjen në konspiracion kriminal nëpërmjet një dënimi parandalues, duke pasur parasysh shkallën e fitimeve të fituara nga organizata kriminale të cilën kërkuesi drejtonte.</p>
<p>G.I.E.M. dhe të tjerë kundër Italisë (GC) (Nr.1828/06, 34163/07 dhe 19029/11) 28 qershor 2018</p> <p>Konfiskim i pa bazuar në dënim në procedurën penale</p> <p>Të drejtat e palëve të treta</p>	<p>Vendosja e konfiskimit si sanksion penal ndaj një individi, përgjegjësia penale personale e të cilit nuk është vërtetuar dhe deklaruar paraprakisht është e paligjshme.</p> <p>Megjithatë, nëse do të zbuloheshin të gjithë elementët e veprës penale dhe procedura do të ndërpritej vetëm për shkak të parashkrimit, ato gjetje mund të konsideroheshin, në thelb, si dënim.</p> <p>Zbatimi i masës së konfiskimit ndaj personave që nuk kanë qenë palë në procedurë është në kundërshtim me ligjin.</p>
<p>Balsamo kundër San Marinos (Nr. 20319/17 dhe 21414/17) 8 tetor 2019</p> <p>Konfiskimi i zgjeruar</p> <p>Konfiskimi i pa bazuar në dënim në procedurë penale</p>	<p>Në korrik të vitit 2011, një gjykatës hetues i San Marinos sekuestroi pasuri me vlerë rreth 1,9 milion Euro që i përkisnin dy motrave italiane, të dyshuara se kishin kryer pastrim parash. Në nëntor të vitit 2014, aplikantët u shpallën fajtorë për pastrim parash dhe e gjithë shuma e sekuestruar u konfiskua. Gjykata u mbështet në prova që babai i tyre ishte gjykuar dhe dënuar në Itali për vjedhje dhe pranimin e mallrave të vjedhura, të cilat kishin krijuar produkt të veprës penale prej 750.000 euro. Gjykata e San Marinos gjithashtu arriti në përfundimin se duke pasur parasysh historikun e mëparshëm të babait, nuk mund të përjashtohet që e gjithë shuma e sekuestruar nga aplikantët të kishte pasur origjinë kriminale. Ajo nuk pranoi shpjegimin e tyre se fondet kishin ardhur nga veprimtari të ligjshme si pasuritë e paluajtshme apo biznesi familjar. Në apel, në tetor të vitit 2016 aplikantët u shpallën të pafajshme për pastrimin e parave për shkak të moshës së tyre të re dhe mungesës së mundshme të dënjësive për origjinën kriminale të fondeve. Megjithatë, urdhri i konfiskimit u la në fuqi për shkak të origjinës së qartë kriminale të fondeve.</p>

<p>Zaghini kundër San Marinos (Nr. 3405/21) 11 maj 2023</p> <p>Konfiskimi i pa bazuar në dënim në procedurë penale</p> <p>Standardi i provës në lidhje me konfiskimin</p>	<p>Çështja ka të bëjë me konfiskimin në San Marino të rreth 2 milionë eurove në kuadër të procedimit penal për pastrim parash (vepra mëmë ishte mashtrimi fiskal i kryer në Itali nga djali i të dënuarit). Pas dënimit të babait të kërkuesit për pastrim parash në San Marino, procedimet italiane kundër kërkuesit u ndërprejnë për shkak të parashkrimit. Megjithatë, ndërkohë dënimi mori formë të prerë, ashtu si dhe urdhri i konfiskimit, dhe përpjekjet e kërkuesit për të marrë paratë ishin të pasuksesshme.</p> <p>Për më tepër, Gjykata nuk kërkon prova "përtej dyshimit të arsyeshëm" për origjinën e paligjshme të aseteve. Faktikisht, provat për bilance të mundshme ose probabiliteti i lartë i origjinës së paligjshme, kombinuar me pamundësinë për të provuar të kundërtën, ishin të mjaftueshme për qëllimet e testit të proporcionalitetit sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1.</p>
<p>Fondacioni Dassa kundër Liechtenstein (Nr.696/05) 10 korrik 2007</p> <p>Konfiskim civil/parandalues</p>	<p>Konfiskimi i pasurisë u urdhëruar si rezultat i një procesi civil <i>in rem</i>, pa përfshirë përcaktimin e akuzës penale, nuk është i një natyre ndëshkuese, por i një natyre parandaluese dhe/ose kompensuese dhe si rrjedhojë nuk mund të shkaktojë zbatimin e prezumimit të pafajësisë.</p>
<p>Gogitidze dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë (Nr.36862/05) 12 maj 2015</p> <p>Konfiskim civil/parandalues</p>	<p>Procedurat civile <i>in rem</i> nuk burojnë nga dënim penal dhe, për rrjedhojë, nuk kualifikohen si dënim, por përkundrazi përfaqësojnë masë kontrolli të përdorimit të pasurisë dhe nuk mund të përbëjnë 'përcaktimin e një akuze penale.'</p>
<p>Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr.41661/98) 27 qershor 2002</p> <p>Konfiskimi në procedimet jo-penale</p>	<p>Urdhri i konfiskimit ishte masë parandaluese dhe nuk mund të krahasohet me sanksion penal, pasi kishte qëllim të nxirte nga qarkullimi para të cilat supozohej se ishin të lidhura me tregtinë ndërkombëtare të lëndëve narkotike. Prandaj, procedurat që çuan në lëshimin e urdhrin nuk përfshinin 'përcaktimin e akuzës penale.'</p>
<p>Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë (Nr. 265/17 dhe 26473/18) 26 shtator 2023</p> <p>Konfiskimi në procedurë jopenale</p> <p>Lidhja midis aseteve dhe një veprë penale kryesore</p>	<p>Gjykatat kombëtare që urdhërojnë konfiskimin duhet të japin disa të dhëna në lidhje me veprat penale, ose shkeljet administrative, në të cilat pretendohet se kanë origjinën pasuritë që do të konfiskohen, dhe të tregojnë në mënyrë të arsyetuar se ato pasuri mund të kenë qenë të ardhurat e sjelljes nëfjalë (me fjalë të tjera, se mund të ketë një lidhje midis veprave të tilla dhe aseteve në fjalë).</p>
<p>Veits kundër Estonisë (Nr.12951/11) 15 Janar 2015</p> <p>Palët e treta në bona fide (mirëbesim)</p>	<p>Gjyshja dhe nëna e zonjës Veits u dënuan për një sërë veprash dhe gjykata urdhëroi konfiskimin e një apartamenti si produkt të krimit, megjithëse ishte regjistruar në emër të zonjës Veits kur ajo ishte e mitur, pa pagesë. GJEDNJ-ja konstatoi se znj. Veits nuk ishte palë e tretë me mirëbesim dhe, për rrjedhojë, konfiskimi u konsiderua si i ligjshëm.</p>
<p>Qendra Burimore e Demokracisë dhe të Drejtave të Njeriut Mustafayev kundër Azerbaxhanit (Nr.74288/14 dhe 64568/16) 14 tetor 2021</p> <p>Bazat për sekuestrimin</p>	<p>Gjykata arriti në përfundimin se ankuesit nuk i përkisnin asnjë prej kategorive të personave ndaj të cilëve mund të zbatohet masa e ngrirjes së një llogarie bankare sipas ligjit të brendshëm. Në veçanti, kërkuesit nuk ishin akuzuar për ndonjë veprë penale në kuadër të procedurës penale ose në procedurë të tjera. Nga palët ishte e padiskutueshme se z. Mustafayev nuk ishte akuzuar zyrtarisht për ndonjë krim, por ishte marrë në pyetje vetëm në disa raste. Për më tepër, gjykata as nuk i ishte referuar ndonjë dispozite ligjore si bazë për urdhrin e saj për ngrirjen e llogarisë së kërkuesit. Prandaj, ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve nuk mund të konsiderohet e ligjshme.</p>

B) GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EUROPIAN

Çështja C-234/18 19 mars 2020	Legjislacioni i BE-së nuk e përjashton legjislacionin e një shteti anëtar i cili parashikon se konfiskimi i pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme urdhërohet nga një gjykatë kombëtare pas procedurave që nuk i nënshtrohen as konstatimit të një veprë penale, ose argumentit më të fortë të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e një veprë të tillë penale.
Konfiskimi i pa bazuar në dënim	
Çështja C-393/19 14 janar 2021	Një rregull kombëtar që lejon konfiskimin e një mjeti që është përdorur për të kryer veprë penale, por që i përket një pale të tretë që vepron me mirëbesim, është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.
Palët e treta në bona fide (mirëbesim) Të drejtat e palëve të treta	Një ligj kombëtar që lejon konfiskimin, në kontekstin e procedimeve penale, të pasurisë që i përket një personi të ndryshëm nga personi që ka kryer veprën penale, pa i siguruar të parës një mjet të efektshëm juridik, është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.
Çështjet e bashkuara C-845 and C-863/19 21 tetor 2021	Direktiva e vitit 2014 parashikon gjithashtu konfiskimin e pasurisë që i përket atij autori, në lidhje me të cilën gjykata kombëtare që shqyrton çështjen është e bindur se rrjedh nga veprimtari të tjera kriminale, në përputhje me rregullat e parashikuara në Direktivë (konfiskim i zgjeruar).
Konfiskimi i zgjeruar	Legjislacioni i BE-së parandalon legjislacionin kombëtar që lejon konfiskimin e pasurisë që i përket një personi të ndryshëm nga autori i veprës penale, pa respektuar të drejtën e këtij personi të paraqitet si palë në procedurën e konfiskimit.
Të drejtat e palëve të treta	
Çështja 319/19 28 tetor 2021	Direktiva e vitit 2014 nuk zbatohet për legjislacionin e një shteti anëtar që parashikon se konfiskimi i pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme duhet të urdhërohet nga një gjykatë kombëtare në kontekst ose në vijim të procedurave që nuk kanë të bëjnë me vendimin e një ose më shumë veprave penale.
Konfiskim jo i bazuar në dënim	

5.

Praktikat e mira në rekuperimin e aseteve

Ky seksion synon të jetë një përmbledhje e të gjithë kapitullit duke theksuar se cilat mund të konsiderohen praktika të mira në fushën e rekuperimit të aseteve dhe në çfarë mase ato zbatohen në legjislacionin shqiptar.

PRAKTIKAT E MIRA NË PËRGJITHËSI	PRAKTIKA NË SHQIPËRI
LLOJET E NDRYSHME TË KONFISKIMIT	
Legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë konfiskimin e vlerës në të gjitha rastet.	Konfiskimi i vlerës parashikohet në KP për produktet, por jo për mjetet e veprës penale.
Legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë konfiskim të zgjeruar, të paktën për shumicën e krimeve të rënda	Konfiskimi i zgjeruar nuk parashikohet në legjislacionin shqiptar.
Legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë konfiskimin nga palët e treta (të cilët nuk janë të përfshirë në veprimtari kriminale) kur pasuritë janë transferuar për të shmangur konfiskimin.	Konfiskimi ndaj palëve të treta parashikohet në LAM.
Në shumicën e rasteve duhet të jetë i mundur konfiskimi i pa bazuar në dënim sipas procedurës penale.	Konfiskimi i pa bazuar në dënim parashikohet në KP.
Duhet të merret në konsideratë mundësia e miratimit të konfiskimit jo të bazuar në dënim në procedura të cilat nuk janë në mënyrë strikte penale.	LAM është shembull i mirë i zbatimit të kësaj mundësie.
EVIDENTIMI I PASURIVE	
Hetimi financiar nuk duhet të përqendrohet vetëm në evidentimin e mjeteve dhe produkteve të veprës penale, por duhet të jetë hetim i plotë i pasurisë në pronësi të të dyshuarve.	Kjo parashikohet shprehimisht në LAM. Ky duhet të jetë edhe fushëveprimi i hetimeve pasurore në procedurë penale, duke qenë se në KP parashikohet konfiskimi i vlerës.
Ekzistenca e një regjistri të bankës qendrore dhe regjistrave publikë për shoqëritë dhe pronat e lehtëson shumë hetimin pasuror. Një regjistër i pronarëve përfitues është gjithashtu shumë i dobishëm. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së duhet t'i mbajnë këto regjistra.	Në Shqipëri Regjistër Qendror të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëritë duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ka gjithashtu edhe regjistër qendror të llogarive bankare dhe regjistër të pronarëve përfitues.
Prania e një Zyrë për Rekuperimin e Pasurive (ZRA) gjithashtu ndihmon për evidentimin e pasurive në pronësi të të dyshuarve. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së duhet të kenë një ZRA të ngarkuar me evidentimin e pronave të lidhura me krimin.	Në Shqipëri nuk ka një ZRA, një zyrë, detyra kryesore e së cilës është evidentimi dhe gjurmimi i produkteve të krimit dhe pasurive të tjera që lidhen me krimin.
Është thelbësore të kryhen hetime paralele si për dokumentimin e kryerjes së veprës penale ashtu dhe për evidentimin e pasurive të të dyshuarve nga vepra penale.	Në Shqipëri prokurorët janë udhëzuar për këtë me Udhëzimin e Përgjithshëm Detyrues nr.10, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.

PRAKTIKAT E MIRA NË PËRGJITHËSI	PRAKTIKA NË SHQIPËRI
SEKUESTRIMI I PASURIVE	
Pasuritë duhet të sekuestrohen që në fillim të procedurës për të shmangur shpërndarjen e tyre.	Një interpretim i shëndoshë i së drejtës shqiptare del në të njëjtin përfundim.
Duhet të respektohen disa masa mbrojtëse procedurale, siç është njoftimi në kohë i urdhrin të sekuestrimit ose mundësia e kundërshtimit të urdhrin përpara gjykatës.	Këto masa mbrojtëse parashikohen nga legjislati shqiptar.
Pasuritë e sekuestruara duhet të menaxhohen siç duhet në mënyrë që të shmanget amortizimi i tyre.	Kjo detyrë i është besuar Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
Shitja ose transferimi i pasurive të sekuestruara duhet të lejohet në disa raste.	Kjo parashikohet në LAM.
KONFISKIMI I PASURIVE	
Urdhri i konfiskimit duhet të miratohet pas gjykimit të drejtë dhe personi i prekur duhet të ketë të drejtën ta kundërshtojë urdhrin përpara gjykatës.	Këto masa mbrojtëse parashikohen në LAM.
SHPËRNDARJA E PASURIVE	
Është shumë e dobishme ekzistenca e një Zyre për Menaxhimin e Pasurive, për të përfituar sa më shumë nga asgjësimi i pasurive të konfiskuara.	Në Shqipëri Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
Të drejtat e viktimave duhet të merren parasysh gjatë ekzekutimit të urdhrave të konfiskimit.	Të drejtat e viktimave duhet të merren parasysh gjatë ekzekutimit të urdhrave të konfiskimit.
Duhet të nxitet përdorimi i pasurisë së konfiskuar për interes publik ose për qëllime sociale.	Kjo parashikohet shprehimisht në LAM.
Ndarja e pasurive është praktikë e mirë në ekzekutimin e vendimeve të huaja të konfiskimit.	Ndarja e pasurive rregullohet në ligjin nr.10193, datë 03.12.2009, Për Marrëdhëniet e Juridiksionit me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale, ndryshuar me Ligjin nr. 97/2021.

KAPITULLI III

HETIMI FINANCIAR DHE PASUROR

Hyrje

Përkufizimi i "Hetimit financiar" sipas nenit 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.10/2020, është "kontrolli i hollësishëm, në lidhje me sendet/mjetet e kryerjes së veprës penale ose produktet e veprës penale, i pasurive në pronësi dhe/ose që ka në kontroll një individ apo kompania dhe një analizë e plotë e burimeve dhe shpenzimeve të fondeve që i përkasin një individ apo kompanie, në kuadrin e procedimit penal për sekuestrimin dhe/ose konfiskimin sipas nenit 36 të Kodit Penal, ku përfshihen edhe ato sipas tipologjive: -pasuri/asete të palëve të treta; -të subjekteve të posaçëm/profesionist; -të vetë subjekteve raportuese (gatekeeper) si dhe -aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte, dhe/ose -vlerë ekuivalente."

Përkufizimi i "hetimit pasuror" sipas nenit 5.1 është procedura për verifikimin/hetimin dhe sekuestrimin e pasurisë në zbatim të LAM.

Në rastet e pastrimit të parave² qëllimi i hetimit financiar është gjurmimi, gjetja, sekuestrimi, dhe konfiskimi i aseteve të veprimtarisë kriminale. Në këtë veprimtari, organi procedues identifikon rolet e ndryshme që luajnë të gjithë subjektet pjesëmarrëse në skemën e pastrimit të parave, me qëllim ndjekjen penale të tyre.

Sipas interpretimit të Rekomandimit Nr. 30 të FATF-së (Përgjegjësitë e Autoriteteve Ligjzbatuese dhe Hetuese)³, "hetim financiar" është hetimi mbi çështjet financiare që lidhen me një veprimtari kriminale, me synim:

- identifikimin e shtrirjes së rrjeteve kriminale dhe/ose shkallës së kriminalitetit;
- identifikimin dhe gjurmimin e produkteve të krimit, fondeve terroriste ose çdo pasurie tjetër që janë ose mund të bëhen objekt konfiskimi;
- zhvillimin e provave që mund të përdoren në procedimin penal.

1. Si shembull, kontabilistët, auditorët ligjorë, këshilltarët tatimorë, avokatët, agjentët e pasurive të paluajtshme, noterët, punonjësit/pronarët/menaxherët e institucioneve financiare, ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale, punonjësit/pronarët/menaxherët e kompanive të lojërave të fatit/kazinove, etj. Lista e plotë e subjektet raportuese përfshihen në nenin 3 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar.

2. "Pastrimi i parave" ka të njëjtin kuptim si në nenin 287 të Kodit Penal.

3. <https://cfatf-gafic.org/index.php/documents/fatf-40r/396-fatf-recommendation-30-responsibilities-of-law-enforcement-and-investigative-authorities2>.


1.

Objektivat e hetimit financiar dhe pasuror

Hetimi financiar është kompleks, kërkon burime të konsiderueshme dhe profesionistë me përvojë të organit hetues për ta kryer atë. Ky hetim shoqërohet me mbledhjen, përpunimin, analizimin, integrimin e informacioneve, të dhënave dhe provave të marra nga burime të ndryshme, sipas një plani hetimi, i cili duhet të përditësohet dhe përshtatet vazhdimisht në vartësi të gjetjeve.

Po kështu, ekzistenca e burimeve të jashtme të informacionit/të dhënave përveç bazave të të dhënave të policisë, nënkupton se hetimi varet nga edhe nga palë të treta. Gjatë hetimit, duhet të vlerësohet herë pas here se çfarë lloj të dhënash mund të merren nga këto institucione, mënyra e përfundimit të tyre si dhe rreziqet që shoqërojnë ndërveprimin me këto bazash të të dhënash, nëse ka të tilla.

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis një hetimi pasuror në zbatim LAM, i ndryshuar, dhe një hetimi financiar për pastrim parash si proces penal. Objektivat e të dy hetimeve janë të ndryshme (i pari përqendrohet kryesisht në identifikimin e aseteve, i dyta në rolet e autorëve kriminalë në skemat e evidentuara të PP-së), por është e rëndësishme të theksohet këtu se hetimi penal për pastrim parash përfshin gjithmonë vlerësim të pasurive të të dyshuarve, megjithëse objektivat e tij janë më të gjera dhe gjithëpërfshirëse.



A) HETIMI PASUROR

Qëllimi i hetimit pasuror është identifikimi i pasurive të lidhura me autorët, në mënyrë që ato të mund të sekuestrohen me synim konfiskimit sipas cilësdo prej formave të konfiskimit të përcaktuara në legjislacionin shqiptar. Hetimi pasuror duhet të jetë një prej objekteve kryesore të çdo hetimi që lidhet me krimin e organizuar.

Për arritjen e efektshmërisë më të madhe, rekomandohet që hetimi pasuror të nisë paralelisht me hetimin parësor (të veprës penale mëmë), sepse nëse përdoret qasja tradicionale (hetimi pasuror fillon shumë pranë ditës së aksionit të hetimit kryesor ose pas saj), efektshmëria e këtij hetimi bie ndjeshëm duke qenë se nuk ka kohë të mjaftueshme për të identifikuar siç duhet të gjitha asetet. Qasja për nisjen e këtyre hetimeve paralele është në përputhje edhe me Udhëzimin e Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020.

Për më tepër, hetimi pasuror i zhvilluar në kohën dhe me hollësitë e duhura bën të mundur zbulimin e rritjes së pajustificuar të pasurisë, si dhe indicieve për fshehjen e pronësisë së vërtetë të pasurive të zbuluara, që përbën element kyç për hetimet e pastrimit të parave, por mund të ndihmojnë edhe në hetimin e veprës penale mëmë.

Hetimi pasuror mund të përdoret edhe në kuadër të zbatimit të ligjit Antimafia. Ky ligj gjen zbatim edhe kur pasuritë janë në pronësi ose posedim të tërthortë të:

- Të afërmeve (bashkëshorti/ja, fëmijët, paraardhësit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi/ja), për të cilët prezumohet të jetë bërë regjistrim i rremë kur ka të dhëna të dobishme të siguruar në mënyrë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë, përveç rasteve kur vërtetohet e kundërta.
- Personave fizikë ose juridikë, kur ka informacion të mjaftueshëm se pasuritë ose veprimtaritë e të cilëve janë tërësisht ose pjesërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi në pronësi, ose janë përdorur, kanë lehtësuar ose kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të paligjshme prej tyre.
- Trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të Ligjit Anti Mafia, por në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes së tij.
- Personave, pasuria e të cilëve është konstatuar para hyrjes në fuqi të LAM, me kusht që pasuritë të jenë krijuar gjatë përfshirjes së tyre të dyshuar në veprimtari kriminale.

B) HETIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

Hetimi i pastrimit të parave është tërësia e veprimeve policore dhe gjyqësore të përqendruara në zbulimin e lidhjes së fshehur ose të maskuar ndërmjet një veprimtari të caktuar kriminale dhe rezultatit të saj ekonomik.

Këto veprime synojnë gjithashtu përcaktimin e identitetit të të gjithë autorëve të përfshirë në veprimtarinë kriminale dhe në procesin e fshehjes së produkteve ekonomike të saj, me rolet e tyre të ndryshme.

Për sa i përket identifikimit të pasurisë, në këtë lloj hetimi synohet identifikimi i të ardhurave të pastruara dhe eventualisht, instrumenteve të përdorura në skemat e pastrimit të parave, por duhet të kemi parasysh se nëse ka dënim, i dënuari ka përgjegjësi financiare shoqëruese që duhet ta përmbushë, kështu që duhet të bëhet identifikimi i pasurisë për qëllime të mundshme konfiskimi.

Objektivat e hetimit të pastrimit të parave janë:

- Identifikimi, gjetja dhe arrestimi i autorëve të përfshirë në veprat penale të pastrimit të parave.
- Përcaktimi i roleve të ndryshme të autorëve.
- Zbulimi i aseteve që janë produkt krimi dhe/ose pasuritë që janë pastruar, përfshirë më përgjithësisht asetet që mund të lidhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me autorët
- Zbulimi i tipologjive/mekanismave të pastrimit të parave të përdorura për pastrimin e parave produkt i veprimtarive kriminale.
- Sigurimi i provave të lidhjes ndërmjet parave të pastruara dhe veprës kryesore (mëmë).
- Sigurimi i provave të lidhjes mes pasurisë dhe veprës.
- Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë.

2.

Terma të dobishëm në hetimin e pastrimit të parave

A) PERSONA KUKULL (STRAW MEN, FRONT MEN)

Personi kukull (front men, straw men) ose i personi i caktuar, është personi i cili lidh kontrata, bën transaksione, hap llogari bankare ose merr shërbime të tjera financiare, ose bën biznes në emrin e tij duke fshehur personin të cilit i përkasin asetet.

Personat kukull janë zakonisht të afërm të autorit ose persona të besuar. Në disa raste, ata mund të jenë pastrues profesionistë parash që ofrojnë këto shërbime, apo kategori të veçanta si të pastrehë, të moshuar, të rinj të kontraktuar nga profesionistët.

Organizatrat dhe individët e përfshirë në veprimtari kriminale përdorin këtë tipologji për t'u distancuar nga prona e përfituar me para të paligjshme, nëpërmjet regjistrimit të pasurive të paluajtshme, automjeteve dhe pasurive të tjera në emër të këtyre palëve të treta.

Sa i përket zbulimit të personave kukull, është e zakonshme që kur kryejmë hetime të disa autorëve, zbulojmë se ata përdorin automjete shumë luksoze ose banojnë në banesa shumë të shtrenjta, dhe kontrollohet në bazat e të dhënave, na tregojnë se këto pasuri duket se janë në pronësi të palëve të treta, të cilët veprojnë si persona kukull.

B) SHOQËRITË GUASKË, TË GATSHME DHE LLOJET E TJERA TË SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë Tregtare⁴ përdoren si subjekte juridike përmes të cilave ndërmerren veprimtari të shumëllojshme tregtare dhe zotërohen asetet. Në ekonomitë e tregut shumica e veprimtarive tregtare dhe sipërmarrëse kryhet në këto subjekte. Pavarësisht rolit të rëndësishëm dhe legjitim që këto subjekte luajnë në sistemin ekonomik botëror, në kushte të caktuara ato mund të keqpërdoren për qëllime të paligjshme, duke përfshirë pastrimin e parave, korrupsionin, mashtrimin tatimor dhe forma të tjera të veprimtarive të paligjshme.

4. Pas Vitrinës së Korporatës – Përdorimi i Subjekteve Korporatë për qëllime të jashtëligjshme; Raport I OECD-së (2001).

Përdorimi i shoqërive tregtare si mjete për kryerjen e veprimtarive të paligjshme është mekanizëm tërheqës, sepse këto subjekte mund t'u mundësojnë autorëve të fshehin identitetin e tyre pas "vitrinës" së një personi tjetër juridik.

Shoqëritë e gatshme⁵: Një shoqëri e gatshme (shelf company) janë shoqëri tregtare të themeluara nga profesionistët si trust apo shoqëri, që lihet pa veprimtari dhe qëndron e "gatshme". Më pas, kjo shoqëri i shitet zakonisht dikujt të cilit i intereson të ketë shoqëri ekzistuese dhe jo të themelojë të re. Vlera e një shoqërie të gatshme është se shoqëria mund të vijë me të dhëna ekzistuese, siç është mundësia huamarrëse e shoqërisë, duke dhënë kështu përshtypjen të veprimtarisë së shoqërisë që prej themelimit.

Shoqëritë guaskë⁶: Shoqëria guaskë mund të përkufizohet si shoqëri pa veprimtari, për shembull, një shoqëri që nuk ka veprimtari të pavarur, aktive të qenësishme, veprimtari të vazhdueshme apo punonjës.

Ndërmjetësit profesionistë ia ofrojnë këto shoqëri guaskë kriminelëve që i përdorin për të fshehur gjurmët e parave duke transferuar fondet e paligjshme në dhe nga llogaritë bankare të shoqërisë ose fshehin pronësinë e vërtetë të çdo malli. Qëllimi kryesor ose i vetëm është fshehja e pronarit përfitues përfundimtar nga autoritetet. Shoqëritë Guaskë quhen gjithashtu shoqëri vitrinë ose shoqëri kutie postare.

Shoqëria fantazmë: Shoqëria "fantazmë" mund të përkufizohet si shoqëri e krijuar vetëm për qëllimin e kryerjes së një ose disa transaksioneve (p.sh., pagesa për mallra dhe shërbime, nëse ka tregues të PP të mundshme të bazuar në tregti (PPBT) dhe më pas mbyllet ose lihen të fjetura dhe jo funksionale.

Mjeti ose subjekti për qëllime të veçanta: "Mjeti ose subjekti për qëllime të veçanta" mund të jetë filial i krijuar nga një shoqëri mëmë për të izoluar rrezikun financiar (p.sh., nëse shoqëria mëmë falimenton) me qëllim menaxhimin e mbrojtjes së aseteve, dhe si strategji për mbrojtjen e aseteve. Ashtu si në rastin e shoqërive guaskë, subjekti juridik nuk është funksional dhe qëllimi i tij kryesor është të zotërojë pronësinë e aseteve.

Shoqëritë e Biznesit Ndërkombëtar (IBC): Shoqëritë e biznesit ndërkombëtar ose korporatat e biznesit ndërkombëtar (IBC) janë shoqëri tregtare offshore të themeluara sipas legjislacionit të disa juridiksioneve si shoqëri me tatime neutrale, e cila zakonisht është e kufizuar në aspektin e veprimtarive që mund të kryejë, por jo domosdoshmërisht nga juridiksioni në të cilin është regjistruar.

Karakteristikat e një IBC-je ndryshojnë nga juridiksioni në juridiksion, por ato zakonisht përfshijnë:

- Përrjashtim nga taksat vendore të shoqërive tregtare dhe pullat tatimore, me kusht që shoqëria të mos ketë veprimtari në vend (tarifat vjetore të agjentit dhe taksat e regjistrimit të shoqërisë paguhet në çdo rast).
- Ruajtjen e fshehtësisë së pronarit përfitues të shoqërisë.
- Tagër të gjerë të shoqërisë tregtare për të marrë pjesë në biznese dhe veprimtari të ndryshme.
- Detyrime të kufizuara për deklarimin e fitimeve të shoqërisë.
- Aftësinë për të emetuar aksione të regjistruara ose të paregjistruara, megjithëse shumë vende i kanë kufizuar ose eliminuar aksionet e paregjistruara.
- Shfuqizimin e çdo kërkesë për emërimin e drejtorëve apo zyrtarëve vendas.
- Sigurimin e një agjenti të regjistruar ose selie të regjistruar në vend.

5. Gjurmimi i Pasurive të Jashtëligjshme: Udhëzues për Profesionistët; Raport i Institutit të Bazelit – Qendra Ndërkombëtare për Rekuperimin e Aseteve (2015).

6. Gjurmimi i pasurive të paligjshme Udhëzues për profesionistët; raport i Institutit të Bazelit – Qendra Ndërkombëtare për Rikuperimin e Pasurive (2015)

C) OFRUESI I SHËRBIMIT TË TRUSTEVE DHE SHOQËRIVE TREGTARE

Sipas Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF)⁷, Ofruesit e Shërbimeve të Trusteve dhe Shoqërive Tregtare përfshijnë të gjithë ata që i ofrojnë palëve të treta shërbimet e mëposhtme:

- veprojnë si agjent formimi i personave juridikë;
- veprojnë si (ose mundësojnë që një person tjetër të veprojë si) drejtor ose sekretar i shoqërisë, ortak ose pozicion të ngjashëm në lidhje me persona të tjerë juridikë;
- sigurojnë seli; adresë biznesi ose akomodimi, letërkëmbimi ose administrative;
- adresën e shoqërisë, ortakërisë ose të ndonjë personi ose organizimi tjetër juridike;
- veprojnë si (ose mundësojnë që një person tjetër të veprojë si) i besuar i një trusti të krijuar posaçërisht;
- veprojnë si (ose mundësojnë që një person tjetër të veprojë si) aksionar i emëruar për një person tjetër.

Neni 3 i Ligjit për PPPFT përfshin personat fizik ose juridikë që ofrojnë këtë lloj shërbimi për një klient si subjekte me detyrim që i nënshtrohen këtij ligji, në kuadër të përkufizimeve të subjekteve që i nënshtrohen ligjit.

Konventa e Hagës “Për Legjislacionin e Zbatueshëm për Trustet dhe Njohjen e Tyre” (1985) pasrashikon në nenin 2 se termi “trust” i referohet marrëdhënies juridike, midis të gjallëve apo si pasojë e vdekjes, përmes së cilës një person, besuesi, ka vënë pasuri nën kontrollin e një të besuari për llogari të një përfituesi apo për një qëllim të posaçëm. Megjithëse Shqipëria nuk e ka ratifikuar këtë Konventë, ky përkufizim është përfshirë në legjislacionin shqiptar.

Sipas nenit 2, pika 19, të Ligjit për PPPFT-në “trust” i referohet një marrëdhënie juridike ndërmjet të gjallëve apo për shkak të vdekjes, me të cilën një person, besuesi, vë pasuri nën kontrollin e një të mirëbesuari për llogari të një përfituesi apo për një qëllim të posaçëm. Kështu “trusti” ka karakteristikat e mëposhtme:

- a) pasuritë përbëjnë një fond të veçantë dhe nuk përfshihen në pasurinë e të mirëbesuarit;
- b) pronësia e pasurive të trustit mbahet nga i mirëbesuari ose nga një person tjetër për llogari të të mirëbesuarit;
- c) i mirëbesuari ka të kompetencën dhe detyrën të kryejë me përgjegjësi administrimin, përdorimin dhe disponimin e pasurive në përputhje me kushtet e trustit dhe detyrat e posaçme të ngarkuara atij me ligj.

Në të njëjtin ligj, në nenin 2, pika 29, “Kujdestari” përkufizohet si personi, i cili është ligjërisht i autorizuar të kontrollojë dhe të administrojë fonde apo pasuri të një organizimi juridik për llogari të një palë të tretë.

Pra, pikat kyçe që duhen kuptuar janë:

- Elementet ose palët kryesore të një trust-i janë besuesi, i mirëbesuari i trust-it, përfituesit dhe pronat e trust-it. Përveç kësaj, është e mundur të përfshihet figura e mbrojtësit në strukturën e trust-it.
- Besuesi transferon pronësinë e pasurive të caktuara tek i mirëbesuari me anë të një akti ose deklaratë mirëbesimi (megjithëse nuk është domosdoshmërisht e nevojshme që akti të jetë i shkruar).
- Këto pasuri duhet të administrohen dhe përdoren për të mirën e përfituesve të përcaktuar ose të pa përcaktuar. Kjo përbën detyrim shtrëngues.
- Gjatë procesit të transferimit, ose “vendosjes” së pasurive të caktuara, pronësia ose kontrolli juridik i pasurive (e njohur si pronë në trust) është e ndarë nga interesi përfitues lidhur me këto pasuri.
- Mbrojtësi mund të caktohet për të mbikëqyrur veprimet e administratorit të besuar mbi trust-in dhe të vlerësojë nëse ato veprime janë në interesin më të mirë të përfituesve.

7. Udhëzuesi i FATF-së për një qasje të bazuar në risk për ofruesit e shërbimeve të trusteve dhe shoqërive

Sipas nenit 3/1 të Ligjit të PPPTF, Kujdestarët e “trust” janë të detyruar të:

- Deklarojnë statusin e tyre e të vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga subjektet e këtij ligji kur lidhin marrëdhënie biznesi apo kur kryejnë transaksione rastësore me to.
- Mbajnë informacion thelbësor për themeluesit, përfituesit, të mirëbesuarit ose personat me kontroll *de-facto* mbi to, agjentët e tjerë objekt normimi dhe ofruesit e shërbimeve, përfshirë këshilltarët, menaxherët, kontabilistët dhe këshilltarët tatimorë/fiskalë.
- Mbajnë informacion të saktë, të përshtatshëm, të vlefshëm dhe të përditësuar lidhur me këto çështje.

D) PRONËSIA PËRFITUESE

‘Pronari përfitues’ është personi fizik fundor që zotëron ose kontrollon një klient dhe/ose personi fizik në emër të të cilit kryhen transaksionet. Këtu përfshihen edhe personat që ushtrojnë kontroll efektiv fundor mbi një person ose marrëveshje juridike.

Konceptet “përfundimisht zotëron ose kontrollon” dhe “kontroll efektiv fundor” kanë të bëjnë me situata në të cilat pronësia/kontrolli ushtrohet nëpërmjet një zinxhiri pronësie ose me anë të mënyrave të kontrollit, përveç atij të drejtpërdrejtë.

Ligji Nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2022, përkufizon në nenin 3 pika 1 “Pronarin përfitues» (PP) si individin që ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individin në emër të të cilit kryhen transaksionet ose veprimtaritë dhe përfshin të paktën:

- Një individ i cili ka në pronësi ose kontroll përfundimtar mbi një person juridik, përmes pronësisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një përqindje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votimit ose të pjesëmarrjes në kapitalin e atij subjekti, përfshirë përmes mbajtjes së aksioneve, ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, ose që përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij.
- Themeluesin ose përfaqësuesin ligjor ose individin që ushtron kontrollin fundor efektiv mbi administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse.
- Kontroll fundor efektiv është marrëdhënia në të cilën një person:
 - o përcakton vendimmarrjen e organizatës jofitimprurëse;
 - o kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të organizatës jofitimprurëse.

Në rastin e një trusti ose marrëveshjeve të tjera juridike:

Themeluesi i trust-it, kujdestari/i mirëbesuari, mbrojtësi, nëse ka, dhe përfituesit ose kur personat që përfitojnë nga marrëveshja juridike ose subjekti nuk janë përcaktuar ende, klasa e personave për interesin kryesor të të cilëve është krijuar ose funksionon marrëveshja juridike ose subjekti; çdo individ tjetër që ushtron kontrollin fundor mbi trustin me anë të pronësisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose me mjete të tjera.”

E) PARAJSAT FISKALE DHE JURIDISKIONET JOBASHKËPUNUESE

Konceptet që lidhen me këto çështje janë shumë të ngjashme, të cilat profesionistët e zbatimit të ligjit duhet t'i dallojnë dhe t'i përdorin saktë në raportet e tyre.

Juridiksioni Jobashkëpunues. Juridiksion jobashkëpunues është çdo vend të huaj i përcaktuar nga FATF⁸-ja si jobashkëpunues në kuadër të parimeve ose procedurave ndërkombëtare kundër pastrimit të parave.

Në periudhën 2000-2006, FATF ndërmori procesin për vendet dhe territoret jobashkëpunuese (VTJB). Rezultati i procesit solli përcaktimin e 23 juridiksioneve si jobashkëpunuese për shkak të mungesës së një sistemi të efektshëm për KPP/LFT. Procesi ishte shumë i suksesshëm. Të 23 juridiksionet e identifikuara si VTJB në vitin 2000 dhe vitin 2001 shënuan përparim të konsiderueshëm dhe vendi i fundit u nxor nga lista në tetor të vitit 2006.

Që prej vitit 2007, Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar të FATF-së (ICRG) analizon juridiksionet me risk të lartë dhe rekomandon veprime të veçanta për trajtimin e rreziqeve të PP/FT që rrjedhin prej tyre. FATF-ja identifikon juridiksionet me masa të dobëta në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (KPP/LFT) në dy dokumente publike që FATF-ja i boton tre herë në vit. Procesi i FATF-së për shpalljen publike të vendeve me regjime të dobëta KPP/LFT ka pasur efekt:

- **Juridiksionet me risk të lartë** kanë mangësi të rëndësishme strategjike në regjimet e tyre të luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të shtimit të armatimeve. FATF-ja u bën thirrje të gjithë anëtarëve lidhur me të gjitha vendet e identifikuara si me risk të lartë dhe nxit gjitha juridiksionet të përforcojnë zbatimin e vigjilencës së përshtatshme, ndërkohë që për rastet më serioze, vendeve u bëhet thirrje të zbatojnë kundërmasa për mbrojtjen e sistemit financiar ndërkombëtar nga rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të shtimit të armatimeve të vendit në fjalë. Shpesh kjo listë njihet si "**lista e zezë**".
- **Juridiksionet nën monitorim të shtuar** po punojnë aktivisht me FATF-në për trajtimin e mangësive strategjike në regjimet e tyre të luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të shtimit të armatimeve. Vënia e një juridiksioni nën monitorim të shtuar nga FATF-ja, do të thotë se vendi është angazhuar të zgjidhë sa më shpejt brenda afateve të rëna dakord mangësitë strategjike të identifikuara dhe se i nënshtrohet monitorimit të shtuar. Shpesh kjo listë shpesh njihet si "**lista gri**".

Këto lista përditësohen çdo gjashtë muaj dhe mund të konsultohen në faqen e internetit të FAFT-së⁹.

Lista e juridiksioneve jo bashkëpunuese e BE-së.¹⁰ Neni 9 i Direktivës 2015/849 (BE) përcakton që juridiksionet e vendeve të treta që kanë mangësi strategjike në regjimet e tyre kombëtare të LPP/LFT-së dhe që paraqesin kërcënime të rëndësishme ndaj sistemit financiar të Bashkimit ('vendet e treta me risk të lartë') duhet të identifikohen për të mbrojtur funksionimin e duhur të tregut të brendshëm.

Për këtë arsye, lista e juridiksioneve jo bashkëpunuese e BE-së, e miratuar për herë të parë në përfundimet e Këshillit të 5 dhjetorit 2017, është pjesë e përpjekjeve të BE-së për të luftuar evazionin fiskal dhe praktikat e dëmshme tatimore. Shtatëmbëdhjetë juridiksione u përfshinë në listë në dhjetor të vitit 2017 nga nëntëdhjetë e dy juridiksionet e përzgjedhura fillimisht për shqyrtim. Që atëherë, në kuadër të angazhimeve të juridiksioneve të identifikuara për të përmbushur kriteret e BE-së, lista e juridiksioneve jobashkëpunuese e BE-së dhe lista gri e BE-së (juridiksionet, angazhimet e të cilave për të përmbushur standardet e BE-së po monitorohen) janë ndryshuar disa herë.

8. [https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc\(fatf_releasedate\)](https://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/?hf=10&b=0&s=desc(fatf_releasedate))

9. <https://www.fatf-gafi.org>

10. <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/eu-list-of-non-cooperative-jurisdictions/timeline-eu-list-of-non-cooperative-jurisdictions/>

Më 24 shkurt 2022, lista e juridiksioneve jo bashkëpunuese e BE-së përfshinte nëntë juridiksionet e mëposhtme¹¹: Samoa Amerikane, Fixhi, Guam, Palau, Panama, Samoa, Trinidad dhe Tobago, Ishujt e Virgjër të SHBA dhe Vanuatu.

Lista përcaktohet në Shtojcën I të Përfundimeve të Këshillit mbi listën e juridiksioneve jobashkëpunuese të BE-së për qëllime tatimore. Përfundimet përfshijnë gjithashtu një dokument të situatës aktuale (Shtojca II) që identifikon juridiksionet bashkëpunuese që kanë bërë përmirësime të mëtejshme në politikat e tyre tatimore ose bashkëpunimin përkatës. Këto lista përditësohen dy herë në vit.

Qendra financiare Offshore (OFC). Qendrat financiare offshore (OFC) përkufizohen si “vend ose juridiksion që ofron shërbime financiare për shtetas të huaj në përpjesëtim të zhdrejtë me përmasat dhe financimin e ekonomisë vendase”¹².

FMN-ja ka përcaktuar katër tipare kryesore që përkufizojnë OFC-në¹³:

- Orientimi parësor ndaj shtetasve të huaj;
- Mjedisi i favorshëm rregullator;
- Sistem me tatime të ulëta ose pa tatim;
- Mospërputhje midis përmasave të sektorit financiar dhe nevojave të brendshme për financim.

Duhet theksuar se programi OFC nisi të zbatohet në vitin 2000, por që prej vitit 2008, FMN-ja nuk ka përdorur apo mbajtur një listë të Qendrave Financiare Offshore.

F) MUSHKAT E PARAVE^{14 15}

“Mushka” e parave (money mule) është një lloj mekanizmi të pastrimit të parave. Këta janë individë që presin para nga një palë e tretë në llogarinë e vet bankare dhe ia transferojnë ato një tjetri ose i tërheqin si mjete monetare dhe ia japin dikujt tjetër, duke marrë komision në këmbim.

Mushkat e parave rekrutohen nga kriminelët për të lëvizur fonde nëpërmjet një sërë metodash, duke përfshirë:

- Para fizike (mjete monetare);
- Transferta bankare;
- Bizneset e shërbimeve të parasë;
- Kartat me parapagesë;
- Kriptomonedha.

Edhe nëse mushkat e parave nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në veprimtaritë kriminale që gjenerojnë paratë (krim kibernetik, pagesa dhe mashtrime në internet, drogë, trafik në qenie njerëzore, etj.), ata janë bashkëpunëtorë, pasi pastrojnë produktet e këtyre veprave. Mushkat e parave ndihmojnë grupet kriminale të ruajnë anonimin gjatë lëvizjes së fondeve nëpër botë.

11. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-6437-2022-INIT/en/pdf>

12. <https://www.imf.org/external/pubs/ft/ep/2007/ep0787.pdf>

13. <https://www.imf.org/external/np/mae/oshore/2000/eng/back.htm>

14. <https://www.europol.europa.eu/operations-services-and-innovation/public-aëareness-and-prevention-guides/money-muling>

15. <https://www.fbi.gov/scams-and-safety/common-scams-and-crimes/money-mules>

Individët që veprojnë si mushka parash mund të kenë marrë emaile anonime ose komunikime të tjera me oferta pune me paga të jashtëzakonshme, u është kërkuar të hapin llogari bankare në emrin e tyre ose në emrin e një biznesi të hapur prej tyre, dhe/ose u është kërkuar të presin fonde dhe më pas t'i përcjellin të gjitha ose një pjesë të tyre tek individë të tjerë.

Çdokush mund të rekrutohet për të qenë mushkë parash, megjithatë, individët që synohen kryesisht janë të moshuarit, studentë dhe individë që sapo kanë imigruar. Ata nuk kanë nevojë të kenë njohuri të teknologjisë së informacionit, sepse mushka e parave do të drejtohet në cilat banka të shkojë, sa dhe çfarë lloj llogarish të hapin dhe sa para duhet të ketë në çdo tërheqje ose transaksion vijues.

Mushkat e parave mund të kategorizohen në tre grupe kryesore: pa dashje/pa dijeni, me dijeni dhe bashkëpunëtorë:

- Mushkat pa dashje apo që nuk kanë dijeni nuk janë të vetëdijshëm se janë të përfshirë në një skemë më të madhe kriminale. Zakonisht, këta individë rekrutohen përmes mashtrimeve romantike dhe u kërkohej të presin fonde në llogaritë bankare personale. Mushkës së parave i thuhet të mbajë një pjesë të fondeve që presin si dhuratë ose pagesë për "mundimin". Në përgjithësi, këta individë besojnë vërtet se po ndihmojnë dikë që po vepron si partneri ose punëdhënësi i tyre romantik.
- Mushkat me dashje neglizhojnë treguesit paralajmërues të veprimtarisë kriminale ose bëjnë me dashje një sy qorr ndaj veprimtarive financiare në të cilat marrin pjesë. Ata mund të kenë marrë paralajmërime nga personeli i bankës, por vazhdojnë të hapin llogari të shumëfishta. Zakonisht, këta individë përfshihen fillimisht si mushkë pa dashje.
- Mushkat konsiderohen bashkëfajtorë kur janë të vetëdijshëm për rolin e tyre si mushka parash dhe janë bashkëfajtorë në skemën më të madhe kriminale. Ata mund të hapin rregullisht llogari bankare në institucione të ndryshme me qëllim pritjen e fondeve të jashtëligjshme. Ata gjithashtu mund të reklamojnë hapur shërbimet të lëvizjes së parave dhe të rekrutojnë aktivisht të tjerë.

Oficerët e Policisë Gjyqësore (OPGJ) nuk duhet të harrojnë fenomenin e vjedhjes së identitetit, sepse ndodh rëndom që grupet kriminale të përdorin këto identitete për të hapur llogari bankare dhe për të lëvizur fondet e jashtëligjshme.

G) KRIPTOASETET

Banka Qendrore Europiane (BQE) i përkufizon monedhat virtuale si paraqitje digjitale të vlerave përkatëse, të cilat nuk emetohen nga bankat qendrore, institucione krediti apo institucione të parave elektronike, të cilat në disa rrethana mund të përdoren në vend të parasë¹⁶. BQE-ja nënvizon gjithashtu se kriptovalutat, si Bitcoin, janë valutë virtuale e decentralizuar me dy drejtime (d.m.th. dypalëshe).

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) i kategorizon kriptovalutat si nëngrup të valutave virtuale, të cilat i përkufizon si përfaqësim digjital të vlerës, të emetuara nga zhvillues privatë dhe të përcaktuara sipas njësisë së vet të kontabilitetit¹⁷.

Autoriteti Bankar European (ABE) ka sugjeruar që kriptomonedhat të konsiderohen valuta virtuale, të cilat i përkufizon si përfaqësim digjital të vlerës që nuk janë emtuar nga një bankë qendrore apo autoritet

16. <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemesen.pdf>

17. <https://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2016/sdn1603.pdf>

publik dhe as nuk janë të bashkangjitura domosdoshmërisht me CASH, por përdoren nga persona fizikë ose juridikë si mjet këmbimi dhe mund të transferohen, ruhen ose tregtohen në mënyrë elektronike¹⁸.

Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) e përkufizon "Asetin virtual"¹⁹ si përfaqësim digjital të vlerës që mund të shkëmbehet ose transferohet në mënyrë digjitale dhe mund të përdoret për qëllime pagese ose investimi. Asetet virtuale nuk përfshijnë përfaqësime digjitale të parave fizike, letrave me vlerë dhe aktiveve të tjera financiare që trajtohen nga instrumente të tjera të FATF-së.

Për sa i përket legjislacionit shqiptar, DLT (Digital Ledger Technology) e përkufizon valutën virtuale si një nga aktivet virtuale, që është përfaqësim digjital i vlerës, që përdoret si mjet këmbimi, mjet pagese, njësi kontabiliteti ose ruajtëse e vlerës, dhe që:

- i. nuk është Token (shënjuar) Digjital sipas përcaktimit me ligj;
- ii. nuk është emetuar ose garantuar nga një bankë qendrore ose një autoritet qeveritar;
- iii. nuk është domosdoshmërisht e lidhur me një valutë të përcaktuar juridikisht,
- iv. nuk është para fizike dhe për rrjedhojë nuk ka statusin juridik të monedhës ose parasë, por pranohet nga persona fizikë ose juridikë si mjet këmbimi;
- v. është lëshuar në DLT-në e vet; dhe
- vi. mund të transferohet, ruhet dhe tregtohet në mënyrë elektronike.

Në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, aseti virtual përkufizohet si përfaqësim digjital i një vlere që mund të ruhet, tregtohet ose transferohet në formë digjitale dhe që mund të përdoret për qëllime pagese ose investimi ose si mjet këmbimi, përfshirë por pa u kufizuar në, kriptovalutat. Ky përkufizim nuk përfshin përfaqësimet digjitale të parasë fizike të emetuara ose të garantuara zyrtarisht nga bankat qendrore ose një autoritet publik, letrat me vlerë dhe aktive të tjera financiare të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

H) OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË ASETEVE VIRTUALE (VASP)

FATF përkufizon²⁰ "Ofruesin e shërbimeve të aseteve virtuale» si person fizik ose juridik që kryen një ose më shumë nga veprimtaritë ose operacionet e mëposhtme për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik:

- i. Këmbim midis aseteve virtuale dhe valutave fiat;
- ii. Këmbim ndërmjet një ose më shumë formave të aseteve virtuale;
- iii. Transferim të aseteve virtuale; dhe
- iv. Ruajtje dhe/ose administrim të aseteve apo instrumenteve virtuale që mundësojnë kontrollin mbi asetet virtuale;
- v. Pjesëmarrje në dhe ofrim të shërbimeve financiare në lidhje me ofertën e një emetuesi dhe/ose shitjen e një aseti virtual.

Në këtë përkufizim, VASP-të përfshijnë shkëmbimet AV dhe shërbimet e transferimit; ofrues të portofolit AV, të tillë si ata që ofrojnë hapësirë kompjuterike për portofolët virtualë ose ruajnë ose kontrollojnë AV-të, portofolët dhe/ose çelësat privatë të një personi tjetër fizik ose juridik; ofruesit e shërbimeve

18. Opinioni i BQE mbi "monedhat virtuale" (2014).

19. Fjalorth i rekomandimeve të FATF.

20. Po aty.

financiare që emetojnë, ofrojnë ose shesin AV (si p.sh. në rastin e Ofertave Ndërkombëtare të Monedhave (*International Coin Offer_ ICO*); dhe modele të tjera të mundshme biznesi.

Sa i përket legjislacionit shqiptar, APMLFT e përkufizon ofruesin e shërbimit të aseteve virtuale si çdo person fizik ose juridik, i cili kryen, për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik, një ose më shumë nga këto veprimtari:

- i. shkëmbimin ndërmjet mjeteve virtuale dhe monedhave të njohura zyrtarisht;
- ii. shkëmbimin ndërmjet mjeteve virtuale dhe pasurive të çdo lloji me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) Lekë;
- iii. shkëmbimin ndërmjet një ose më shumë formave të mjeteve virtuale;
- iv. transferimin e mjeteve virtuale;
- v. ruajtjen dhe/ose administrimin e mjeteve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontroll mbi mjetet virtuale;
- vi. pjesëmarrjen dhe sigurimin e shërbimeve financiare lidhur me ofertën e një emetuesi dhe/ose shitjen e një mjeti virtual”.

Në këtë përkufizim, transferimi nënkupton kryerjen e transaksionit për llogari të një personi tjetër fizik apo juridik, që lëviz mjetin virtual nga adresa e mjetit virtual ose llogaria e një personi tjetër.

3.

Metodologjia e hetimit të pastrimit të parave (PP)

A) FILLIMI I HETIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

OPGJ-të i marrin njoftimet e para të fakteve që rezultojnë në nevojën e hetimeve ekonomiko-financiare në mënyra të ndryshme:

- Me kërkesë të Prokurorisë, e cila urdhëron nisjen e hetimeve për faktet për të cilat ka dijeni;
- Nga kallzimi penal, i bërë nga shtetas apo institucione të ndryshme (Neni 280 e vijues i K. Pr. Penale);
- Nëpërmjet informacionit nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) përmes raporteve të saj të inteligjencës, apo nga institucione të tjera publike si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj;
- Me kërkesë bashkëpunimi policor ndërkombëtar, duke përdorur kanalet e ndryshme ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- Me kërkesë të autoriteteve të huaja gjyqësore, të dërguara nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme për verifikim pasuror;
- Me nismën e saj, kur Policia e Shtetit kryen hetime ndaj grupeve kriminale aktive dhe në kuadër të qasjes gjithëpërfshirëse të luftës kundër krimit të organizuar, apo kundër pastruesve profesionistë që ofrojnë shërbime për grupe të ndryshme kriminale (krimi si shërbim).


Në varësi të informacionit të marrë, OPGJ-të mund të përcaktojnë dy rrugë për gjurmimin e parave e paligjshme që autorët përpiqen t'i pastrojnë:

- Gjurmimin e rrugës që ndjekin paratë nga vepra penale mëmë e tutje, kur vepra penale mëmë është e identifikuar qartë.
- Ose, gjurmimin e rrugës që ndjekin paratë nga destinacioni fundor deri në burimin e tyre, kur vepra penale mëmë nuk është identifikuar ende dhe kur OPGJ-të kanë dijeni vetëm për disa transaksione të dyshimta.

Pasi të kenë marrë informacionin e parë për veprat e dyshuara penale që duhen hetuar, OPGJ-të duhet t'i qasen hetimit në mënyrë metodike dhe sipas një plani të mirëpërcaktuar.


Për të nisur një hetim për pastrim parash, organi i procedimit duhet të përcaktojë tre kritere të cilat duhet të përmbushen njëkohësisht:

- Shtimi i pazakontë i pasurive/aseteve, ose rritja e papritur e pasurisë;
- Mungesa e veprimtarive të ligjshme ekonomike për justifikimin e tyre;
- Lidhjet ndërmjet të dyshuarit dhe veprimtarive kriminale, ose ndonjë lidhje me njerëz ose grupe të përfshira në veprimtari kriminale.



B) FAZAT E HETIMIT FINANCIAR

Në kuadrin e hetimeve financiare, identifikojmë tre faza:



- **Faza e mbledhjes dhe analizimit të informacionit:** Në këtë fazë të parë, OPGJ-ja mbledh informacionin përkatës nga burime të ndryshme informacioni dhe i analizon për të marrë indicie inkriminuese të përcaktuara sipas ligjit²¹.

Gjatë hetimit financiar është e nevojshme që, në bazë të Kodit të Procedurës Penale, organi i akuzës të kryejë hetim të brendshëm dhe të shfrytëzojë bashkëpunimin ndërkombëtar për identifikimin në subjektet publike dhe private të produkteve të veprës penale të pastruara, dhe pasurinë e autorëve.

21. Këta tregues apo rrethana faktike përmenden në Udhëzimin e Përgjithshëm Detyrues të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 dhe përcaktohen në kapitullin e parë të këtij manuali.

Krijimi i mekanizmave dhe protokolleve për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private që marrin pjesë në luftën kundër pastrimit të parave dhe rekuperimit të aseteve kanë sjellë rezultate të efektshme në kryerjen e hetimeve financiare, duke përmirësuar shpejtësinë e qasjes në informacion dhe efektshmërinë përfundimtare të tij.

Në këtë kuadër mund të ketë 2 nënfaza, në varësi të përfshirjes së Prokurorisë:

- **Faza paraprake:** Kjo është faza e parë, e cila nis nga hapja e hetimeve, kur Policia e Shtetit/OPGJ merr informacionet e para për faktet e mundshme kriminale, deri në momentin kur Policia e Shtetit/OPGJ njofton Prokurorinë lidhur me këtë. Në këtë moment, policia e shtetit merr informacion duke hyrë në bazat e të dhënave të veta dhe bazat e të dhënave të jashtme për të cilat nuk nevojitet urdhër prokurori apo gjyqtari. Kjo fazë vijon me hartimin e një raporti paraprak drejtuar prokurorit, që përfshin informacionin e mbledhur, përfshirë dhe identifikimin e aseteve, analizën përkatëse dhe një përfundim ku renditen indiciet mbi pastrimin e parave.

Për sa i përket legjislacionit shqiptar, sipas nenit 293 të Kodit të Procedurës Penale, policia gjyqësore, me njoftimin e një veprë penale, i referon me shkrim prokurorit elementët thelbësorë të veprës penale dhe elementët e tjerë të mbledhur deri në atë moment.

Disa nga veprimet që mund të kryhen nga Policia janë këto:

- Informacion nëse personi i dyshuar ka qenë i përfshirë në veprimtari kriminale të kryer brenda dhe/ose jashtë vendit.
- Verifikimi i pasurive (pasuri të paluajtshme, automjete, mjete lundruese, shoqëri tregtare, etj.) duke kërkuar informacion tek institucionet përkatëse.
- Verifikime në terren, që krahasojnë realitetin me informacionin e marrë nga burimet.

Legjislacioni shqiptar parashikon kompetencat e nevojshme si për prokurorinë dhe OPGJ-në në lidhje me mbledhjen e të dhënave pasurore dhe verifikimin e tyre. Kështu që, sipas Nenit 8 të LAM²², OPGJ-ja ka të drejtë të verifikojë asetet që duhen verifikuar me nismën e vet sipas këtij ligji, dhe t'ia referojë të dhënat e marra prokurorit. Në interpretimin e kësaj dispozite, OPGJ-ja ka kompetencën të kërkojë informacion paraprakisht dhe të sigurojë të dhëna për t'i vënë ato në dispozicion të prokurorit. Gjithashtu, Policia e Shtetit ka edhe kapacitetin për të mbledhur informacion brenda kompetencave të veta²³. **Faza e prokurorit:** Pas referimit të çështjes në prokurori, prokurori njihet me faktet e përfshira në referimin e OPGJ-së.

Memorandumi i Bashkëpunimit midis Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i vitit 2020 "Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimit të aseteve kriminale, në funksion të përmushjes së rekomandimeve të FATF-së,..." parashikon shprehimisht bashkërendimin e veprimtarisë së shërbimeve të OPGJ-së me prokurorinë përpara fazës së referimit, nëpërmjet një konsultimi mes tyre dhe vlerësimit paraprak të materialeve nga prokurori.

22. Shih nenin 8 të Ligjit Anti Mafia ku "1. Prokuroria dhe policia gjyqësore marrin dënimin për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, me iniciativën e vet ose me njoftim të bërë nga të tretët. 2. Me marrjen dënimin për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe të dhënat e siguruar prej saj. 3. Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, subjekte të zbatimit të këtij ligji."

23. Shih Nenin 129 të Ligjit për Policinë e Shtetit.

Ky konsultim paraprak është i nevojshëm për të shmangur parandalimin e fillimit të procedimit penal në ato raste kur nuk ka të dhëna të dokumentuara që vërtetojnë elementet bazë të veprimitarisë kriminale.

Referuar nenit 5, pika 7, geramat a dhe b të këtij Memorandumi gjatë fazës përpara referimit ky bashkërendim ka të bëjë me:

- a) konsultimin dhe vlerësimin paraprak të materialeve objekt referimi apo kallëzimi penal, dhe;
- b) në fazën e hetimeve paraprake, vlerësimin e informacioneve apo indicieve dhe administrimin e provave për ndjekjen penale.

Gjithashtu, sipas dispozitës së Nenit 5, pika 8 të Memorandumit, shërbimet e policisë gjyqësore bashkëpunojnë, shkëmbejnë informacione dhe kryejnë analiza të përbashkëta me institucionet e përfshira në këtë Memorandum, dhe jo vetëm, në të gjitha fazat e hetimeve paraprake.....”²⁴

Pas studimit të raportit të përgatitur nga OPGJ-ja, prokurori mund të veprojë në tre mënyra:

- Sa herë që e vlerëson të nevojshme, mund të kryejë veprime të mëtejshme verifikuese;
- Kur prokurori vlerëson se të dhënat e siguruar nga policia e shtetit dhe faktet mbi të cilat bazohet referimi janë të mjaftueshme për ngritjen e dyshimit lidhur me një prej veprimeve të renditura nga pika “a” deri në pikën “dh” të nenit 287 të KP-së, sipas nenit të sipërpërmendur, prokurori merr vendimin për regjistrimin e procedimit penal dhe urdhëron masat hetimore përkatëse për identifikimin e personave të përfshirë dhe veprës së kryer;
- Prokurori mund t’ia kthejë OPGJ-së raportin fillestar nëse ai nuk përmban provat e nevojshme që vërtetojnë ndonjë element bazë të pastrimit të parave. Kjo është mënyrë praktike për të shmangur regjistrimin e referimeve pa asnjë provë bazë dhe që nuk supozohet të kenë sukses.

Në dy mënyrat e para, me autorizimin e Prokurorit, OPGJ-ja mund të vijojë hetimin duke përdorur bazat e të dhënave të kufizuara, për të marrë informacion shtesë dhe më shumë indicie për veprimitarinë kriminale.

- **Faza e ditës së veprimit operacional:** Pas marrjes së indicieve nga hetimi financiar, duhet kryer veprim operacional (aksion) ndaj autorëve. Rekomendohet që në ditën e operacionit të kryhen arrestimet e personave të përfshirë në veprimitari kriminale, të ekzekutohen urdhra kontrolli, si dhe sekuestrohen asetet e zbuluara.

Ekzekutimi i efektshëm i kësaj faze është shumë i rëndësishëm, pasi vetëm në këtë moment mund të sekuestrohen dokumente të ndjeshme që mbeten të fshehura, si shënime të shkruara me dorë, kontrata private, llogari ose komunikime. Këto dokumente mund të konfirmojnë faktet e hetuara. Duhet të mbahet parasysh se ka shumë gjasa që këto dokumente të mos jenë më të aksesueshme në një moment të dytë pasi ato ose do të fshihen në vende të tjera më të sigurta ose do të asgjësohen.

- **Faza pas ditës së veprimit operacional:** Në këtë fazë, analizohen dokumentet dhe provat digjitale të sekuestruara për të vërtetuar hipotezat e ngritura gjatë hetimit. Kjo analizë e materialeve të sekuestruara mund të lejojë gjithashtu zbulimin e operacioneve të tjera të pastrimit të parave të pazbuluara më parë, si dhe identifikimin e autorëve të rinj dhe fakteve të reja penale.

24. Shih dokumentin e plotë në https://www.pp.gov.al/Bashkepunime/Marreveshje_Bashkepunimi/

C) METODOLOGJIA E PËRDORUR NË HETIME FINANCIARE

Pasi OPGJ-ja të ketë marrë informacionin fillestar për faktet penale, ai duhet të hartojë një hipotezë të parë hetimore. Me këto të dhëna të disponueshme dhe të pjesshme, OPGJ-ja mund të përcaktojë nëse po përballet me veprën e pastrimit të parave përmes tipologjive të ndryshme të mundshme apo po përballet vetëm me hetim të pasurisë. Gjithashtu, është e nevojshme të identifikohen veprat e mundshme penale mëmë që përbëjnë origjinën e fondeve të paligjshme.

OPGJ-ja duhet të vendosë objektivat që synon të arrijë me hetimin financiar. Kjo do të lejonte OPGJ-së të vlerësonte ecurinë e hetimit dhe të vlerësonte efektshmërinë në çdo moment.

Objektivat e përgjithshëm që duhet të përcaktohen gjatë hetimeve financiare janë si më poshtë:

- Identifikimi, gjetja dhe arrestimi i autorëve të përfshirë në veprat penale të pastrimit të parave, duke përcaktuar rolet e ndryshme të tyre;
- Zbulimi i aseteve të lidhura me këta autorë dhe sigurimi i provave për lidhjen ndërmjet aseteve dhe veprimtarive kriminale;
- Sigurimi i indiceve penale që lejojnë ndjekjen penale të këtyre autorëve, identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të tyre;
- Zbulimi i tipologjive të pastrimit të parave të përdorura për pastrimin e parave produkt i veprimtarive kriminale;
- Sigurimi i provave të lidhjes midis parave të pastruara dhe veprës mëmë përmes gjurmimit të operacioneve individuale të pastrimit të parave;
- Sekuestrimi i aseteve, me qëllim për të siguruar konfiskimin.

Nëse pikënisja e hetimit është një person i përfshirë në veprimtari kriminale, veprimet e para duhet të përqendrohen në identifikimin e tij të plotë, marrëdhëniet familjare, banesat, stilin e jetesës dhe çdo informacion të rëndësishëm që mund të konfirmojë informacionin e mëparshëm.

Nga ana tjetër, nëse pikënisja e hetimit është një transaksion i dyshimtë (zakonisht i marrë përmes një raporti të inteligjencës nga AIF) , është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje të gjitha të dhënave që mund të merren nga vetë raporti dhe dokumentet e bashkëngjitura, në mënyrë që të krahasohen me pjesën tjetër të të dhënave të disponueshme në bazat e tjera të të dhënave, dhe në të njëjtën kohë duhen bërë përpjekje për zbulimin e lidhjeve me veprat mëmë. Sipas rastit, mbetet në vlerësim edhe kërkimi i të dhënave shtesë nga AIF.

Për të arritur të gjithë këta objektiva është shumë e rëndësishme të kryhet një kontroll dhe vlerësim i të dhënave dhe hallkave në ecurinë e hetimeve përfshirë të dhënat në regjistrat përkatës të procedimit.

Faza e mbledhjes dhe analizës së informacionit

Duke pasur parasysh objektivat kryesore të hetimit financiar, organet e zbatimit të ligjit duhet të përcaktojnë qëllimin e hetimit. Kjo qasje u mundëson të jenë të qartë në çdo moment lidhur me thelbin e hetimit, përfshirë personat fizikë dhe juridikë. Ky qëllim duhet të rishikohet vazhdimisht, kështu që OPGJ-ja të mund ta zgjerojë ose kufizojë atë. Gjithashtu, kjo qasje u lejon të racionalizojnë hetimin dhe të mos e zgjerojnë atë në mënyrë të tepruar.

Pjesa thelbësore e hetimit duhet të përfshijë pjesëtarët e drejtpërdrejtë të familjes, pasi nga përvoja ata përdoren zakonisht si persona kukull (straw men). Koncepti se kush mund të konsiderohet familjar

i drejtpërdrejtë përcaktohet në Nenin 158 dhe Nenin 16 të KPrP-së, ku përfshihen bashkëshortët, bashkëjetuesit, të afërmit e ngushtë (paraardhësit, pasardhësit, vëllezërit, motrat, xhaxhallarët, tezet, nipat, mbesat, fëmijët e motrave dhe vëllezërve) ose të afërm nga ana e partnerit (vjehera, vjeherri, thjeshtri, thjeshtra, kunata, kunati, njerka, njerku).

Përkufizime të tjera se kush konsiderohen "persona të afërt" jepen në nenin 3.2 të Ligjit Anti Mafia në të cilin përkufizohen të afërmit duke përfshirë bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët, paraardhësit, pasardhësit, vëllezërit, motrat dhe bashkëjetuesit.²⁵

Përveç kësaj, njerëz (individë dhe persona juridikë) nga rrethi i tyre shoqëror dhe i veprimtarisë tregtare duhet të shqyrtohen mirë gjatë hetimit, duke u përpjekur të zbulohet njerëz që mund të veprojnë si figura, përfshirë edhe njerëzit e tyre të besuar dhe bashkëpunëtorët në veprimtaritë e tyre kriminale. Përfshirja e këtyre njerëzve duhet të bëhet në bazë të disa kriterëve logjike dhe të qëndrueshme dhe OPGJ-të duhet të jenë në gjendje të përjashtojnë personat që nuk i plotësojnë këto kriterë.


Neni 2.10 i Ligjit për PPPFT-në përfshin një përkufizim të personave të lidhur dhe anëtarëve të familjes së Personave të ekspozuar politikisht duke përcaktuar në nenin 2.10/1 se familjarët e personave të ekspozuar politikisht janë:

- a) bashkëshorti/ja apo bashkëjetuesi/ja i/e një personi të ekspozuar politikisht;
- b) fëmijët dhe bashkëshortët/et e tyre apo bashkëjetuesit/set e personit të ekspozuar politikisht;
- c) prindërit e personit të ekspozuar politikisht.

Ndërkohë, neni 2.10/2 përcakton se persona të lidhur, në marrëdhënie të ngushta personale, pune ose biznesi me personin e ekspozuar politikisht për qëllime të këtij ligji janë:

- a) individët që janë bashkërisht pronarë përfitues në persona juridikë ose organizime juridike apo çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngushtë biznesi me personin e ekspozuar politikisht;
- b) personat të cilët janë pronarët përfitues të vetëm një personi juridik apo organizimi juridik, i cili dihet se është krijuar për përfitimin de-facto të personit të ekspozuar politikisht.

25. Mbi kuptimin e paraardhësve dhe pasardhësve referojuni Kodit Civil Shqiptar në seksionin për trashëgiminë nenet 360-458, Përsa i përket bashkëjetuesve, referojuni Kodit Civil Shqiptar të Familjes, nenet 163-164. Shih edhe Ligjin nr.84/2016, datë 30.8.2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (i njohur si Ligji i Vettingut) i cili përdor termin "Persona të Lidhur" duke përcaktuar se ata përkufizohen si "është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile (neni 3.13). Ligji nr. 95/2016, date 6.10.2016 "Për Organizimin Dhe Funkcionimin E Institucioneve Për Të Luftuar Korrupsionin Dhe Krimin E Organizuar" (i njohur si Ligji i SPAK) përdor termin 'Anëtar i afërt i familjes' i cili nënkupton bashkëshortin/ bashkëshorten, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person me lidhje gjaku apo martesore, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim' (neni 3.1).



Këto dy ide duhet të përfshihen në një plan pune për të mbledhur dhe kërkuar indicie dhe prova kriminale që të përfshihen në raport. Logjikisht, ky plan do të ndikohet nga tipologjitë e mundshme të pastrimit të parave (për shembull organeve u duhet të përdorin qasje të ndryshme për hetimin e një rrjeti kriminal korrierësh të parave fizike ose për hetimin e operacioneve të investimit në pasuri të paluajtshme me para të paligjshme). Nga ana tjetër, plani i punës mund të ndikohet edhe nga problemet praktike që mund të lindin gjatë hetimit. Kjo do të thotë se OPGJ-të duhet të veprojnë rast pas rasti (për shembull, nëse rasti përfshin ndonjë "person të ekspozuar politikisht" ose nevojën e përgjimeve në vende të veçanta).

Në planin e punës OPGJ-të duhet të përfshijnë: a) një listë të hollësishme të personave dhe shoqërive të përfshira në hetim; b) arsyet e përfshirjes së secilit prej tyre; c) masat hetimore për secilin prej tyre. Ky lloj planifikimi i lejon OPGJ-së të vlerësojnë objektin e hetimit të tyre, si dhe për institucionin që duhet të sigurojë burimet njerëzore dhe materiale për ta kryer atë, si dhe për prokurorin që drejton hetimin.

Pas përcaktimit të planit të punës, OPGJ-të do të jenë të gatshëm të fillojnë mbledhjen e të dhënave të çështjes, duke ndjekur metodologjikisht ciklin e informacionit kriminal:




Mbledhja e informacionit: Në këtë fazë të parë, OPGJ-të duhet të përcaktojnë një rend logjik për mbledhjen e informacionit, duke dalluar informacionin policor ose ekonomik, si dhe informacionin në burime publike dhe private, me atë në burimet ku zbatuesit kanë qasje të lirë ose të kufizuara.

Disponueshmëria e një liste apo katalogu burimesh është thelbësore për mbledhjen logjike të informacionit. Ky katalog duhet të përditësohet. Ai do të lejojë konsultimin e burimeve në mënyrë logjike dhe sistematike, duke ditur se çfarë informacioni mund të merret nga ai burim, si duhet të kërkohet dhe cilat kërkesa duhet të përmbushen për të marrë informacionin. Në çdo rast, OPGJ-të duhet të kenë parasysh risqet me të cilat përballen kur përdorin burime të caktuara, por duke pasur parasysh rëndësinë e aksesit në mënyrë efikase dhe në kohë të këtyre burimeve të informacionit, pasi kjo do të ndikojë në rezultatet përfundimtare të hetimit.

Gjithashtu, një katalog i tillë lejon përdorimin e përshtatshëm të këtyre burimeve, duke shmangur mungesën e informacionit të nevojshëm, por edhe mbingarkimin me informacione të padobishme që mund të pengojnë ecurinë e hetimit.

Përpunimi i informacionit: Pasi informacioni mblidhet, ai duhet të përpunohet për të lehtësuar analizimin e tij. Ky proces siguron që informacioni të jetë i strukturuar saktë. Për të arritur këtë qëllim, OPGJ-të duhet të përcaktojnë kritere të unifikuara regjistrimi. Përveç kësaj, informacioni duhet të përditësohet shpesh. Data e përditësimit të fundit dhe origjina duhet të jenë pjesë e çdo informacioni të përfshirë në hetim.

Përpunimi teknologjik i informacioni të mbledhur është absolutisht i nevojshëm dhe ai duhet të përfshihet në dosjet mbi subjektet me interes ekonomik-financiar (si individë, shoqëri, llogari bankare, operacione të rindërtuara ose pronat), sipas kritereve të unifikuara.



FINANCIAL INFO	INFORMACIONI FINANCIAR
POLICE INFO	INFORMACIONI I POLICISË
ASSET INFO	INFORMACIONI MBI PASURINË
UNIFIED CRITERIA PROCESSING	PËRPUNIMI I KRITEREVE TË UNIFIKUARA
PERSONS	PERSONA
COMPANIES	SHOQËRITË
BANK ACCOUNTS	LLOGARI BANKARE
PROPERTIES	PRONAT
RECONSTRUCTED TRANSACTIONS	TRANSAKSIONET E RINDËRTUARA

Përdorimi i këtij sistemi dosjesh bazuar në subjekte është veçanërisht i dobishëm për efikasitetin e analizës së informacionit financiar, pasi bën të mundur mbajtjen e të gjithë informacionit për të njëjtin subjekt (individ, shoqëri, llogari, operacione të rindërtuara ose pronë) në një vend të vetëm, që mund të përditësohet, gjithmonë duke përcaktuar datat e përditësimit dhe origjinën e informacionit.

Ky sistem dosjesh i lejon OPGJ-ve të njohin në çdo moment subjektet kyçe të çështjes dhe të krijojnë një ide të përgjithshme për subjektet e përfshira, çka lehtëson krijimin e një ideje të përgjithshme mbi hetimin.

Informacioni minimal që OPGJ-të duhet të marrin për çdo subjekt janë si më poshtë:

1. Subjekti **INDIVID**:

- Gjeneralitetet.
- Adresat dhe numrat e telefonit.
- Automjetet dhe mjetet e transportit.
- Puna/profesionit i deklaruar ose i njohur.
- Individë të lidhur.
- Shoqëritë e lidhura.
- Asetet e lidhura.
- Transfertat e kapitalit.
- Llogaritë bankare përkatëse.
- Operacionet e importit/eksportit të deklaruar ose të zbuluar.
- Rekordet kriminale.
- Lidhjet me veprën mëmë.

2. Subjekti **SHOQËRI**:

- Të dhëna identifikimi individual
- Aksionarët, pronarët përfitues, administrator, përfaqësues ligjor.
- Përshkrimi i llogarisë bankare sipas të dhënave në dispozicion.
- Pronat dhe asetet e tjera.
- Transfertat e kapitalit.
- Operacionet e importit/eksportit të deklaruar ose të zbuluar.

3. Subjekti **LLOGARI BANKARE**:

- Numrin e llogarisë bankare, Bankën (agjencinë, degën, nëse janë të nevojshme) vendndodhjen, datën e hapjes dhe, sipas rastit, datën e mbylljes.
- Persona të autorizuar për veprime në llogari dhe gjeneralitetet e tyre; Kartoni i nënshkrimeve, nëse ka, raporte kaligrafie.
- Periudhën e vëzhgimit/analizimit të llogarisë.
- Flukset e parave hyrëse: llojet e operacioneve, origjina e parave, shumat dhe datat.
- Flukset e parave dalëse: llojet e operacioneve, destinacioni i parave, shumat dhe datat.
- Transaksionet e dyshimta të zbuluar.
- Shumat e flukseve hyrëse dhe dalëse të lidhura me llogarinë gjithsej.

4. Subjekti **OPERACIONI I RINDËRTUAR**:

- Identifikimin e operacionit, shumës dhe vlerës së këmbimit valutë të huaj, nëse është e nevojshme.
- Origjinën, destinacionin, pjesëmarrësit në operacion.

- Instrumentet financiare të përdorura gjatë operacionit.
- Dokumentet financiare dhe tregtare të siguruara në operacion.

5. Subjekti **PRONË/ASET**:

- Pronarin nominal dhe pronarin e vërtetë përfitues.
- Identifikimin e plotë të pronës, datën e blerjes, vlerën aktuale, hipotekat dhe huatë përkatëse.
- Llojet e veprimeve ose tjetërsimeve të pasurisë, shumat dhe datat e tyre.
- Identifikimin e origjinës së çdo tjetërsimi.
- Identifikimin e destinacionit të çdo tjetërsimi.

Analiza e informacionit: Pasi informacioni të jetë përpunuar, ai duhet të analizohet. Me këtë analizë, OPGJ-të mund të përcaktojnë marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet individëve, mes tyre dhe me shoqëritë, ndërmjet tyre dhe asetëve të zbuluara, dhe marrëdhëniet e tyre me operacionet e rindërtuara.

Gjithashtu, ata duhet të përcaktojnë lidhjet me veprimtaritë kriminale të mëparshme, rolin e secilit prej autorëve dhe lidhjen e tyre me pasuritë e identifikuar, tipologjitë e zbuluara, rindërtimin e operacioneve të pastrimit të parave dhe përfundimisht provat penale.

Pasi informacioni të jetë analizuar, OPGJ-të duhet të rishikojnë nëse objektivat e rastit janë arritur pjesërisht ose plotësisht, ose nëse kanë mungesë informacioni. Nëse po, OPGJ-të duhet t'i kthehen planit dhe të mbledhin informacionin që mungon:

- Në lidhje me objektivin e parë të përcaktuar, OPGJ-të duhet të identifikojnë plotësisht të gjithë autorët dhe pjesëmarrjen e tyre në operacionet e rindërtuara. Një nga praktikatat e mira është që kjo pjesëmarrje në nivelin e individit të raportohet në një dosje çështjeje, ku OPGJ-të përcaktojnë rolin e secilit autor të zbuluar në kuadër të çështjes, duke theksuar adresat e përdorura nga secili prej tyre (me qëllim përcaktimin e vendndodhjes së tyre edhe për urdhrat e kërkimit në të ardhmen).
- Në lidhje me asetet e identifikuar, OPGJ-të duhet të hetojnë të gjitha llojet e asetëve me vlerë ekonomike (pasuri të paluajtshme, automjete, mjete lundrimi, produkte financiare, argjendari ose objekte të tjera me vlerë të lartë, asete krypto, para fizike), dhe këto pasuri duhet të lidhen me autorët përkatës, qoftë përmes pronësisë apo edhe përdorimit. Këto pasuri duhet të dokumentohen në mënyrë të përshtatshme me qëllim mundësimin e sekuestrimit në një moment të dytë. Është thelbësore që të gjitha asetet të regjistrohen saktë, për shembull, për pasuritë e paluajtshme OPGJ-të duhet të përfshijnë të dhënat e identifikimit të pronës; mënyrën e përfuturimit të saj, të dhënat e plota të kontratës, çmimin e pasurisë, nëse ajo është e regjistruar zyrtarisht dhe historikun e të gjitha transaksioneve të pronës; ose lidhur me produktet bankare, OPGJ-të duhet të shënojnë të dhëna për llojin e llogarisë, datën e hapjes dhe mbylljes së saj, transaksionet e rëndësishme dhe vlerat e tyre, si dhe klientët e përfshirë në transaksione.
- Lidhja e pasurive me origjinën e tyre të paligjshme arrihet nëpërmjet rindërtimit të operacioneve të pastrimit të parave, të cilat mundësojnë gjurmimin nga fondet e pajustificuara tek pasuritë që lidhen me autorët. Këto lidhje i lejojnë prokurorit/OPGJ-së të kërkojnë sekuestrim të pasurive, duke qenë se kjo kërkesë nuk mund të jetë e pabazuar. Është e nevojshme që prokurori/OPGJ-ja të përshkruajë shkurtimisht se si këto pasuri janë përfuturuar duke nisur nga fitimet e paligjshme të veprës penale deri tek pasuritë e përfshira në skemat e pastrimit të parave që janë zbuluar.
- Provat e mbledhura duhet të jenë ato të përcaktuara nga legjislati dhe jurisprudenca dhe duhet të jenë të shumta dhe të ndërlidhura.
- OPGJ-të duhet të identifikojnë tipologjitë e përdorura në analizën e kryer dhe ata duhet të pasqyrojnë këto teknika të pastrimit të parave në raportet e tyre. Kjo është e rëndësishme për faktin se çdo tipologji shoqërohet me disa indicie të mundshme kriminale. Megjithatë, është e rëndësishme të

vërehet se tipologjitë e pastrimit të parave janë në zhvillim të vazhdueshëm, dhe është e zakonshme që hetimet të hasin tipologji të përziera.

- Në lidhje me analizën e operacioneve të ndryshme të PP-së të kryera nga autorët, OPGJ-të duhet t'i përshkruajnë ato individualisht, duke përcaktuar origjinën dhe destinacionin e fondeve, personat e përfshirë, format e pagesës, dokumentacionin e përdorur për të justifikuar operacionin, parregullsitë e zbuluara që tregojnë kompleksitetin e tepruar të operacionit, mungesën e logjikës së biznesit dhe fitimin tregtar.

Faza e ditës së veprimit operacional

Si rezultat i të gjithë informacionit të mëparshëm dhe pasi OPGJ-të kanë përcaktuar qartë rolet e autorëve të ndryshëm në skemat e PP-së të fondeve të paligjshme dhe kanë identifikuar asete të lidhura me këto fonde të parregullta, ata duhet të organizojnë një ditë veprimesh operacionale ndaj këtyre personave dhe pasurive të tyre. Gjithashtu, duhet theksuar se forcat ligjzbatuese mund të kërkojnë prova të reja që mbështesin analizën e mëparshme gjatë operacionit.

Ky veprim duhet të jetë i koordinuar, për të shmangur largimin e autorëve, si dhe asgjësimin provave apo fshehjen e pasurive të identifikuara. Kjo ditë veprimesh operacionale mund të shtrihet në disa vende dhe organet përkatëse mund të koordinojnë veprimet në vende të ndryshme nëpërmjet mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë kuadër, forcat e zbatimit të ligjit duhet të veprojnë në mënyrë të sinkronizuar kundër autorëve dhe pasurive të tyre si më poshtë:

- Arrestimi/ndalimi i autorëve të përfshirë në hetim.
- Kryerja e kontrolleve sipas ligjit në vendet e përdorura nga këta autorë dhe ku OPGJ-të supozojnë se mund të gjenden prova të tjera.
- Qasje në provat digjitale në servera.
- Përmbushja e kërkesave për informacion ndaj institucioneve publike dhe private në lidhje me çështjen në fjalë.
- Sekuestrimi i aseteve financiare të lidhura me autorët.
- Sekuestrimi i pasurive të paluajtshme, duke ndaluar shitjen e tyre palëve të treta.
- Sekuestrimi fizik i pasurive të tjera (automjete, mjete lundrimi, para fizike, bizhuteri, vepra arti ...).
- Sekuestrimi digjital i kriptomonedhave.

Për ekzekutimin e urdhrave të kërkimit, është thelbësore të bëhet planifikim paraprak, me qëllim parashikimin e çdo rrethane që mund të ndodhë, si dhe parashikimin e burimeve të përshtatshme për të shmangur ose zgjidhur këto problema (për shembull, ekzistenca e mundshme e kasetave të sigurisë, serverë kompjuteri, asete kripto, mundësia e pranisë së armëve, prania e njerëzve të rrezikshëm).

Përveç kësaj, nëse rrethanat e lejojnë, organet duhet të filtrojnë dokumentacionin që do të sekuestrohet pasi kjo do të lehtësojë analizën e mëvonshme. Është e rëndësishme që forcat e zbatimit të ligjit të përdorin një metodë vetme dhe sistematike për mbledhjen dhe dokumentimin e dokumentacionit të sekuestruar dhe sendet e tjera, çka siguron zinxhirin e ruajtjes dhe lehtëson punën e mëvonshme.

Faza e ditës pas veprimeve operacionale

Në këtë fazë të fundit, informacioni i mbledhur gjatë ditës së veprimeve operacionale duhet të analizohet dhe të integrohet me informacionin e disponueshëm më parë. Objektivi kryesor i kësaj faze është konfirmimi i hipotezave hetimore.

Kryesisht do të ketë dy lloje dokumentesh që duhen analizuar: nga njëra anë, dokumentacioni fizik; nga ana tjetër provat elektronike (telefonat, hard disqet, apo pajisje të tjera). OPGJ-të duhet të kenë një proces të veçantë për përpunimin e tyre përpara se të analizojnë përmbajtjen e tyre.

Në lidhje me dokumentacionin fizik, ai duhet të përshkruhet dhe identifikohet saktë sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni. Një praktikë e mirë me dobi, mund të jetë skanimi i dokumentacionit përmes protokolleve të Njohjes Optike të Germave (OCR) që lejon kërkimet e fjalëve kyçe në dokumentet e skanuara në një moment të dytë.

Sekuestrimi e pajisjeve të TI (kompjutera, aparatë celularë *smartphone*, hard disqe, etj.) fizikisht kryhet me nismë të OPGJ-së, ndërsa nxjerrja e të dhënave kompjuterike kryhet me autorizim të Gjykatës ose Prokurorit, në prani të një eksperti, sipas kërkesave të K.Pr.Penale. Pasi të jetë shkarkuar informacioni i pajisjes, ky informacion mund të hetohet nga OPGJ-të.

Pasi prokurori/OPGJ-të të kenë përpunuar provat, mund të përdoren dy strategji të analizimit të informacionit, të cilat nuk përjashtojnë njëra-tjetrën:

- Kryerja e një kërkimi inteligjent të dokumentacionit të sekuestruar, kërkimi i fjalëve kyçe ose referencave të rëndësishme në këtë rast, vendosja e të gjithë informacionit të sekuestruar (kopjet e skanuara me OCR dhe provat elektronike) në të njëjtën dosje dhe përdorimi i programeve të posaçme të indeksimit dhe kërkimit.
- Kryerja e një kontrolli shterues të të gjithë dokumentacionin e sekuestruar, duke shqyrtuar të gjitha dokumentet një nga një.

Përdorimi i secilës prej strategjive ndikon në burimet e nevojshme për analizën, kohën dhe efikasitetin e saj.

D) STRUKTURAT E RAPORTIT NË RASTET E PASTRIMIT TË PARAVE

Gjatë procesit hetimor, OPGJ-të duhet të hartojnë raporte të ndryshme me informacion mbi analizat e kryera në kuadër të çështjes për Prokurorin.

Ata duhet të strukturojnë, të renditin dhe të organizojnë një sasi të madhe të dhënash, ndaj duhet një instrument i përshtatshëm për t'i komunikuar prokurorisë rezultatet e analizave komplekse. Këto raporte duhet të përfshijnë faktet e hetuara, analizat e kryera, përfundimet e nxjerra nga analiza dhe disa propozime për prokurorin (nëse është e nevojshme).

Raporti duhet të jetë i qartë, i përmbledhur dhe i saktë, duke pasur parasysh se kompleksiteti i hetimeve të pastrimit të parave është një pengesë që OPGJ-ja duhet ta zgjidhë me teknika të ndryshme. Pra, një praktikë e parë e mirë është që thelbi i raportit të jetë i shkurtër dhe konciz, me të gjitha informacionet që mbështesin këtë themel të përfshirë në shtojca. Objektivi është që volumi i madh i informacionit që dorgohet të mos jetë pjesë e trupit të raportit (por në shtojca) për të mos mbingarkuar, mos humbur efektshmërinë dhe kuptimin e materialit.

Për më tepër, praktikë tjetër e mirë është të përfshihen grafikë që nxjerrin në pah marrëdhëniet ndërmjet subjekteve të analizuar, ose që përmbledhin operacionet e rindërtimit.

Një strukturë e zakonshme elektronike e një raporti të plotë të pastrimit të parave mund të jetë si më poshtë:

Indeksi
Hyrje - Përmbledhje ekzekutive
Thelbi i raportit
<ul style="list-style-type: none">• Njerëz dhe shoqëri të përfshira me rolet e tyre• Pasuritë e zbuluara• Analiza e kryer• Tipologjitë e PP të zbuluara• Operacione të rindërtuara• Indiciet kriminale
Përfundimet
Propozime
Shtojca
<ul style="list-style-type: none">• Dosjet individuale (persona, shoqëri, llogari bankare, asete, operacione të rindërtuara)• Grafikët dhe diagramet• Dokumentet dhe provat

OPGJ-të duhet të përfshijnë në raportin e tyre një sërë përfundimesh të nxjerra nga analiza e tyre. Praktikë e mirë do të ishte formulimi me paragrafë të veçantë, të qartë, sa më të shkurtër dhe sa më të thjeshtë e objektivë (bazuar në faktet e mbledhura në raport). Ata duhet të jenë në gjendje të nxjerrin përfundime për rolin e autorëve, për fondet e gjurmuara dhe skemat e pastrimit të përdorura dhe sigurisht që duhet të përcaktojnë sasinë e pastruar.

Së fundmi, OPGJ-të duhet të jenë proaktive dhe të propozojnë të gjitha masat hetimore që ata i konsiderojnë të nevojshme jo vetëm për arrestimin e autorëve, por edhe për marrjen e provave të reja dhe sekuestrimin e pasurive të zbuluara.

4.

Teknikat e hetimit në hetimin financiar

A) ANALIZA E DOKUMENTACIONIT

Gjatë çështjeve OPGJ-të mund të gjejnë dokumente që janë ofruar nga autorët në momente të caktuara (akte, dokumente identiteti, fatura ose kontrata të paraqitura pranë Administratës Tatimore, Noterëve, regjistrave të pasurive ose bankave), ose kur janë sekuestruar me ekzekutimin e urdhër kontrollit.

Gjatë analizimit të këtij dokumentacioni OPGJ-të duhet të kenë parasysh sa më poshtë:

- Këto dokumente duhet të regjistrohen siç duhet, në mënyrë që prokurori/OPGJ-të të dinë origjinën e tyre dhe të sigurojnë zinxhirin e kujdestarisë (chain of custody) apo hapat dhe procedurat strikte për marrjen e provave.
- Ata duhet të dinë rrethanat në të cilat janë gjetur këto dokumente (për shembull, nëse ato janë paraqitur vullnetarisht për të justifikuar veprime bankare, ose janë sekuestruar me urdhër kontrolli në një kasafortë ose në kuti depozite bankare).
- Ata duhet të analizojnë nëse dokumentet janë të vërteta apo të falsifikuara.
- Për më tepër, ata duhet t'i krahasojnë këto dokumente me burime të tjera (për shembull, nëse është paraqitur kontratë në një institucion tjetër, por ka ndryshime në përmbajtje, ose në rastin e një fature, duhet verifikuar nëse ka veprim bankar përkatës, ose nëse ka variante të atij dokumenti që i lejojnë OPGJ-ve të arrijnë në përfundimin se dokumenti mund të jetë përgatitur aty për aty).
- Gjithashtu duhet verifikuar nëse ngjarja e treguar në dokument është kryer apo jo (për shembull, shitja e një automjeti të shënuar në kontratë, ose shitja e produkteve që dokumentohet në një faturë).
- Zakonisht, këto dokumente përgatiten sipas rastit për të justifikuar një operacion përpara një organi ose institucioni (si banka ose autoritetet tatimore), por autori nuk merr në konsideratë hetime financiar në të ardhmen që mund të kenë qasje në burime të ndryshme informacioni. Këto burime të ndryshme lejojnë kontroll të kryqëzuar dhe OPGJ-të mund të zbulojnë mospërputhje që u lejojnë të verifikojnë se dokumentet janë përgatitur sipas rastit për të simuluar ndonjë akt, ose se kanë për qëllim ta justifikojnë atë.

B) INFORMACIONI BANKAR

Të dhënat e llogarisë bankare mund të jenë një nga burimet më të rëndësishme të informacionit financiar në dispozicion të një OPGJ-je. Regjistrat bankarë pasqyrojnë realitetin financiar të një autori, i cili zakonisht nuk përputhet me justifikimet e përgatitura sipas rastit, që OPGJ-të i zbulojnë në baza të tjera të dhënash.

Këto të dhëna mund të përdoren për të vërtetuar të ardhurat e paraportuara dhe të ardhurat e paligjshme, si dhe për të ndjekur gjurmët e parave nga burimi i parave deri në destinacionin e tyre përfundimtar. Llogaritë bankare mund të ofrojnë gjithashtu indicie për burimet e fondeve, shpenzimet, asete të fshehura dhe transaksione personale.

Sipas ligjeve për sekretin bankar, të dhënat bankare janë konfidenciale dhe nuk janë të disponueshme për publikun. Megjithatë, prokurorët mund të marrin të dhënat bankare duke i lëshuar bankës udhërrëfues.

Kërkesa për dokumentacion duhet të përfshijë një listë të të dhënave të posaçme që duhet të sigurohen nga institucioni financiar. Ajo duhet të përfshijë një periudhë të caktuar kohore dhe të kërkojë sigurimin e të dhënave për të gjitha llogaritë e hapura dhe të mbyllura.

Me qëllim analizimin e veprimeve bankave, është e nevojshme të përdoren mjetet e duhura të TIK-ut, si programe për fletëllogaritëse (*spreadsheets*) ose programe me pagesë për analizim. Me këto mjete, analisti financiar mund të kërkojë modele ose të identifikojë lëvizje të veçanta, duke përdorur filtra ose tabela "pivot" të programeve fletëllogaritëse. OPGJ-të duhet të kenë parasysh se nuk kanë nevojë për një analizë të plotë kontabiliteti pasi kjo është teknikë tjetër hetimore.

Para së gjithash, është e nevojshme të kryhet analizë tërësore e llogarisë. Pas kësaj, OPGJ-të duhet të thellohen në analizimin e operacioneve të dyshimta të veçanta. Me qëllim analizimin e duhur, duhet që OPGJ-të të kenë një panoramë të përgjithshme të çështjes.

Kur analizohet një llogari, OPGJ-të duhet të hulumtojnë sjellje jashtë normales nga sa do ishte e zakonshme për pronarin ose personat e autorizuar të llogarisë (person fizik ose juridik, punonjës ose sipërmarrës, në varësi të veprimtarisë).

Në të njëjtën kohë, OPGJ-të duhet të verifikojnë nëse të dhënat e bankës përputhen me pjesën tjetër të burimeve të konsultuara (tatimet, dokumentacioni tregtar, përgjimet, përgjimet audio...).

C) INFORMACIONI JOBANKAR

Është e rëndësishme të theksohet se, gjatë hetimeve financiare, OPGJ-të jo vetëm që duhet të analizojnë informacionin bankar, por edhe informacione të tjera që lidhen me operacionet ekonomike që pasqyrohen në burime të tjera, dhe për rrjedhojë rëndësinë e disponimit dhe të përditësimit të katalogut të burimeve të informacionit.

Për shembull, analiza e informacionit tatimor lejon hetuesit të kontrollojnë nëse pasuritë e zbuluara të një personi janë në përputhje me të ardhurat e tij/saj të ligjshme, ose nëse biznesi tregtar pasqyrohet në të gjitha llojet e dokumenteve, si librat e shoqërisë, apo llogaritë financiare të shoqërisë, ose dokumente të lidhura me tregtinë, të cilat janë të gjitha me rëndësi në kontekstin e hetimit të PP të bazuar në tregti (TBML).

Një katalog i hollësishëm i burimeve të disponueshme për OPGJ-të përfshihet në SHTOJCËN 1 të këtij manuali.

D) GJURMUESHMËRIA E KRIPTOMONEDHAVE

Strategjia për hetimin e veprimeve me kriptomonedha të përdorura për pastrim parash, bazohet në dy ide kryesore:

- Para së gjithash, organizatat kriminale përdorin asete kripto kryesisht si mjet për lëvizjen e fondeve të paligjshme në mënyrë anonime dhe shpejt, dhe së dyti për të ruajtur vlerën.
- Për më tepër, hetimi i PP-së duhet të përqendrohet në dy objektiva:
 - Të gjejë pika kompromisi, ku autorët këmbëjnë asetet kripto në para fizike (këmbim, bankomat...).
 - Kur OPGJ-të zbulojnë përdorimin e këtyre VASPS-ve, atëherë ata mund të pyesin këto subjekte për të marrë informacion rreth operacionit dhe mund të identifikojnë pronarin e fondeve.
 - Të gjurmojë rrugën e kriptomonedhës në *blockchain*. Në këtë kuadër, OPGJ-të me njohuritë në fushën përkatëse duhet të bashkëpunojnë me strukturat e specializuara.

Për shembull, nëse OPGJ-ja ka zbuluar se një adresë BTC-je (Bitcoin) është e lidhur me një autor, ai mund të zbulojë bilancin e adresës vetëm duke kërkuar informacionin e *blockchain* përmes çdo shfletuesi të disponueshëm. Për më tepër, OPGJ-ja mund të gjurmtojë origjinën dhe destinacionin e fondeve duke ndjekur transaksionet në të njëjtin *blockchain*, megjithëse kjo zakonisht kërkon disa programe kompjuterike me pagesë për analizim.

Nëse zbulohet se kjo adresë i përket një VASP-je, mund të kërkohet informacion nga kjo VASP në lidhje me të, dhe OPGJ-ja merr kështu informacion mbi identitetin e pronarit të fondeve, IP-të e lidhjes, dokumentacionin e dorëzuar gjatë hapjes së llogarisë, si dhe fonde të tjera që mund të ketë autori në atë VASP.

E) KËRKIMI DHE SEKUESTRIMI

Gjykata duhet të miratojë kërkesën për një urdhër kontrolli kur prokurori jep argumente të arsyeshme për të besuar se sendet që përbëjnë provë të një veprë penale janë në një vend të caktuar.

a) Provat elektronike

Me përdorimin gjithnjë me më të madh të ruajtjes digjitale të informacionit përdoret, ekzaminimi shkencor digjital që ka të bëjë me mbledhjen dhe analizimin e informacionit digjital, do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për prokurorët dhe OPGJ-të.

Parimet e përgjithshme kriminalistike dhe procedurale më poshtë gjejnë zbatim edhe kur bëhet fjalë për prova elektronike:

- Procesi i mbledhjes, sigurimit dhe transportit të provave elektronike nuk duhet të ndryshojë provat;
- Provat elektronike duhet të shqyrtohen vetëm nga persona të trajnuar posaçërisht për këtë qëllim;
- Çdo veprim i kryer gjatë sekuestrimit, transportit dhe ruajtjes së provave elektronike duhet të jetë plotësisht i dokumentuar, i ruajtur dhe i disponueshëm për shqyrtim.

Të gjitha veprimet që lidhen me identifikimin, mbledhjen, paketimin, transportin dhe ruajtjen e provave elektronike duhet të dokumentohen plotësisht. Gjatë përgatitjes së provave elektronike për transport, OPGJ-ja duhet:

- Të sigurohet që të gjitha provat elektronike mblidhen në mënyrën e duhur, dokumentohen, etiketohen, fotografohen, filmohen ose skicohen dhe inventarizohen përpara se të paktohen. Të gjitha lidhjet dhe pajisjet lidhëse duhet të etiketohen për rikonfigurim të lehtë të sistemit më vonë.
- Të ketë parasysh se provat elektronike mund të përmbajnë gjithashtu prova të pazbuluara ende, mikrogjurmë ose prova biologjike që kërkojnë veprimet e përshtatshme për ruajtjen e tyre. Kopjimi i provave elektronike (imazhimi) duhet të bëhet përpara analizimit të provave të pazbuluara, mikrogjurmëve ose provave biologjike.
- Paketojë të gjitha provat elektronike në qese plastike, zarfa letre, kuti kartoni dhe/ose enë antistatike.
- Etiketojë të gjithë materialin e paketimit qartë dhe siç duhet.
- Të mbajë telefonat celularë ose inteligjentë (ndezur ose fikur).
- Paketojë celularët ose telefonat inteligjentë me materiale që bllokojnë sinjalin, si p.sh. paketime izoluese Faraday, material mbrojtës ndaj frekuencave të radios ose letër alumini për të parandaluar dërgimin ose marrjen e mesazheve të të dhënave nga pajisjet.
- Mbledhë të gjithë karikuesit dhe përshtatësit për të gjitha pajisjet elektronike të sekuestruara.
- Të parandalojë që provat elektronike me vlerë potenciale, përfshirë datat, oraret dhe cilësimet e konfigurimit të sistemit, të mos humbasin për shkak të magazinimit të zgjatur nëse bateritë shkarkohen ose burimi i energjisë që ruan këtë informacion pëson avari. Nëse ka përcaktime të tilla, OPGJ-ja duhet të informojë kujdestarin e provave dhe ekzaminuesin shkencor ligjor se pajisjet elektronike funksionojnë me bateri dhe kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të ruajtur të dhënat në to.
- Nëse disa kompjuterë ekuestrohen si provë, atyre duhet t'iu vihen etiketa për të lehtësuar rimontimin, nëse është e nevojshme, së bashku me kabllot e tyre dhe pajisjet e lidhura me to.

Ekzaminimi i paisjeve kompjuterike dhe paisjeve të tjera që shërbejnë për komunikim publik dhe paisjeve të tjera elektronike që shërbejnë për të ruajtur informacionin duhet të kryhet vetëm nga persona me njohuri të nivelit të lartë mbi ekspertimin digjital ligjor në Sektorin Përkatës. Megjithatë, OPGJ-ja mund të ndihmojnë në procesin e ekzaminimit duke informuar ekspertin e ekzaminimit digjital ligjor për llojin dhe natyrën e informacionit që ata kërkojnë ose ata mund të punojnë së bashku.

Në shumicën dërrmuese të rasteve, analiza kriminalistike e një hard disku zgjat shumë dhe nuk mund të kryhet në vend gjatë ekzekutimit fillestar të një urdhri kontrolli. Kështu, specialistët duhet të kryejnë ekzaminimin në një vend tjetër. Ky proces përfshin dy hapa:

1. kopjimin (imaging) e përmbajtjes së hard diskut; dhe
2. analizën, gjatë së cilës analizohet kopja e pajisjes për të kërkuar provat përkatëse.

Kopjimi është procesi i krijimit të një kopjeje të përmbajtjes së diskut, duke duplikuar të gjithë informacionin e diskut. Pas kopjimit, fillon hapi i dytë i procesit që ka të bëjë me ekzaminimin digjital ligjor, analizën e hard diskut dhe identifikimin e të dhënave që mund të përdoren si provë.

Pasi profesionistët të kenë gati të gjithë informacionin, ata mund të përdorin dy strategji për të analizuar dokumentet, në varësi të burimeve në dispozicion.

Kur OPGJ-ja ka mjetet e duhura të TIK-ut, ai mund të bëjë analizën duke kërkuar me fjalë kyçe në të gjitha dokumentet e ruajtura. Për këtë qëllim, OPGJ-ja duhet të përgatisë një listë fjalësh përkatëse për hetimin në fjalë. Ata duhet ta përgatisin këtë listë duke përdorur emra, mbiemra, pseudonime, data të

rëndësishme, shifra ose çdo gjë me kuptim në rastin konkret. Kjo strategji është më efikase dhe kërkon më pak burime njerëzore dhe më pak kohë.

Strategjia tjetër është shqyrtimi i të gjitha dokumenteve digjitale të sekuestruara. Kjo strategji ka nevojë për më shumë burime njerëzore dhe kërkon më shumë kohë, por zakonisht nuk kërkon mjete të veçanta TIK-u.

b) Dokumenta Fizike në Kontrollin e Banesave

Sekuestrimi i dokumenteve fizike është një nga pjesët themelore të ekzekutimit të urdhrave të kontrollit. Për të pasur sa më efikasitet në këtë kuadër, personat e ngarkuar me çështjen duhet të planifikojnë paraprakisht kontrollin, me qëllim përcaktimin e qartë të sendeve të dobishme për hetimin dhe duke u përpjekur të shmangin sekuestrimin e dyfishtë ose dokumentet e padobishme.

Për më tepër, bazuar në rregullat e përcaktuara në legjislacion, ligjzbatuesit duhet të kenë parasysh disa kritere operacionale për të kryer kontrollin në mënyrë të sigurtë dhe efikase:

- Planifikimi i mëparshëm: OPGJ-të duhet të planifikojnë se cilët elementë mund të jenë me interes për hetimin dhe rrethanat në të cilat ata duhet të ekzekutojnë urdhrin e kontrollit.
- Duhet të jetë e qartë se çfarë lloj sendesh janë të autorizuar të sekuestrojnë sipas vendimit gjyqësor.
- Krijimi dhe regjistrimi i ekipeve të përshtatshme, me funksione të përcaktuara për secilin prej anëtarëve të tyre (udhëheqës, kontroll, pritje dhe klasifikim, rishikim, kujdestari).
- Shmangni, për aq sa është e mundur, mbledhjen pa kriter të dokumentave, duke përdorur kriteret e përcaktuara më parë për përzgjedhjen e tyre.
- Ndërsa sendet sekuestrohen, ato duhet të vendosen nga OPGJ-ja sekuestrues në një qese ose kontejner që shënohet qartë me: 1) emrin ose inicialet e OPGJ-së i cili i ka sekuestruar; 2) datën dhe vendin e saktë ku është sekuestruar sendi; dhe 3) përshkrimin e përgjithshëm të sendit të sekuestruar. Sendet e sekuestruara nga vende të ndryshme nuk duhet të vendosen në të njëjtën qese ose kontejner.
- Qeset ose kontejnerët do të zhvendosen në një vend qendror ku drejtuesi i ekipit ose një person tjetër i caktuar harton një regjistër të inventarit të provave. Përpara transportit, qesja ose kontejneri duhet të mbyllet me shirit mbyllës për të shmangur çdo heqje të provave ose "ndotje" me sende të sekuestruara nga vende të tjera.
- Sendet e sekuestruara duhet të ruhen në kontejnerë të ndryshëm në varësi të trajtimit të mëpasshëm, duke ndarë materialin kompjuterik nga dokumentet fizike ose sendet e tjera të sekuestruara, si bizhuteri apo sende me vlerë.
- Nëse ekzaminimi paraprak i provave shkresore zbulon se disa regjistra mund të kenë vlerën e provës, dokumentet origjinale duhet të fotokopjen. Puna vijuese me të dhënat duhet të kufizohet në këto kopje. Është e rëndësishme të përdorni një sistem numërimi të dokumenteve t'i skanoni ato me OCR dhe t'i ruani në kompjuter. OPGJ-ja mund të krijojë një indeks/tabelë duke identifikuar numerikisht dokumentet për të lehtësuar rikthimin e dokumentit në të ardhmen.

c) Kriptoasetet

Gjatë planifikimit të ditës së veprimeve operacionale, OPGJ-të duhet të marrin në konsideratë mundësinë e shfaqjes së kriptoaseteve në momentin e arrestimeve dhe kontrollit, në mënyrë që të mund të sekuestrojnë dhe menaxhojnë këto aktive virtuale. Në përgjithësi, më poshtë jepen hapat për sekuestrimin e kriptoaseteve gjatë ditës së veprimeve operacionale:

- Para së gjithash, sekuestrimi i kësaj lloj pasurie duhet të përfshihet në vendimin gjyqësor.
- Para kontrollit (ose edhe në momentin e kontrollit në shtëpi nëse është e nevojshme), specialistët e policisë duhet të kenë gjeneruar një portofol USB (cold wallet), ku do të kryejnë transferimin e të gjitha monedhave virtuale të sekuestruara që gjenden në portofolin e të dyshuarit.
- Është thelbësore që pjesëtarët e ekipit të kontrollit të jenë në gjendje të zbulojnë praninë e provave që na paralajmërojnë se një i dyshuar po operon me kriptovaluta (shënimet e adresave të bitcoin ose portofolit, çelësat publikë ose privatë, kodet QR, portofolet në letër (paper wallets) ose pajisjet e tipit USB, shënimet e frazave, aplikacione të veçanta në pajisjet celulare, aplikacione dhe regjistra historikë në kompjuterë, etj.).
- Gjatë ekzekutimit të regjistrimit, OPGJ-të duhet të gjejnë posaçërisht çelësat privatë për akses në portofolin e të dyshuarve, qoftë duke kryer një kontroll të drejtpërdrejtë në pajisjet elektronike të dyshuarit, ose duke kontrolluar sendet dhe dokumentet e sekuestruara, pasi vetëm kur ata janë në posedim të këtij çelësi, ata mund të vijnë me sekuestrimin e këtyre monedhave virtuale.
- Nëse gjendet një frazë rikuperimi (seed phrase), çelësi privat mund të rindërtohet përmes aplikacioneve përkatëse dhe, për rrjedhojë, kriptoaleti që ndodhet në portofolin e rindërtuar mund të sekuestrohet.
- Ky transferim duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse vetëm kur OPGJ-të kanë fondet në portofolin e tyre të ftohtë, ata mund të konsiderojnë se kriptoaletet janë sekuestruar. Sekuestrimi i vetëm i harduerit ose i çelësit privat nuk mjafton për të siguruar sekuestrimin e fondeve, sepse autori mund të aksesojë fondet duke përdorur mënyra të tjera.
- Pasi asetet virtuale të jenë transferuar në atë portofol të ftohtë, informacioni që përmban çelësin privat mund të ndahet vetëm me Prokurorin, pasi ky çelës jep akses të drejtpërdrejtë te fondet. Nuk duhet të ekzistojë asnjë kopje e këtij çelësi privat (ose frazës së tij të rikuperimit ose kodit QR përkatës) në asnjë vend, përveç origjinalit të transferuar te Prokurori. OPGJ-të mund të shkruajnë adresën publike që lejon këdo të kontrollojë fondet që gjenden në portofolin e ftohtë.
- Në rast se OPGJ-ja zbulon prova se një i dyshuar mund të ketë asete virtuale me cilindo Ofrues të Shërbimit të Aseteve Virtuale (VASP), ata duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të sekuestruar fondet.

F) TEKNIKA E POSAÇME TË HETIMIT:

Në këtë pjesë jepen disa teknika të posaçme që mund të jenë të dobishme gjatë hetimeve financiare, duke shtuar informacione me ndjeshmëri të lartë që duhet të integrohen në analizat hetimore.

Teknikat e posaçme hetimore mund të përkufizohen si *“metodat e posaçme të hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimeve të tjera ligjore, përdorimi i të cilave nuk është i autorizuar për të gjitha llojet e veprave penale, të tilla si veprimet e simuluara, infiltrimi në përbërje të grupit kriminal, dorëzimi i kontrolluar, mbrojtja e dëshmitarit si dhe teknika të tjera si përdorimi i ekspertizës kontabël, përgjimi elektronik, marrja dhe përdorimi i informacioneve nga vende të huaja, provat kompjuterike, përdorimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose bashkëpunimi në marrëveshjet e fajësisë, etj.”*²⁶.

Përdorimi i këtyre teknikave të posaçme hetimore, të cilat ndikojnë të drejtat e autorëve duhet të përdoren sipas parimeve ligjore të domosdoshmërisë, efektivitetit dhe proporcionalitetit në lidhje me faktet e supozuara kriminale në hetim.

Në rastin e hetimeve për pastrim parash, serioziteti i krimit lejon përdorimin e këtyre teknikave hetimore si proporcionale. Por përveç kësaj, duhet të arsyetohet se përdorimi i kësaj mase do të jetë i efektshëm për

26. Regullorja e Këshillit të Prokurorisë “Mbi Kriteret dhe Procedurën Për Ngritjen në Detyrë të Prokurorëve Pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit Dhe Krimit të Organizuar” nr.51, datë 19.03.2019. Neni 2.

marrjen e indicieve apo provave që lidhen me këtë vepër penale dhe se është veçanërisht e nevojshme të kryhet si mjet kërkimi provash për shkak se mjetet e tjera të hetimit nuk kanë mundur t'i sigurojnë këto prova.

Kështu, përdorimi i këtyre masave (mbikëqyrje në vende të hapura dhe të mbyllura, përgjime telefonike, përdorimi i agjentëve në mbulim dhe dërgesa të kontrolluara ose përdorimi i gjurmuesve GPS) lejon qasjen në informacione shumë të ndjeshme në lidhje me strukturën dhe mënyrën e funksionimit të përdorur për të kryer pastrimin e parave.

Për shembull, mund të mblidhen të dhëna për pjesëmarrjen dhe rolet e autorëve të ndryshëm të përfshirë (për shembull, duke identifikuar personat që marrin pjesë në bisedat dhe takimet e zbuluara dhe duke pasur qasje në përmbajtjen e tyre), për strukturën hierarkike të organizatës kriminale (për shembull, njohja e rrjedhës së urdhrave nga krerët të vartësit dhe anasjelltas), në lidhje me kontrollin efektiv mbi strukturat e përdorura për të lëvizur fonde dhe për të blerë asete të ndryshme që janë formalizuar në emër të drejtuesve (për shembull, duke ditur se kush i përdor realisht asetet ose jep porosi për produkte financiare edhe nëse nuk janë pronar të tyre) ose për fluksin e fondeve jashtë sistemit financiar (për shembull dërgesat në para dhe marrja në dorë ose përdorimi i mekanizmave të kompensimit).

Përveç kësaj, këto masa u mundësojnë OPGJ-ve të mbledhin prova për qëllimshmërinë e veprimeve të kryera nga autorët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe që do të ishte e vështirë të vërtetohej me mjete të tjera hetimore.

a) Përgjimet telefonike

Neni 221 i KPP-së përcakton se përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni, me anë të telefonit, faksit, kompjuterit ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në ambiente private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, lejohet vetëm kur ka një procedim:

- a) për veprat me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak se shtatë vjet, ku përfshihet edhe pastrimi i parave;
- b) për çdo vepër penale me dashje kur kryhet me anën e mjeteve të telekomunikimit apo përdorimit të teknologjive informatike ose telematike.
- c) Për veprat penale të cilat gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

Përgjimi mund të urdhërohet ndaj:

- a) një personi të dyshuar për kryerjen e një vepre penale;
- b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;
- c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;
- d) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit

Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë personat e përfshirë në komunikim.

Për zbatimin e kësaj teknike hetimore nevojitet urdhër gjykate, me kërkesë të prokurorit. Përjashtimisht, kur ka baza të arsyeshme për të besuar se vonesa mund t'i shkaktojë dëm të rëndë hetimeve, prokurori vendos përgjimin me akt të arsyetuar dhe njofton menjëherë gjykatën, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e vendimit.

Vendimi i përgjimit tregon mënyrën dhe afatin kohor të ekzekutimit të tyre, i cili nuk mund të kalojë pesëmbëdhjetë ditë. Ky afat mund të zgjatet nga gjykata për një periudhë prej 15 ditësh të tjera, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit.

Veprimet e përgjimit mund të kryhen vetëm nëpërmjet pajisjeve të instaluar në vende të përcaktuara, të autorizuara dhe të kontrolluara nga prokurori. Përgjimi dhe procesverbali bëhet nga OPGJ-ja, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e prokurorit të çështjes.

Nëse ndonjë nga kriteret e përgjimit nuk përmbushet më, OPGJ-ja njofton menjëherë prokurorin, i cili urdhëron ndërprerjen e përgjimit dhe njofton gjykatën, nëse urdhri për përgjim është lëshuar prej saj.

Komunikimet e përgjuara do të regjistrohen dhe do të mbahet procesverbal për të gjitha veprimet e kryera. Procesverbali përfshin zbardhjen e përmbajtjes së komunikimeve të përgjuara. Këto procesverbale dhe regjistrimet i kalojnë menjëherë prokurorit dhe brenda pesë ditëve nga përfundimi i veprimeve i dorëzohen sekretarit së bashku me akt-vendimet që kanë urdhëruar, autorizuar, vërtetuar dhe zgjatur përgjimin. Kur këto dorëzime mund të dëmtojnë hetimet, gjykata autorizon prokurorin të shtyjë dorëzimin deri në përfundim të hetimeve paraprake.

b) Dorëzime të kontrolluara

Kjo teknikë e veçantë është e përcaktuar në Nenin 294/c të KPP-së, i cili përcakton se dorëzimi i kontrolluar autorizohet nga prokurori që drejton hetimet paraprake, me kërkesë të autoriteteve të huaja.

Dorëzimi i kontrolluar mund të autorizohet në rastet e mëposhtme:

- a) kur personat që dyshohet se janë përfshirë në transportin e paligjshëm të lëndëve narkotike, armëve, sendeve të vjedhura, materialeve plasëse ose bërthamore, materialeve radioaktive, shumave të parave dhe të ardhurave të tjera produkte të veprës penale ose të sendeve të përdorura si mjet për kryerjen e veprave penale, kur ata nuk mund të identifikohen ose arrestohen në mënyra të tjera, si dhe kur identifikimi apo arrestimi i tyre do të dëmtonte hetimet ose do të rrezikonte sigurinë e personave apo sillte dëmtimin ose humbjen e sendeve që transportohen;
- b) kur zbulimi i veprave penale dhe marrja e provave është e pamundur ose e vështirë me mënyra të tjera.

Dorëzimi i kontrolluar ndërkombëtar kryhet sipas kushteve të përcaktuara nga prokurori, i cili urdhëron kryerjen e tij me akt të arsyetuar, pasi sigurohet se autoritetet e huaja:

- a) kanë dhënë pëlqimin që sendet e paligjshme apo të dyshimta të hyjnë, të kalojnë tranzit ose të dalin nga territori i tyre;
- b) garantojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme të hyrjes, kalimit tranzit ose daljes së sendeve nga territori i tyre;

Urdhri i prokurorit që autorizon dorëzimin e kontrolluar duhet të përmbajë:

- a) emrin e të dyshuarit ose të pandehurit, nëse dihet;
- b) provat që vërtetojnë natyrën e paligjshme të sendeve që duhet të hyjnë, kalojnë ose dalin nga territori i shtetit dhe mënyrat në të cilat do të kryhet kontrolli ose mbikëqyrja e tyre.

Kur është rasti, urdhrin të prokurorit i bashkëlidhet akti që autorizon zëvendësimin e plotë ose të pjesshëm të sendeve të paligjshme dhe vendin ku vendosen kampionet e marra.

Dorëzimi i kontrolluar ekzekutohet nga OPGJ-ja, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit.

c) Agjentët në Mbulim

Kjo teknikë e veçantë përcaktohet në Nenin 294/b KPP me titullin *"Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal."*

Neni 294/b përcakton se për qëllimet e zbulimit të krimeve të rënda, oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, me autorizimin dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hetimin, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e vet si oficer policie.

Oficeri i policisë gjyqësore në mbulim nuk duhet të provokojë një akt kriminal, i cili nuk do të ishte kryer pa ndërhyrjen e tij. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.

Autorizimi i prokurorit duhet të përcaktojë afatin e infiltrimit, që lejohet të zgjatet nga prokurori deri në gjashtë muaj, dhe hapësirën e lejueshme për oficerin në mbulim, duke treguar, sipas rastit, veprimet e paligjshme që lejohet të kryejë ai, pa rrezikuar jetën e të tjerëve.

Punonjësi i policisë gjyqësore në mbulim mund të pyetet si dëshmitar. Nëse marrja e dëshmisë nga personat në mbulim është thelbësore për çështjen, dëshmia merret duke respektuar rregullat mbi ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të informatorit. Kur ata nuk janë thirrur si dëshmitarë, informacionet e dhëna prej tyre nuk mund të përdoren.

d) Përgjimi i posacëm

Këto teknika të veçanta hetimore janë parashikuar në nenet 221.2, 222.6 dhe 222.8 të KPP-së. Këto lloj teknikash, që përfshijnë regjistrimin e fshehtë fotografik, filmik ose video të personave në vende publike ose përdorimin e mjeteve gjurmuese të vendndodhjes, lejohen vetëm për veprat penale të qëllimshme, të dënueshme me jo më pak se tre vjet burgim.

Për ta përdorur atë në vende publike duhet autorizim nga prokurori, por në ambiente private duhet vendim gjykate, si në rastin e përgjimeve telefonike.

Në vendimin e gjykatës, oficeri i policisë gjyqësore ose specialisti i kualifikuar mund të autorizohet të hyjë në këto vende në mënyrë të fshehtë, duke vepruar në përputhje me vendimin. Ky autorizim duhet të zbatohet brenda 15 ditëve.

e) Kontrollat e shumave në të holla në kufi

Një teknikë hetimore e përdorur gjerësisht në kontekstin e hetimeve të pastrimit të parave që përfshijnë sasi të mëdha parash është kryerja e kontrolleve administrative në hyrje dhe/ose dalje nga Shqipëria.

Sipas nenit 17/1 të ligjit nr. 9917 për APLMFT, çdo person që hyn ose del nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të prurësit, metale ose gurë të çmuar, sende me vlerë dhe antikitet, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose vlerë të barasvlershme në valuta të tjera, qëllimi i mbartjes së tyre dhe paraqitjes së dokumenteve përkatëse mbështetëse.

Këtë detyrim për të deklaruar kanë edhe përfaqësuesit e personave që hyjnë dhe/ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë me çdo mjet transporti tokësor, ajror ose detar ose me shërbim postar.

Deklarimi duhet të bëhet duke plotësuar formularin e veçantë që mund të gjendet në zyrat doganore ose mund të shkarkohet nga faja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nëse konstatohet mosdeklarim ose deklarim i rremë ose i pasaktë, Drejtoria doganore ka të drejtë të vendosë gjobë, e cila për herë të parë në varësi të shumës së padeklaruar është shumë fikse dhe për rastet e përsëritura llogaritet në përqindje të vlerës së padeklaruar si më poshtë:

- a) për shumat nga 10 000 deri në 19 999 euro ose të barasvlershmen e tyre në valuta të tjera, gjoba është në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë për herë të parë, 10% e vlerës së padeklaruar për herën e dytë dhe 30% të vlerës së padeklaruar për raste të tjera;
- b) për shumat nga 20 000 deri në 49 999 euro ose të barasvlershmen e tyre në valuta të tjera, gjoba është 40 000 (dyzet mijë) lekë për herë të parë, 20% e vlerës së padeklaruar për herë të dytë dhe 40% të vlerës së padeklaruar për raste të tjera;
- c) për shumat mbi 50 000 euro ose të barasvlershmen e tyre në valuta të tjera, gjoba është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për herë të parë, 30% e vlerës së padeklaruar për herë të dytë dhe 50% e vlerës së padeklaruar në raste të tjera.

Kjo gjobë vendoset paralelisht me trajtimin e çështjes, në përputhje me përcaktimet e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Është e rëndësishme të theksohet se autoritetet doganore duhet t'u raportojnë autoriteteve përgjegjëse kopjet e formularëve të deklarimit, dokumentet mbështetëse të paraqitura dhe të dhëna të tjera sipas rastit, si dhe të dhëna të plota për rastet e mosdeklarimit.

Ky lloj kontrolli lejon sekuestrimin e parave të gatshme për organizatat kriminale që përpiqen të kontrabandojnë para brenda ose jashtë vendit në rast të mosdeklarimit, ose akses në dokumentacionin mbështetës të përfshirë në deklarata, i cili zakonisht përgatitet ad-hoc për kalimin e kufirit.

KAPITULLI IV

ÇËSHTJET PROCEDURALE

1.

Provat e nevojshme për ta dërguar çështjen në gjykatë

A) SA I PËRKET VEPRËS PENALE TË PASTRIMIT TË PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE OSE VEPRIMTARISË KRIMINALE

Demonstrimi përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri është fajtor për veprën e pastrimit të parave është i vështirë, veçanërisht në rastet komplekse të pastrimit të parave, ku përfshihen pastruesit profesionistë të parave (avokatët, noterët publikë, kontabilistët, këshilltarët tatimorë, bankierët, ofruesit e shërbimeve të trust-eve dhe shoqërive, etj.).

Megjithatë, sikurse parashikohet në Nenin 9.2.c) të Konventës së Varshavës, “*dijenia, synimi ose qëllimi, si elemente të veprës penale (të pastrimit të parave), mund të nxirren nga rrethana fakti objektive*”. I njëjti formulim gjendet edhe në Nenin 6.2.f) të UNTOC-së dhe Nenin 26 të UNCAC-së, si dhe në Nenin 278 të KP-së.

a) Provat e bazuara në indicie

Dijenia mund të jetë rrjedhojë e situatave faktike konkrete që kanë të bëjnë me çështjen. Në shumicën e rasteve, prokurorit, të cilit i mungojnë provat e drejtpërdrejta për të vërtetuar dijeninë për origjinën e pasurisë, i duhet ta bazojë akuzën mbi prova të tërthorta ose indicie, me kusht që këto të jenë të rëndësishme, të sakta dhe të përputhshme me njëra-tjetrën. Në disa raste, është e mundur të bëhet lidhja e drejtpërdrejtë midis veprimeve të veçanta financiare dhe një sjelljeje specifike kriminale. Megjithatë, në shumë raste kur nuk mund të bëhet asnjë lidhje e drejtpërdrejtë me veprimet financiare, pasuria e pajustificuar mund të sjellë deduksionin se paratë vijnë nga burime të paligjshme. Mënyra se si një individ i caktuar i shpenzon paratë për shembull, mund të tërheqë vëmendjen dhe mund të shërbejë si indicie për të hetuar origjinën e pasurisë së tyre. Sipas këtij arsyetimi, hetimi duhet të përqendrohet te të afërmit, marrëdhëniet e punës dhe interesat e tjerë të përgjithshëm të personit që nuk mund t'i justifikojë veprimet financiare vetëm me të ardhurat e tij personale dhe profesionale, pasi nuk përkojnë me llojin e punës që bën dhe të ardhurat që merr prej saj.

Rrjedhimisht, akuzat për pastrimin e parave zakonisht bazohen në treguesit e mëposhtëm:

- a) Rritja e pazakontë ose joproporcionale e pasurisë; si dhe administrimi i shumave të parave që, për sasinë e lartë ose mënyrën e transferimit të tyre (*lp.sh., përdorimi i madh i parave në dorë, ose përdorimi i*

veprimeve financiare që nuk bazohen në veprimtari ekonomike faktike dhe të ligjshme), çojnë në zbulimin e veprimeve të pazakonta në lidhje me transaksionet financiare të kryera.

- b) Mungesa e veprimtarive tregtare të ligjshme që mund të justifikojnë rritjen e të ardhurave dhe pasurisë, si dhe shpjegimet e dyshimta të dhëna nga të pandehurit për të justifikuar origjinën e të ardhurave të tyre.
- c) Lidhja me veprimtari kriminale, si dënime ose hetime të mëparshme të të pandehurve, të afërmeve të tyre ose personave të tjerë të afërt me ta.

Këto mund të konsiderohen edhe tre shtyllat kryesore mbi të cilat duhet të bazohet çdo dënim për pastrim parash.

b) Veprimi me Dashje të Tërthortë (*Dolus eventualis*) dhe neglizhenca

Duke marrë parasysh vështirësinë e provueshmërisë së dijenisë për origjinën e paligjshme të pasurive, Neni 9.3 i Konventës së Varshavës përcakton se çdo Palë, sipas legjislacionit kombëtar, mund të konsiderojë si vepër penale të gjitha ose disa akte të përkufizuara në Konventë si pastrim parash, ku autori i veprës penale dyshon ose duhej të kishte supozuar se pasuria ishte produkt i veprës penale. Një dispozitë e ngjashme parashikohet edhe në legjislacionin e BE-së.¹

Kjo dispozitë u lejon Shteteve Anëtare ta marrin më pak në konsideratë elementët e anës subjektive të autorit dhe rrjedhimisht të përcaktojnë kriminalizimin e sjelljes së pakujdesshme ku gjykata i çmon provat në mënyrë objektive dhe vendos nëse autori duhet të kishte supozuar se pasuria ishte produkt i veprës penale, ndonëse nuk ka pasur dijeni të mirëfilltë për këtë.²

Ndonjëherë, fakti se autori ka parashikuar ose duhet të parashikonte se pasuria ka qenë produkt i veprës penale, mund të trajtohet nga institucioni i veprimit me dashje të tërthortë ose të ashtuquajturës '*dolus eventualis*', pa kriminalizim të veçantë të kësaj veprimtarie në përshkrimin e veprës penale të pastrimit të parave. Për më tepër, ky kriminalizim i posaçëm nuk është i nevojshëm kur Kodi Penal i Vendit Anëtar e parashikon kryerjen e pastrimit të parave nga pakujdesia si vepër penale. *Dolus eventualis* do të thotë që i pandehuri i parashikon dhe i pranon pasojat e mundshme të veprimit të tij, megjithëse ai ose ajo nuk i dëshiron drejtpërdrejt ato rezultate dhe madje mund edhe të mos presë që ato të ndodhin. Ky institucion mund të përkufizohet si ndërgjegjësimi për rezultatin e mundshëm të një veprimi.³

Për më tepër, ky kriminalizim i qartë nuk është i nevojshëm kur kryerja e pastrimit të parave nga pakujdesia parashikohet si vepër në Kodin Penal të Shtetit Palë. Sjellja e pakujdesshme nënkupton se qëllimi i drejtpërdrejtë nuk është i nevojshëm për kryerjen e krimit. Sipas Nenit 16 të KP-së "*vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte*". Ky përkufizim përfshin edhe të ashtuquajturën "*verbëri të qëllimshme*", ku ata të cilëve u kërkohet bashkëpunim, edhe pse janë në gjendje ta kuptojnë natyrën e bashkëpunimit, refuzojnë të kenë dijeni dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Megjithatë, ndonëse Neni 14 i KP-së parashikon se "*një person është fajtor nëse e kryen veprën penale me dashje ose nga pakujdesia*", kryerja e veprës penale të pastrimit të parave nga pakujdesia, ndryshe

1. Neni 3.2i Direktivës (BE) 2018/1673 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2018, për luftën kundër pastrimit të parave nga e drejta penale (AMLCLD).

2. I njëjti formulim gjendet edhe te Neni 6.2.f) i UNTOC-së dhe Neni 26 i UNCAC-së, si dhe te Nenin 278 i KP-së.

3. Për një shpjegim të mëtejshëm, shih 'Shënimin interpretues mbi nenin 9(3) të Konventës së Varshavës', datë 12 maj 2021 (Dokument C198-COP[2021]4 i CoE). Neni 2(1) e Direktivës (BE) 2018/1673 së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2018 (Këtu e më poshtë AMLCLD).

nga veprat e tjera penale, si vrasja, plagosja apo shkatërrimi i pronës, nuk parashikohet shprehimisht në KP si element i anës subjektive të figurës së veprës penale Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale. Për më tepër, përkufizimi i veprës penale përfshin edhe shprehjen “dijenia se kjo pasuri është produkt i një vepre ose veprimtarie kriminale”, që shkon përtej sjelljes së pakujdesshme.

B) SA I PËRKET VEPRËS PENALE OSE ‘VEPRIMTARISË KRIMINALE’ MËMË

Në thelb, nuk kërkohet dijëni për veprën penale mëmë sikurse kërkohet dijënia, dashja apo qëllimi, si elementë të anës subjektive (*‘mens rea’*); mjafton të kesh dijëni për parregullsinë e veprimit dhe të bësh deduksione të arsyeshme se pasuritë rrjedhin nga vepra penale. Kjo është arsyeja se përse parapëlqehen terma, si “veprimtari kriminale” ose “sjellje kriminale” në vend të termit “vepër penale mëmë, kur përkufizojmë veprën specifike penale të pastrimit të parave”. Neni 287 i KP-së i referohet “veprës penale” dhe “veprimtarisë kriminale” pa dallim midis tyre. Në legjislacionin e BE-së, “veprimtaria kriminale” ka përkufizim mjaft të gjerë; është “çdo lloj përfshirje kriminale në kryerjen e një vepre penale [...]”.⁴

Prandaj, nuk ka rëndësi nëse nuk dihen elementët faktikë, si hollësitë, vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për identifikimin e saktë të viktimave ose të *‘nomen iuris’* që i atribuohen atij krimi. Ajo që kërkohet është dijënia e rrethanave bazë të një fakti. Sikurse parashikohet në Nenin 9.6 të Konventës së Varshavës, nuk është e nevojshme të përcaktohet saktësisht se cila është vepra mëmë. Për më tepër, Neni 3.3.b) i AMLCLD-së përcakton se “nuk është e nevojshme të përcaktohen të gjitha elementet faktike ose të gjitha rrethanat që lidhen me atë veprimtari kriminale, përfshi edhe identitetin e autorit”.

Bazuar në sa më sipër, nuk është e nevojshme të jesh i dënuar më parë për veprën mëmë. Mjafton thjesht referimi i kryerjes së veprës mëmë, cilado qoftë ajo, pa dhënë të gjitha hollësitë. Sikurse parashikohet në Nenin 9.5 të Konventës së Varshavës dhe Nenin 3.3.a) të AMLDCL-së, asnjë dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprimtarinë kriminale nga e cila ka ardhur pasuria nuk është parakusht për dhënien e dënimit për pastrim parash. Në po të njëjtën mënyrë, Neni 287 i KPSH-së përcakton se vepra penale e pastrimit të parave mund të kryhet edhe kur “nuk ka nisur ndjekja penale, ose kur nuk është dhënë asnjë ndëshkim me vendim të formës së prerë për veprën penale prej së cilës kanë buruar produktet”.

Për më tepër, sipas Nenit 9.7 të Konventës së Varshavës, Nenit 3.3.c) të AMLDCL-së dhe Nenit 278 të KP-së, nuk ka rëndësi nëse vepra penale mëmë është kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të jetë e dënueshme si në vendin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të thotë se, në raste të tilla, provat për sjellje të mëparshme kriminale duhen marrë zyrtarisht nga jashtë shtetit, duke përdorur instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar që analizohen në Kapitullin V të këtij Manuali.

C) LLOJET E NDRYSHME TË PROVAVE

Në mënyrë që Gjykata të deklarojë fajësinë dhe dënimin e të pandehurit, duhet provuar faji i të pandehurit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (Neni 390.1 i KPP-së). Pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat, Gjykata çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke përcaktuar arsyet që kanë shërbyer si bazë për gjykimin e saj (Neni 152.1 i KPP-së). “Vendimi merret menjëherë pas diskutimeve përfundimtare të palëve” (Neni 379. 1 i KPP-së) dhe, duke bërë këtë “gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera përveç atyre që merren ose verifikohen

4. Neni 2.1 i AMLCLD.

gjatë procesit gjyqësor” (Neni 380.1 ii KPP-së). Për më tepër, “vendimi përmban [...] provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet se përse gjykata i sheh të papranueshme provat e kundërta ” (Neni 383.1.ç) i KPP-së).

Sipas Nenit 149.1 të KPP-së, provat “janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij”. Megjithatë, “asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar me ligj”.

a) Dokumentet (konsideratë e veçantë për informacionin bankar)

Ndër llojet e ndryshme të provave, dokumentet janë veçanërisht të rëndësishme për procedimet për pastrim parash, pasi përdoren zakonisht për të provuar veprimet që kryhen për të pastruar produktet e veprimtarisë kriminale.

Informacioni bankar është veçanërisht thelbësor për dhënien e dënimit në shumë çështje pastrimi parash. Kjo është arsyeja përse Neni 7 i Konventës së Varshavës i detyron Shtetet Palë t'i fuqizojnë gjykatat ose autoritetet e tjera kompetente (*prokurorët për shembull*) që të urdhërojnë vënien në dispozicion ose sekuestrimin e të dhënave bankare, financiare ose tregtare, për të hetuar çështjet e pastrimit të parave, duke shtuar se “një Palë nuk mund të refuzojë t'i vërë në dispozicion [...] duke përdorur fshehtësinë bankare”. Sipas rastit, çdo Shtet Anëtar duhet të jetë në gjendje të:

- a) përcaktojë nëse një person fizik ose juridik është mbajtësi ose pronari përfitues i një ose më shumë llogarive, të cilësdo natyrë, në çdo bankë që ndodhet në territorin e vet, dhe nëse është ky rasti, të marrë të gjitha hollësitë e llogarive të identifikuara;
- b) marrë hollësi specifike për llogari dhe veprime të caktuara bankare që janë kryer gjatë periudhës së përcaktuar nëpërmjet një ose më shumë llogarish, përfshirë specifikat e çdo llogarie dërguese dhe marrëse;
- c) monitorojë, gjatë një periudhe të caktuar, veprimet bankare që janë kryer nëpërmjet një ose më shumë llogarive të identifikuara; dhe
- ç) sigurojë se bankat nuk i bëjnë me dije klientit të bankës në fjalë apo një pale tjetër të tretë se informacioni është kërkuar apo marrë, ose se po kryhet hetim”.

Ajo që shkruhet në fund të germës b) (*‘përfshirë specifikat e çdo llogarie dërguese ose marrëse’*) është shumë e rëndësishme, pasi të lejon gjurmimin e rrugës që ndjekin paratë nga njëra llogari bankare në tjetrën dhe, rrjedhimisht, zbulimin e përfituesit fundor të parave.

Krahas bankave, ka edhe “subjekte të tjera të detyruara”, sikurse përkufizohen në Nenin 2 të *AMLD-së*⁵ (pra, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre dhe subjektet financiare jobanka, audituesit, noterët, agjentët e pasurive të paluajtshme, shoqëritë që ofrojnë shërbime etj.) që mund të urdhërohen të hartojnë dokumente me qëllim përdorimin e tyre si prova në procese gjyqësore për pastrimin e parave. Me kusht që të përmbushin të gjitha masat e parashikuara në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave (*për shembull, masat për kujdesin e duhur ndaj klientit ose masat për informacionin rreth pronësisë përfituese*), këto subjekte duhet të kenë mjaft informacione të vlefshme për të provuar nëse është kryer vepra penale e pastrimit të parave.

5. Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit (këtu e me pas AMLD). Shiko gjithashtu dhe nenin 3 të Ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 ‘Për Parandalimin e Parave dhe Financimin e Terrorizimit’, i ndryshuar

Sipas Nenit 40 të AMLD "subjektet e detyruara" sipas ligjit duhet të mbajnë prova ose dokumente mbështetëse që vërtetojnë transaksionet e kryera, të përbëra nga dokumente origjinale ose kopje të tyre, të pranueshme në procese gjyqësore sipas legjislacionit kombëtar në fuqi. Këto dokumente janë të nevojshme për identifikimin e transaksioneve, për një periudhë të paktën pesë vjet pas përfundimit të marrëdhënies së punës me klientin ose pas datës së një prej transaksioneve të rastit. Kjo periudhë pesë vjeçare është pragu minimal dhe mund të zgjatet më tej me dispozitë të legjislacionit vendas.

Edhe Njësitë e Inteligjencës Financiare (*referuar në vijim si FIU*) luajnë rol të rëndësishëm në hetimin për veprën penale të pastrimit të parave. Ato janë krijuar për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, (neni 32.1 i AMLD-së).⁶ Ato janë përgjegjëse veçanërisht për të marrë dhe analizuar raportime për transaksione të dyshimta (*zakonisht nga "subjektet e detyruara" sipas ligjit*) dhe informacione të tjera që lidhen me pastrimin e parave dhe vepra të tjera penale kryesore/mëmë, si dhe për t'u dhënë autoriteteve kompetente rezultatet e analizave të tyre dhe çdo informacion tjetër kur ka arsye për të dyshuar për pastrim parash apo vepra të tjera penale të lidhura me to (neni 32.3 i AMLD-së).⁷

Ndonëse FIU-të duhet të shkëmbejnë informacion lidhur me pastrimin e parave apo veprat e tjera penale mëmë, të paraqitura nga autoritetet kompetente, vendimi i takon FIU-t (Neni 32.4 i AMLD-së).⁸ Për më tepër, detyra kryesore e FIU-t është të kryejë analiza financiare⁹, që nuk janë prova të mirëfillta, ku roli i saj është thjesht inicimi i referimeve duke i raportuar autoriteteve kompetente transaksione të dyshimta, që të nisë hetimi penal.¹⁰ Prandaj, është shumë e pazakontë që të FIU të marrë informacion të ofruar drejtpërdrejt nga "subjektet e detyruara" apo "të tjera" (akte noteriale, fatura, marrëveshje tregtare, etj.) në hetime financiare.

FIU Shqiptar është Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), e ngritur në vitin 2000 si institucion me natyrë administrative midis subjekteve raportuese dhe autoriteteve ligjzbatuese përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ekonomike.

Dokumente të tjera që mund të nxirren si prova në çështjet e pastrimit të parave janë ato që mund të merren duke pasur akses në baza të dhënash ose regjistra të përmendur në Kapitullin III të këtij Manuali.

b) Dëshmitarët (konsideratë e veçantë për sinjalizuesit)

Dëshmitar është kushdo që ka dijeni rreth fakteve apo ngjarjeve të caktuara që janë të rëndësishme për hetimin ose ndjekjen penale.

Ndryshe nga dokumentet, dëshmitë nuk konsiderohen si prova të zakonshme mbi të cilat bazohet dhënia e dënimit për veprën e pastrimit të parave.

Megjithatë, në disa raste, të ashtuquajturit "sinjalizues" mund të luajnë rol thelbësor për zbulimin e *modus operandi* të disa skemave të pastrimit të parave, sidomos brenda organizatave të ndërlikuara që i janë përkushtuar kryerjes së kësaj vepre penale. Sinjalizuesi mund të përkufizohet si dikush që, në kontekstin e marrëdhënies së tij të punës, raporton ose bën të ditura informacione rreth një kërcënimi ose dëmtimi në dëm të publikut.¹¹ Figura e sinjalizuesit rregullohet nga Ligji nr. 60/2016 'Për Sinjalizimin

6. neni 21.2 APLMFT.

7. neni 22 APLMFT .

8. nenet 22.e dhe 22.e/1. APLMFT

9. neni 22. a APLMFT

10. neni 22.g APLMFT

11. Figura e sinjalizuesit rregullohet edhe nga Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 tetor 2019, për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të legjislacionit të BE-së.

dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve'. Megjithatë, ky ligj parashikon edhe procese administrative dhe nuk synon të ketë si rezultat hetimin penal në kuadër të proceseve gjyqësore.

Gjithsesi, nëse informacioni i raportohet policisë ose prokurorisë nga sinjalizuesit, hetimi penal mund të nisë në bazë të fakteve të raportuara dhe ky hetim mund të përfundojë me regjistrimin e procesit gjyqësor. Në këtë rast duhet marrë parasysh ajo që parashikohet në Nenin 283 të KPP-së, sipas të cilit *"kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit"*. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, si rregull i përgjithshëm, por *"të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elemente të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre"* (Neni 283.3 i KPC-së).

Ndaj, ndonjëherë, "sinjalizuesi" mund të kthehet në "dëshmitar i drejtësisë" ose "bashkëpunëtor i drejtësisë". Sipas Neni 3 të ligjit nr. 10 173, datë 22 tetor 2009, *"Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë"*

- "Dëshmitari i Drejtësisë" është personi i cili, në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën deklarime a dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal dhe që, për shkak të këtyre deklarimeve a dëshmime, ndodhet në gjendje rreziku. (Neni 3.2)
- "Bashkëpunëtor i drejtësisë" është personi, i cili vuan dënimin penal ose është i pandehur në një procedim penal për krime të kryera në bashkëpunim, që ndodhet në gjendje rreziku, për shkak të bashkëpunimit me drejtësinë, të deklarimeve apo dëshmime për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në të njëjtin procedim penal ose në një procedim të lidhur (Neni 3.3). Marrëveshja e bashkëpunimit rregullohet nga Neni 37/a i KPP-së.

Sipas Neni 36/a të KPP-së, "bashkëpunëtori i drejtësisë" pyetet në cilësinë e dëshmitarit dhe deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre (neni 152.3 i KPP-së). Krahas kësaj, neni 361/a i KPP-së parashikon se *"marrja në pyetje e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, personave të infiltruar ose personave nën mbulim, dhe e dëshmitarëve të mbrojtur dhe dëshmitarëve me identitet të fshehur zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, të cilat përcaktohen nga gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve"*. Megjithatë, sado e rëndësishme të jetë kjo lloj prove, duhet marrë parasysh se *"gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e fajësisë vetëm ose kryesisht te deklarimet e të bashkëpandehurit apo dëshmitë e marra nëpërmjet teknikave të veçanta për fshehjen e identitetit të dëshmitarit [...]"* (Neni 390.3 i KPP-së).

c) Provat digjitale

Provat kompjuterike ose digjitale mund të konsiderohen si prova shkresore, pasi shumica e dokumenteve që janë hartuar dhe nënshkruar në të shkuarën në letër, sot gjenden të hartuara e nënshkruara edhe në format digjital dhe ruhen në kompjuter ose pajisje të tjera elektronike, ose në të ashtuquajturën "re"(cloud). Madje, në këto sisteme ruajtjeje mbahen edhe kopje digjitale të dokumenteve shkresore.

Rrjedhimisht, mbledhja dhe analizimi i provave kompjuterike ose digjitale merr rëndësi jetike përse i përket provueshmërisë së kryerjes së veprës penale të pastrimit të parave. Hapi i parë i këtij procesi mund të jetë marrja e të dhënave kompjuterike (Neni 191/a i KPP-së), ose sikurse ndodh zakonisht, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, në bazë të Neni 208/a të KPP-së. Sekuestrimi mund të vijë pas kontrollit dhe këqyrjes së një vendi të caktuar (*për shembull, banesa e të dyshuarit ose mjediset e shoqërisë përgjegjëse*), me kusht që sendet e sekuestruara të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit (Neni 207.1 i KPP-së). Në këtë rast, të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka pronësinë e vendit, u

dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke i njohur me të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar ose avokatit mbrojtës (Nenet 201.1 dhe 205.1 të KPPS-së).

Në nenet 299/a dhe 299/b të KPP-së ka disa dispozita mjaft interesante për ruajtjen dhe mbajtjen e të dhënave kompjuterike, në ato raste kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se të dhënat mund të humbasin, dëmtohen ose modifikohen.

Sigurisht që, gjetja e pajisjeve elektronike (*kompjuterë, tableta, celularë, disqe, USB, etj.*), marrja e të gjitha informacioneve prej tyre dhe parandalimi i modifikimit të përmbajtjes në to janë veprime shumë më të ndërlikuara që duhen kryer nga ekspertë, të tillë si oficerë të aftësuar të policisë gjyqësore, ose ekspertë të ekzaminimeve kompjuterike të kriminalistikës. Kjo është arsyeja se përse kjo çështje trajtohet në mënyrë më të thelluar në një seksion të veçantë në Kapitullin III, lidhur me hetimet financiare. Ka edhe disa teknikalitete lidhur me mënyrën se si kryhen këto veprimtari, përshkrimi i të cilave shkon përtej objektit të këtij manuali.

d) Provat rrethore (jo të drejtpërdrejta)

Sikurse është përmendur tashmë, vepra penale e pastrimit të parave mund të provohet në bazë të provave rrethore, sikurse parashikohet në Nenin 9.2.C) të Konventës së Varshavës dhe Nenin 287 të KPPSH-së, që përcakton se: *“Dijenia, synimi ose qëllimi, si elemente të veprës penale (të pastrimit të parave), mund të nxirren nga rrethana objektive fakti”*.

Megjithatë, Neni 152.2 i KPP-së parashikon se *“ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën”*. Në këtë drejtim, ekzistojnë disa rregulla të pranuar përgjithësisht kur bëhet fjalë për përdorimin e provave rrethore si bazë për një dënim; *përkatësisht*:

- *Indiciet duhet të jenë të shumta;*
- *Ato duhet të jenë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën;*
- *Ato duhet të jenë qartësisht inkriminuese.*

Për shembull, sipas nenit 3.6 të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10, datë 17 korrik 2020, provat rrethore për të provuar këtë lloj vepre penale mund të jenë:

Shtylla e I-rë	Shtylla e II-të	Shtylla e III-të
a) Rritje e pajustificuar e pasurive/aseteve.	c) Mungesa e veprimtarive ekonomike ose tregtare që justifikojnë rritjen	ç) Lidhja ose përfshirja në veprimtari kriminale
b) Kryerja e operacioneve financiare të pazakonta.		

Sipas të njëjtit Udhëzim, disa shembuj të veprimeve financiare të pazakonta (germa b në tabelë) janë:

- i. Rithemelimi dhe/ose likuidimi i shoqërive të ndryshme;
- ii. Menaxhimi i shumave jashtëzakonisht të larta të parave në dorë;
- iii. Përdorimi i shoqërive për t'i vështirësuar sa më shumë autoriteteve identifikimin e personave që kanë kontroll *de facto* mbi operacionet;
- iv. Mosmbajtja e mbledhjeve të aksionerëve në rastin e “shoqërive guaskë” që tregojnë qartë se këto shoqëri nuk administrohen nga aksionarë të regjistruar;
- v. Ekzistenca e të dhënave të parregullta në dokumentacionin e tyre kontabël;

- vi. Depozitimi i parave në banka me pjesë, që nuk i bindet një dinamike të arsyeshme;
- vii. Përdorimi i dokumentave të falsifikuara që justifikojnë importin e mallrave që nuk ekzistojnë;
- viii. Hapja e llogarive bankare të njëpasnjëshme në intervale të shkurtra.

Sigurisht që ka edhe shumë indicie të tjera të cilat mund të përdoren si prova rrethore, ndër të cilat të lartpërmendurat janë vetëm disa shembuj. Gjithsesi, provat mund të jenë të mjaftueshme për të vërtetuar tre shtyllat e përmendura më lart, përkatësisht: shtimin e pajustificuar të pasurisë ose ekzistencën e operacioneve të pazakonta financiare (germat a] dhe b]), mungesën e një shpjegimi të arsyeshëm për këtë (germa c) dhe marrëdhëniet me veprimtaritë kriminale (germa ç).

2.

Garancitë procedurale dhe respektimi i të drejtave të njeriut

A) E DREJTA PËR PROCES GJYQËSOR TË DREJTË DHE E DREJTA E RESPEKTIMIT TË JETËS PRIVATE DHE FAMILJARE

Si në të gjitha procedimet e tjera penale, të drejtat e njeriut dhe garancitë procedurale duhen respektuar edhe në procedime që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, sidomos e drejta për proces të drejtë gjyqësor, parashikuar në Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Është e rëndësishme të merret parasysh edhe Neni 8 i Konventës dhe Kartës, lidhur me të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës, pasi shumë procedura hetimore të zbatuara në procedimet e pastrimit të parave (*kontrolli i banesës, hetimi i llogarive bankare, sekuestrimi i dokumenteve personale, analizimi i mesazheve të gjetura në kompjutera, laptopë, celularë etj.*) zakonisht e cenojnë ushtrimin e kësaj të drejte. Prandaj, procedurat hetimore duhet të jenë jo vetëm të nevojshme dhe proporcionale, por edhe të miratohen e zbatohen në përputhje me ligjin.

Për më tepër, Neni 8/a.1 i KPP-së parashikon se “*faktet në procesin penal provohen me çdo provë, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*”. Për më tepër, sipas Nenit 9.1 të KPP-së, “*personave që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë u kthehen të drejtat dhe shpërblehen për dëmin e pësuar*”. Të drejtat e veçanta të personave nën hetim parashikohen në Nenin 34/a të KPP-së.

B) PREZUMIMI I PAFAJËSISË

Sipas Nenit 6.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenit 48.2 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore, çdokush që akuzohet se ka kryer veprë penale prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia sipas ligjit.

Në çdo rast, prokuroria duhet të vërtetojë se pasuritë e pastruara nuk janë produkt i veprimtarisë ligjore, për shembull, duke treguar se si bizneset e përdorura nga pastruesi si mbulim nuk kanë pasur mallra të mjaftueshme për të justifikuar vëllimet e shitjes, ose nuk kanë qenë hapur për publikun gjatë orarit të punës, etj.

Në këtë rast, personat nën hetim duhet të japin të dhëna që provojnë në mënyrë të pakundërshtueshme burimin e ligjshëm të pasurive të tyre. Kjo nuk do të thotë që barra e provës ndryshon, apo që njerëzit janë të detyruar të kryejnë veprimtari të pamundura, të jashtëzakonshme ose të kushtueshme vetëm për të provuar origjinën e pasurisë, pasi është mjaft e lehtë të japësh prova për burimin e ligjshëm.

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së *“anëtarët e trupës gjyqësore nuk duhet të nisen me mendimin paraprak se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet; barra e provës bie mbi prokurorinë dhe çdo dyshim duhet të jetë në dobi të të akuzuarit. Kështu, nëse barra e provës kalon nga prokuroria te mbrojtja, prezumimi i pafajësisë shkelet”*. Megjithatë, mbrojtjes mund t'i kërkohet të japë shpjegime pasi prokuroria ta ketë ngritur çështjen *prima facie* kundër të akuzuarit (Çështja *Telfner kundër Austrisë*, Nr. 33501/96, datë 20 mars 2001).

C) E DREJTA PËR TË HESHTUR

Duke qenë se në shumë procedime penale për pastrim parash është vështirë të marrësh prova të drejtpërdrejta për të gjitha elementet e veprës penale, veçanërisht anën subjektive *'mens rea'*, provat rrethore marrin rëndësi thelbësore, pasi ekziston tundimi që heshtja e të pandehurit të shihet si *“indicie”* fajësie. Prandaj, duhet theksuar e drejta *“e heshtjes dhe paraqitjes lirish të mbrojtjes së vet, si dhe e drejta të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara;”*, (neni 34/a, germa c i KPP-së). Krahas kësaj, *“i pandehuri merret në pyetje vetëm në qoftë se bën kërkesë ose kur i kërkohet të dëshmojë dhe jep pëlqimin”* (neni 166.1 i KPP-së), dhe ka të drejtë të bëjë në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor deklaratimet që çmon të përshtatshme (Neni 358 i KPP-së).

E drejta për të heshtur ose mospranimi i përgjegjësisë nuk kanë aspak të bëjnë me detyrimin për të vënë në dispozicion të dhëna që mund t'i lejojnë gjyqtarëve të verifikojnë nëse faktet që janë objekt hetimi janë të vërteta apo jo. Nëse i pandehuri refuzon t'i vërë në dispozicion të dhënat në fjalë, vlerësimi gjyqësor i kësaj sjelljeje refuzuese lidhet me faktin se personi refuzon të japë të dhëna që vetëm ai mundet t'i japë, në mënyrë krejt unike dhe të pavëzëndësueshme. Shfajësimi mbetet në dorën e të akuzuarit, i cili provon se origjina e parave të tyre është e pastër dhe transparente.

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e lejon konsiderimin e heshtjes së të akuzuarit si provë; për shembull çështja *Murray kundër MB-së* (GC, Nr. 18731/91, 8 shkurt 1996). Në këtë rast, GJEDNJ-ja konstatoi se *“duke pasur parasysh peshën e provave kundër aplikantit [...], nxjerrja e deduksioneve nga refuzimi për të dhënë shpjegime për praninë e tij në banesë në fazën e arrestimit, gjatë marrjes në pyetje nga policia dhe në seancën gjyqësore, është çështje që ka të bëjë me gjykimin e shëndoshë dhe nuk mund të shihet si e padrejtë ose e paarsyeshme në kuadër rrethanash”*. Në fushën konkrete të procedimeve për pastrim parash, është veçanërisht interesant vendimi i GJEDNJ-së në çështjen *Zschüschen kundër Belgjikës*, 2 maj 2017, përmbledhur në seksionin e fundit të këtij Kapitulli.

3.

Të drejtat e palëve të treta

Në këtë seksion mund të dallojmë dy grupe kryesore subjektësh që nuk janë në hetim ose në ndjekje penale, por mund të preken disi nga vendime të marra në procedime për pastrime parash: së pari, të drejtat e të cilëve mund të jenë të kufizuara përsa u përket pasurive që konsiderohen si instrumente ose produkte krimi, përfshijnë p.sh pronarët e atyre pasurive, ose njerëzit që kanë të drejta të tjera pronësie (luzufukte, për shembull), ndërsa grupi i dytë përfshin viktimat e veprës penale.

A) E DREJTA E PALËVE TË PREKURA NGA MASAT PARANDALUESE

Për sa i përket grupit të parë, duhet vërejtur se të gjitha palët e interesit të prekura nga urdhri i ngrirjes, sekuestrimit ose konfiskimit duhet të kenë mjete juridike efikase për të mbrojtur të drejtat e tyre (Neni 8 i Konventës së Varshavës). Kjo dispozitë trajtohet më me hollësi në legjislacionin e BE-së. Sikurse përmendet në Kapitullin II të këtij Manuali, krahas mundësisë për të mbrojtur të drejtat e tyre në gjyq dhe për të kundërshtuar vendimin e sekuestrimit ose konfiskimit të pasurisë në gjykatë, të drejtat e tjera të parashikuara në Nenin 8 të Direktivës së vitit 2014 janë informimi sa më shpejt të jetë e mundur, duke treguar arsyen ose arsyet për lëshimin e urdhrin në fjalë, dhe prania e avokatit përgjatë gjithë procedimit. Gjithashtu, thuhet se urdhri i sekuestrimit mbetet në fuqi për sa kohë është e nevojshme që pasuria të ruhet, me qëllim konfiskimin e mundshëm vijues, dhe se pasuria e sekuestruar që nuk konfiskohet më pas i kthehet menjëherë pronarit.

B) TË DREJTAT E VIKTIMËS

Përsa u përket të drejtave të viktimës, gjëja e parë që duhet të kemi parasysh është që veprat penale të pastrimit të parave në vetvete nuk kanë viktima. Megjithatë, në shumë raste, ka viktima të veprave penale mëmë. Veprimtaritë e mëtejshme të pastrimit të parave e pengojnë efektshmërinë e pretendimeve të viktimave, pasi këto veprimtari synojnë ta maskojnë marrëdhënien midis pasurive në pronësinë aktuale të autorit ose bashkëpunëtorëve të tij dhe produktit të veprës penale mëmë. Për shembull, në një skemë të madhe mashtrimi, sapo kryhet vepra penale, qëllimi më i zakonshëm dhe i menjëhershëm i mashtruesve është pikërisht të pastrojnë në mënyrë efikase të ardhurat e paligjshme, për ta bërë kthimin e parave tek pronarët e ligjshëm më të vështirë.

Prandaj, kur bëhet një lidhje e qartë mes veprës penale mëmë me viktimë dhe operacionit të pastrimit të parave, të dyja veprat penale duhen hetuar dhe ndjekur penalisht në të njëjtat procedime dhe viktimize duhet t'u njihen të drejtat e parashikuara me ligj.

Në legjislacionin shqiptar, viktimë ka të paktën këto të drejta (Neni 58.1 i KPP-së):

- a) të kërkojë ndjekjen penale të autorit;
- b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimizeve të veprës penale;
- c) të komunikojë në gjuhën e vet dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpret i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar;
- ç) të zgjedhë avokat mbrojtës dhe, kur është rasti, të marrë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, sipas kushteve të caktuara në këtë Kod;
- ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit;
- f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- h) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimit të veprës penale; i) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e viktimit si dëshmitar;

Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre (Neni 58.2 i KPP-së).

4.

Praktika gjyqësore e gjednj-së

Fillimisht, duhet të bëjmë dallimin midis vendimeve dhe gjykimeve të GJEDNJ-së. Zakonisht, vendimi jepet nga një Gjyqtar, Komision ose Dhomë e Gjykatës. Ka të bëjë vetëm me pranimin e çështjes dhe jo me themelin e saj. Në të kundërt, kur shqyrton njëkohësisht pranueshmërinë dhe themelin e një aplikimi, Dhoma jep gjykim. Gjykimet për gjetjen e shkeljeve janë detyruese për Shtetet në fjalë, të cilat janë të detyruara t'i ekzekutojnë ato. Ndryshe nga gjykimet, vendimet e GJEDNJ-së nuk janë detyruese, ndonëse shumë vendime për të drejtat e njeriut shihen si aq të rëndësishme sa bëhen pjesë e legjislacionit të BE-së, që është detyrues për vendet anëtare të BE-së.

<p>Zschüschen kundër Belgjikës (Vendimi i datës 2 maj 2017) (Aplikimi Nr. 23572/07)</p> <p>Prezumimi i pafajësisë</p> <p>E drejta për të heshtur</p> <p>Provat rrethanore</p> <p>Nuk ka nevojë për përshkrimin e veprës penale mëmë</p>	<p>Çështja ka të bëjë me procedimet penale të cilat sollën dënimin e Z. Z për pastrim parash. Ai kishte hapur një llogari bankare në një bankë belge dhe, brenda dy muajsh depozitoi në të një shumë prej 75.000 eurosh gjithsej. Kur u pyet nga autoritetet rreth origjinës së parave, ai heshti gjatë gjithë procedimit. Z. Z u ankua për shkeljen e së drejtës së prezumimit të pafajësisë, të drejtës për të qëndruar në heshtje dhe së drejtës për mbrojtje në përgjithësi. Gjykata konstatoi se ankesa e tij ishte e pabazë, duke parashtruar qasjen se gjykatat, që nuk e kishin parë të nevojshme përcaktimin e veprës penale mëmë për ta dënuar një person për veprën penale të pastrimit të parave, nuk kishin pasur si efekt kalimin e barrës së provës nga prokuroria te mbrojtja. Gjykata vërejtë se gjykatat kombëtare kishin mbledhur mjaftueshëm prova rrethanore për ta shpallur fajtor Z. Z dhe se refuzimi i tij për të dhënë shpjegimet e kërkuara rreth origjinës së parave thjesht i kishin përforcuar më tej ato prova. Z. Z u ankua për shkeljen e të drejtës së tij për t'u informuar në kohë për akuzat ndaj tij, pasi vepra penale mëmë që përfshihej në veprën penale tërësore të pastrimit të parave nuk ishte përshkruar në fletëthirrjen e gjyqit. Gjykata e çmoi këtë ankesë si të pabazë, duke parashtruar se fletëthirrja përmbante përshkrimin e gjithanshëm dhe të hollësishëm të të gjitha transaksioneve të dyshimta dhe i referohej karakterizimit ligjor të fakteve, në mënyrë që Z. Z të vihej në dijeni për akuzën për pastrim parash dhe ushtrimin e të drejtave të tij për mbrojtje.</p>
<p>M. N. dhe të tjerë kundër San Marinos (Gjykimi Nr. 28005/12) 7 korrik 2015</p> <p>Garancitë procedurale</p>	<p>Shkalla dhe kompleksiteti i çështjes penale lidhur me pastrimin e dyshuar të parave në rang ndërkombëtar dhe falsifikimin e dokumenteve (<i>u desh që hetimet të kryheshin në pesë shtete të ndryshme</i>), që zakonisht vështirësohet më tej nga përfshirja e disa të dyshuarve, mund ta justifikojnë zgjatjen e procedimit në kohë (mbi pesë vjet).</p>

<p>Arewa kundër Lituanisë (Gjykimi Nr. 16031/18) 9 mars 2021</p>	<p>Shkalla dhe kompleksiteti i çështjes penale lidhur me pastrimin e dyshuar të parave në rang ndërkombëtar dhe falsifikimin e dokumenteve (<i>lu desh që hetimet të kryheshin në pesë shtete të ndryshme</i>), që zakonisht vështirësohet më tej nga përfshirja e disa të dyshuarve, mund ta justifikojnë zgjatjen e procedimit në kohë (mbi pesë vjet).</p>
<p>Kohëzgjatja e procedimeve</p>	
<p>Michaud kundër Francës (Gjykimi Nr. 12323/11) 6 dhjetor 2012</p>	<p>Detyrimi i avokatit për të raportuar dyshimet lidhur me veprimtaritë e pastrimit të parave nuk e cenon privilegjin profesional në mënyrë shpërpjesëtimore.</p>
<p>Avokatët dhe Pastrimi i Parave</p>	
<p>Särgava kundër Estonisë (Gjykimi Nr. 698/19) 16 nëntor 2021</p>	<p>Çështja ka të bëjë me legjislacionin për konfidencialitetin avokat-klient. Z. S, avokat, dyshohej se i përkiste një organizate kriminale që merrej me pastrim parash dhe autoritetet autorizuan një kontroll të firmës së tij ligjore, banesës dhe makinës, përfshirë edhe laptopin dhe celularin. Sipas këndvështrimit të gjykatës, mungesa e garancive procedurale lidhur veçanërisht me mbrojtjen e privilegjit profesional ligjor, solli mospërbushjen e kërkesave që rridhnin nga kriteri se cenimi duhet të jetë në përputhje me ligjin.</p>
<p>Konfidencialiteti avokat-klient</p>	
<p>Garancitë procedurale</p>	

KAPITULLI V

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

1.

Hyrje

Bashkëpunimi i mirë ndërkufitar është kyç për suksesin e hetimeve penale, veçanërisht të veprave të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit. Ky bashkëpunim kërkon njohuri të mjeteve ndërkombëtare të zbatueshme në këtë fushë dhe të disa aspekte teknike për zgjedhjen dhe zbatimin e mjetit, njohuri të Rezervimeve dhe Deklarimeve të Traktateve, të kuptuarit të rajonit të cili po i dërgojmë kërkesë dhe sistemit ligjor të shtetit që dërgon ose merr kërkesën.

Kur bëhet fjalë për sistemet ndërkombëtare të bashkëpunimit, ka një sërë traktatesh dhe marrëveshjesh dypalëshe që i lidhin palët me njëra-tjetrën dhe që si rrjedhojë përcaktojnë fushën e bashkëpunimit. Në këtë kuadër, përpara dërgimit të një kërkesë për NNJ apo ekzekutimit të një të tille, duhet të bëhen disa verifikime: profesionistët verifikojnë nëse vendi në fjalë ka traktat dypalësh me Shqipërinë, nëse ka detyrime në kuadër të Traktateve në fuqi të OKB-së dhe nëse vendi kërkues është shtet anëtar i Këshillit të Evropës dhe ka ratifikuar konventat përkatëse. Në varësi në nivelit të marrëdhënies, gjen zbatim një prej Konventave/Traktateve. Së fundmi, duhet të merren në konsideratë Deklaratat apo Rezervat ligjore me qëllim vlerësimin e shtrirjes së traktatit në shtetin ekzekutues. Ky është proces i nevojshëm që ndonjëherë është i ndërlikuar në rastet kur nuk ka një bazë të dhënash apo fjalorth që e lejon gjyqtarin apo prokurorin të njohë sistemin e vendit me të cilin dëshiron të bashkëpunojë dhe të identifikojë menjëherë traktatin që gjen zbatim në varësi të veprës që po hetohet.

Me qëllim lehtësimin e këtij hapi, në këtë kapitull është bashkëngjitur si shtojcë, një shqyrtim paraprak i legjislacionit ndërkombëtar përkatës dhe një tabelë krahasuese.

Tabela ndahet në qeliza dhe kolona. Çështjet janë të organizuara në qeliza me qëllim lehtësimin e konsultimit të tyre për çdo shtet, si më poshtë: Objekti i Traktatit (përfshirë adresën e internetit për shqyrtimin e statusit të ratifikimit), përcaktimet e përgjithshme që duhet të mbahen parasysh gjatë lëshimit/ekzekutimit të një kërkesë për NNJ, seksionet e veçanta që i kushtohen bllokimit dhe konfiskimit, ekstradimit, zbatimit të vendimeve të huaja, dispozitat e veçanta për hetimet financiare, shkëmbimin spontan të informacionit, formalitetet që duhet të kihet në konsideratë, (legjislacionin në fuqi, konsultimet ndërmjet autoritetit lëshues dhe atij ekzekutues, etj.), dispozitat për njoftimin e dokumentacionit, njohjen e vendimeve të huaja, mënyrat e transmetimit të kërkesës, formatin dhe gjuhën e kërkesës, parimin e veçorisë, konfidencialitetin, citimin e rezervave dhe deklaratave, masat e posaçme dhe kostot. Me pak fjalë, këto janë aspektet bazë që duhen marrë në konsideratë gjatë trajtimit të një kërkesë për NNJ. Citimet e veçanta për vlerësimin e rregullave të ndarjes nuk përfshihen këtu, sepse as analizat e traktateve nuk i përfshijnë këto citime.

2.

Sistemet e bashkëpunimit ndërkufitar të analizuara

Çështja praktike me interes më të madh është se si të lëshohet ose ekzekutohet një kërkesë për bashkëpunim ndërkombëtar, duke marrë parasysh mjetin e zbatueshëm. Për ta bërë këtë, është e nevojshme të kuptohen sistemet ekzistuese: Kur NNJ-ja lëshohet nga një një vend me të cilin nuk ka as marrëveshjedypalëshe dhe as shumëpalëshe, duke bërë të zbatueshëm parimin e reciprocitetit, sipas kuadrit ligjor shqiptar. Mungesa e garancive për reciprocitetin nga shteti kërkues mund të përbëjë bazë për mos lejimin e zbatimit të Letër Porosisë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.¹ Shih më poshtë parimet e zbatueshme kur nuk zbatohet asnjë traktat apo konventë.

- a) Një nga skenarët më të lehtë është ndërveprimi me një vend që ka detyrime në kuadër të një Konventë dypalëshe. Ajo mundëson hapësirë për zgjidhje më të hollësishme dhe specifike të problemeve që lidhen me bashkëpunimin ndërkufitar pasi të dy vendet mund të përfshijnë mjete më të përparuara që nuk janë parashikuar ose nuk janë aq të zhvilluara në traktatet shumëpalëshe, si dhe të jenë në gjendje të krijojnë kanale shumë të gjera për të komunikuar në varësi të afërsisë së tyre (p.sh. përdorimi i mjeteve të zakonshme në krimet kibernetike, shkëmbimi i inteligjencës, komunikimi i drejtpërdrejtë duke shmangur autoritetin qendror).
- b) Ndonjëherë, në varësi të veprës nën hetim, mjeti i zbatueshëm është një nga Konventat e OKB-së. Në këtë fushë kryesisht gjejnë zbatim Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermos) ose Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridës).
- c) Së fundmi, janë mjetet e KiE-s. Profesionistët juridikë duhet të kenë gjithmonë parasysh dispozitat e Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike (1959 dhe protokollet e veta shtesë, veçanërisht Protokollin e Dytë) dhe në kuadrin e veçantë të hetimit të veprave të pastrimit të parave dhe rekuperimin e aseteve, Konventën e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin, dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit (Nr. 198), (Konventa e Varshavës, 2005), ose (vetëm në marrëdhëniet me vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Varshavës) Konventën e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (ETS Nr. 141, Konventa e Strasburgut, 1990).

1. Kodi i Procedurës Penale, Neni 505, pika 5; Ligji Nr. 10193 datë 3.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale", Neni 9, pika 1.

Instrumentet e analizuara kanë një veçori të përbashkët, që është mishërimi i parimit të bashkëpunimit sa më të gjerë të mundshëm për veprat e kryera nga individë apo organizata kriminale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, etj. Kjo mund të shihet për shembull në Nenin 13.1 të Konventës së Palermos, Nenin 16 të Konventës së Varshavës, Nenin 6 të Konventës së Strasburgut, që do të thotë se autoritetet e zbatimit të ligjit nuk duhet të ndihen të kufizuara nga mungesa e dispozitave lidhur me çështje të veçanta, por ato duhet të përpiqen gjithmonë të nxjerrin ose të zbatojnë kërkesat për NNJ, me kusht që ato të mos jenë në shkelje të kuadrit të brendshëm ligjor apo të dispozitave të instrumenteve përkatëse.

A) PARIMET PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJE PENALE KUR NUK KA MJETE TË DISPONUESHME. REFERENCA SPECIFIKE TË SISTEMEVE LIGJORE

Në rastin e lëshimit ose zbatimit të kërkesave për NNJ duhet të theksohet se në mungesë të traktateve të zbatueshme, rregulli i përgjithshëm përcaktohet nga legjislacioni shqiptar, si për lëshimin ashtu edhe për ekzekutimin, çka përcaktohet në Nenin 1, pika 2 të Ligjit Nr. 10193 datë 3.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale", i cili përcakton se "dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet kur ka parashikime të tjera në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë", që sipas nenit 9 të të njëjtit Ligj përbën parimin e reciprocitetit që analizohet më poshtë. Për më tepër, Kodi Penal i Shqipërisë (neni 10) mishëron vlefshmërinë e vendimeve të gjykatave të huaja ndaj shtetasve shqiptarë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare². Nga ana tjetër, neni 518/1 i KPP përcakton se "Pas njohjes, vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen në përputhje me legjislacionin shqiptar".

Në rast se nuk ka traktat të zbatueshëm, profesionistët duhet të zbatojnë disa parime të përgjithshme ose rregullat e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar si më poshtë vijon:

- **Sovraniteti.** Parimi i sovranitetit do të thotë se çdo vend ka juridiksion ekskluziv në territorin e vet sipas legjislacionit të vendit. Në kuadër të nënshkrimit të traktateve, vendet heqin dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre me qëllim bashkëpunimin e efektshëm juridik. Megjithatë, nëse nuk ka traktat të zbatueshëm, vendi ka të drejtë të vlerësojë rast pas rasti nëse një kërkesë mund të zbatohet në emër të palës kërkuese. Ky vlerësim nuk është i vlefshëm pas hyrjes në fuqi të një Traktati.
- **Veçoria.** Parimi i veçorisë përfshihet në shumicën e traktateve. Ky parim thotë se shteti kërkues, i cili përmes bashkëpunimit juridik, ka marrë prova ose informacion, mund t'i përdorë ato për qëllimet për të cilat është kërkuar ndihma. Nëse informacioni ose provat do të përdoren edhe për qëllime të tjera, kjo mund të bëhet vetëm pas lejes shtesë të dhënë nga vendi të cilit i dërgohet kërkesa. P.sh., shihni Nenin 42 të Konventës së Varshavës, ose Nenin 18 të Konventës së Palermos.
- **Besimi/Besueshmëria.** Parimi i besimit të ndërsjellë mund të shihet në faktin e nënshkrimit të një traktati mes dy vendeve, duke qenë se kjo mund të shihet si shprehje e besimit të tyre në sistemet

2. Neni 10, Vendimet penale të marra nga gjykatat e huaja kundër shtetasve shqiptarë të cilat përcaktojnë kryerjen e një veprë penale, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, janë të vlefshme në Shqipëri në kuadër të objektit të legjislacionit shqiptar, edhe sa i përket sa më poshtë:

- a) kualifikimit të personit që ka kryer veprën penale si përsëritës;
- b) për ekzekutimin e vendimeve që përbajnë dënime plotësuese;
- c) për zbatimin e masave të sigurisë;
- d) për rikuperimin e dëmeve dhe efekteve të tjera në kuadër të së drejtës civile.

juridike të njëri-tjetrit. Ndërmjet vendeve nuk ka besim të verbër dhe zbatimi më i suksesshëm i këtij parimi mund të shihet ndërmjet Vendeve Anëtare të BE-së, sepse ai përbën një nga themelet e bashkëpunimit dhe procesit të integritetit të BE-së. Kjo do të thotë se çdo Vend Anëtar është i bindur se të gjitha Vendet e tjera Anëtare dhe autoritetet janë të afta të zbatojnë saktë legjislacionin e BE-së në përputhje me kuadrin e të drejtave individuale të njeriut. Pra, ky është parim i zbatueshëm ligjërisht me objekt të gjerë zbatimi. Shembulli më domethënës i këtij parimi është Opinioni i GJDBE-së 2/13 për anëtarësimin e BE-së në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut³. Në këtë rast, besimi i ndërsjellë është tipar specifik që rrjedh “nga vetë natyra” e të drejtës evropiane (pika 166) si pasojë e natyrshme e pavarësisë dhe autonomisë së juridiksionit të BE-së.

Megjithatë, besimi i ndërsjellë nuk mund të merret si i mirëqenë, duke qenë se Vendet Anëtare vënë në dyshim përmbushjen e plotë të së Drejtës së BE-së dhe të së drejtës për të drejtat e njeriut nga të tjerët. Kjo ndodh në disa fusha të ndjeshme, si p.sh. lidhur me mungesën e harmonizimit të vlerave të Nenit 2 të TBE-së nga disa Vende Anëtare, ngurrimit kur lind detyrimi i dorëzimit të vendasve në Vendet Anëtare kërkuese bazuar në argumente si pasaktësitë e sistemit procedural apo të burgimit në Shtetin kërkues, dhe në raste të keqkuptimit politik në fushën e sistemit të rivendosjes për migrantët.

- **Kriminaliteti i dyfishtë.** Parimi kërkon që faktet e përshkruara në kërkesë të përbëjnë veprë penale edhe në vendin të cilit i drejtohet kërkesa. Megjithatë, shteti të cilit i drejtohet kërkesa nuk kufizohet në etiketimin e veprës që përdoret në vendin kërkues dhe mund ta përkufizojë ndryshe veprën penale. Tashmë kriminaliteti i dyfishtë nuk shihet më si pengesë për bashkëpunimin pa ngërçe. Një shembull i mirë jepet në Konventën për NNJ-në e vitit 1959 dhe në Protokollin e Dytë Shtesë, duke qenë se në kuadër të saj, mungesa e kriminalitetit të dyfishtë nuk përbën argument për refuzimin e ekzekutimit të kërkesës, përveç kërkimit dhe sekuestrimit e pronës (në këtë rast refuzimi është opsional, sipas Nenit 5)
- **Disponueshmëria.** Ky parim parashikon që informacioni për krimet e rënda (p.sh. planifikimi i sulmeve terroriste) që zotërohet nga një autoritet hetues në një vend, duhet t’i vihet në dispozicion vendit tjetër, në mënyrë që ky i fundit të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme. Kjo disponueshmëri ka disa kufij: njëri prej tyre është parimi i specialitetit, i përmendur tashmë, ose kufijtë e konfidencialitetit, ose kur ka hetime të krimeve të rënda në vazhdim.
- **Reciprociteti** është parimi në bazë të shumë traktateve shumëpalëshe. Ky do të thotë se një shtet është i përgatitur të ofrojë ndihmë juridike nëse shteti tjetër është po ashtu i gatshëm të veprojë në të njëjtën mënyrë. Parimi i reciprocitetit mund të ndikojë bashkëpunimin juridik në dy situata. Nga njëra anë shteti mund të kufizojë nivelin e vet të bashkëpunimit përmes një deklarate në traktat. Si rrjedhojë, shtetet e tjera mund të kufizojnë nivelin e ndihmës juridike për shtetin në fjalë në të njëjtën mënyrë. Nga ana tjetër, ky parim mund të luajë rol kur merret vendim nëse duhet kërkuar ndihmë nga shtete me të cilat nuk janë nënshkruar ende traktate ose marrëveshje dypalëshe. Duke dërguar një kërkesë për ndihmë juridike, shteti kërkues mund të japë idenë se kur shteti të cilit i drejtohet kërkesa do të ketë nevojë për ndihmë, reciprociteti do të zbatohet. Për të parandaluar diçka të tillë, Ministria e Drejtësisë, në rastet kur kërkesa duhet të dërgohet përmes saj, përcakton në shkresën përcjellëse të kërkesës për ndihmë juridike se cilat elemente të reciprocitetit nuk mund të ofrohen.
- **Ne bis in idem.** Parimi i mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë siguron bazën për refuzimin e veprimit në kuadër të një kërkesë për bashkëpunim gjyqësor. Shteti të cilit i dërgohet kërkesa mund të refuzojë ndihmën kur një i akuzuar është shpallur fajtor ose i pafajshëm për të njëjtën veprë të përcaktuar në kërkesën për ndihmë juridike.
- **Konfidencialiteti.** Ky parim kërkon që çdo informacion i ndarë nga shteti kërkues në një kërkesë për ndihmë juridike të trajtohet me konfidencialitet nga ana e shtetit të cilit i drejtohet kërkesa. Në fund të fundit, informacioni i siguruar në kërkesat për ndihmë juridike është në “pronësi” të autoritetit hetues në shtetin kërkues. Përdorimi i këtij informacioni pa njoftim paraprak ose pas këshillimit me shtetin kërkues mund të dëmtojë seriozisht hetimin penal në fjalë.

3. GJDBE, 18 dhjetor 2014, Opinioni 2/13, ECLI:EU:C:2014:2454

Së fundi, vlen të theksohet ekzistenca e dy sistemeve të ndryshme të aplikimit dhe zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare në legjislacionin vendas. Nga njëra anë, i ashtuquajturit sistem monist konsideron se dispozitat e përcaktuara në traktatet ndërkombëtare janë të detyrueshme dhe drejtpërdrejt të zbatueshme pasi traktati të jetë botuar zyrtarisht. Shqipëria, për shembull, është sistem monist, sepse Neni 122 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë se traktatet ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme kur nuk kërkojnë implementim. Vendet *me sisteme të së drejtës civile* shpesh janë moniste. Nga ana tjetër, disa vende (veçanërisht vendet me *sistem të së drejtës zakonore*) ndjekin të ashtuquajturin sistem dualist, sipas të cilit traktatet ndërkombëtare krijojnë vetëm detyrime ndërmjet vetë shteteve (jo për autoritetet vendase) dhe nuk zbatohen drejtpërdrejt nga gjyqtarët ose prokurorët. Ata janë të detyruar vetëm nga legjislacioni i brendshëm dhe mund të zbatohen dispozitat e së drejtës ndërkombëtare, vetëm për aq sa janë zbatuar në legjislacionin e tyre të brendshëm dhe në mënyrën se si janë zbatuar. Ky ndryshim është i rëndësishëm sepse juridiksionet më pak bashkëpunuese janë zakonisht vende me sistem dualist dhe, megjithëse ato kanë ratifikuar disa traktate për ndihmën e ndërsjellë juridike, jo të gjitha dispozitat e tyre mund të jenë zbatuar në legjislacionin e tyre të brendshëm me të njëjtën përmbajtje të dispozitave të parashikuara në ato traktate.

B) CITIMI I INSTRUMENTEVE TË OKB-SË. KUADRI I NDARJES SË ASETIVE

Siç u përmend edhe më lart, konventat e analizuara të Kombeve të Bashkuara janë Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermos, hyrë në fuqi më 29 shtator 2003) dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridës, hyrë në fuqi më 14 dhjetor 2005). Objekti i Konventës së Palermos janë veprat transnacionale të cilat përfshijnë organizatat kriminale dhe që lidhen me veprat e renditura në nenet 5, 6, 8, dhe 23, si dhe krimet e rënda të përcaktuara në konventë, ndërsa Konventa e Meridës synon parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të korrupsionit, si dhe bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe kthimin e këtyre produkteve. Të dy konventat përcaktojnë pjesë të veçanta për kërkesat për NNJ, bllokimin dhe konfiskimin dhe për masat për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar. Në veçanti, rregullat për disponimin e produkteve janë të përfshira me formulime të ndryshme: nga njëra anë, Neni 14 i Konventës së Palermos përcakton se rregulli i përgjithshëm është që të ardhurat nga konfiskimet disponohen në përputhje me legjislacionin vendas, megjithëse është e mundur që këto produkte t'i kthehen palës kërkuese me qëllim kompensimin e viktimave ose për t'iu rikthyer pronarëve. Gjithashtu, përfshihen rregulla të mëtejshme për ndarjen e pasurive, por kjo bëhet me marrëveshje. Nga ana tjetër, Konventa e Meridës përcakton në Nenin 57 se kthimi ose disponimi i pasurisë bëhet në përputhje me legjislacionin vendas dhe shton disa dispozita të veçanta: në rast përvetësimi të fondeve publike, pasuritë i kthehen palës kërkuese. Në çështjet e tjera, pasuritë kthehen kur pala kërkuese vërteton pronësinë e tyre ose kur pala së cilës i drejtohet kërkesa i pranon dëmin palës kërkuese. Dispozitat e tjera janë të paraqitura në tabelën bashkëlidhur.

C) INSTRUMENTET E KËSHILLIT TË EVROPËS (KIE). CITIMET PËR KUADRIN E NDARJES SË ASETIVE

Këshilli i Evropës (KiE) është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në kontinentin tonë. Ajo ka 46 shtete anëtare, 27 prej të cilave janë vende anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha Shtetet Anëtare kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), traktat ky i nënshkruar për ruajtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë, dhe shtetit të së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) mbikëqyr zbatimin e Konventës në Shtetet Anëtare.

Seria e konventave të Këshillit të Evropës përmbledh të gjitha konventat e miratuara nga Organizata që prej vitit 1949. Pavarësisht emrit ("marrëveshje", "konventë", "organizim", "kod", etj.), të gjithë këta dokumente janë traktate ndërkombëtare sipas kuptimit të Konventës së Vjenës e vitit 1969 për Ligjin për Traktatet.

Konventat e Këshillit të Evropës hartohen dhe negociohen brenda kuadrit institucional të Këshillit të Evropës. Negociatat përmbillen me një vendim të Komitetit të Ministrave për miratimin e tekstit përfundimtar të traktatit të propozuar. Më pas bihet dakord që traktati të hapet për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit, dhe kur është e përshtatshme edhe nga shtete e organizata të tjera që kanë marrë pjesë në hartimin e tij.

Konventat e Këshillit të Evropës nuk janë akte detyruese të Organizatës. Ekzistenca e tyre ligjore bazohet në pëlqimin e shteteve anëtare të cilat i nënshkruajnë dhe i ratifikojnë ato. Për më tepër, shumica e konventave të Këshillit të Evropës ofrojnë mundësinë që Shtete jo anëtarë të Organizatës të bëhen palë e tyre me ftesë nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës dhe përmes procedurës së aderimit.

Sekretari i Përgjithshëm është depozituesi i konventave të Këshillit të Evropës. Ai është depozituesi i këtyre konventave dhe drejton nënshkrimin e tyre dhe depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit. Sekretari i Përgjithshëm është gjithashtu përgjegjës për njoftimin e parashikuar në dispozitat e fundit të konventave dhe për regjistrimin e tyre në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara.

Për pjesën më të madhe të konventave janë botuar edhe raporte shpjeguese. Ato hartohen nga komiteti i ekspertëve të udhëzuar të hartojnë konventën në fjalë. Këto raporte shpjeguese mund të lehtësojnë zbatimin e dispozitave të konventës, por ato nuk përbëjnë instrumente që sigurojnë një interpretim të tyre me autoritet.

Teksti i të gjitha konventave të KiE-s, raportet e tyre shpjeguese, statusi i nënshkrimit dhe ratifikimit, deklaratat dhe rezervat e bëra nga Shtetet, si dhe njoftimet e bëra nga Zyra e Traktateve që prej vitit 2000, janë të disponueshme në faqen e internetit të Zyrës së Traktateve të Këshillit të Evropës⁴. Në kuadër të këtij kapitulli, trajtohen disa traktate kyçe: Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale 1959, (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale (1978, ETS Nr.99), Konventa Evropiane për Ekstradimin (1957, ETS Nr. 024), Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin (1990, ETS Nr. 141), Strasburg 1990 dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe për Financimin e Terrorizmit (2005, ETS nr. 198), e njohur si Konventa e Varshavës. Të gjitha sa më lart analizohen në tabelën e bashkëngjitur.

Të dyja konventat e vitit 1990 dhe vitit 2005 përcaktojnë se pala kërkuese do të bëjë disponimin e aseteve në përputhje me legjislacionin dhe me procedurat administrative vendase. Megjithatë, Raporti Shpjegues i këtyre konventave, konsideron se një marrëveshje e ndarjes së aseteve, edhe pse nuk parashikohet shprehimisht në konventa, nuk është në kundërshtim me to dhe mund të ketë disa avantazhe.

4. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list>

D) INSTRUMENTET E BE-SË

a) Urdhri Evropian i Hetimit

Urdhri Evropian i Hetimit (UEH) është vendim gjyqësor i lëshuar në ose i vërtetuar nga autoriteti gjyqësor i një vendi anëtar të BE-së me qëllim zbatimin e masave hetimore në një vend tjetër të BE-së. Ky urdhër është i vlefshëm në të gjithë BE-në, por nuk gjen zbatim në Danimarkë dhe në Irlandë. Duke qenë se UEH-ja bazohet në njohje të ndërsjellë, në parim autoriteti ekzekutues është i detyruar të pranojë dhe të sigurojë ekzekutimin e kërkesës së vendit tjetër.

UEH-ja është përcaktuar nga Direktiva 2014/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për Urdhrin Evropian të Hetimit në çështjet penale. Direktiva krijon një kuadër të vetëm gjithëpërfshirës për mbledhjen e provave (përveç JIT-eve, dëshmime të penalitetit, shkëmbimit spontan të informacionit). Masat hetimore përfshijnë masa të tilla si marrja në pyetje e dëshmitarëve, përgjimet telefonike, hetimet në mbulim, dhe informacionin mbi operacionet bankare.

Që prej fillimit të zbatimit të tij në maj të vitit 2017, UEH-ja i siguron autoriteteve gjyqësore një alternativë më të thjeshtë dhe më të shpejtë krahasuar me instrumentet për kërkimin e provave. Në veçanti, instrumenti i siguron profesionistëve një formë standarde dhe unike për mbledhjen dhe marrjen e provave. Ai përcakton afate rigoroze dhe mundësi të kufizuara për refuzimin e zbatimit nga ana e Shtetit ekzekutues. Në veçanti, afati prej 90 ditësh me disa përjashtime dhe lista e veprave penale për shmangien e kriminalitetit të dyfishtë, janë pikat kyçe të sistemit të UEH-së.

b) Urdhër Arresti Evropian

Urdhër Arresti Evropian (UAE) është procedurë e thjeshtuar ndërkufitare për dorëzimin gjyqësor, që zbatohet në të gjitha Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian. UAE-ja lëshohet nga një autoritet gjyqësor në Vendin e parë Anëtar (Vendi Anëtar lëshues) drejt një autoriteti gjyqësor në një Vend të dytë Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa (Vendi Anëtar ekzekutues) për qëllimin e ndjekjes penale ose ekzekutimit të një dënimi me burgim.

Në zbatim prej janarit të vitit 2004, UAE-ja bazohet në parimin e njohjes së ndërsjellë dhe në besimin dhe kontaktin e drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore të Vendeve Anëtare. Duke qenë se zëvendëson instrumentet e mëparshme të ekstradimit që kërkonin përfshirje politike, instrumenti mundëson procedura më të shpejta dhe më të thjeshta dorëzimi duke përcaktuar afate rigoroze kohore për dorëzimin e të dyshuarve dhe të dënuarve, dhe duke u siguruar profesionistëve një standard të vetëm, si dhe duke përcaktuar mundësi të kufizuara për refuzim nga ana e Shtetit ekzekutues.

c) Legjislacioni mbi njohjen e ndërsjellë të urdhrave për ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve. Trajtim i posaçëm i kuadrit të BE-së për ndarjen e pasurive

Gjurmimi, bllokimi, konfiskimi dhe rikuperimi i parave dhe pasurive të përfuara në mënyrë të paligjshme është përparësi me rëndësi për autoritetet kombëtare të vendet anëtare, përfshi dhe vendet candidate si dhe është gjithashtu përparësi strategjike për luftën e Bashkimit Evropian kundër krimit të organizuar.

Siç është përmendur në kapitujt e tjerë, katër fazat kryesore të rekuperimit të aseteve janë gjurmimi i pasurive (procesi me anë të të cilit hetuesit ekzaminon produktin e krijuar nga veprimtaria kriminale dhe gjurmojnë pasuritë e përfuara në mënyrë të paligjshme), ngrirja e pasurisë (që përfshin ngrirjen e përkohshme të pasurisë ndërkohë që pritet vendimi i formës së prerë në një çështje penale, duke parandaluar kështu shkatërrimin, tjetërsimin, zbritjen, transferimin ose disponimin e pasurive përpara se çështja të mbyllet, konfiskimin e pasurisë (parandalon qasjen e kriminelëve në pasuritë që janë sekuestruar përfundimisht) dhe disponimin e pasurive (rekuperimi faktik i aseteve, pas të cilit pasuritë i rikthehen shtetit përkatës, ndahen ndërmjet shteteve përkatëse ose i kthehen viktimës).

Çështjet e zakonshme të hasura nga autoritetet kombëtare gjatë fazës së gjurmimit të aseteve përfshijnë identifikimin e saktë të aseteve jashtë vendit dhe përdorimin e Zyrave të Rekuperimit të Aseteve (ARO), si dhe vështirësitë për të bindur autoritetet e të cilave u drejtohet kërkesa të kryejnë hetime; për shembull, për shkak të ndërgjegjësimit të pamjaftueshëm për ekzistencën e ARO-ve dhe rolin e tyre.

Në raste të tjera, mund të ketë gjithashtu problematika në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare të përfshira, përfshirë Njësitë e Inteligjencës Financiare (FIU). Për shembull, ka kompleksitete që rezultojnë nga transmetimi i njëkohshëm i Letrave të Porosisë (LP) ose UEH që kërkojnë informacion bankar dhe financiar, ose vështirësi që lidhen me kanalin e transmetimit të këtij informacioni.

Kuari ligjor i BE-së përbëhet nga instrumente të ndryshme për të gjithë procesin e gjurmimit dhe konfiskimit të aseteve: gjurmimi i pasurive duhet të kërkohet kryesisht përmes UEH-së, duke qenë në vetvete ato janë provë e veprimtarisë kriminale (bashkëpunimi ndërmjet ARO-ve është gjithashtu i mundur), ndërsa ngrirja dhe konfiskimi duhet të bëhen përmes një Rregulloreje.

Ngrirja e aseteve do të thotë bllokim i përkohshëm i pronës, në pritje të një vendimi të formës së prerë për çështjen. Kjo do të thotë se pronari nuk mund të disponojë pronën e vet përpara se çështja të mbyllet. Konfiskimi është masë përfundimtare e krijuar për të parandaluar qasjen e kriminelëve në pasuritë e përfuara duke shkelur ligjin. Pasuria largohet përfundimisht nga autori ose bashkëpunëtorët e tij. Rregullorja zbatohet për urdhrat e bllokimit dhe konfiskimit të lëshuar nga një Vend Anëtar në procedime penale. Disa prej pikave të forta të Rregullores janë si më poshtë vijon: ajo përcakton afate të qarta dhe të shkurtra për njohjen e ndërsjellë dhe ekzekutimin e urdhrave të bllokimit, ajo përforcon të drejtat e viktimave për kthim dhe kompensim në çështjet ndërkufitare, ajo përcakton garanci për të siguruar që njohja e ndërsjellë e urdhrave të bllokimit dhe sekuestrimit të jetë në përputhje me Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore dhe Vendet Anëtare informojnë Komisionin lidhur me autoritetet kompetente dhe deklaratat që ato bëjnë në lidhje me transmetimin e urdhrave të bllokimit dhe sekuestrimit dhe përkthimeve të tyre. Është shumë e rëndësishme të theksohet qasja e përcaktuar nga Rregullorja për viktimën, që përcaktohet në recitalin [45]: E drejta e viktimës për kompensim dhe kthim nuk duhet të paragjykohet në çështjet ndërkufitare. Koncepti i "viktimës" duhet të interpretohet në përputhje me legjislacionin e Shtetit lëshues, që mund gjithashtu të jetë i aftë të përcaktojë se një person juridik mund të jetë viktimë për qëllimet e kësaj Rregulloreje. Kjo Rregullore nuk duhet të paragjykojë rregullat për kompensimin dhe kthimin e pasurisë viktimave në procedimet kombëtare. Shih gjithashtu edhe recitalin [46] për më shumë informacion.⁵

5. Paragrafi 46 "Në rastet kur autoriteti ekzekutues informohet për një vendim të lëshuar nga autoriteti lëshues ose nga një autoritet tjetër kompetent në Shtetin lëshues për kthimin e pasurisë së bllokuar viktimës, autoriteti ekzekutues duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që pasuria në fjalë të bllokohet dhe t'i kthehet viktimës sa më shpejt të jetë e mundur. Autoriteti ekzekutues duhet të jetë i aftë t'i transferojë pasurinë Shtetit lëshues, në mënyrë që ky i fundit të ketë mundësi t'ia kthejë pronën viktimës, ose drejtpërdrejt viktimës me pëlqimin e Shtetit lëshues. Detyrimi për kthimin e pasurisë së bllokuar viktimës duhet t'i nënshtrohet kushteve të mëposhtme: pronësia e viktimës mbi pasurinë në fjalë nuk duhet të jetë e kundërshtuar, pra duhet të jetë pranuar që viktima është pronari i ligjshëm i pasurisë dhe se nuk ka asnjë pretendim serioz që e kundërshton këtë; duhet që pasuria të mos jetë e nevojshme si provë në procedimin

Neni 30.7 i Rregullores trajton qasjen e BE-së për ndarjen e pasurisë, duke përcaktuar sa më poshtë:

'Nëse urdhri i konfiskimit nuk shoqërohet me vendim për kthimin e pasurisë viktimës ose për kompensimin e viktimës në përputhje me pikat 1 deri 5, ose nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet Vendeve Anëtare të përfshira, Shteti ekzekutues disponon paratë e përfuara si pasojë e ekzekutimit të një urdhri konfiskimi si më poshtë vijon:

(a) nëse shuma e përftuar nga ekzekutimi i urdhrit të konfiskimit është e barabartë ose më pak se 10 000 Euro, shuma i kalon Shtetit ekzekutues;

ose

(b) nëse shuma e përftuar nga ekzekutimi i urdhrit të konfiskimit është më shumë se 10 000 Euro, 50% e shumës i transferohet Shtetit lëshues nga Shteti ekzekutues'.

Sistemi i ndarjes së pasurive përgjysmë është rregull me ndikim të sigurt, sepse i nxit të dy shtetet të veprojnë në mënyrë proaktive në hetimet pasurore. Ky rregull nuk përcaktohet në konventa të tjera ndërkombëtare; megjithatë, një praktikë e mirë është zbatimi i këtij rregulli në lidhje me vendet e tjera në përputhje me parimin e reciprocitetit (p.sh., shihni Spanja e zbaton këtë rregull me vendet e treta jashtë BE-së).⁶

d) Provat elektronike

Në ditët e sotme marrja e provave të mira elektronike po bëhet vendimtare në çdo hetim penal. Në këtë drejtim, janë ose do të hyjnë në fuqi disa mjete ndërkombëtare për të lehtësuar mbledhjen dhe transmetimin e këtyre provave: në thelb, duhet të nënvizohet Protokollin i Dytë i Konventës së Budapestit për krimin kibernetik dhe Direktiva dhe Rregullorja e BE-së për Urdhrat Evropian të Prodhimit dhe Urdhrat Evropian të Ruajtjes.

Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës së Budapestit mbi krimin kibernetik (CETS Nr. 224) është aktualisht akti më modern në këtë fushë. Ai u hap për nënshkrim në maj të vitit 2022. Ai ofron mjete për të rritur bashkëpunimin dhe zbulimin e provave elektronike - si: a) bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me ofruesit e shërbimeve dhe regjistruarit, b) mjetet e efektshme për marrjen e informacionit të pajtimtarëve dhe të dhënave të trafikut, c) bashkëpunimin e menjëhershëm në situata urgjente ose hetime të përbashkëta, që i nënshtrohen sistemit të respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, përfshirë masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave. Shqipëria nënshkroi Protokollin e Dytë më 27 shkurt 2023, por ai ende nuk është ratifikuar. Të gjitha këto masa specifike janë të një rëndësie të jashtëzakonshme dhe vendosin mjetet e KiE në pararojë të bashkëpunimit ndërkombëtar. Pikat kryesore të Protokollit të Dytë Shtesë janë:

penal në Shtetin ekzekutues; dhe të drejtat e personave të ndikuar, në veçanti të drejta e palëve të treta në mirëbesim, nuk duhet të paragjykojnë. Autoriteti ekzekutues duhet t'ia kthejë pasurinë e bllokuar viktimës, vetëm kur këto kushte përmbushen. Kur autoriteti ekzekutues konsideron se këto kushte nuk janë përmbushur, ai duhet të konsultohet me autoritetin lëshues, për shembull, për sigurimin e informacioneve shtesë ose për të diskutuar situatën, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje. Nëse nuk mund të gjendet një zgjidhje, autoriteti ekzekutues duhet të ketë mundësi të vendosë të mos ia kthejë pasurinë viktimës.'

6. Dispozita e katërt shtesë e Legjislacionit Spanjoll për njohjen e ndërsjellë të instrumenteve të BE-së (Ligji 23/2014).

5. Kur ekzekutimi i urdhrit të konfiskimit ndikon pasuritë që janë pjesë e trashëgimisë kulturore të Spanjës, këto të fundit nuk shiten dhe nuk i kthehen Shtetit kërkues në asnjë rrethanë. Në këto raste, konfiskimi i njoftohet menjëherë autoriteteve kompetente spanjolle dhe në këto raste gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit 16/1985, datë 25 qershor 1985 për Trashëgiminë Kulturore Spanjolle dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

- Kërkesa të drejtpërdrejta regjistruarit në juridiksione të tjera për informacion mbi regjistrimet e emrave të *domain*-it;
- Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me ofruesit e shërbimeve në juridiksione të tjera për të marrë informacionin e pajtimtarëve;
- Mjete më të efektshme për marrjen e informacionit të pajtimtarëve dhe të dhënave të trafikut nëpërmjet bashkëpunimit qeveri-qeveri;
- Bashkëpunimi i përshpejtuar në situata urgjente;
- Ekipet e përbashkëta hetimore dhe hetimet e përbashkëta.
- Videokonferencë.

Çështja e pranueshmërisë së provave të mbledhura në procedimet penale ndërkufitare në BE është përfshirë tashmë në Përfundimet e Tampere-s. Neni 82 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) siguron mundësinë që Parlamenti Evropian dhe Këshilli të miratojnë rregullat minimale për pranueshmërinë e ndërsjellë të provave. Standardet e përbashkëta minimale për mënyrën se si provat duhet të mbledhen dhe transferohen, si dhe për një grup rregullash të përcaktuara për përjashtimin, janë të nevojshme me qëllim garantimin e të drejtave themelore dhe lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor në nivelin e BE-së, duke qenë se provat elektronike paraqesin një element ndërkufitar në thuajse të gjitha hetimet dhe procedimet penale.

Rëndësia e një grupi të përbashkët rregullash për provat dhe provat elektronike është rritur për shkak të digjitalizimit të shpejtë të sektorit privat dhe publik, si dhe të veprimtarive profesionale dhe joprofesionale. Disa zhvillime legjislative (Direktiva 2014/41/BE për Urdhrin Evropian të Hetimit (UEH) në çështjet penale dhe Rregullorja e Këshillit (BE) 2017/1939 për përcaktimin e bashkëpunimit të shtuar për ngritjen e Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (ZPPE), e kanë trajtuar pjesërisht këtë çështje. Megjithatë, UEH-ja nuk përfshin rregulla për pranueshmërinë e provave ose rregulla për përjashtimin e tyre. Pranueshmëria e provave të mbledhura jashtë vendit varet nga mënyra si janë marrë dhe nga cilat rregulla janë zbatuar gjatë procedurës.

Kështu, nuk ka praktikë unike ndër Vendet Anëtare të BE-së në këtë kuadër. Shumëllojshmëria e zgjidhjeve që përdoren në Vendet Anëtare nga njëra anë pengon krijimin e të ashtuquajturës “zonë e lëvizjes së lirë të provave penale” dhe nga ana tjetër mund të ketë ndikim negativ mbi të drejtën e të pandehurve për t’u mbrojtur. Ndërkohë që para disa vitesh Vendet Anëtare mund të kenë menduar se rregullat mbikombëtare për pranueshmërinë e provave mund të mos ishin ngushtësisht të detyrueshme dhe si pasojë nuk vepronin sipas parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit të së drejtës së BE-së, situata ka ndryshuar tërësisht në dhjetëvjeçarët e fundit për shkak të ndryshimeve të dukshme në “shoqërinë e sotme digjitale”.

Rregullat e reja të BE-së për provat elektronike përbëhen nga dy masa legjislative:

- Rregullorja (BE) 2023/1543 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 12 korrik 2023, për Urdhrat Evropian të Prodhimit dhe Urdhrat Evropian të Ruajtjes për provat elektronike në procedurën penale dhe për ekzekutimin e dënimeve me burgim pas procedurës penale;
- Direktiva (BE) 2023/1544 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 12 korrik 2023, që përcakton rregulla të harmonizuara për caktimin e institucioneve të caktuara dhe emërimin e përfaqësuesve ligjorë me qëllim mbledhjen e provave elektronike në procedurat penale.

Tekstet do t’i mundësojnë autoriteteve kompetente t’ia drejtojnë urdhrat e gjykatës për marrjen e provave elektronike drejtpërsëdrejti ofruesve të shërbimeve në Vende të tjera Anëtare. Rregullorja për urdhrat evropianë për prodhimin dhe ruajtjen e provave elektronike në procedimet penale synon të paraqesë një mekanizëm alternativ ndaj instrumenteve ekzistuese të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndihmës së

ndërsjellë ndërkombëtare. Ajo trajton në veçanti problemet që lindin nga natyra e paqëndrueshme e provave elektronike dhe nga aspekti i "humbjes së gjurmueshmërisë", duke krijuar procedura të reja për qasjen ndërkufitare të shpejtë, efikase dhe të efektshme. Në këtë drejtim, mund të përmenden nenet 299/a (Ruajtja e përshpejtuar e të dhënave kompjuterike) dhe neni 299/b (Ruajtja e përshpejtuar dhe zbulimi i pjesshëm i të dhënave kompjuterike.) e KPP.

Rregullorja krijon urdhrat evropianë të prodhimit dhe të ruajtjes të cilët mund të lëshohen nga autoritetet gjyqësore për marrjen dhe ruajtjen e provave elektronike, pavarësisht vendndodhjes fizike të të dhënave. Këta urdhra mund t'i referohen të gjitha kategorive të të dhënave, përfshirë të dhënat për abonentët, qarkullimin dhe përmbajtjen. Është përcaktuar një kufi për të dhënat e trafikut (përveç të dhënave të kërkuara vetëm për identifikimin e përdoruesit) dhe për të dhënat e përmbajtjes. Ato mund të kërkohen vetëm për vepra të dënueshme në vendin lëshues me burgim jo më pak se tre vjet në maksimum, për vepra të veçanta lidhur me krimin kibernetik, pornografinë e fëmijëve, falsifikimin e mjeteve jomonetare të pagesës, ose terrorizëm.

Është përcaktuar një afat i detyrueshëm prej 10 ditës për t'iu përgjigjur një urdhri provash. Në rastet e urgjencës të përcaktuara sipas procedurave, afati mund të reduktohet në gjashtë orë. Ofruesit e shërbimeve mund të përballen me sanksione nëse nuk zbatojnë urdhrat në fjalë. Mund të vendosen penaltete financiare deri në 2% të xhiros së tyre të përgjithshme vjetore në të gjithë botën për vitin financiar paraardhës. Përveç rasteve kur autoriteti lëshues konsideron se vepra është kryer ose ka gjasa të jetë kryer në vendin lëshues dhe/ose se presoni të dhënat e të cilit kërkohen jeton në territorin e vet, ngrihet një sistem njoftimi për të dhënat e trafikut (përveç rasteve kur të dhënat kërkohen vetëm për të identifikuar përdoruesin) dhe për të dhënat e përmbajtjes. Qëllimi i këtyre njoftimeve është të informojë Shtetin ekzekutues dhe t'i japë atij mundësinë të vlerësojë, dhe nëse e sheh të arsyeshme, të pretendojë argumentet e refuzimit të përcaktuara në legjislacion, si për shembull në rastin kur të dhënat e kërkuara janë të mbrojtura.

Shteti ekzekutues ka 10 ditë, ose në raste urgjente 96 orë, për të ngritur argumentet për refuzim. Nëse kjo ndodh, ofruesi i shërbimit duhet të ndalojë ekzekutimin e urdhrat dhe nuk transferon të dhënat, dhe autoriteti lëshues tërheq urdhrin. Nëse të dhënat janë transferuar tashmë, sipas përcaktimit për rastet e urgjencës, autoriteti lëshues fshin ose kufizon në mënyra të tjera të dhënat, ose përmbush kushtet e përcaktuara gjatë përdorimit të tyre.

Direktiva për përcaktimin e organeve përgjegjëse dhe përcaktimin e përfaqësuesve juridikë për marrjen e provave elektronike në çështjet penale është instrument plotësues dhe thelbësor në zbatimin e Rregullores. Ajo përcakton rregullat që zbatohen për caktimin e përfaqësuesve juridikë të ofruesve të shërbimeve ose përcaktimin e organeve të tyre përgjegjëse për pritjen dhe përgjigjen për këta urdhra. Kjo është e nevojshme për shkak të mungesës së një kërkesë të përgjithshme ligjore për ofruesit e shërbimeve jashtë BE-së për të pasur prani fizike në BE. Për më tepër, përfaqësuesit juridikë ose organet përgjegjëse sipas kësaj Direktive mund të përfshihen edhe në procedurat kombëtare.

3.

Kuatrid ligjor shqiptar. Referenca specifike për ndarjen e aseteve

Referencat kryesore të legjislacionit vendas lidhur me bashkëpunimin juridiksional ndërkombëtar parashikohen në Kushtetutë (Nenet 5, 39, 116, 122, 123), në Kodin Penal (Nenet 10, 11); Kodin e Procedurës Penale (Nenet 488-523) dhe Ligjin Nr. 10193, datë 3.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë në Çështje Penale" (ndryshuar me Ligjin nr. 100/2013 datë 18.03.2013 dhe Ligjin Nr. 97/2021 datë 07.07.2021).

Siç është përmendur në kapitujt e tjerë, Kushtetuta përcakton parimet kryesore të zbatimit të së drejtës ndërkombëtare në Shqipëri dhe marrëdhënien e saj me legjislacionin kombëtar. Kushtetuta përcakton se 'marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara' janë zbatueshme në territorin e Shqipërisë (Neni 116, pika 1 dhe neni 122). Në rast mospërputhje, marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj merr përparësi mbi legjislacionin kombëtar që nuk pajtohet me të. Në mënyrë të ngjashme, normat e nxjerra nga një organizatë ndërkombëtare kanë gjithashtu përparësi në rast mospërputhje me legjislacionin shqiptar, kur marrëveshja e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj në organizatën në fjalë përcakton shprehimisht zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të normave të përcaktuara nga organizata. (Pikat 2 dhe 3 të Nenit 122). Bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare, Shqipëria mund t'i delegojë organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të veçanta (Neni 123/1).

Kodi Penal përcakton kushtet kur ekstradimi mund të lejohet ose nuk mund të lejohet (Neni 11) dhe fuqinë apo vlefshmërinë e vendimeve penale të gjykatave të huaja ndaj shtetasve shqiptarë në Shqipëri brenda kufijve të ligjit shqiptar, nëse nuk përcaktohet ndryshe në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe (Neni 10).

Kodi i Procedurës Penale përcakton tre format kryesore të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, Ekstradimin (Nenet 488-504), Letër Porositë Ndërkombëtare (Nenet 505-511) dhe Ekzekutimin e Vendimeve Penale (Ekzekutimin e Vendimeve Penale të Huaja: Nenet 512-518 dhe Vendimeve Penale Shqiptare Jashtë Vendit: Nenet 519-523).

Qëllimi i Ligjit Nr. 10193, datë 3.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale"

është të përcaktojë më tej rregullat e Ekstradimit, Letër Porosive, dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale në kontekstin e bashkëpunimit ndërkombëtar, që nuk janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës

Penale, transferimi i personave të dënuar, transferimi i procedimeve dhe njoftimi i dënimeve të huaja ndaj shtetasve shqiptarë për t'i përfshirë në regjistrin kombëtar të dosjeve kriminale, dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme (Neni 3):

1. në procedimet që lidhen me veprat penale që në momentin e depozitimit të kërkesës janë në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkues ose të atyre të Republikës së Shqipërisë;
2. në procedimet që janë në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ose të gjykatave të tjera ndërkombëtare juridiksioni i të cilave është pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Duhet theksuar se legjislacioni shqiptar nuk përcakton dispozita të veçantë për rregullat e ndarjes së asetëve, duke marrë në konsideratë se ato nuk përcaktohen as në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

Vendimi që njeh urdhrin e konfiskimit të lëshuar nga një autoritet i huaj urdhërohet nga gjykata shqiptare, në përputhje me ligjin (neni 516.5 të KPP-së), i cili thotë se “vendimi i njohjes në lidhje me ekzekutimin e një konfiskimi, duhet të urdhërojë ekzekutimin e konfiskimit.” Përveç kësaj, neni 59/1 i ligjit të ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 193/2009 parashikon shpërndarjen dhe ndarjen e pronave të konfiskuara nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet shtetit që dërgon kërkesën dhe shtetit të **kërkuar në bazë të vendimit të një gjykate të huaj**, i njohur dhe i ekzekutueshëm sipas legjislacionit në fuqi për njohjen e vendimeve penale të huaja”. Ai gjithashtu parashikon që marrëveshja, si rregull, duhet të pasqyrojë një ndarje proporcionale të pasurive në përputhje me vendin ku është kryer vepra penale që ka sjellë të ardhura, si dhe rolin e punës hetimore të vendit ku është kryer vepra penale që prodhonte të ardhura, si dhe rolin e punës hetimore të çdo vendi, përveç rasteve kur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara parashikojnë ndryshe”.

Një tjetër mjet që plotëson kuadrin ligjor shqiptar për konfiskimin e pasurive produkt të veprës penale është sekuestrimi dhe konfiskimi në bazë të ligjit nr. 10,192/2009, datë 03.12. 2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pronës”, i njohur edhe si Ligji Antimafia dhe i përshkruar në Kapitullin II të këtij manuali.

4.

Sfidat gjatë hetimeve ndërkufitare

- a) a) Nëse i referohemi gjurmimit të aseteve, mund të përmenden vonesat që rrjedhin nga përkthimet e dobëta dhe mangësitë e tjera në LP ose UEH, si dhe çështje procedurale, për shembull në lidhje me të drejtat e njoftimit të pronarëve të llogarive bankare. Lidhur me çështjet që lindin gjatë fazës së ngrirjes së aseteve, mund të përmenden paqartësitë rreth kërkesave për lëshimin e një urdhri/certifikate për ngrirje (p.sh., si rezultat i ndryshimeve në procedurat kombëtare të zbatimit dhe/ose legjislacionit), përfshirë identifikimin e autoritetit kombëtar kompetent , (p.sh., kur asetet ndodhen në vende të ndryshme në shtetin zbatues/kërkues, si dhe zgjedhja e instrumenteve juridike të përdorura për ngrirjen e aseteve).
- b) b) Në raste të tjera, profesionistët mund të hasin probleme që lidhen me arsyet për refuzimin e ekzekutimit të një urdhri/certifikate për ngrirje ose një LP-je **që kërkon ngrirjen e aseteve, si dhe ato që rrjedhin nga sfidat dhe mjetet juridike, dhe nga komunikimi i dobët i ekzekutimit të një urdhri/certifikate ngrirjeje ose një LP-je.**
- c) c) Për sa i përket menazhimit të aseteve, ka disa çështje në lidhje me kostot, vlerën e aseteve, mundësinë e shitjes së hershme, mënyrën se si është bërë vlerësimi i vlerës, ose mungesën e administratorëve gjyqësorë të shoqërive që i nënshtrohen urdhrit/certifikatës së ngrirjes.
- d) d) Lidhur me konfiskimin e pasurisë, problemet mund të përfshijnë kërkesat për lëshimin e një urdhri/certifikate konfiskimi ose një LP-je **që kërkon masa konfiskuese, ose kërkesat për ekzekutimin e tyre.** Vështirësi të tjera mund të rrjedhin nga kërkesat për dokumentacion ose informacion shtesë, ose nga palët e treta që pretendojnë pronësinë e të drejtave të tjera mbi pronën që i nënshtrohet konfiskimit.
- e) e) Çështjet që lidhen me koston shfaqen gjithashtu gjatë fazës së konfiskimit; për shembull, kur shteti i kërkuar kërkon përkthimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të gjykatës së lartë në shtetin kërkues përpara se të shqyrtojë ekzekutimin e masës së konfiskimit. Çështje të tjera të zakonshme përfshijnë vonesat nga autoritetet përmbare në konfirmimin e ekzekutimit të masave të konfiskimit, ose ato që rezultojnë nga keqkuptimet ndërmjet autoriteteve kërkuese dhe atyre të kërkuara.
- f) f) Në lidhje me asgjësimin dhe ndarjen e aseteve, problemet mund të lidhen me shitjen e aseteve të konfiskuara, për shembull kur personi i dënuar kundërshton mënyrën në të cilën autoriteti përmbare zgjedhi për të vlerësuar vlerën e parashikuar të pasurisë. Pyetjet mund të lidhen gjithashtu me ndarjen e aseteve, që përfshijnë, për shembull, regjimin e shtetit të kërkuar për ndarjen e aseteve, zyrtarizimin e marrëveshjes së ndarjes së aseteve dhe vonesat në arritjen e marrëveshjes faktike të ndarjes së aseteve.
- g) g) Së fundi, mund të lindin edhe çështje në lidhje me kthimin e pasurive të konfiskuara viktimave.

5.

Mjete të tjera

A) EUROJUST

Eurojust-i është Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale e ngritur për të luftuar organizatat kriminale ndërkombëtare. Ajo u themelua në vitin 2002 si Njësia e BE-së për Bashkëpunim Gjyqësor bazuar në Vendimin e Këshillit 2002/187/JHA. Rregullorja e Eurojust-it (Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësinë Penale, që zëvendëson dhe shfuqizon Vendimin e Këshillit 2002/187/JHA) u miratua më 6 nëntor 2018 dhe hyri në fuqi më 12 dhjetor 2019.

Vendet Anëtare të BE-së pjesëmarrëse komnadojnë një Anëtar Kombëtar. Anëtarët Kombëtarë përbëjnë Kolegjin e Eurojust-it, që është përgjegjës për punën operationale të Agjencisë. Kolegji ndihmohet nga Administrata e Eurojust-it, që ndër të tjera përfshin analistë çështjesh, këshilltarë ligjorë dhe ekspertë të dhënash. Agjencia ofron një sistem mbledhesh të bashkërendimit të llojeve të ndryshme, nga më të rëndësishmet e të cilave janë mbledhjet e nivelit 3 që mbledhin autoritete/zyrtarë gjyqësorë nga Vendet e ndryshme Anëtare ose vende të treta, të cilët kanë një hetim penal të përbashkët. Ambientet e agjencisë ofrojnë interpretim në të gjitha gjuhët e BE-së dhe një sallë mbledhesh të krijuar enkas për qendrat e koordinimit, prej të cilave mund të monitorohen dhe bashkërendohen në kohë reale ditët e përbashkëta të aksionit.

Rregullorja e re e themeloi Eurojust-in si Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Drejtësinë Penale dhe hyri në fuqi drejtpërsëdrejti në Vendet Anëtare më 12/12/2019, pa nevojën e zbatimit në ligjin e vendas. Baza e re ligjore solli një sërë ndryshimesh për forcimin e mëtejshëm të rolit të Eurojust-it në shërbim të drejtësisë ndërkufitare për një Evropë më të sigurt: kapacitete të shtuara operationale dhe rritje të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Eurojust-it dhe Vendeve Anëtare; një strukturë të re qeverisëse:

Kolegji i Eurojust-it, përbëhet nga anëtarë kombëtarë nga Vendet Anëtare të BE-së dhe nga një përfaqësues i Komisionit. Kur Kolegji ushtron funksionet e veta të menaxhimit, ai është ndër të tjera përgjegjës për miratimin e buxhetit, programin vjetor dhe atë shumëvjeçar dhe Raportin Vjetor, zgjedhjen e Presidentit dhe Zëvendëspresidentit dhe emërimin e Drejtorit Administrativ; për të ndihmuar Kolegjin është ngritur edhe një Bord Ekzekutiv, i përbërë nga Presidenti i Eurojust-it, dy Zëvendëspresidentët, një përfaqësues i Komisionit Evropian dhe dy anëtarë të tjerë të Kolegjit të emëruar sipas një sistemi dy vjeçar rotacioni. Drejtori Administrativ merr pjesë në mbledhjet e Bordit Ekzekutiv pa të drejtë vote. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për miratimin e një sërë vendimesh administrative (p.sh. miratimin dhe

zbatimin e rregullave të Statutit, rregullat financiare, strategjinë kundër mashtrimit), për shqyrtimin e disa dokumenteve administrative përpara se t'i dorëzohen Kolegjit dhe për ngritjen ose ndryshimin e strukturave të brendshme administrative.

Më 1 qershor 2022, Rregullorja e Eurojust-it u ndryshua duke i dhënë Agjencisë mundësinë ligjore për të mbledhur, ruajtur dhe ndarë prova për krimet e luftës.

Eurojust-i ndërmerr edhe veprimtari të tjera. Agjencia është gjithashtu edhe qendra e BE-së për ndarjen e dijes dhe shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e drejtësisë penale. Në këtë pikëpamje, Eurojust-i është selia e: Forumit Konsultativ të Prokurorëve të Përgjithshëm/Drejtimesve të shërbimeve të prokurorisë, Rrjetit JIT, Rrjetit për Gjenocidin, Rrjetit Gjyqësor Evropian, Rrjetit Gjyqësor Evropian për Krimin Kibernetik, dhe Grupin e Fokusit për Kontrabandimin e Migrantëve.

Për më tepër, Eurojust-i ka marrëveshje ndërkombëtare me vende jo anëtare të BE-së për komandimin e Prokurorëve Ndërlidhës (PN). Ata punojnë me kolegjet e tyre të Vendeve Anëtare për të mbështetur hetimet ndërkufitare në të cilat përfshihet edhe vendi i tyre. Me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet Eurojust-it dhe vendeve të treta, PN-të kanë qasje në instrumentet dhe ambientet operacionale të Eurojust-it, përfshirë përdorimin e zyrave dhe shërbimeve të sigurta të telekomunikacionit.

Mandati dhe kohëzgjatja e secilit komandim përcaktohet nga autoritetet kombëtare të vendeve të treta. Dhjetë vende të treta kanë komanduar PN në Eurojust: Shqipëria, Gjeorgjia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Serbia, Zvicra, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

PN-të dhe ndihmësit e tyre mund të marrin pjesë gjithashtu në mbledhjet operacionale dhe strategjike me ftesë të Presidentit të Kolegjit, dhe me miratimin e Anëtarëve Kombëtarë në fjalë. Anëtarët Kombëtarë, zëvendësit dhe ndihmësit e tyre, si dhe stafi i Eurojust-it mund të marrin gjithashtu pjesë në mbledhjet e organizuara nga PN-të ose autoritete të tjera kompetente të vendit në fjalë.

Marrëveshja për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST, u nënshkrua më 5 Tetor 2018, dhe u ratifikua me ligjin nr. 113/2018 nga Kuvendi i Shqipërisë. Në nenin 4 pika 1 e kësaj marrëveshjeje parashikohet se: "1. Autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë. Eurojust-i dhe Shqipëria nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në tetor të vitit 2018, dhe Prokurori i parë Ndërlidhës në Zyrën Shqiptare pranë EUROJUST filloi detyrën në janar të vitit 2021.

PN-ja shqiptare në Eurojust ka këto detyra:

- bashkëpunon ngushtë me pikat e kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe Ministrinë e Drejtësisë;
- mund të kontaktojë drejtpërdrejt me autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë;
- ka akses në informacionin në regjistrat penalë kombëtarë ose në çdo regjistër tjetër të Republikës së Shqipërisë në të njëjtën mënyrë si një prokuror ose person me të njëjtën kompetencë, siç përcaktohet në legjisllacionin shqiptar.

B) SKUADRAT E PËRBASHKËTA HETIMORE (JIT)

Skuadrat e Përbashkëta Hetimore (JIT) janë një instrument për bashkëpunimin ndërkombëtar bazuar në një marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente të dy ose më shumë shteteve. Këto ekipe përbëhen

nga prokurorë dhe autoritete të zbatimit të ligjit, si dhe gjyqtarë, dhe ngrihen për një periudhë të caktuar, për kryerjen e hetimeve në dy ose me shume shtete. Kjo justifikon zbatimin e organizimeve të posaçme për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe provave ndërmjet shteteve të interesuara. Ky mjet paraqet avantazhe të rëndësishme në lidhje me kërkesat e NNJ, siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm.⁷

Dallimet kryesore midis një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe një ekipi të përbashkët hetimor	
Kërkesë për ndihmë juridike të ndërsjellë	Skuadër e Përbashkët Hetimore
<p>Kërkoni ose përgjigjuni kërkesës</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi i kufizuar në një kërkesë specifike Masat shtesë -> kërkesë e re <p>Kryesisht mjedis dypalësh – kërkues kundrejt shtetit të kërkuar</p>	<p>Nisma e përbashkët me një qëllim të përbashkët</p> <ul style="list-style-type: none"> Partnerët në baza të barabarta -> nuk ka rol udhëheqës Marrëveshje e vetme me shkrim I përshtatshëm edhe për ambiente shumëpalëshe
<p>Informacioni/dëshmia e transmetuar pas ekzekutimit të NNJ-së</p>	<p>Shkëmbim i pakufizuar informacioni/provash në kohë reale</p>
<p>Pjesëmarrje e kufizuar e autoritetit kërkues</p>	<p>Pjesëmarrje aktive e anëtarëve</p>
<p>In principle, no investigation in the executing state</p>	<p>Kërkesa/hetime të ndërlidhura ndërkufitare që kërkojnë koordinim</p> <ul style="list-style-type: none"> Objektivat e përbashkëta operationale Marrëveshja për hetimin dhe/ose ndjekjen penale strategjive

Përmbajtja dhe niveli i detajeve të dispozitave për JIT-et ndryshojnë nga një instrument në tjetrin. Duhet të theksohet se dispozitat për JIT-et përfshihen në dy instrumente të BE-së (Konventa për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së, e datës 29 maj 2000, dhe Vendimi i 13 qershorit 2002 për JIT-et) dhe në Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës Evropiane për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale. Rregulloret e BE-së dhe të KiE janë pothuajse identike. Dispozitat për JIT-et që rrjedhin nga instrumentet e OKB-së përgjithësisht konsiderohen si 'dispozita mundësuese' që kërkojnë arritjen e marrëveshjeve ose marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe, ose në mungesë të këtyre të fundit, një marrëveshje rast pas rasti. Për më tepër, dispozitat e përfshira në instrumentet e OKB-së janë shumë më pak të detajuara dhe lënë të hapura një sërë çështjesh, të cilat do të duhet të rregullohen në marrëveshjen për JIT-in ndërmjet shteteve pjesëmarrëse.

Gjithsesi, statusi i JIT-eve në mjete të ndryshme ndërkombëtare mund të kontrollohet në grafikun e bashkëlidhur në shtojcën përkatëse. Brenda BE-së, duhet përmendur posaçërisht Dokumenti i Këshillit 11037/05, i cili krijoi Rrjetin e Ekspertëve Kombëtarë për Skuadrat e Përbashkëta të Hetimit (Rrjeti i JIT-eve) për të lehtësuar punën e profesionistëve, si dhe për të nxitur përdorimin e JIT-ve dhe për të kontribuar për shkëmbimin e përvojës dhe praktikave më të mira në përdorimin e këtij mjeti. Sekretariati i Rrjetit është i vendosur në Eurojust dhe ky i fundit promovon dhe ofron mbështetje praktike dhe logjistike për veprimtarinë e tij.

Që prej vitit 2005, Sekretariati i Rrjetit JIT ka organizuar mbledhje të përvitshme të Rrjetit të JIT në ambientet e tyre në Hagë, me mbështetjen e Eurojust dhe Europol. Mbledhjet sigurojnë një forum për profesionistët e JIT-eve nga Vendet Anëtare dhe nga institucionet përkatëse të BE-së me qëllim ndarjen e përvojave dhe sfidave dhe për të propozuar zgjidhje nga këndvështrimi i profesionistëve.

Shteteve që nuk janë shtete anëtare të BE-së mund t'u jepet statusi i vëzhguesit. Autoritetet kombëtare kompetente të shteteve vëzhguese caktojnë një ose më shumë përfaqësues për të vepruar si pika kontakti me Rrjetin JIT.

7. Burimi: Skuadrat e Përbashkëta të Hetimit: Guida Praktike (europa.eu), fq 9

Termet sipas të cilave JIT-i funksionon ndryshojnë sipas rastit, por ato bazohen në marrëveshjen model për JIT-et bashkëngjitur Rezolutës së Këshillit (2017/C 18/01). Kjo rezolutë "nxit autoritetet kompetente të Vendeve Anëtare që dëshirojnë të ngrenë një Ekip të Përbashkët Hetimor me autoritetet kompetente nga Vende të tjera Anëtare, në përputhje me termet e Vendimit Kuadër të Konventës, ose me Vende jashtë BE-së mbi bazën e instrumenteve përkatëse ndërkombëtare, të përdorin në të gjitha rastet e përshtatshme Marrëveshjen Model [...] me qëllim përcaktimin e modaliteteve të ekipit të përbashkët hetimor".

JIT-i drejtohet nga një anëtar nga vendi në të cilin ngrihet JIT-i. Veprimtaritë e JIT-it normohen nga legjislativi i vendit në të cilin ai është ngritur. Ndërmjet vendeve të përfshira nuk ka nevojë të nxirren NNJ, por ato duhet të lëshohen për vendet e treta. Në lidhje me vendet jo anëtare të BE-së, rrjeti global i Eurojust-it, i përbërë nga PN të vendosur në Eurojust dhe pikat e kontaktit të Eurojust-it në vendet jashtë BE-së, kontribuon ndjeshëm në vendosjen e kontakteve në një fazë të hershme dhe përfundimisht në ngritjen e suksesshme të JIT-eve me vendet e jashtë BE-së. PN-të e vendosur në Eurojust luajnë një rol vendimtar në ngritjen e JIT-ve, gjë që reflektohet në numrin e JIT-ve të ngritura deri më tani me vendet jashtë BE-së. Në të vërtetë, ata mund të ndihmojnë në vendosjen e kontakteve me homologët e duhur në vendet e tyre përkatëse, të identifikojnë bazën ligjore për ngritjen e një JIT-i, të shpjegojnë disa kërkesa dhe veçori ligjore që duhen marrë parasysh dhe të hartojnë marrëveshjet për JIT-in, dhe të ofrojnë ndihmë gjatë fazës operacionale të JIT-it përkatës. Që nga tetori i vitit 2021, Eurojust ka një rrjet të pikave të kontaktit gjyqësor në më shumë se 50 vende jashtë BE-së anëmbanë botës. Këto lidhje u mundësojnë prokurorëve nga shtetet anëtare të krijojnë kontakte të shpejta dhe të ndërlidhen me homologët e tyre në vendet jashtë BE-së kur një krim shtrihet përtej kufijve të BE-së. Në të njëjtën datë, Eurojust ka lidhur 13 marrëveshje bashkëpunimi me këto vende jashtë BE-së: Shqipërinë⁸, Gjeorgjinë, Islandën, Lihtenshtajnin, Moldavinë, Malin e Zi, Norvegjinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Zvicrën, Ukrainën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Vendet që kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust-in mund të vendosin një PN në Eurojust.

Kreu VI i Ligjit shqiptar për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale i referohet JIT-eve (ndryshuar me Ligjin nr. 97/2021, datë 7.7.2021).

Sa i përket funksionimit të brendshëm të një JIT-i, autoritetet kompetente në një apo më shumë Vende Anëtare, të cilave siç u tha më lart u bashkohen autoritete nga jashtë BE-së, mund të vendosin të ngrenë një JIT për një qëllim të veçantë dhe për një periudhë të caktuar kohe (që mund të shtyhet me marrëveshje të ndërsjellë). JIT-i mund të përbëhet nga: prokurorë, gjyqtarë, oficerë të zbatimit të ligjit ose personel tjetër përkatës.

Në Shqipëri JIT-i mund të ngrihet me kërkesë të Drejtuesit të Prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vetëm nëse a) vepra penale në hetim është e ndërlidhur dhe kërkon akte që lidhen me shtete të tjera ose b) një ose më shumë shtete të tjera po hetojnë vepra penale që kërkojnë hetime të përbashkëta me vende të tjera. Kërkesa i dërgohet autoriteteve të huaja përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe duhet të përmbajë:

1. informacionin e përmbajtur në Nenin 14 të Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS Nr. 30);
2. propozimin për përbërjen e ekipit të hetimit;
3. kohëzgjatjen e tij (Neni 75/1).

Nga ana tjetër, kërkesa për një JIT nga një autoritet i huaj duhet të shqyrtohet së pari për vlefshmërinë e vet nga Ministria e Drejtësisë, dhe më pas t'i drejtohet Drejtuesit të Prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm të Rrethit Gjyqësor përmes Prokurorisë së Përgjithshme ose drejtpërsëdrejti Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (Neni 75/2).

8. Eurojust-Albania-2018-10-05-EN.pdf (europa.eu)

JIT-i ngrihet vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet drejtuesve të prokurorisë shqiptare dhe autoritetit të huaj. Marrëveshja duhet të përfshijë a) përbërjen e JIT-it, b) drejtuesin, c) objektin dhe qëllimin, ç) afatin dhe planin e veprimeve. Kur është e nevojshme për çështjen, të dy drejtuesit e palëve mund të ndryshojnë me shkrim në marrëveshje a) objektin, b) qëllimin dhe gjithashtu c) përbërjen e ekipit (Neni 75/3).

Gjatë procedurave hetimore në Shqipëri, përfaqësuesit e autoritetit të huaj veprojnë si zyrtarë publikë, në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore. Megjithatë, me anë të një vendimi të arsyetuar, prokurori vendas mund të urdhërojë anëtarët e Autoritetit Kompetent të huaj të mos marrin pjesë në procesin e hetimit në territorin e Republikës së Shqipërisë (Neni 75/4).

Kur hetimet kryhen në Shqipëri, JIT-i drejtohet nga një prokuror (Neni 75/3, pika 6) dhe ai kryen hetimin në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Provat e mbledhura nga një JIT jashtë territorit të Shqipërisë kanë të njëjtën vlerë me ato të mbledhura në Shqipëri (Neni 75/5). Shteti shqiptar mbulon gjithë dëmet e shkaktuara nga përfaqësuesit e palës shqiptare në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre në territorin e vendi të huaj si dhe dëmtimin e shkaktuar nga përfaqësuesit e autoritetit të huaj në Shqipëri me të drejtën e kërimit kompensim nga vendi i huaj përkatës (Neni 75/6).

C) BASHKËPUNIMI ME PROKURORINË PUBLIKE EVROPIANE

Më 4 korrik 2022 u nënshkrua dhe hyri në fuqi Marrëveshja e Punës ndërmjet Prokurorisë Publike Evropiane (EPPO) dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, më 29 qershor 2023, u nënshkrua dhe hyri në fuqi edhe një marrëveshje ndërmjet EPPO-së dhe Prokurorisë së Posaqme Kundër Korrupsionit (SPAK).

Këto marrëveshje synojnë të lehtësojnë bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe shkëmbimin e informacionit strategjik ndërmjet palëve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Prokuroria Publike Evropiane (EPPO) bashkëpunon me vende të treta dhe sipas raportit të parë vjetor, vende të treta janë përfshirë në 45 raste të veprimtarisë së saj, dhe një prej tyre ishte edhe Shqipëria.

Për mbledhjen e provave ose ekstradimin e personave të kërkuar, si dhe për forma të tjera të bashkëpunimit gjyqësor, Palët zbatojnë instrumentet përkatëse shumëpalëshe për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: Konventën Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale dhe Protokollet e saj Shtesë, Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Kjo marrëveshje parashikon forma të bashkëpunimit operacional për:

- mbledhjen e provave,
- ngrirjen e aseteve,
- ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore dhe
- ekstradimin,
- si dhe format e bashkëpunimit strategjik dhe çështjet institucionale, si shkëmbimi i informacionit strategjik, emërimi i oficerëve ndërlidhës në EPPO, transferimi i të dhënave personale, siguria e të dhënave, etj.

Neni 10 i Marrëveshjes së Punës ndërmjet Prokurorisë Publike Evropiane (EPPO) dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, parashikon se Pika e Kontaktit e EPPO në Shqipëri është Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme.

6.

Referenca për agjencitë shtetërore ligjzbatuese të bashkëpunimit ndërkufitar

Ky seksion do t'i referohet shkurtimisht mekanizmave të ndryshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar që ekzistojnë aktualisht në fushën e rekuperimit të aseteve dhe hetimeve të pastrimit të parave. Krahas bashkëpunimit dypalësh që mund të zhvillohet nëpërmjet oficerëve të ndryshëm ndërlidhës që vende të ndryshme mund të kenë vendosur në Shqipëri, ka edhe institucione shumëkombëshe që lejojnë shkëmbimin e informacionit me autoritetet policore apo agjencitë shtetërore të vendeve të tjera.

A) EUROPOL

Europol-i është agjencia e zbatimit të ligjit të Bashkimit Evropian. Objektivi i tij kryesor është të kontribuojë për një Evropë më të sigurt për të mirën e të gjithë qytetarëve të BE-së.

Europol-i ndihmon autoritetet e zbatimit të ligjit në të gjithë BE-në në veprimtaritë e tyre të luftës kundër krimit dhe terrorizmit në të gjitha fushat e përgjegjësisë së tij: lëndë narkotike të paligjshme, trafikim i qenieve njerëzore, migrim i paligjshëm, krim kibernetik, falsifikimi i euros, mashtrimi me TVSH-në, pastrim parash dhe gjurmimi i aseteve, qelizat e krimit të organizuar, krimi ndaj pronësisë intelektuale, kontrabanda e duhanit, përcaktimi i bandave të motoçikletave si të paligjshme dhe terrorizmi.

Për sa i përket krimit ekonomik, në Drejtorinë e Operacioneve u krijua Qendra Evropiane Financiare dhe Ekonomike (EFECC). Ajo rrit mbështetjen operative dhe strategjike të Europolit duke parandaluar dhe luftuar krimin financiar dhe ekonomik në Bashkimin Evropian. EFECC nxit përdorimin e vazhdueshëm të hetimeve financiare dhe konfiskimit të aseteve duke krijuar aleanca me subjekte publike dhe private.

Europol mirëmban infrastrukturë teknikisht të avancuar, të besueshme, efikase dhe të sigurt telekomunikacioni me qëllim mbështetjen e operacionet të veta dhe orfrimin e një game gjithnjë e më të madhe shërbimesh operationale dhe strategjike për Shtetet Anëtare, vendet jo anëtare të BE-së dhe palët e treta. Këto komunikime zhvillohen përmes tre kanaleve kryesore:

- Aplikacioni i Rrjetit të Shkëmbimit të Sigurt të Informacionit (SIENA)
- Sistemi i Informacionit të Europolit (EIS)
- Platforma e Europolit për Ekspertët (EPE)

Projektet e Analizës (PA) janë sisteme të përpunimit të informacionit brenda Sistemit të Analizës së Europolit dhe përqendrohen në fusha të caktuara të krimit. Me këto analiza, Europol mund t'i japë përparësi burimeve të tij për të mbështetur hetimet e ALZ-ve. Projektet e Analizave që lidhen me rekuperimin e asetëve dhe pastrimin e parave janë:

- PA për Rekuperimin e Asetëve: Qëllimi kryesor është të mbështetet gjurmimi dhe identifikimi i të ardhurave kriminale të lidhura me fushat e përgjegjësisë për krimin të Europolit. Ky ekip i vogël ndërton partneritete operacionale dhe strategjike. Ai pret Rrjetin Ndër-Agjencior të Rekuperimit të Asetëve, Camden, dhe është i përfshirë në grupet e punës të Zyrës së Rekuperimit të Asetëve për monedhat virtuale dhe Regjistrat Qendror të Llogarive Bankare.
- PA për Transaksionet e dyshimta (Sustrans): Është i përfshirë në çështje që lidhen me rrjetet e krimit të organizuar të përfshirë në pastrimin e parave.

B) INTERPOL

Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (INTERPOL) është organizatë ndërqeveritare që ka 195 vende anëtare. Misioni i INTERPOL-it është t'i mundësojë policisë në mbarë botën të punojnë së bashku për të parandaluar dhe luftuar krimin. Agjencia i ofron policisë infrastrukturë ndërkombëtare të teknologjisë së përparuar të mbështetjes teknike dhe operacionale për të përballuar sfidat gjithnjë e më të mëdha të luftimit të llojeve të reja të krimit.

Sekretariati i Përgjithshëm bashkërendon veprimtaritë e përditshme për të luftuar një sërë krimesh, me seli në Lion, një kompleks global për inovacionin në Singapor dhe disa zyra satelitore në rajone të ndryshme. Në çdo vend, një Zyrë Qendrore Kombëtare e Interpol (ZQK) siguron pikën qendrore të kontaktit për Sekretariatit e Përgjithshëm dhe ZQK-të e tjera. ZQK-të drejtohen nga zyrtarë të policisë kombëtare dhe zakonisht vendoshen në ministrinë përgjegjëse për policinë.

Të gjitha ZQK-të janë të lidhura nëpërmjet një sistemi komunikimi të quajtur I-24/7. Vendet e përdorin këtë rrjet të sigurt për të kontaktuar njëri-tjetrin dhe Sekretariatit e Përgjithshëm. Ai gjithashtu i lejon ata të aksesojnë bazat e të dhënave dhe shërbimet e INTERPOL në kohë reale, si nga vendet qendrore ashtu edhe nga ato të largëta.

Për të koordinuar reagimin ndërkombëtar ndaj krimit financiar, Interpol ka krijuar Qendrën e Interpolit për Krimet Financiare dhe Kundër Korrupsionit (IFCACC). Fushat e veprimit të kësaj qendre janë:

- Mashtrimi dhe krimet me pagesat: IFCACC mbështet vendet anëtare në hetimet e tyre transnacionale dhe ndan *modus operandi* të rëndësishme me palët e interesuara përkatëse.
- Kundër pastrimit të parave dhe për rekuperimin e asetëve: IFCACC përgjigjet në mënyrë shumëdisiplinore duke shënjestruar flukset e paligjshme financiare globale. Ajo përqendrohet në lloje të ndryshme të skemave të pastrimit të parave dhe përdorimit të asetëve virtuale, si dhe identifikimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale.
- Kundër korrupsionit: Përpjekjet tona kundër korrupsionit përfshijnë lloje të ndryshme krimi, duke përfshirë dopingun në sport, korrupsionin e zyrtarëve publikë dhe korrupsionin e nivelit të lartë

(përfshirë figura të larta politike). IFCACC përforcon aftësinë e vendeve anëtare për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë si në rang kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

C) CARIN

Rrjeti Ndërkombëtar i Rekuperimit të Aseteve Camden (CARIN) është rrjet jozyrtar i profesionistëve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit në fushën e gjurmimit, ngrirjes, konfiskimit dhe konfiskimit të aseteve. Është një rrjet ndërinstytucional. Çdo shtet anëtar ose vëzhgues përfaqësohet nga një oficer i zbatimit të ligjit dhe një ekspert gjyqësor (prokuror, gjyqtar hetues, etj., në varësi të sistemit të tyre ligjor).

Qëllimi i CARIN-it është të rrisë efektshmërinë e përpjekjeve të anëtarëve të tij të bazuara të shumë agjencive, për t'i privuar kriminelët nga fitimet e tyre të paligjshme. Kontaktet e CARIN mbështesin procesin e plotë të rekuperimit të aseteve, që nga momenti i nisjes së hetimit që përfshin gjurmimin e pasurive, deri te ngrirja dhe sekuestrimi, administrimi dhe në fund humbja e të drejtës/konfiskimi, duke përfshirë çdo ndarje të nevojshme të aseteve ndërmjet juridiksioneve. Përfaqësuesit e shteteve anëtare quhen "pikat kombëtare të kontaktit". Të gjithë ata flasin anglisht pasi gjuha e punës e rrjetit është anglishtja. Kontaktet e CARIN mund të kontaktohen drejtpërdrejt me telefon ose email.

Përveç rrjetit CARIN, ka rrjete rajonale të krijuara përgjatë linjave të CARIN, të quajtura ARIN, nga të cilat aktualisht janë shtatë:

- ARIN-AP: Rrjeti Ndërinstytucional i Rekuperimit të Aseteve - Azi Paqësor
- RAG: Rrjeti i Rekuperimit të Aseteve të GAFILAT
- ARINWA: Rrjeti ndërinstytucional i rekuperimit të aseteve Afrika Perëndimore
- ARIN-EA: Rrjeti ndërinstytucional i rekuperimit të aseteve Afrika Lindore
- ARIN-CARIB: Rrjeti i rekuperimit të aseteve për Karaibet
- ARIN-WCA: Rrjeti i Rekuperimit të Aseteve për Azinë Qendrore Perëndimore

Të gjitha këto rrjete janë të ndërlidhura përmes sekretariateve të tyre, duke bërë të mundur aksesin në informacion nga njëri-tjetri.

D) AMON

Rrjeti Operativ Kundër Pastrimit të Parave (AMON) është rrjet informal i krijuar për të lidhur dhe lehtësuar ndërveprimin dhe shkëmbimin e ekspertizës ndërmjet profesionistëve që punojnë në fushën e luftimit të pastrimit të parave.

Rrjeti u krijua për të rritur efektshmërinë e parandalimit, luftës dhe goditjes së pastrimit të parave përmes promovimit dhe nxitjes së vazhdueshme të ndërveprimin proaktiv midis ekspertëve që vijnë nga juridiksione të ndryshme, por që të gjithë punojnë në fushën e pastrimit të parave. Çdo vend anëtar i rrjetit duhet të ketë një ose dy pika kontakti kombëtare (PKK), profesionistë të pastrimit të parave. Nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë midis këtyre PKK-ve, objektivat kryesore të rrjetit janë:

- Të nxisë ndërveprimin aktiv ndërmjet anëtarëve dhe shkëmbimin e shpejtë të informacionit nëpërmjet kanaleve të sigurta;

- Të krijojë një rrjet të mirëzhvilluar profesionistësh që punojnë në fushën e pastrimit të parave, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i të cilëve do të çonte në rezultate të përmirësuara në përpjekjet e zbatimit të ligjit;
- Nëpërmjet Platformës së Ekspertëve të Europolit (EPE), të krijohet hapësira e përbashkët për anëtarët me vlerën e shtuar të përmbajtjes së pasur të administruar nga Europoli në fushën e pastrimit të parave;
- Të themelohet AMON fillimisht si një qendër evropiane dhe më pas ndërkombëtare e ekselencës në të gjitha aspektet e pastrimit të parave;
- Të mundësojë rrjetin të mbështesë dhe përmirësojë performancën e transaksioneve të dyshimta të AP të Europolit duke nxitur dhe inkurajuar angazhimin e Anëtarëve të AMON me AP-të dhe duke mbrojtur potencialin e tij si mjet i rëndësishëm në luftën kundër pastrimit ndërkombëtar të parave;
- Të lehtësojë, sipas kërkesës, trajnime në të gjitha aspektet e luftës kundër pastrimit të parave.

E) BAMIN

Rrjeti Ndërinstitucional i Menaxhimit të Aseteve Ballkanike (BAMIN) është rrjet joformal profesionistësh, që punojnë në mënyrë operative brenda Zyrave ose Agjencive të Menaxhimit të Aseteve, ose brenda institucionit ose departamentit me tagër menaxhimin dhe asgjësimin e aseteve kriminale në juridiksionin e tyre. Anëtarët e tij kryesorë përfaqësojnë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, por rrjeti është i hapur për vëzhguesit dhe anëtarët e asociuar të çdo vendi.

Lista e kontakteve të BAMIN përbëhet nga një ose dy kontakte për çdo juridiksion ose organizatë anëtare. Në rastin e Shqipërisë, përfaqësuesi është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSKA).

Veprimtaritë kryesore strategjike të BAMIN janë si më poshtë:

- Të nxisë shkëmbimin e informacionit dhe praktikat e mira në menaxhimin e aseteve.
- Të përmirësojë kapacitetin e anëtarëve për të ruajtur vlerën e aseteve, për të shitur asetet dhe për t'i ripërdorur ato dhe për të zbatuar procese të efektshme në çdo fazë të procedurës së menaxhimit.
- Të lehtësojë, kur është e mundur, trajnimin në të gjitha aspektet e menaxhimit të produkteve të veprës penale.
- Të marrë përsipër të bëjë rekomandime për organet ndërkombëtare, në lidhje me të gjitha aspektet e menaxhimit të produkteve të krimit.

Për të përmirësuar menaxhimin operacional të aseteve ndërkufitare, kontaktet e BAMIN mund të ofrojnë informacion të përgjithshëm mbi procedurat e menaxhimit të aseteve në juridiksionet e tyre dhe të lehtësojnë shkëmbimin e efektshëm të informacionit dhe inteligjencës aty ku është e nevojshme brenda kërkesave të kuadrit ligjor ndërkombëtar.

F) SELEC

Qendra e Evropës Juglindore për Zbatimin e Ligjit (SELEC) është organizatë ndërkombëtare e zbatimit të ligjit, e bazuar në traktate, që bashkon burimet dhe ekspertizën e autoriteteve të policisë dhe doganave, të cilat bashkojnë sinergjitë për luftë më të efektshme ndaj krimit të organizuar ndërkufitar në Evropën Juglindore.

SELEC është krijuar për të ofruar mbështetje për 11 shtetet e saj anëtare (Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Greqisë, Hungaria, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Rumania, Republika e Serbisë dhe Republika e Turqisë), për të rritur koordinimin në parandalimin dhe luftimin e krimit, duke përfshirë krimin e rëndë dhe të organizuar transnacional.

Dokumenti themelues i SELEC është Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit të Evropës Juglindore, e cila ka hyrë në fuqi më 7 tetor 2011.

SELEC ofron ekspertizë shumëkombëshe për autoritetet e zbatimit të ligjit në të gjithë rajonin e Evropës Juglindore duke ofruar platformën e nevojshme për shkëmbimin e informacionit dhe kërkesave për ndihmë, mbështetjen e mbledhjeve operacionale, hetimet e përbashkëta dhe operacionet rajonale, si dhe ofrimin e produkteve cilësore analitike.

Përveç 11 Shteteve Anëtare, SELEC ka më shumë se 25 vende dhe organizata partnere dhe ka krijuar partneritete të shumta me organizata, organe të tjera, si dhe me sektorin privat.

Për më tepër, nën kujdesin e SELEC-it është duke funksionuar Grupi Këshillues i Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG), i cili mbledh prokurorë që punojnë në bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar nga të 11 shtetet anëtare me qëllim që të lehtësojë dhe përshpejtojë bashkëpunimin në hetimet dhe çështjet e krimeve të rënda ndërkufitare në rajonin e Evropës Juglindore.

Shtetet Anëtare dhe partnerët operativë vendosin në selinë e SELEC oficerë ndërlidhës nga Dogana dhe Policia, oficerë që punojnë së bashku çdo ditë, duke lehtësuar kështu shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe kërkesave për ndihmë. Çdo Oficer Ndërlidhës mbështetet në veprimtaritë e veta nga një Pikë Fokale Kombëtare e përkushtuar (PFK) e krijuar në çdo Shtet Anëtar.

Pikat Fokale Kombëtare (PFK) veprojnë si pika të vetme kontakti në shtetin anëtar për komunikimin me SELEC, nëpërmjet Oficerëve Ndërlidhës të Shtetit Anëtar përkatës, dhe sigurojnë rrjedhën e shpejtë të informacionit, duke mbledhur dhe shpërndarë kërkesat dhe përgjigjet e informacionit nga dhe drejtagjencive të zbatimit të ligjit dhe Oficerëve Ndërlidhës të vendosur në selinë e SELEC.

G) AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE DHE BASHKËPUNIMI ME HOMOLOGËT (GRUPI EGMONT)

Agjencia e Inteligjencës Financiare është FIA dhe bashkëpunon me njësitë homologe jashtë vendit, në kuadër të anëtarësimit të Grupit Egmont⁹, duke përdorur një rrjet të koduar për shkëmbimin e informacionit të vlefshëm në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave që ka çdo njësi/agjenci sipas legjislacionin të vendit përkatës.

Në përgjithësi, të dhënat e shkëmbyera lidhen me transaksione ose të drejta pronësore të çdo lloji dhe mund të përdoren për qëllime inteligjence që drejtojnë AIF sipas rastit në gjurmimin e provave.

9. Shih Kartën e Grupit Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare, miratuar në korrik 2013 nga Drejtuesit e Njësive të Inteligjencës Financiare të Grupit Egmont, dhe Parimet për Shkëmbimin e Informacionit ndërmjet Njësive të Inteligjencës Financiare, miratuar nga Drejtuesit e Njësive të Inteligjencës Financiare në korrik 2013. përditësuar në 2023 dhe mund të gjendet dhe konsultohet në faqen e internetit të Egmont Group (egmontgroup.org).

Nuk ka një afat specifik për përgjigjet ndërmjet subjekteve si më sipër, për sa kohë që konsiderohet i arsyeshëm në varësi të llojit të informacionit të kërkuar. Rekomandohet që përgjigjet të kthehen brenda një periudhe prej 30-60 ditësh. Mund të kthehen më herët nëse informacioni i kërkuar gjendet në bazat e të dhënave të njëjsteve, por mund të kërkojë edhe më shumë kohë nëse këto të fundit duhet të japin të dhëna shtesë.

Ky lloj komunikimi mund të përdoret edhe nga Policia apo Prokuroria, për të ndihmuar hetimet e kryera, veçanërisht nga Prokuroritë, si mekanizëm për të verifikuar paraprakisht të dhënat e mundshme në vende të tjera, përpara se të dërgohen kërkesa për NNJ. Në këtë mënyrë, rast pas rasti, mund të ketë një ulje të numrit të letër porosive të dërguara, duke shkurtuar kështu kohëzgjatjen e hetimit.

Kërkesat drejtuar palëve homologe duhet të jenë të justifikuara, me informacione për llojin e hetimeve që kryhen brenda vendit, veprat penale përkatëse dhe, nëse ka procedim penal të regjistruar, numrin e tij, lidhjet specifike me vendet nga të cilat është marrë informacioni të kërkuara si dhe transaksionet përkatëse.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, të dhënat e siguruara nga shkëmbimi i informacionit si më sipër, shërbejnë si informacion në formën e inteligjencës dhe jo si provë në procedimet penale apo procedimet pasurore sipas AAML (ligjit shqiptar "Antimafia").

SHTOJCA I

BURIMET E
VLEFSHME PËR
KËRKIMIN E
INFORMACIONIT
TË HETIMIT
FINANCIAR

HYRJE

Siç është theksuar në Kapitullin III, gjatë hetimeve financiare është e nevojshme që organi i akuzës, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të kryejë hetime të brendshme dhe ndërmarrë bashkëpunim ndërkombëtar për të identifikuar produkte të veprës penale që pastrohen dhe pasuritë e autorëve në subjektet publike dhe private.

Gjithashtu, zhvillimi i mekanizmave dhe protokolleve të reja për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private që marrin pjesë në luftën kundër pastrimit të parave dhe rekuperimit të aseteve kanë pasur efektshmëri në kryerjen e hetimeve financiare, duke përmirësuar shpejtësinë e qasjes në informacion dhe efikasitetin përfundimtar të hetimeve.

Për këtë arsye, është e nevojshme që OPGJ-të të jenë në dijeni të burimeve të ndryshme të disponueshme të informacionit ku mund të merret informacioni.

Në gjuhën akademike, burim informacioni quhet çdo lloj dokumenti i shkruar, i arkivit elektronik, vendndodhja e materialit informues, krijuesi, dëshmitari, autori, që përmban apo disponon të dhëna të dobishme për të përmbushur një nevojë për marrjesh të dhënash. Nga pikëpamja policore, burim informacioni është çdo gjë që mund të gjenerojë të dhëna të dobishme për një hetim të caktuar. Pra, çdo gjë dhe çdo person, juridik ose fizik, institucion apo organ apo ent publik/privat që mund të sigurojë informacionin përkatës, konsiderohet si burim informacioni.

Numri i burimeve të informacionit nuk është i caktuar, por një katalog i përditësuar i burimeve të informacionit që tregon se çfarë informacioni mund të merret, kriteret që duhen plotësuar për qasjen në këtë informacion dhe si OPGJ-të mund t'i qasen atij, është me rëndësi kryesore. Përveç kësaj, çdo informacion i dobishëm duhet të jetë mjaftueshëm, i vlefshëm dhe i përditësuar.

Burimet e informacionit mund të klasifikohen sipas karakteristikave të ndryshme (publike/private, policore ose jo policore, qasje e lirë ose me autorizim të prokurorit ose të gjykatës, dokumentarë ose teknika ose njerëzore...). Por, është më e rëndësishme që zbatuesit e ligjit të jenë në gjendje t'i qasen këtyre burimeve sipas një kriteri logjik dhe kronologjik.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të burimeve kryesore të përdorura në hetimet financiare, me kolonat përkatëse:

- Faza: Paraprake/Prokuror. Kjo kolonë përcakton se në cilën fazë të hetimit OPGJ-ja mund t'i qaset burimit përkatës.
- Klasifikimi: PERSON/ASET/SHOQËRI/FINANCIARE/TJETËR. Kjo kolonë përcakton se me cilin subjekt lidhet kryesisht ky burim.
- Burimi i informacionit: Emri i burimit.
- Kërkesat: Kjo fushë përcakton se çfarë kriteresh duhet të plotësojë OPGJ-ja për të hyrë në informacion.
- Metoda e qasjes: Kjo kolonë tregon se si kërkuesi mund t'i qaset burimit të informacionit.

NR	FAZA	KLASIFIKIMI	BURIMI I INFORMACIONIT	KËRKESAT	METODA E QASJES
1	Paraprake	PERSON	SISTEMI I REGJISTRIT TË GJENDJES CIVILE	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSE
2	Paraprake	PERSON	SISTEMI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSE
3	Paraprake	PERSON	TIMS	Akses i drejtpërdrejtë Sistemi i hyrje Daljeve në kufi, mjetet e përdorura	DEEPSE
4	Paraprake	PERSON	REGJISTRI I NGJARJEVE KRIMINALE	Akses i Drejtpërdrejtë	DEEPSE
5	Paraprake	PERSON	REGJISTRI I PERSONAVE TE DENUAR	Akses i drejtpërdrejtë	Me persona kontakti, drejtpërdrejt dhe me kërkesë
6	Paraprake	PERSON	REGJISTRI I MENAXIMIT TË INFORMACIONIT KRIMINAL MEMEX	Akses të drejtpërdrejtë për OPGJ-të e Policisë Shtetit Me kërkesë Drejtorisë Analizës informacionit kriminal	MEMEX & Me kërkesë
7	Paraprake	PERSON	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE (DPT)	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSEE Elektronikisht
8	Paraprake	ASET	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSEE Elektronikisht
9	Paraprake	ASET	AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS (ASHK)	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSEE Elektronikisht Sistemi Multifunksional
10	Paraprake	ASET	REGJISTRI I KAPITENERISË	Me Kërkesë	Regjistri po digjitalizohet
11	Paraprake	Aset	REGJISITRI I MJETEVE TE TRANSPORTIT TË AVIACIONIT CIVIL	Me Kërkesë	Regjistri po digjitalizohet
12	Paraprake	KOMPANI	QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT (QKB)	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSEE Elektronikisht
13	Paraprake	KOMPANI	QENDRA KOMBËTARE E LICENCIMIT (QKL)	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSEE Elektronikisht
14	Paraprake	KOMPANI	REGJISTRI I PRONARËVE PËRFITUES	Akses i drejtpërdrejtë	Elektronikisht Nuk Është Zbatuar Ende
15	Paraprake	FINANCIARE	DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE	Akses i drejtpërdrejtë	Kërkesë zyrtare
16	Paraprake	FINANCIARE	REGJISTRI QENDROR I LLOGARIVE BANKARE	Akses i drejtpërdrejtë	Elektronikisht
17	Paraprake	TJETËR	OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSE
18	Paraprake	TJETËR	UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË	Akses i drejtpërdrejtë	DEEPSE
19	Paraprake	TJETËR	NJËSIA E INFORMACIONIT TË PASAGJERËVE	Kërkesë zyrtare	Kërkesë zyrtare

SHTOJCA 1. BURIMET E VLEFSHME PËR KËRKIMIN E INFORMACIONIT TË HETIMIT FINANCIAR

NR	FAZA	KLASIFIKIMI	BURIMI I INFORMACIONIT	KËRKESAT	METODA E QASJES
20	Prokurori	FINANCIARE	RREGJISTRI I KREDIVE NE BANKËN E SHQIPËRISË	I kufizuar - ME AUTORIZIM TË PROKURORIT	Kërkesë zyrtare
21	Prokurori	ASETE	DEKLARIMET E PERSONAVE TË EKSPOZUAR POLITIKISHT, ZYRTARËVE DHE FUNKSIONARËVE ME DETYRIM RAPORTIMI NË ILDKPI	ME KERKESË I kufizuar - me AUTORIZIM TË PROKURORIT	Kërkesë zyrtare
22	Prokurori	PERSON	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
23	Prokurori	PERSON	ARKIVAT GJYQËSORE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
24	Prokurori	PERSON	NOTERËT	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
25	Prokurori	ASET	REGJISTRI I PASURIVE TË LUAJTSHME	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
26	Prokurori	FINANCIARE	BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
27	Prokurori	FINANCIARE	REGJISTRI I KONTRATAVE TË SIGURIMIT TË JETËS	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
28	Prokurori	FINANCIARE	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FONDEVE TË SIGURIMEVE DHE PENSIONEVE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
29	Prokurori	FINANCIARE	DREJTORIA E LOJËRAVE TË FATIT	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
30	Prokurori	FINANCIARE	AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA	Akses i drejtpërdrejtë	Kërkesë zyrtare
31	Prokurori	FINANCIARE	AGJENCIA E PËRPUNIMIT TË KREDIVE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
32	Prokurori	TJETËR	KËSHILLAT BASHKIAKË OSE NDËRMARRJET VENDORE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
33	Prokurori	TJETËR	ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
34	Prokurori	TJETËR	SHOQËRITË E SIGURIMEVE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
35	Prokurori	TJETËR	NDËRMJETËSIT TREGTARË	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
36	Prokurori	TJETËR	SHOQËRITË DHE AGJENCITË E LETRAVE ME VLERË	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
37	Prokurori	TJETËR	AGJENCITË, UNIONET, SHOQËRITË E TRANSFERIMIT TË PARAVE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
38	Prokurori	TJETËR	KOMISIONI KOMBËTAR I TREGUT TË LETRAVE ME VLERË	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
39	Prokurori	TJETËR	FIRMA LIGJORE, ZYRA PROFESIONALE, KONSULENCE DHE AGJENCI	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
40	Prokurori	TJETËR	OFRUESIT E SHËRBMIMIT TË INTERNETIT	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare

NR	FAZA	KLASIFIKIMI	BURIMI I INFORMACIONIT	KËRKESAT	METODA E QASJES
41	Prokurori	TJETËR	AGJENCITË TURISTIKE	I kufizuar- Autorizimi i prokurorit	Kërkesë zyrtare
42	Prokurori	TJETËR	AMZA, REGJISTRI I VLERËSIMIT NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE E PRIVATE	ME KËRKESË TË PROKURORIT	Kërkesë zyrtare
43	Prokurori	TJETËR	AUTORITETI I MBIKQYRJES FINANCIARE	ME KËRKESË TË PROKURORIT	Kërkesë zyrtare
44	Prokurori	Tjetër	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONESISË INDUSTRIALE	ME KËRKESË TË PROKURORIT	Kërkesë zyrtare

1. SISTEMI I REGJISTRIT TË GJENDJES CIVILE

Ky burim duhet të konsiderohet si burim parësor informacioni, për identifikimin e personit, por edhe sepse individët me të shkuar kriminale shpesh ndryshojnë gjeneralitetet e tyre.

Një nga hapat e parë në çdo rast, është kërkesa drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, duke kërkuar të gjitha gjeneralitetet e subjektit dhe datën e ndryshimit të tyre. Pas përfundimit të këtij informacioni, OPGJ-të mund të nisin verifikimet në të gjitha institucionet publike dhe private, duke kërkuar informacione për të gjitha gjeneralitetet që këto institucione mund të sigurojnë për subjektet nën hetim.

Ky verifikim është thelbësor, sepse kursen kohë dhe parandalon përsëritjen e të njëjtave verifikime për gjeneralitete të tjera të ndryshme të personave nën hetim.

Aty shënohen dhe regjistrohen të gjitha rrethanat dhe faktet e rëndësishme të jetës së një personi: lindja, martesja, ndryshimi i gjendjes martesore, ndarja e pasurisë, vdekja, etj. Nga pikëpamja e hetimeve ekonomike dhe pronësore, informacioni më i rëndësishëm që ai i siguroar nga certifikatat e martesës, kontratat e martesës dhe certifikatat e vdekjes.

Autorët e veprave penale i ndajnë pasuritë e tyre për t'i regjistruar në emër të bashkëshortëve dhe për të shmangur sekuestrimin e tyre në rast arrestimi. Prandaj, fakti që pasuritë janë ndarë mund të tregojë se subjekti po përpiqet të pastrojë produktet e veprave penale.

Ky burim përfshin informacionin e mëposhtëm i cili është integruar përmes DEEPSE:

- Gjeneralitetet e personit: të dhëna të plota personale për identifikimin e subjektit: Emri, Mbiemri, Emri i babait, Emri i Nënës, Data dhe vendi i lindjes, numri personal i identifikimit, të tjera.
- Marrëdhëniet Familjare: të dhënat e anëtarëve të familjes (babai, nëna, bashkëshorti, fëmijët, vëllai/motra, të tjerët).
- Letërnjoftimi Elektronik: të dhënat mbi Kartën e ID-së personale (numri i identitetit, numri personal, emri, mbiemri, data e lindjes, vendlindja, numri i telefonit, adresa, të tjera).
- Pasaporta biometrike: të dhëna për pasaportën e një personi: Numri i pasaportës, Emri, Mbiemri, Data e lindjes, Vendlindja, adresa, Numri i telefonit, vendi dhe data e lëshimit, data e skadimit, sistemi i institutit të sigurimeve shoqërore).
- Sistemi i lejes së drejtimit të mjetit: informacion mbi lejen e drejtimit të një personi, ku mund të gjeni adresa alternative, numra telefoni, sistemi i institutit të sigurimeve shoqërore.

2. SISTEMI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nëpërmjet DEEPSE, ky burim ofron informacione për:

- Të dhënat e punësimit: të dhënat e historikut së punësimit të një personi, si: emri dhe numri i regjistrimit të çdo punëdhënësi, vendet e punës, periudha e punësimit, të ardhurat, të tjera.
- Deklarimi e pagës: të dhëna për pagat e deklaruar të paguara personit në fjalë, si: emri dhe numri i regjistrimit të çdo punëdhënësi, pagat e marra në çdo periudhë punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.
- Pagesat e pensionit: të dhëna për pagesat e marra si pensionist.

3. SISTEMI TIMS

TIMS, është Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Tërësor. Është sistem i menaxhimit të të dhënave që ofron informacion të centralizuar për individë konkretë. Qasja në këtë sistem mundësohet edhe përmes DEEPSE.

Ai jep informacion rreth:

- Sektorit të të dhënave të hyrjeve dhe daljeve: përmban informacion mbi të dhënat e hyrjes dhe daljes të individëve në Shqipëri si datën dhe orën e regjistrimit të hyrjes ose daljes, piknë e kalimit kufitar, llojin e mjeteve ajrore, detare, tokësore dhe lejen e drejtimit për automjetet.
- Sektori i të dhënave penale: përmban informacion mbi të shkuarën kriminale të individëve.
- Sektori i kallëzimeve penale: përmban informacion mbi kallëzimet penale të një personi, si për shembull nëse ka ndonjë kallëzim të bërë në emër të tij ose të bërë prej tij.
- Sektori i raportimeve të të arratisurve: përfshin informacion mbi shpalljen e individëve në kërkim nga policia dhe arsyen e shpalljes në kërkim.
- Sektori i fletarrestit: përfshin informacion mbi raportet e arrestit të një personi, informacion nëse personi është ndaluar ndonjëherë nga policia dhe pse.
- Sektori i Regjistrimeve të Shoqërimeve në Polici: përfshin informacion mbi shoqërimin ose ndalimin e individëve në fjalë policia dhe përse.
- Sektori i Menaxhimit të Çështjeve: ku shfaqen të gjitha çështjet penale të referuara nga Policia në Prokurori, secila me numrin e vet të regjistrimit (lidhje të mundshme me veprimtari kriminale).
- Aplikimet në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve: përmban të dhëna të aplikimeve të dorëzuara për çështjet përkatëse, licenca kombëtare (kërkesa për leje armësh, të tjera).
- Aplikimet në zyrën e punësimit: të dhënat e aplikimeve të dorëzuara në zyrën e punës, me qëllim punësimin.
- Persekutimi politik: përfshin të dhëna nëse personi ka qenë ndonjëherë i përndjekur politik dhe përse.
- Sektori i Ndhmës Ekonomike: përmban të dhëna për ndihmën ekonomike të dhënë nga shteti për individët (në të shkuarën ose aktualisht). Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme në dy mënyra në lidhje me të ardhurat e ligjshme: e para, për t'u llogaritur si të ardhura të ligjshme; dhe e dyta, për të vërtetuar falimentimin ekonomik. Për t'u miratuar, duhet të dorëzohen dokumente të tilla si raportet e gjendjes financiare personale ose familjare dhe ato që mund të jenë me interes për hetimin (dallimet midis të të dhënave të deklaruar për këtë qëllim dhe të dhënave që dalin në kuadër të hetimit).
- Aplikimet për qëndrim: përmban të dhëna për aplikimet për leje qëndrimi, arsyet e aplikimit, periudhën kohore përkatëse, adresat, kontaktet dhe marrëdhëniet personale, duke përfshirë marrëdhëniet ndërkombëtare, pasuritë dhe të tjera.

Informacioni në lidhje me historikun e penalitetit mund të plotësohet me të dhëna të siguruar nga bazash të tjera të dhënash të cilat mund të aksesohen me ose pa kërkesë, për shembull verifikim shtesë në Zyrën

e Interpolit dhe zyrat e tjera ndërkombëtare me bashkëpunim zyrtar ose jozyrtar për gjendjen gjyqësore të personit¹; verifikime shtesë në Prokurorinë e Përgjithshme (Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë) dhe në prokuroritë e rretheve (seksioni i ekzekutimit të vendimeve penale) për çdo praktikë ekstradimi, letërporosie, njohje vendimesh të huaja, etj., që mund të lidhen me këtë person; ose verifikim shtesë nëse ekziston ndonjë letër porosie e hartuar nga prokurori drejtuar autoriteteve të huaja në lidhje me këtë person.

4. REGJISTRI I NGJARJEVE KRIMINALE

Regjistri elektronik i ngjarjeve kriminale përfshin informacion nga raportet ditore të ngjarjeve (komunikatat) nga viti 1994 e në vazhdim.

Ky informacion i nevojitet oficerit të policisë gjyqësore për të bërë verifikime nëse personi në hetim është i përfshirë në ngjarje kriminale, është mbajtur në paraburgim, ka arrestime në flagrancë, kallëzime penale, si dhe për lidhjen mes personit të përfshirë dhe kohës së kryerjes së veprimtarisë kriminale.

5. REGJISTRI I PERSONAVE TË DËNUAR

Regjistri i personave të dënuar është pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, dhe aty verifikohet nëse personat në hetim janë dënuar më parë për vepra penale. Dëshmitë e penalitetit që merren nga ky regjistër janë të nevojshme në hetime për të dokumentuar veprimtarinë e mëparshme kriminale, nëse personi është përsëritës, për të dokumentuar kohën e kryerjes së veprimtarisë kriminale dhe kryer hetimet pasurore për subjektet e ligjit Nr. 10192.

6. REGJISTRI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT KRIMINAL (MEMEX)

Sistemi MEMEX është sistem për menaxhimin e informacionit policor. Në këtë sistem ruhet, përpunohet dhe administrohet informacion i klasifikuar "sekret shtetëror" deri në nivelin e klasifikimit "sekret". Sistemi është në pronësi të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është Autoriteti Operues i aplikacionit SMIP MEMEX.

Përdorues të sistemit janë vetëm punonjësit e Policisë së Shtetit, të strukturave të hetimit të krimeve dhe strukturave mbështetëse të tyre.

Sistemi disponon informacion për persona të evidentuar me të dhëna për veprimtari kriminale, për persona me precedent penal, për ngjarje kriminale, persona në gjurmim policor, persona në kërkim.

Autoriteti verifikues në Policinë e Shtetit është Kartoteka për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë e Analizës dhe Informacionit Kriminal, në Departamentin e Policisë Kriminale.

Në hetimet financiare, për verifikime nëse personat, subjekt të hetimit apo lidhjet e tyre, janë të evidencuar për veprimtari kriminale nga strukturat e Policisë së Shtetit (në sistemin MEMEX), sipas përcaktimeve të pikës 4.7, Kreu VII, të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.686, datë 25.11.2019, "Mbi rregullat për

1. Neni 192 i KPP

realizimin e përpunimit të informacionit policor, si dhe masat për administrimin dhe ruajtjen e dokumenteve për ndjekjen e veprimtarisë kriminale”, verifikimet bëhen në kartotekën për hetimin e krimeve.

Për procedime penale/pasurore të regjistruara për hetim financiar, nëse Prokurori i çështjes ka deleguar veprime për oficerë të policisë gjyqësore të strukturave të hetimit financiar në Policinë e Shtetit, për veprime të shpejta, këta të fundit të dërgojnë kërkesa për verifikim kartotekën për hetimin e krimeve.

Për procedime që ndiqen nga Prokuroria dhe/ose Byroja Kombëtare e Hetimit, kërkesa të përcillet zyrtarisht prej tyre në strukturën e cituar më sipër.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) ka marrëveshje bashkëpunimi me Byronë Kombëtare të Hetimit, nr.1590/1, datë 28.02.2022, “Për dhënien e të drejtës së konsultimit në bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit dhe caktimin e një pike kontakti për kontrollin e personave në interes të hetimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”. Sipas pikës 2, të Nenit 2, DPPSH “Cakton një pikë kontakti në Departamentin e Policisë Kriminale, e cila në bazë të kërkesave të BKH do të kryejë kontrolle nëse personat e specifikuar në këto kërkesa janë të evidentuar për veprimtari kriminale nga strukturat e Policisë së Shtetit”. Në zbatim të kësaj pike, pikë kontakti është Drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale.

Informacioni që disponohet nga sistemi MEMEX nuk ekspozohet dhe nuk përdoret në gjykatë, por mund të shërbejë për të orientuar hetimin.

7. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Për të patur qasje në këtë informacion, praktikisht hetuesit e Drejtorisë për Krime Ekonomike dhe Financiare të Policisë së Shtetit Shqiptar nuk kanë nevojë për urdhër nga prokurori, ata thjesht mund të përdorin kanalet zyrtare për të kërkuar informacionin (Shkresë nga DKEF).

Në të ardhmen e afërt, ata mund të kenë qasje të drejtpërdrejtë në të dhëna të caktuara të sistemit tatimor [kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk është ende në fuqi për momentin].

Ky është ndoshta një nga burimet më të rëndësishme për hetimet tona, sepse ky informacion lejon krahasimin e asetëve të pikasura të personit me të ardhurat e tij të ligjshme. OPGJ-të mund të marrë informacionin e mëposhtëm për personat fizikë dhe juridikë:

- Të dhënat e identifikimit të personave të hetuar.
- Marrëdhëniet familjare (bashkëshort dhe fëmijë), veçanërisht kur ata dorëzojnë deklaratat të përbashkëta tatimore dhe fëmijët e tyre janë nën moshë.
- Pronat dhe vlera e tyre kadastrale.
- Deklaratat tatimore të dorëzuara, veçanërisht të ardhurat dhe pasuria.
- Vetëdeklarimet e palëve të interesuara.
- Deklaratat e palëve të treta, në veçanti, Deklarata Vjetore e Operacioneve me Palët e Treta (mbi shumën sipas ligjit)
- Informacioni i mundësuar nga subjektet që integrojnë Sistemin Financiar dhe janë të detyruar ligjërisht të raportojnë kapitalin e të ardhurave të paguara te palët e treta.
- Identifikimin e llogarive bankare që ata mbajnë dhe/ose në të cilat janë përdorues të autorizuar, si dhe subjekteve dhe zyrave në të cilat janë të hapura këto llogari, interesat e përfituara nga llogaritë, etj.
- Transaksionet e jashtme: hyrje dhe dalje të parave (transaksione të padukshme dhe tregtare).
- Identifikimi i ortakëve, administratorëve dhe drejtuesve të subjekteve.

Transferimet e pronave: Në lidhje me këto, informacione të tjera përfshijnë likuidimet e Tatimit të Përfitimeve nga Trashëgimia, që është burim i rëndësishëm për të marrë informacion për pronësinë e pronave të paluajtshme kur nuk ka akte publike dhe palët ndërhyrëse (blerësit) janë të detyruara të deklarojnë kalimin dhe të paguajnë këtë taksë.

8. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Kjo drejtori është institucioni publik shtetëror përgjegjës për regjistrimin e automjeteve që i pajis ato me targa, regjistrim dhe tituj pronësie.

Ai ofron informacion në lidhje me mjetet motorike në pronësi të të dyshuarit ose të afërmeve të tij, së bashku me dokumentacionin përkatës. OPGJ-të mund të marrin të dhëna historike në lidhje me një person ose një automjet. Për shembull, është e mundur të kërkoni si listën e automjeteve në pronësi të një personi të caktuar, ashtu edhe listën e personave që zotërojnë një automjet të caktuar.

9. AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS (ASHK)

Është një agjenci qeveritare përgjegjëse për regjistrimin e banesave dhe të gjitha pronave të paluajtshme. Ajo përbëhet nga Autoriteti Kombëtar i Banesave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), të cilat regjistrojnë dhe ruajnë titujt e pronave të paluajtshme dhe informacione të tjera në lidhje me pasurinë e paluajtshme, si dhe të administrojnë dhe mbajnë të dhënat e pasurive të paluajtshme, hartat e pronës së regjistruar dhe dokumentacionin që vërteton pronësinë dhe të drejtat e tjera juridike mbi pasurinë e paluajtshme.

Nëpërmjet sistemit DEEPSEE, OPGJ-të dhe prokurorët kanë qasje në sistemin e Agjencisë së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që është pjesë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke i lejuar OPGJ-ve të kërkojnë një pronë të caktuar me numrin e saj të regjistrimit të tokës. Policia merr të dhënat e pronarit të regjistruar dhe mjete të tjera identifikimi në lidhje me pronën.

Në sistemin e kërkimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Policia mund të kërkojë prona duke futur emrin, mbiemrin dhe emrin e babait të personit, duke marrë informacionin e mëposhtëm:

- Konfirmimin e adresave, pronësisë së pronave rurale dhe urbane (nga vendndodhja e pronave, është e mundur të zbulohet pronari i saj).
- Ndër dosjet e pronave urbane, OPGJ-të mund të përcaktojnë vendndodhjen dhe planet e objektit, fotografitë, aktet, planet topografike të situatës, duke hedhur fotografi dhe koordinata të pronave.

Është e rëndësishme të theksohet se në ditët e sotme, ky burim ka integruar Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe A.L.U.I.Z.N.I. (Agjencia për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/ndërtesave Informale. Në kadastrë gjithashtu mund të sigurohet informacion për objektet e ndërtuara pa leje, të legalizuara apo në proces legalizimi, të cilat mund të jenë objekt hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi.

Duke qenë se informacioni është shumë i kufizuar dhe nuk është i përditësuar tërësisht, është e nevojshme që OPGJ-të të marrin të gjitha informacionet dhe dokumentet me një procesverbal, me autorizimin e prokurorit.

10. REGJISTRI I KAPITENERISË, DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Regjistri i mjeteve lundruese, aktualisht manual, është pranë kapitanerisë në Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës. Digjitalizimi i regjistrit të mjeteve lundruese është në proces. Me autorizim të prokurorit, oficerët e policisë gjyqësore mund të marrin informacion në këtë regjistër.

11. REGJISTRI I MJETEVE TË TRANSPORTIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil mund të kërkohet informacion për mjete fluturuese të cilat janë licencuar dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

12. QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Ky burim ofron informacion publik rreth:

- Emri tregtar dhe emërtimi i shoqërisë.
- Numri i identifikimit të caktuar nga autoriteti tatimor i vendit (NUIS, i barasvlerëshëm me numrin e TVSH-së).
- Aktin e themelimit.
- Vendbanimi.
- Të dhënat e anëtarëve të bordit drejtues dhe/ose ortakët, numrat e telefonit të administratorit
- Të dhëna të tjera, si adresa e selisë, qëllimi i korporatës, kapitali social, llogaritë vjetore dhe transfertat e aksioneve, numri i telefonave dhe adresa e emailit të administratorit.
- Pasqyrat e bilanceve dhe rezultatet financiare.

Duke qenë se Qendra Kombëtare e Regjistrimit disponon informacione për të dhënat e personave juridikë që lidhen me të dyshuarit, OPGJ-të mund të shikojnë një regjistër konkret tregtar dhe të shqyrtojnë aktet e themelimit të shoqërive dhe hartimet e njëpasnjëshme të akteve të ndryshme tregtare dhe akteve të transmetimit të aksioneve, emërimit të administratorëve dhe përfaqësuesve.

Në sistemin DEEPSEE, përfshihet një formular që përfshin informacionin e mëposhtëm:

- Veprimtaritë e biznesit: të dhënat e veprimtarive të regjistruara të biznesit, si: numri i regjistrimit të shoqërisë, emri i biznesit, statusi juridik, të tjera.
- Sistemin e automjeteve: të dhënat e mjeteve motorike të regjistruara nga një person (targa; lloji, modeli dhe marka e mjetit; ngjyra, të tjera).

Për më tepër, faqen e internetit të qendrës mund të bëhet edhe kërkim në internet. Është e mundur të kërkoni sipas NUIS, emrit të shoqërisë, adresës, emrit të aksionerit, emrit tregtar ose numrit të identifikimit.

Faqja e internetit e Qendrës Kombëtare të Biznesit është aktualisht faqe interneti publike falas për çdo individ dhe, për rrjedhojë, mund të shqyrtohet nga hetuesit financiarë për të marrë informacion mbi personat juridikë dhe fizikë të regjistruar, emrin, datën e regjistrimit, pronarët, ortakët, aksionerët, bilancet, adresat e selisë, administratorët, telefonat, email-et, etj.

Ky informacion mund të jetë shumë i dobishëm në çdo hetim financiar për të zbuluar të gjithë strukturën e biznesit nën kontrollin e autorëve, se ata mund të përdoren për të pastruar dhe fshehur fitime të paligjshme.

13. QENDRA KOMBËTARE E LICENCIMIT (QKL)

Qendra jep informacion nëse i dyshuari ose personat e afërt me të posedojnë ose kanë aplikuar për ndonjë lloj licence për të drejtuar biznese/veprimtari.

14. REGJISTRI I PRONARËVE PËRFITUES

Ky regjistër mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB). Të gjitha subjektet juridike janë të detyruara të raportojnë dhe regjistrojnë informacionin e tyre të pronësisë përfituese dhe janë të detyruar të paraqesin informacion në lidhje me pronarët e tyre përfitues.

Pronari përfitues është personi ose personat e vërtetë që zotërojnë, kontrollojnë ose përfitojnë nga një person juridik, si një shoqëri ose organizatë. Kriminelët mund të përdorin një "pronar anonim" ose një "të emëruar" si pronar të një shoqërie në mënyrë që të lëvizin fshehurazi, të pastrojnë dhe shpenzojnë para nga veprimtaria kriminale.

Kështu, OPGJ-ja mund të marrë informacion thelbësor për të zbuluar pronarin e vërtetë përfitues të personave juridikë dhe organizatave (Pronari përfitues i vërtetë është ai që ka kontroll mbi të paktën 25% të totalit të pjesëmarrjeve ose aksioneve të personave juridikë të organizatës, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet të tretëve, në formën e personave juridikë ose fizikë).

Së fundmi, oficerët e policisë gjyqësorë të policisë së shtetit dhe të prokurorisë të caktuar për hetimin e krimeve ekonomike e financiare, korrupsionit, krimin të organizuar dhe trafikëve të paligjshme, si dhe krimeve të tjera serioze, janë autoritete kompetente, dhe sipas Nenit 7.3 të ligjit Nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", Autoritetet kompetente shtetërorë kanë akses elektronik të lirë, të drejtpërdrejtë dhe të pa kufizuar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.²

Ky informacion mund të jetë shumë i dobishëm për të kutptuar strukturat e biznesit të kontrolluara nga autorët dhe të përdorura për të fshehur pronësinë e çdo lloj pasurie.

15. AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIAR (AIF - ISH DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE - AIF)

AIF përfaqëson Njësinë e Inteligjencës Financiare Shqiptare (Agjencia e Inteligjencës Financiare AIF) e krijuar si ndërmjetës midis subjekteve raportuese dhe autoriteteve përgjegjëse për hetimet dhe ndjekjen penale të krimin financiar. AIF-ja është anëtare e grupit EGMONT që prej vitit 2003. Për të përmbushur

2. Duhet cilësuar se në disa bazash të dhënash e drejta e qasjes në të dhënave është e parashikuar shprehimisht në ligjet organike të institucioneve përkatëse si p.sh. në "Regjistrin e pronarëve përfitues", e drejta e qasjes së "Autoriteteve kompetente shtetërore" ku përfshihen pokuroria, policia, dhe jo vetëm, parashikohet në nenin 3 pika 7 e ligjit nr.112/2020 i ndryshuar ose sipas KPP.

funksionet e saj, ajo merr dhe analizon informacionin financiar që raportohet nga subjektet e detyruara. Informacioni i raportuar në AIF përfshin:

- Transaksione në mjete monetare fiat mbi shumën 1 milion Lekë që subjektet kryejnë për llogari të klientëve të tyre gjatë marrëdhënies së punës;
- Raportet për Veprimtaritë e Dyshimta (RVD);
- Raportet ndërkufitare të transportit të parave fizike, instrumenteve të negociueshme si dhe metaleve dhe gurëve të çmuar. Këto raporte dorëzohen periodikisht nga Drejtoria e Doganave;
- Informacioni i shkëmbyer me Njësitë e Inteligjencës Financiare partnere në mbarë botën,

Analiza operationale e ndërmarrë nga AIF-ja përdor të gjitha burimet e informacionit në dispozicion për të prodhuar modele veprimtarie që nga ana e tyre i ofrojnë analistit metoda për hartimin e treguesve të të ardhurave të fshehura të një individi, një grupi individësh apo një organizate.

Kjo metodë e tërthortë është e efektshme për mbledhjen, organizimin dhe paraqitjen e informacionit në lidhje me gjendjen financiare të subjekteve. Kjo analizë është e duhur kur tregon se personat ose subjektet e përfshira nuk mund të paraqesin burim legjitim për diferencën midis fluseve të parave fizike (fiat) dhe të ardhurave të tyre. Gjurmimi i pasurive mund të sigurojë gjithashtu pista që lidhin subjektin me veprën penale mëmë.

Informacioni i marrë pas analizave të bëra nga AIF i dërgohen Policisë së Shtetit ose Prokurorisë për ndërmarrjen e hetimeve të mëtejshme dhe mbledhjen e provave të mëtejshme që mund të çojnë në dënim. Vendimi për marrësin e informacionit bazohet në provat e një veprë penale mëmë, kompleksitetin e çështjes, aspektin kombëtar ose ndërkombëtar të çështjes, etj.

Në kuadër të veprimtarisë së saj, AIF ofron gjithashtu informacion për Agjencitë e Zbatimit të Ligjit që kryejnë hetime lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, duke ofruar kështu mbështetje të vazhdueshme për të garantuar që fondet ose pasuritë gjurmohen, sekuestrohen dhe konfiskohen siç duhet. Gjithashtu, AIF jep kontributin e saj duke bashkëpunuar ngushtësisht me Ekipe të Përbashkëta Hetimore.

Është e rëndësishme të theksohet se çdo informacion apo e dhënë që i shpërndahet organeve ligj zbatuese nga AIF-ja i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror dhe nuk përbën provë sipas kuptimit në Kodin e Procedurës Penale.

16. REGJISTRI QENDROR I LLOGARIVE BANKARE

Ndër subjektet e tjera, në përputhje me strukturën e saj të miratuar, në këtë regjistër kanë akses punonjës të caktuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët punojnë në fushën e krimit ekonomik e financiar shtetëror, financimit të terrorizmit dhe gjurmimit të pasurive.

Ndër të tjera regjistri përmban të dhëna të zotëruesve individualë të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë, sipas Ligjit Nr. 154/2020 të Regjistrimit të Llogarive të Bankaës Qendrore.

Ky regjistër përmban të dhëna lidhur me llogaritë bankare apo kasafortat e individëve dhe përditësohet në kohë reale nga institucionet financiare. Të dhënat e Regjistrimit nuk përfshijnë lëvizjet e llogarisë bankare, dokumentet e transaksioneve mbështetëse dhe dokumente të tjera.

Së fundmi, Drejtoria për Krimet Ekonomike dhe Financiare ka qasje në sistemin 'Regjistri i Llogarive Bankare', nga i cili mund të marrin drejtpërdrejt informacione për IBAN-in e llogarisë bankare dhe statusin

e tyre, por jo për kasafortat. Kjo mundësi lehtëson dhe shkurton kohën e hetimit financiar, pasi identifikon llogaritë e subjektit pa iu drejtuar me shkresë zyrtare, të gjitha subjekteve bankare e financiare.

17 OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Nëpërmjet DEEPSE, OPGJ-të mund të marrin të dhëna për faturat e energjisë elektrike të një individi. Informacioni i përfshirë në faturë do t'i lejojë OPGJ-ve të zbulojnë adresën ku furnizohet energjia elektrike, ndoshta e ndryshme nga adresa ku dërgohet fatura, dhe mënyrën e pagesës (nëpërmjet llogarisë bankare ose të tjera). Është shumë e rëndësishme të kontrollohen të gjitha të dhënat në dispozicion për të dyshuarin.

18. SISTEMI I UJËSJELLËS KANALIZIMEVE TIRANË

Nëpërmjet DEEPSE profesionistët mund të marrin të dhëna për faturat e furnizimit me ujë të një personi. Informacioni i përfshirë në faturë do t'i mundësojë OPGJ-ve të zbulojnë adresën ku furnizohet uji, ndoshta ndryshe nga adresa ku dërgohet fatura dhe mënyrën e pagesës (nëpërmjet llogarisë bankare ose të tjera). Është shumë e rëndësishme të kontrollohen të gjitha të dhënat në dispozicion për të dyshuarin.

19. NJËSIA E KONTROLLIT TË PASAGJERËVE

Njësia e informacionit të pasagjerëve është strukturë e Policisë së Shtetit, në Departamentin e Policisë Kriminale me qendër në Aeroportin "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë, e cila trajton dhe administron të dhëna elektronike për pasagjerët që udhëtojnë me linjat ajrore, linjat dhe oraret e fluturimeve, destinacionin, etj.

Këto të dhëna mund të shfrytëzohen për hetime financiare, hetime pasurore, hetime për pastrim parash, financim terrorizmi dhe krime të tjera. OPGJ-të dhe prokurorët mund t'i marrin këto të dhëna me kërkesë zyrtare në cilësinë e hetueseve në procedimet penale.

20. REGJISTRI I HUAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Sistemi elektronik i regjistrimit të huave është pronë e Bankës së Shqipërisë. Ai disponon informacione për të gjitha huatë e marra, kohën e marrjes, këstin mujor ose periodik si dhe historikun e pagesave të huave, bashkë huamarrësit, etj. Në këtë regjistër kanë qasje bankat, institucionet financiare të kreditit.

Në hetimet financiare mund të merret informacion me kërkesë të prokurorit në funksion të procedimit penal për pastrim parash, financim terrorizmi, hetim pasuror apo çdo hetim financiar.

Shpesh herë pastruesit e parave zbatojnë marrjen e huave të panevojshme dhe i mbyllin ato shpejt vetëm për të mbuluar gjurmët e parave që rrjedhin nga veprat penale, ndaj është e rëndësishme që të merret, analizohet dhe shfrytëzohet ky burim në hetime financiare, në hetime pasurore dhe në hetime për pastrim parash dhe financim terrorizmi.

Në Bankën e Shqipërisë mund të kërkohet informacion dhe për transaksionet me bonot e thesarit, obligacionet, letrat me vlerë.

21. DEKLARIMET E PERSONAVE TË EKSPOZUAR POLITIKISHT, ZYRTARËVE E FUNKSIONARËVE ME DETYRIM RAPORTIMI NË INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT (ILDKPKI)

Deklarimet e pasurisë, detyrimeve financiare dhe konfliktit të interesit të zyrtarëve shtetërorë dhe funksionarëve publikë në ILDKPKI, sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003³, janë burim zyrtar informacioni që shërben për rastet e hetimeve financiare, hetimeve për pastrim parash dhe hetimeve pasurore të zyrtarëve dhe të zgjedhurve të subjekteve deklaruese, që janë në hetim apo të përfshirë në hetime.

Aktualisht, ky informacion merret me kërkesë zyrtare gjatë procedimit penal dhe përdoret si provë në gjykatë. ILDKPKI ka ngritur sistem elektronik deklarimi, i cili është në proces digjitalizimi. Për të shërbyer si provë në gjykatë, deklaratat pranë ILDKPKI (kopje të njësuar me origjinalin) merren me kërkesë zyrtare.

Kjo bazë të dhënash, e vendosur në Tiranë, mbledh e administron të gjitha deklaratat vjetore të zyrtarëve publikë, lidhur me pronat dhe të ardhurat e tyre dhe të familjarëve të tyre subjekt deklarimi. Dy vitet e fundit deklaratat bëhen në formë elektronike dhe dërgohet një kopje e printuar dhe firmosur.

22. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Sistemi Doganor (ASICUDA) është sistem i menaxhimit të të dhënave i disponueshëm dhe i aksesueshëm nga zyrtarët doganorë, por qasja për Policinë Gjyqësore nuk është ende funksionale.

Ky sistem përmban të dhëna të dobishme për hetimin e subjekteve që kryejnë veprimtari eksporti, si emri i shoqërisë, numri i identifikimit, pronarët, sasia, cilësia, data e dërgesës, lloji i mallit, data e deklarimit, çmimi, sasia, mjetet e transportit, puna më mallra pa dhe me TVSH, vlera e detyrueshme dhe shuma e detyrimit doganor që duhet paguar, duke qenë kështu shumë i dobishëm në çështjet e PP.

23. ARKIVAT E SISTEMIT GJYQËSOR

OPGJ-të mund të konsultojnë përmbledhjet, procedurat, raportet etj. të gjykatës. Ato duhet të lidhen me procedimin gjyqësor në fjalë dhe duhet të kenë autorizimin e nevojshëm gjyqësor. Të dhënat që mund të merren mund të jenë të çdo lloji, nga deklaratat e bëra në dëshmi, deri te informacionet për pronat e siguruar nga palët e përfshira në proces.

Kjo mund të jetë çdo lloj e dhëne, nga deklaratat në seancat gjyqësore, te informacionet rreth pasurive nga palët e përfshira në procedim.

3. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

24. NOTERËT

Ky burim është i një rëndësie maksimale, për shkak të llojit të informacionit që OPGJ-të mund të marrin prej tyre.

Noterët janë profesionistët që garantojnë besimin e publikut në vërtetësinë dhe vërtetësinë e veprimeve në të cilat përfshihen, të cilat në thelb i përkasin dy llojeve:

- Transaksionet e lëmit trashëgimor: aktet e shitblerjes.
- Transaksione të tjera me përmbajtje jopasurore: lëshimi i prokurave, themelimi i shoqërive, etj.

Në përputhje me legjislacionin Kundër Pastrimit të Parave, noterët janë subjekte të detyruar dhe duhet t'i informojnë FIU-t për kontratat dhe aktet për të cilat marrin njohuri gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, që mund të përbëjnë tregues ose prova për pastrim parash nga veprimtari kriminale.

Të dhënat për aktet noteriale disponohen nëpërmjet Regjistrat të Noterisë Shqiptare (RNSH) si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me dhomën dhe zyrat e noterëve.

Në Shqipëri, ndodh shpesh që autorët të nënshkruajnë kontratë për pasuri të paluajtshme, automjete etj., por nuk shkojnë në Agjencinë e Kadastrës apo Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për t'i regjistruar këto kontrata, ndaj në këto zyra mund të ketë informacion të kufizuar për këto prona. Në këtë kontekst është e një rëndësie maksimale që këto kontrata të merren nga Noterët.

25. REGJISTRI I PASURIVE TË LUAJTSHME

Ky burim përfshin pasuritë e luajtshme të regjistruara (automjete, anije, avionë, makineri industriale, interesa sigurie në pasuri të luajtshme, kushte të përgjithshme kontraktimi, kontratat e qirasë, kontratat e leasing-ut, veprat e artit, stollitë, etj.) me informacion për pronësinë, karakteristikat dhe të dhënat e regjistrimit të këtyre pasurive.

26. BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

Këto burime japin informacion për dokumentet që lidhen me të gjitha llogaritë, depozitat, kasafortat, etj., të hapura nga persona të dyshimtë ose persona juridikë në çdo degë të bankës.

Zakonisht, për çdo llogari, dokumentacioni duhet të përfshijë: identifikimin dhe vendndodhjen e plotë të llogarive dhe depozitave, kontratat e hapjes, nënshkrimet e autorizuara, ekstraktin e lëvizjeve, operacionet e rëndësishme, transaksionet e aseteve (hua, hipoteka), dokumentacionin mbështetës të operacioneve me interes, kontrata qiraje, kasaforta, karta krediti dhe karta debiti, marrëveshje huaje dhe raporte risku.

Në Shqipëri, sipas Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, institucionet duhet të mbajnë dokumentacionin që lidhet me regjistrat e llogarive, transaksionet (kombëtare dhe ndërkombëtare, të kryera në emër të klientit ose të palëve të treta), korrespondencën me klientin, dokumentacionin mbështetës, dosjet e llogarisë dhe korrespondencën e biznesit për 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së punës ndërmjet klientit dhe subjektit; ose nga data e transaksionit të rastit, por jo më shumë se 40 vjet nga data e çdo transaksioni. Ato duhet të ruajnë të dhënat e transaksioneve me të gjitha hollësitë e nevojshme për të lejuar rindërtimin e të gjithë ciklit të transaksioneve, në formë të shkruar ose elektronike.

Gjithashtu, të dhënat ose dokumentet bankare janë konfidenciale dhe marrja e informacionit mund të kryhet vetëm përmes kërkesës me shkrim të prokurorit në funksion të një procedimi penal.

Nëse prokurorit do t'i duhet të tërheqë (sekuestrojë) dokumente origjinale bankare, të cilat janë të ndryshme nga ato që prokurori kërkon për sekuestrim në bazë të vendimit të tij, prokurori mund të veprojë kështu vetëm në raste urgjente.

Zakonisht dokumentet bankare sekuestrohen me vendim gjykatë. Në këtë rast, prokurori duhet të bindë gjykatën se përfitimi i dokumentacionit bankar është i nevojshëm për zbardhjen e mekanizmit të kryerjes së veprimtarisë kriminale dhe për identifikimin e autorit të veprës penale.

27. REGJISTRI I KONTRATAVE TË SIGURIMIT TË JETËS

Në këtë regjistër regjistrohen kontratat e sigurimit që ofrojnë mbulim për sigurimin e jetës. Informacioni që mund të marrë OPGJ-ja përfshin: llojin e sigurimit të jetës (disa janë në fakt depozita fondesh), mbajtësit, përfituesit, etj.

28. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FONDEVE TË SIGURIMIT DHE TË PENSIONIT

Kjo drejtori merr të dhëna nga subjektet e sigurimit, duke përfshirë ndër funksionet e saj kontrollin, mbikëqyrjen, analizën, koordinimin dhe mbrojtjen administrative në çështjet e shoqërive të sigurimit, fondeve të pensionit, planeve individuale të pensioneve, administratorëve të fondeve të pensioneve dhe depozituesve të fondeve të pensioneve.

OPGJ-ja mund të marrë informacionin e mëposhtëm si: policat e sigurimit, fondet e pensionit, planet individuale të pensioneve (mbajtësit, përfituesit, shumat, etj.).

29. DREJTORIA E LOJRAVE TË FATIT

Nga ky burim OPGJ-të mund të marrin të dhëna për subjektet dhe fituesit në lojërat e fatit, kazinotë, lotaritë, etj. Ky informacion mund të jetë shumë i dobishëm në skemat e pastrimit të parave duke përdorur këto lloj teknikash.

30. AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

OPGJ-të mund të marrin informacione për pasuritë që ata administrojnë, ose figurojnë të sekuestruara ose të konfiskuara, si dhe për identifikimin e pasurive të tjera të konstatuara nga kjo agjenci gjatë procesit të marrjes dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.

31. AGJENCIA E PËRPUNIMIT TË KREDIVE

Ky informacion është i dobishëm për identifikimin dhe nivelin e kredive, për të përcaktuar dallimin ndërmjet burimeve të ligjshme dhe të paligjshme në hetimet pasurore.

32. KËSHILLAT BASHKIAKË APO SHOQËRITË NË NIVEL VENDOR

Ato ndodhen kryesisht në vende të tilla si vendlindja, vendbanimi i zakonshëm ose dytësor, ose ku subjekti ushtron punën ose veprimtarinë e tij profesionale.

Në këto institucione ka tre burime shumë të rëndësishme për mbledhjen e të dhënave për pronat, pastrimin e parave dhe hetimet financiare:

- Regjistri e Censit Bashkiak: Regjistri i subjekteve dhe personave të lidhur (që banonin në të njëjtën adresë); Adresat, dokumentet e identitetit, marrëdhëniet familjare, etj.
- Taksat vendore: Pagesa e taksave ose detyrimeve të çdo lloji: Kontributi urban, taksa e qarkullimit të automjeteve, taksa e ujit dhe mbetjeve, aplikime për leje ndërtimi, kërkesa për hapje objekti, etj. (të gjitha këto na ndihmojnë të njohim pasuritë e tyre).
- Zyrtarë të Policisë Bashkiake: OPGJ-të mund të marrin informacione të përditësuara për persona, shoqëri, adresa, etj nga këta zyrtarë.
- Këshilli i rregullimit të territorit, për lejet e ndërtimit, ku mund të merren të dhënat për projektet dhe situacionin e punimeve.

33. ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR

Këto subjekte ofrojnë informacion për të gjitha transaksionet e kryera përmes tyre. Sipas ligjit, ato janë të detyruara të mbajnë të dhëna për të gjitha transaksionet dhe të informojnë Bankën e Shqipërisë çdo ditë. Megjithatë, disa prej tyre bëjnë raportime javore.

Ky burim informacioni është thelbësor kur skemat e pastrimit të parave përfshijnë këmbimin nga një valutë në tjetrën (për shembull, Euro ose Dollarë në Lekë).

34. SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Bëhet fjalë për shoqëri private, çka nënkupton se konsultimi i të dhënave në regjistrat dhe dosjet e tyre duhet të bëhet gjithmonë me autorizimin përkatës gjyqësor.

Informacioni në këto shoqëri ka të bëjë me ekzistencën e policave të sigurimit, të cilat në raste të caktuara janë me interes të madh hetimor (asetet e siguruar, vlera e dorëzimit të kapitalit, sigurim me vetëm një prim, etj.). Pagesat e primeve të sigurimeve mund të gjenden edhe tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

35. NDËRMJETËSIT TREGTARË

Ata janë 'noterë' të kontratave tregtare. Dokumentet apo regjistrat e këtyrë ndërmjetësve mbajnë të dhëna në lidhje me transaksionet financiare të kryera nga ata, të cilat mund të shërbejnë për hetimin. Ata kryejnë veprimtari që lidhen me emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që lidhet me tregtimin e letrave me vlerë.

36. AGJENCITË, UNIONET SHOQERITË E TRANSFERIMIT TË PARAVE

Wester Union, AK-Invest, Ria, dhe çdo shoqëri tjetër e licencuar nga Banka e Shqipërisë që ushtron veprimtari të transferimit të parave, janë subjekte të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit dhe kanë detyrimin të raportojnë transaksionet e pazakonta dhe të dyshimta, transaksionet në vende me parajse fiskale, etj. tek AIF-ja.

Për më tepër, me autorizim apo kërkesë të pas regjistrimit të procedimit, oficerët e policisë gjyqësore mund të marrin të dhëna për transaksione të subjekteve në hetim. Informacion nga këto subjekte mund të merret paraprakisht edhe nëpërmjet AIF-së, nëse nevojitet të ruhet sekreti hetimor.

Informacioni i marrë nga këto institucione është shumë i dobishëm në skemat ku organizatat përpiqen të lëvizin para jashtë vendit duke shmangur sistemin financiar zyrtar, duke maskuar transaksionet e paligjshme, ndër të tjera të kryera nga klientët me mirëbesim.

37. KOMISIONI KOMBËTAR I TREGUT TË LETRAVE ME VLERË (K.K.L.V.)

Letrat me vlerë janë instrumente të borxhit publik të emetuara nga qeveria. Bonot e privatizimit janë gjithashtu letra me vlerë të caktuar nga qeveria dhe mund të përdoren për legalizimin dhe blerjen e objekteve shtetërore. Bonot e thesarit janë instrumente afat shkurtra investimi.

Me kërkesë të prokurorit, pas regjistrimit të kallëzimit ose procedimit penal oficerët e policisë mund të marrin informacion në Komisionin Kombëtar të Letrave me Vlerë (K.K.L.V.) nëpërmjet një kërkesë zyrtare drejtuar Banksë së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.

38. ZYRAT LIGJORE, ZYRA PROFESIONALE, KONSULENCE DHE AGJENCI

Këto lloj zyrash dhe subjektesh shpesh menaxhojnë pasuritë e personave të hetuar; në shumë raste, pronarët e tyre zakonisht veprojnë si persona kukull (front men).

Ndonjëherë ata janë përgjegjës për ruajtjen e dokumenteve të kompromentuara që lidhin kriminelët me pronën zyrtarisht në emrin e palëve të treta.

Informacioni që OPGJ-të mund të marrin prej tyre përfshin:

- Shoqëritë e mundshme në emër të tyre dhe dokumentacionin në lidhje me veprimtarinë e tyre: pagesat e TVSH-së, pagesat e tatimeve të korporatës, operacionet tregtare të kryera.

- Kopje të akteve të themelimit të shoqërive dhe autorizimeve që i lejojnë ato të veprojnë në emër të tyre.
- Llogaritë bankare të mbajtura nga personat ose shoqëritë e hetuara dhe mbi të cilat ata kanë të drejtën e disponimit.
- Kontratat private të transmetimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme etj.

39. OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË INTERNETIT

Këto shoqëri ofrojnë disa shërbime interneti për klientët e tyre, kështu që OPGJ-të mund të marrin informacion për faturat, mjetet e pagesave, adresat e shërbimeve dhe produkte të ndryshme të përdorura nga klientët.

40. AGJENCITË E UDHËTIMIT

Këto agjenci ofrojnë shërbime për fluturimet, akomodimin, paketat e pushimeve, kështu që OPGJ-të mund të marrin jo vetëm informacione se ku mund të qëndronjë disa autorë në momente të caktuara, por edhe kush dhe si paguajnë për këto shërbime, si edhe informacion për mënyrën e jetesës së autorëve, duke i krahasuar më pas me të ardhurat e deklaruarat prej tyre.

41. AMZA, REGJISTRI I VLERËSIMIT NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE E PRIVATE

AMZA është regjistër i vlerësimit të rezultateve të nxënësve dhe studentëve, QW mund të merren gjatë hetimeve me kërkesë të prokurorit drejtuar institucionit arsimor publik ose privat përkatës dhe Ministrisë së Arsimit, veçanërisht nëse institucioni arsimor përkatës e ka mbyllur aktivitetin.

42. AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE (AMF)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u themelua në vitin 2006 si institucion publik, dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarive kryesore financiare në vend.

Informacioni që mund të merret gjatë hetimit nga AMF-ja përfshin transaksionet dhe ose pagesat me subjektet e licencuara; në tregun e sigurimeve, (shoqëritë e sigurimeve të jetës dhe jo jetës, shoqëritë e ri sigurimeve, me agjentët dhe ndërmjetësit në sigurime, me vlerësues dëmsh), me tregun e titujve, me tregun e sipërmarrjeve kolektive, me fondin e pensioneve vullnetare, me tregun e letrave me vlerë dhe me bursën).

43. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, disponon regjistrin e patentave dhe markave e shpikjeve. Ky është regjistër publik. Oficerët e policisë gjyqësore me kërkesë të prokurorit, mund të marrin informacion të përditësuar mbi shpikjet, patentat dhe markat regjistruara, kur mund të lindë nevoja për këtë informacion gjatë hetimeve financiare apo për pastrim parash dhe financim terrorizmi.

SHTOJCA II

TIPOLOGJITË E PASTRIMIT TË PARAVE

1.

Përdorimi i parave fizike

Kjo metodë ka të bëjë kryesisht me përdorimin e korrierëve për transportin e parave fizike nga njëri vend në tjetrin. Është niveli “më i ulët” ose elementar i trajtimit të pastrimit të parave nga policia, për të cilin nuk kërkohet trajnim intensiv teknik.

Gjurmimi mund të jetë hapi i parë i nisjes së hetimeve për të zbuluar strukturat që fshihen pas qarkullimit të parave fizike. Fondet e transportuara në këtë mënyrë mund të lidhen, si në rang kombëtar, ashtu edhe në rang ndërkombëtar, me çdo krim që sjell gjenerim ose sigurim fitimesh në para fizike.

Për mbartjen e parave fizike mund të përdoret çdo mënyrë transporti: tokësore, ajrore ose detare. Zakonisht, operacione të tilla për qarkullimin e parave fizike i nënshtrohen rregullores administrative, të paktën kur hyjnë ose dalin nga vendi. Kështu, paratë fizike duhet të deklarohen nëse shuma është e barabartë ose më e madhe se \$10.000 (ose shuma e barasvlershme në monedhën vendase).

Prandaj, organizatat kriminale që përdorin këtë sistem kanë dy alternativa kur kalojnë kufirin:

- të mbartin më pak se 10.000 euro para fizike në mënyrë që të mos detyrohen ta deklarojnë shumën;
- të mbartin mbi 10.000 euro para fizike, duke:
 - Deklaruar shumën dhe duke certifikuar prejardhjen e ligjshme.
 - Mos e deklaruar shumën dhe duke përdorur metoda të tjera për fshehjen e parave.

Nëse për mbartjen e parave do të përdoret fshehja e tyre, mund të përdoren këto alternativa:

- fshehja e parave nën rroba;
- përdorimi i ngjitësit adeziv, brezit ose objekteve të tjera që shërbejnë për puthitjen e parave pas trupit;
- fshehja e parave në valixhe ose çanta dore dhe/ose valixhet e kontrolluara në rastin e transportit ajror.
- fshehja e parave në automjete.

Mbartja e parave mund të ketë disa avantazhe ndaj metodave të tjera të transferimit të fondeve si:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, ndër vite, ka publikuar në raportet vjetore ndër vite tipologji të rasteve të dyshimta për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nëpërmjet publikimit të këtyre tipologjive synohet edhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve raportuese të parashikuara në ligjin nr. 9917, dt. 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar. Versionin e plotë të këtyre raporteve e gjeni në linkun <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>


- Fleksibilitet - mundësia për t'i dërguar fondet në rajone që kanë pak institucione bankare (për shembull Afganistan ose Irak).
- Siguria - Korrierët e besuar janë më të sigurt se institucionet financiare ose operatorët "hawala", pasi këta të fundit mund të kërcënojnë konfidencialitetin e operacionit.

Zgjedhja e rrugës për lëvizjen e parave fizike midis juridiksioneve varet nga disa faktorë ndikues dhe vendoset vetëm pasi të jetë përcaktuar qëllimi, destinacioni dhe metoda e transportit.

Për sa i përket transportit të parave fizike, dëshira kryesore e një grupi kriminal, pasi ka fituar shumë të mëdha parash duke kryer krime në një vend të caktuar, është të ndërmarrë hapa për të shmangur gjurmimin e fitimeve të paligjshme nga autoritetet e atij vendi duke vështirësuar lidhjen e tyre me veprën penale mëmë. Transporti i parave fizike në vendin më të afërt të disponueshëm është mënyra më e lehtë dhe me gjasë, edhe më e lira.

Valutat më të përdorura janë dollari amerikan dhe euro, të gjetura madje edhe në juridiksione të tjera krahas atij ku përdoren si valutë zyrtare, duke treguar kështu se paraja fizike në fjalë është futur kontrabandë në atë juridiksion.

Për sa u përket teknikave më të përdorura nga kriminelët për transportimin e parave fizike, mund t'i ndajmë në këto kategori: paratë fizike nga veprimtaria kriminale deklarohen pjesërisht; nuk ka përpjekje për t'i fshehur paratë fizike nga veprimtaria kriminale; fshihen në trupin e personit (pakëtohen në trup ose fshihen poshtë rrobave); fshihen në valixhet e pasagjerëve dhe fshihen në automjete dhe ngarkesa.



Burimi: Raporti i FATF-së për *Pastrimin e Parave nëpërmjet Transportimit të Parave Fizike*

1. TREGUESIT E RISKUT (ALARMET)

Këta tregues risku janë marrë nga raporti i OECD-së² dhe ndahen në gjashtë kategori kryesore:

Origjina e pazakontë e fondeve

- Para fizike nga vende me nivel të lartë korrupsioni ose paqëndrueshmëri politike.
- Vende me sisteme financiare të mirëzhvilluara (si alternativë e sigurt dhe e lirë e transportimit të parave fizike)
- Depozitat e parave fizike në llogari bankare biznesi dhe personale nga burime të pashpjeguara.

Shpjegime të pazakonta për shkak të

- dhënies së shpjegimeve të paplota, pak të mundshme ose pjesërisht të pasakta, apo mosdhënies së shpjegimit për origjinën e parave fizike.
- Nuk ka prova ose dokumentacion mbështetës lidhur me origjinën ose pronarin.

Posedim i pazakontë

- Shuma, prerja ose valuta nuk përkojnë me historikun personal ose të punës së mbartësit.

Metodat e pazakonta të transportimit

- Transportimi i fshehtë i parave fizike.
- Rrezik i qartë i metodës së transportit për sigurinë.
- Kosto të larta transporti krahasuar me metodat alternative të transportit.

Destinacion dhe shpenzim i pazakontë

- Vendet me risk (p.sh. prodhim droge, rregullore joefikase kundër PP-së, sekret i rreptë bankar).
- Paratë fizike të marra në vende që nuk përkojnë me historikun e mbartësit.
- Para të shpenzuara për artikuj luksi.
- Tërheqje parash fizike në shuma të mëdha ose pagesa pa arsye ose shpjegim ekonomik.

Flukse të pazakonta parash fizike

- Xhiro parash fizike/shitje që nuk priten në industri.
- Rritje e konsiderueshme e xhiros së parave/shitjeve nga klientë të paidentifikueshëm.
- Depozita ose tërheqje bankare në para fizike në prerje ose valutë që nuk janë të pritshme në industri.
- Depozitat e parave që nuk regjistrohen si xhiro/shitje.
- Hua nga jashtë të marra në para fizike dhe në valuta vendase.

2. Raporti i OECD-së, *Doracak i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit*

- Investime të mëdha në para fizike nga huadhënësi ose pronari i huaj.
- Transaksion rastësor i shumave të mëdha të parave (p.sh xhiro/shitje, fatura).
- Strukturimi i depozitave bankare: transaksione më të vogla për një periudhë të shkurtër kohe, për të shmangur raportimin (strukturimi).

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 1³

U zbulua se një grup i vogël personash që vepronin për llogari të grupeve të ndryshme kriminale, dërgonin në mënyrë sistematike nga Evropa Perëndimore drejt Evropës Lindore, rreth 2-3 herë në javë (250 – 300.000 euro për rrugë), para të gjeneruara nga veprimtari kriminale. Paratë fshiheshin në shasitë e automjeteve të përdorura për transport dhe kalonin nëpër disa vende të BE-së, për t'i larguar sa më shumë nga burimi.

U zbulua se njëri burim parash lidhej me importin e mallrave të falsifikuara ose nën standard të konsumit, me çmime shumë më të ulëta, që vinin nga Azia dhe rishiteshin në BE (ndonëse mendohet të jenë përfshirë edhe veprimtari të tjera). Kështu, biznesi kriminal kishte grumbulluar shuma të mëdha parash fizike që duheshin pastruar, si dhe transferuar shitësve në Azi.

Këta korrierë të parave fizike lehtësonin pastrimin e parave fizike duke depozituar shuma parash fizike në llogari bankare të hapura në emër të "shoqërive tregtare". U vërejt se një prej korrierëve kishte lidhje të rëndësishme me një bankë tregtare, çka ka gjasa të ketë lehtësuar hapjen e llogarive dhe depozitave bankare. Këto shuma u transferuan më pas në llogari bankare në Azi që në dukje u përkisnin shoqërive tregtare dhe lëvizjet justifikoheshin si të lidhura me marrëveshje ndërkombëtare tregtie dhe pagesa mallrash.

Vlerësohet se në këtë mënyrë, nëpërmjet pesë llogarive janë pastruar jo më pak se 100 milionë euro dhe 300 milionë dollarë. Për më tepër, u zbuluan të paktën 60 shoqëri të tjera, llogaritë bankare të të cilave menaxhoheshin nga korrierë që ushtronin veprimtarinë në Evropë.

Rasti 2⁴

Në vitin 2016, autoritetet gjermane të mbështetura nga ekspertë të EUROPOL-it morën masa kundër OVG-së Irakiane (me bazë në Gjermani) që dyshohej se ofronte shërbime PP-je për trafikantët ndërkombëtarë të heroinës. Operacioni u parapri nga hetime të gjera dhe komplekse dhe u mbështet nga EUROPOL-i, i cili bashkërendoi me autoritetet ligjzbatuese të Francës, Spanjës, Gjermanisë dhe Holandës, nën mbikëqyrjen e autoriteteve gjyqësore të EUROJUST-it.

Kjo sindikatë kriminale, e përbërë kryesisht prej shtetasve irakianë, ishte përgjegjëse për mbledhjen e produkteve nga shitja e heroinës në gjithë Evropë (Spanjë, Holandë, Itali dhe MB) dhe pastrimin e këtyre fondeve në Lindjen e Mesme nëpërmjet Gjermanisë, duke pastruar një shumë prej rreth 5 milionë euro gjithsej.

3. Marrë nga raporti i EUROPOL-it (2015) "Përse Paraja Fizike Mbretëron Ende?"

4. Marrë nga Raporti i FAFT-së *Pastrimi Profesional i Parave*

Mënyra e operimit të kriminelëve përfshinte përdorimin e korrierëve të parave fizike që udhëtonin me automjet për të mbledhur paratë e pista fizike nëpër Evropë. Më pas përdoshin teknika të pastrimit të parave nëpërmjet tregtisë për t'i dërguar paratë në Lindjen e Mesme, kryesisht duke përdorur mjete të përdorura, makineri të rënda dhe pajisje ndërtimi të blera në Gjermani dhe të eksportuara në Irak, ku mallrat rishiteshin në këmbim të parave të pastra.

Kështu, OCG-ja i përdorte shërbimet e PPNT-së dhe kanalet e parregulluara financiare (sistemi "hawala") për t'i integruar dhe transferuar më tej fondet në sistemin e ligjshëm financiar. Kjo mënyrë pune nuk linte gjurmë shkresore për hetim nga agjencitë ligjzbatuese.

Për ta vënë këtë skemë në funksion, nevojiteshin aftësitë dhe njohuritë e profesionistëve të ofrimit të shërbimit, si juristëve, kontabilistëve dhe profesionistëve të themelimit të shoqërive për zbatimin e procedurave financiare. Ndonëse këto shërbime ofrohen nga pak grupe, ato pastrojnë shuma të mëdha parash dhe ndikojnë ndjeshëm tek aftësia e OCG-ve të tjera për të fshehur dhe investuar produktet e veprimtarive kriminale. Këto sindikata janë pengesë e madhe për gjurmimin e pasurive kriminale.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- OECD (2019), Doracak i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- FATF dhe MENAFATF (2015), Pastrimi i Parave nëpërmjet Transportimit të Parave Fizike, FATF, Paris, Francë dhe MENAFATF, Manama, Bahrein. www.fatf-gafi.org/publications/methodsandtrends/documents/ml-through-physical-transportation-of-cash.html
- RAPORTI I EUROPOLIT (2015) *PËRSE PARAJA FIZIKE MBRETËRON ENDE?*
- FATF (2018), Pastrimi Profesional i Parave, FATF, Paris, Francë www.fatf-gafi.org/publications/methodsandtrends/documents/professional-money-laundering.html
- Raportet vjetore 2016, 2017 botuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>
- Europol (2023), Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin Financiar dhe Ekonomik Evropian 2023 - Ana tjetër e monedhës: Një analizë e krimit financiar dhe ekonomik, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, Luksemburg.

2.

Përdorimi i kriptomonedhave

Gjatë dy viteve të fundit, përdorimi i kriptomonedhave, sidomos Bitcoin-it (BTC) që është më i përdoruri prej tyre, ka pësuar rritje eksponenciale, që prej krijimit të tyre në vitin 2008.

Kjo teknologji krejtësisht novatore, që ka përfshirë një sërë konceptesh dhe aktorësh të rinj ekonomikë në transaksionet ekonomike, i ka bërë operacionet të aksesueshme nga persona që më parë nuk e kishin këtë mundsië. Karakteristikat e operacioneve me kriptomonedha përfshijnë një sërë avantazhesh dhe risqesh të cilat përdoruesit duhet t'i kenë kujdes dhe ato po bindin gjithnjë e më shumë përdorues t'i përdorin ato gjithnjë e më rregullisht dhe jo vetëm si formë eksperimentimi apo investimi.

Megjithatë, po këto karakteristika kanë bërë që kriptomonedhat të kthehen në mjete të zakonshme pagese në disa veprimtari të caktuara të paligjshme që lidhen me krimin kibernetik. Për më tepër, duke qenë se po përdoren dhe pranohen në mbarë globin, kriptomonedhat po "certifikohen" si mekanizma të rinj për pastrimin e përfitimeve të paligjshme nga veprimtari të tjera kriminale.

Rreziqet e përdorimit të aseteve kripto për qëllime të paligjshme mund të ndahen në tre grupe të gjera:

- Përdorimi i aseteve kripto për të paguar shërbimet kriminale.
- Përdorimi i aseteve kripto për pastrimin e fondeve me origjinë të paligjshme.
- Përdorimi i aseteve kripto si mekanizma mashtrimi.

Përdorimi i kriptomonedhave për pastrim parash bazohet tek anonimiteti, shpejtësia e operacioneve, derregullimi, natyra ndërkombëtare/ndërkufitare dhe pranimi gjithnjë e më tepër i tyre në rang botëror. Ndoshta, ajo që e ka frenuar deri tani përdorimin e këtyre monedhave ka qenë mungesa e njohurive për përdorimin dhe leverdinë e tyre, ndonëse këto pengesa janë kapërcyer tashmë.

Në këtë rast, një shumë e caktuar e parave reale, që do të ishin gjeneruar nga veprimtaria kriminale, transformohet në njëfarë mënyre në monedhë virtuale (kryesisht Bitcoin, Ethereum ose monedha të qëndrueshme si Tether, pasi duhet të merret parasysh pranueshmëria e tyre për fazat e mëvonshme të pastrimit të parave).

Rrjedhimisht, pas fazës së diversifikimit ose shtresëzimit, rifuten në ciklin real për të përfituar nga këto fonde të paligjshme.

Për më tepër, në disa raste është zbuluar se këto kriptomonedha (veçanërisht Tether) mund të përdoren për ta ruajtur vlerën në "portofola të ftohtë", duke mbrojtur kështu pasuritë e palës së hetuar nga konfiskimi.

Në këtë rast, organizata kriminale e përkushtuar për të kryer veprën penale mëmë, që gjeneron para të paligjshme mund ose të ketë strukturën dhe njohuritë e nevojshme për realizimin e vetëpastrimit të këtyre parave ose i blen këto shërbime nga një palë e tretë, që kontrollon strukturën e posaçme të pastrimit, duke marrë komision për shumën e pastruar. Kjo e fundit është gjithnjë e më e zakonshme sidomos në tipologjitë që kërkojnë njohuri më teknike.

Mund të përqendrohemi te rreziqet e pastrimit të parave për disa aktorë të përfshirë në botën e transaksioneve me kryptoasete:

Prodhimi

Rreziku i parë përqendrohet te roli i prodhuesve në strukturën e transaksioneve dhe krijimi i blloqeve në zinxhirin publik të blloqeve (blockchain). Në këtë rast, organizata që gjeneron fitime nëpërmjet veprimtarive kriminale, i përdor një pjesë të tyre për të blerë pajisje prodhimi (kompjuterë) për prodhimin e bitcoin-it ose monedhave të tjera, të cilat me t'u prodhuar mund t'i investojnë në çdo pasuri.

Aktualisht, për prodhimin e këtyre aseteve krypto kërkohet kapaciteti i madh kompjuterik, çka do të thotë se duhet të punojnë njëkohësisht disa kompjuterë prodhues, që nënkupton nga ana tjetër se nevojitet infrastrukturë e madhe për t'i vënë në punë si duhet në një vend me izolim akustik dhe të freskët, për instalimin masiv të këtyre pajisjeve kompjuterike. Kjo do të thotë se këto galeri prodhimi lidhen zakonisht me nivele të larta të konsumit energjetik, ose kemi të bëjmë me veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike.

Zyrat e Këmbimit

Zyrat e Këmbimit janë Ofruesit e shërbimit të aseteve virtuale që sillen si ndërmjetës në biznes duke i mundësuar klientëve të tyre t'i konvertojnë paratë reale në para virtuale dhe anasjelltas.

Tre janë rreziqet e lidhura me përdorimin e zyrave të këmbimit nga pikëpamja e pastrimit të parave: a) ndonëse janë subjekte të rregulluara, mund të përdoren nga organizatat për të futur në sistem fonde që i shmangen kontrolleve të NJKT(Njih Klientin Tënd) nëse nuk janë mjaftueshëm të fuqishme (përdorimi i identiteteve të rreme ose teknikave të strukturimit), b) shumë prej tyre operojnë nga vende të treta me legjislacion të ndryshëm dhe më pak të rreptë dhe mund të kontrollohen drejtpërdrejt nga organizata e pastrimit të parave.

Tregtarët vendas

Tregtarët janë persona që reklamojnë këmbimin e monedhave virtuale me valutë reale në shkëmbime individ me individ. Tregtari mund të përkufizohet si person që blen/shet BCT kundrejt parave) ose formave të tjera të pagesës si këmbime tregtare, duke e marrë vetë rrezikun përsipër.

Indicet që do t'i lidhnin këta tregtarë me operacionet e pastrimit të parave do të ishin këto:

- Këmben BTC kryesisht kundrejt parave.
- Komisione të larta këmbimi dhe çmime më të ulëta këmbimi se metodat e tjera të këmbimit (rreth 6-10%).
- Këmbimet ndodhin në vende të pazakonta, zakonisht në vende publike.
- Këmbime anonime (individ me individ), pa interes për origjinën e monedhës.

- Garanci për anonimitetin e këmbimeve monetare.
- Vënia e metodave më të sigurta dhe të lira alternative në dispozicion të klientit.

Bankomatet e Bitcoin-it

Bankomatet përdoren për të futur në sistem para fizike dhe për t'i transformuar ato në kriptomonedhën e zgjedhur (zakonisht BTC), që më pas dërgohet në portofolin e caktuar të përdoruesit që kryen transaksionin (dhe anasjelltas).

Këto bankomate instalohen zakonisht në qendra tregtare, dyqane të të gjitha llojeve të hapura për publikun, si restorante, dyqane kompjuterësh ose parukeri, të cilat u ofrojnë klientëve të tyre mundësinë e përdorimit të bankomateve të instaluara gjatë orarit të punës.

Nga pikëpamja e klientit, mënyra e përdorimit është mjaft e thjeshtë dhe mund të përmblihet në këto hapa:

- Zgjidhet kriptomonedha që do të blihet;
- Vendoset kodi QR i portofolit, në lexuesin e kodit QR të bankomatit.
- Depozitohen kartmonedhat;
- Merret konfirmim në portofol.

Këto bankomate vendosin disa kufij të caktuar për transaksionet dhe në disa raste të caktuara kërkohet skanimi i dokumentit të identitetit në pajisje.

Rreziqet që lidhen me këtë veprimtari mund të vërehen në tre nivele:

- Së pari, përdorimi i rrjetit të bankomateve për injektimin në sistem të fondeve me origjinë të paligjshme nëpërmjet teknikave të strukturimit.
- Niveli tjetër i rrezikut është instalimi i bankomateve në dyqane që nxisin transaksionet individuale me qëllim futjen në sistem të parave me origjinë të paligjshme.
- Niveli më i rrezikshëm është kur rrjeti i bankomateve kontrollohet drejtpërdrejt nga organizata kriminale, ku paratë me origjinë të paligjshme injektohen në sistemin financiar pa iu nënshtruar kontrollit kundër PP-së.

Ofruesit e shërbimeve dhe mallrave

Ky rrezik i referohet efektit të rritjes së pranueshmërisë së BTC-së në transaksionet tregtare botërore, ku bizneset po i pranojnë gjithnjë e më tepër pagesat me bitcoin dhe kriptomonedha të tjera për mallra dhe shërbime.



Kjo sjell rrezik të madh për pastrimin e fondeve me origjinë të paligjshme, pasi lehtëson fazën e fundit të pastrimit, që ka të bëjë pikërisht me integrimin e kapitalit të pastruar, për blerjen e aseteve që kriminelët mund t'i gëzojnë.

Blerja e drejtpërdrejtë me BTC nuk kërkon konvertim të BTC-së në monedhë fiat, gjë që eliminon pikat e kompromisit që mund të sjellin hapjen e hetimeve kundër organizatave kriminale.

Kriptokartat

Një tjetër mundësi për futjen e këtyre fondeve në sistem pasi janë konvertuar në BTC në fazat e para të pastrimit të parave (ose prodhuar direkt në kriptomonedha) është nëpërmjet përdorimit të kartave të kreditit me parapagim me bilance në BTC. Këto karta rimbushen praktikisht me BTC dhe paguhen aty për aty me para fiat.

Ato përdoren për pagesa në internet, ose pagesa fizike ndaj shitësve që nuk pranojnë pagesa në kriptomonedha, por vetëm pagesa me VISA ose MASTERCARD, apo për këmbimin e kriptomonedhave me para fiat nëpërmjet bankomateve të zakonshme të rrjeteve bankare që nuk i lejojnë tërheqjet me VISA ose MASTERCARD.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku janë marrë nga raporti i FATF-së⁵ dhe ndahen në gjashtë kategori kryesore:

Alarmet lidhur me Transaksionet

- Strukturimi i transaksioneve të Aseteve Virtuale (p.sh. këmbime ose transferta) në shuma të vogla, ose në shuma më të vogla se pragjet e regjistrimit ose raportimit, të ngjashme me strukturimin e transaksioneve në para fizike.
- Kryerja e disa transaksioneve të njëpasnjëshme në shuma të mëdha dhe brenda një periudhe të shkurtër kohe, apo me parregullsi ose rregullsi, ndjekur nga moskryerje transaksionesh për një periudhë të gjatë, ose kryerje transaksionesh në llogari të sapohapur ose në llogari që më parë nuk ka qenë aktive.
- Transferimi i menjëhershëm i PV-ve drejt disa OSHPV-ve, sidomos atyre të regjistruara ose që veprojnë në juridiksione ku klientët as nuk banojnë, as nuk punojnë, ose ku nuk ka ose ka legjislacion të dobët kundër PP-së/FT-së.
- Depozitimi i PV-ve në formë të këmbyer dhe më pas tërheqja e tyre pa veprimtari këmbimi në PV të tjera, që është hap i panevojshëm dhe sjell tarifim të transaksioneve, ose këmbimi i PV-ve në PV të ndryshme, sërish duke sjellë tarifim të transaksioneve, por pa shpjegim logjik nga pikëpamja e punës, ose tërheqja e menjëhershme e PV-ve nga OSHPV-të në portofol privat.
- Pranimi i fondeve që dyshohen se janë të vjedhura ose falsifikuara.

5. Raporti i FATF-së për *Treguesit e Dyshimtë të Pasurive Virtuale për Pastrim Parash dhe Financim Terrorizmi*.

Alarmet lidhur me prirjet e transaksioneve

- Depozitimi i një shume të madhe fillestare për të krijuar një marrëdhënie të re me një OSHAV të caktuar, kur shuma e depozituar nuk përputhet me profilin e klientit.
- Depozitimi i një shume të madhe fillestare për të krijuar një marrëdhënie të re me një OSHAV të caktuar dhe derdhja e të gjithë shumës në depozitë që ditën e parë të hapjes dhe klienti fillon ta këmbëjë të gjithë shumën ose një pjesë të saj po atë ditë ose disa ditë më pas, ose klienti e tërheq të gjithë shumën një ditë më pas.
- Përpjekjet e një përdoruesi të ri për të këmbyer ose tërhequr të gjithë bilancin e PV-ve dhe përpjekjet për ta nxjerrë bilancin jashtë platformës.
- Transaksionet që përfshijnë përdorimin e disa AV-ve ose llogarive njëherësh, pa shpjegim logjik nga pikëpamja e punës.
- Kryerja e transfertave të shpeshta brenda një periudhe të caktuar kohore në të njëjtën llogari AV-sh nga më shumë se një person, nga e njëjta adresë IP nga një ose më shumë persona, ose kryerja e transfertave në shuma të mëdha.
- Transfertat hyrëse nga shumë portofola që nuk lidhen me njëri-tjetrin në shuma relativisht të vogla (akumulimi i fondeve), ndjekur nga transfertat në një portofol tjetër ose këmbime të plota me para fiat.
- Këmbime AV-sh në para fiat edhe kur mund të ketë humbje.
- Konvertimi i shumave të mëdha fiat në AV, ose i një shume të madhe AV-je të caktuar në disa lloje të tjera AV-sh, pa pasur një shpjegim të logjikshëm nga pikëpamja e punës.

Alarmet lidhur me Anonimitetin

- Transaksione nga klientë në më tepër se një lloj AV-je, pavarësisht tarifave shtesë të transaksionit, veçanërisht ato AV që ofrojnë nivele më të larta anonimiteti.
- Lëvizja e AV-ve që qarkullojnë në blockchain publik dhe transparent, si bitcoin, drejt shërbimeve të centralizuara të këmbimit dhe më pas këmbimi i tyre i menjëhershëm me monedhë private.
- Klientët që operojnë si OSHAV të paregjistruar/palicensuar në faqet e internetit për këmbime individ me individ dhe që tarifojnë më shumë se shërbimet e tjera të këmbimit.
- Transaksione të pazakonta (në nivel dhe vëllim) të AV-ve të kthyera në para fizike falë këmbimeve në platformat e këmbimeve individ me individ në portofolat përkatës, pa shpjegim logjik nga pikëpamja e punës.
- AV-të e transferuara në ose nga portofolat që tregojnë tendencat e mëparshme të veprimtarisë që lidhen me përdorimin e OSHAV-ve të cilat ofrojnë shërbime përzjerje ose kombinimi, apo platforma të këmbimeve individ me individ.
- Transaksionet që përdorin shërbime përzjerje dhe kombinimi
- Fondet e depozituara ose tërhequra nga adresa ose portofola VP-sh me lidhje ekspozuese të drejtpërejta ose të tërthorta me burime të dyshimta të njohura, përfshi tregjet në darknet, shërbimet e përzjerjes/kombinimit, faqe të dyshimta ku luhen lojëra fati, veprimtari të paligjshme (p.sh ransomware) dhe/ose raportime vjedhesh.
- Përdorimi i hardware-ve të decentralizuar/pa hostuar ose i portofolave të letrës për t'i transportuar AV-të përtej kufijve.
- Përdoruesit që hyjnë në platformën e OSHAV-ve të cilët i kanë regjistruar emrat e tyre në domain-et e internetit nëpërmjet përfaqësuesve (proxy) ose duke përdorur regjistruarit e emrit të domain-it (RED) që fshehin ose censurojnë pronarët e emrave të domain-eve.
- Përdoruesit që hyjnë në platformën OSHAV-ve të cilët përdorin adresë IP-je që lidhet me darknetin ose me programe kompjuterike të ngjashme që mundësojnë komunikim anonim, përfshi emaile dhe RRVP. Transaksionet midis partnerëve duke përdorur mjete komunikimi anonime dhe të koduara (p.sh forume, chat-e, aplikacione telefonike, lojëra në internet, etj.) në vend të një OSHAV-je.

- Numër i madh portofolash AV nga e njëjta adresë IP që duket se nuk lidhen me njëri-tjetrin.
- Marrja ose dërgimi i fondeve OSHAV-ve, proceset NJKT të të cilëve janë të dobëta ose joekzistuese.
- Përdorimi i bankomateve të AV-ve pavarësisht tarifave të larta të transaksioneve, përfshi ato që përdoren zakonisht nga transportuesit e parave ose viktimat e mashtrimeve, apo në vendndodhje me rrezik të lartë, ku mund të ndodhin më tepër veprimtari kriminale.

Alarmet rreth Dërguesit dhe Marrësit

- Gjurmimi i parregullsive gjatë hapjes së llogarisë, si p.sh hapja e llogarive të veçanta në emra të ndryshëm për të shmangur kufizimet që vendosin OSHAV-të lidhur me këmbimet ose tërheqjet; transaksionet e nisura nga adresa IP-je jo të besueshme; përpjekja e përsëritur për të hapur llogari me të njëjtin OShAV nga e njëjta adresë IP-je, ose lidhur me tregtarët/përdoruesit e korporatave, regjistrimet e domain-it të internetit të të cilëve janë bërë në juridiksion tjetër nga ai i banimit dhe operimit ose në juridiksion me procese të dobëta për regjistrimin e domain-it.
- Gjurmimi i parregullsive të vërejtura gjatë procesit të Kujdesit të Duhur ndaj Klientit (KDK), si p.sh informacion i paplotë ose i pamjaftueshëm i marrë nga klienti në kuadër të NJKT-së ; dhënia e informacionit të pasaktë rreth transaksionit, burimit të fondeve, apo marrëdhënies me palën tjetër nga dërguesi apo marrësi; ose klienti ka vënë në dispozicion dokumente të falsifikuara si pjesë e procesit të KDK-së.
- Klienti jep të dhëna identifikimi ose llogarie (p.sh. adresë IP-je jostandarde, ose flash cookies) të cilat mbahen edhe nga një llogari tjetër.
- Ka mospërputhje midis adresave të IP-së që lidhen me profilin e klientit dhe adresave të IP-së nga të cilat po kryhen transaksionet.
- Adresa e AV-ve të klientit shfaqet në forume publike që lidhen me veprimtarinë e paligjshme.
- Klienti njihet nga organet e zbatimit të ligjit nëpërmjet informacionit të disponueshëm publikisht për shkak të veprimtarisë së mëparshme kriminale.
- Profili i klientit përkon me atë të "transportuesit të parave" ose viktimës së mashtrimit, sepse dërguesi duket se nuk e njeh teknologjinë e AV-së ose zgjidhjet online lidhur me portofolin në kujdestari, ose klienti është më i madh se mosha mesatare e përdoruesve të platformës, duket se është në situatë të paqëndrueshme financiare, ose blen shuma të mëdha AV-sh që nuk justifikohen nga pasuria aktuale, apo nuk janë në përputhje me profilin e tij/saj historik financiar.
- Sjellje të tjera të pazakonta që gjurmohen, si p.sh klienti ndryshon vazhdimisht identitetin, përpiqet të hyjë në një prej ose disa OSHAV nga adresa të ndryshme IP-je disa herë brenda ditës, përdor gjuhën që përdoret në fushën e komunikimeve lidhur me AV-të që tregon se transaksioni po kryhet në kushtet e veprimtarisë së paligjshme, ose kryen transaksione të përsëritura me një grup individësh me fitime ose humbje të konsiderueshme.

Alarmet lidhur me Burimin e Fondeve ose Pasurisë

- Transaksionet me adresat AV ose kartat bankare kanë lidhje me rastet e ditura të mashtrimit, zhvatjes, skemave "ransomware", adresa të sanksionuara, tregje darkent-i ose faqe të tjera interneti të paligjshme.
- Transaksionet AV me origjinë ose të destinuara për shërbimet online të lojërave të fatit.
- Përdorimi i një ose disa kartave të kreditit dhe/ose debitit që lidhen me portofolin e AV-ve për të tërhequr shuma të mëdha të monedhës fiat (nga krypto në kartë), ose fondet për blerjen e AV-ve merren nga depozita në para fizike që përdoret për mbushjen e kartave të kreditit.
- Depozitat në një llogari ose adresë AV-je mbajnë shuma ndjeshëm më të larta se ato të zakonshmet dhe me burim të paidentifikuar fondesh, ndjekur nga konvertimi në monedhë fiat.

- Mungesa e transparencës ose informacioneve të mjaftueshme për origjinën dhe pronarët e fondeve.
- Fondet e klientit merren drejtpërsëdrejti nga shërbimet e përzjerjes ose kombinuesit e portofolave që veprojnë si palë e tretë.
- Pjesa më e madhe e pasurisë së klientit buron nga investimet në AV, OFM (Ofertat Fillestare të Monedhës), ose IFM mashtroese etj.
- Pasuria e klientit buron në mënyrë shpërpjesëtimore nga AV-të që e kanë origjinën nga OSHAV që u mungojnë kontrollet kundër PP-së/FT-së.

Alarmet lidhur me Rreziqet Gjeografike

- Fondet e klientit burojnë ose i dërgohen një platforme këmbimi që nuk është e regjistruar në juridiksionin ku banon klienti ose do të kryhet këmbimi.
- Klienti përdor një platformë për këmbimin e PV-ve ose një SHTPV që ndodhet jashtë shtetit, në një juridiksion ku nuk ka legjislacion ose ku legjislacioni kundër PP-së/FT-së është i dobët, përfshi këtu edhe masat për KDK-në apo NJKT-në.
- Klienti i dërgon fondet në OSHPV që veprojnë në juridiksione ku nuk ka legjislacion për PP, ose nuk ndërmarrin kontrolle kundër PP-së/FT-së.
- Klienti i krijon ose i zhvendos zyrat në juridiksione që nuk kanë ose nuk zbatojnë legjislacion për PV-të, ose krijon zyra të reja në juridiksione, kur nuk ka arsye të qartë pune.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 3⁶

Në maj të vitit 2013, Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së akuzoi Liberty Reserve, një transmetues parash me bazë në Kosta Rika, dhe shtatë drejtorë e punonjës për veprimtari të peregjistruar të transmetimit dhe pastrimit të parave nëpërmjet të cilave lehtësuan qarkullimin e një shume të paligjshme prej 6 miliardë dollarësh amerikanë. Me aksion të koordinuar, Departamenti i Thesarit e identifikoi Liberty Reserve si institucion financiar që përbënte shqetësim parësor për pastrim parash, sipas Seksionit 311 të Aktit Patriot, duke e nxjerrë efektisht nga sistemi financiar i SHBA-së.

Krijuar në vitin 2006, Liberty Reserve u projektua për të shmangur kontrollin nga organet rregullatore dhe ligjzbatuese, si dhe për t'i ndihmuar kriminelët të grumbullojnë dhe pastrojnë produktet nga mashtimet me kartat e kreditit, vjedhja e identitetit, mashtimi me investimet, hakerimi i rrjeteve kompjuterike, trafiku i lëndëve narkotike dhe pornografia me fëmijët, dhe për t'u mundësuar kryerjen e transaksioneve anonime financiare të pagjurmueshme. Meqenëse e ushtronte veprimtarinë në shkallë të gjerë, kishte mbi një milion përdorues në mbarë botën, ku vetëm në Shtetet e Bashkuara ishin më shumë se 200 000, dhe kishte kryer afërsisht 55 milionë transaksione, thuajse të gjitha të paligjshme. Liberty Dollars (LR) kishte krijuar monedhën e vet virtuale, por në fund, transfertat përcaktoheshin dhe ruheshin në monedhë fiat (dollarë amerikanë).

Për të përdorur monedhën e LR-së, përdoruesi duhet të hapte llogari nëpërmjet faqes së internetit Liberty Reserve. Liberty Reserve dukej se i kërkonte informacionet bazë të identitetit të klientëve, por nuk i verifikonte ato. Përdoruesit krijojnë llogari me emra të rremë, përfshi emra kriminalë

6. Marrë nga raporti i FATF-së *Përkufizimet Kyç të Monedhave Virtuale dhe Rreziqet e Mundshme për PP/FT*.

("Hakerat e Rusisë", "Llogaria e Hakerave", "Joe Bogus") dhe adresa dukshëm të rreme ("123 Rruga Kryesore e Rremë, Qyteti Kryekëput i Sajuar, Nju Jork"). Për t'i shtuar anonimitetit edhe një shtresë tjetër, Liberty Reserve u kërkoi përdoruesve që të hapnin depozita dhe të bënin tërheqje nëpërmjet platformave të këmbimit që vepronin si palë të treta, zakonisht biznese të palicensuara parash që operonin në Rusi dhe në disa vende të tjera të cilat në atë kohë nuk e mbikëqyrnin, ose nuk e rregullonin sa duhej pastrimin e parave, si Malajzia, Nigeria dhe Vietnam. Duke shmangur depozitat dhe tërheqjet e drejtpërdrejta nga përdoruesit, Liberty Reserve anashkaloi mbledhjen e informacionit rreth tyre, që do të krijonte gjurmën shkresore nëpërmjet transaksioneve bankare ose veprimtarive të tjera. Me të hapur llogarinë, përdoruesi mund të kryente transaksione me përdorues të tjerë të Liberty Reserve duke transferuar LR nga llogaria e tij në llogaritë e përdoruesve të tjerë, përfshi edhe shoqëri "tregtare" fasadë që pranonin pagesa në LR. Përdoruesit mund t'i fshihnin numrat e llogarisë në Liberty Reserve gjatë transferimit të fondeve kundrejt një "tarife privatësie" shtesë, duke i bërë kërkesat krejtësisht të pagjurmueshme. Pasi mësoi se po hetohej nga organet ligjzbatuese të SHBA-së, Liberty Reserve pretendoi se e kishte mbyllur veprimtarinë në Kosta Rika, por vijoi të operonte nëpërmjet një sërë shoqëriësh guaskë, duke qarkulluar me miliona nëpërmjet llogarive në Australi, Qipro, Kinë, Hong Kong, Rusi, Spanjë dhe vende të tjera.

Rasti 4⁷

Prania e alarmeve të mëposhtme nxiti një IF (bankë) t'i dërgonte autoriteteve një RTD, duke sjellë kështu hapjen e një hetimi për PP:

- transaksione jokonsistente me profilin e titullarit të llogarisë - gjatë dy ditëve të para pasi një i ri kishte hapur llogari personale, ishin depozituar shuma të mëdha me natyrë tregtare nga persona të ndryshëm juridikë;
- modeli i transaksioneve - fondet e depozituara u transferuan menjëherë në llogaritë e disa OSHPV-ve (brenda një dite) për të blerë PV (bitcoin);
- profili i klientëve - një prej palëve porositëse njihej nga banka si subjekt në një rast mashtrimi. Banka u kishte dhënë autoriteteve edhe adresat e IP-së të përdorura për shërbimet bankare në internet.

Sipas një hetimi, titullari i llogarisë personale, dukej se ishte transportues parash i rekrutuar nga kriminelët në platformën e një medieje sociale për të ndihmuar në marrjen e pagesave nga shitjet e pretenduara të mallrave në internet. Në të vërtetë, këto fonde ishin depozituar nga shoqëri të tjera viktime dhe nuk ishin pagesa për mallra. Fondet e depozituara ishin transferuar menjëherë në disa pagesa të ndara nga llogaria bankare personale kundrejt një llogarie tjetër të një shoqërie aksionare në Republikën Çeke dhe ishin mbajtur në PV (bitcoin) në disa OSHPV vendore. Këto OSHPV ishin tërhequr më pas menjëherë nga llogaria. Krahas dërgimit të RTD-së, banka kishte pezulluar edhe transfertat e dyshimta dhe sekuestruar fondet e mundshme.

OSHPV-të vendore kishin vënë re parregullsi lidhur me fondet e marra dhe kishin ofruar informacione të dobishme në ndihmë të hetimit. Ky informacion përfshinte: rrethanat se kur ishin blerë PV-të; transaksionet dhe informacione të tjera rreth KDK-së si adresa e portofolit, kopja e dokumentit të identitetit të keqpërdorur për blerje dhe emri i blerësit të supozuar. Të gjitha sa më lart i nxitën autoritetet të kërkonin informacion shtesë nga bankat (p.sh. pasqyrat financiare).

7. Raporti i FATF-së për *Treguesit e Dyshimtë të Pasurive Virtuale për Pastrim Parash dhe Financim Terrorizmi*.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- FATF (2021), Shqyrtimi i Dytë Vjetor i Pasurive Virtuale dhe OShPV-ve, FATF, Paris, Francë, www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/second-12-month-review-virtual-assets-vasps.html
- FATF (2023), Përditësimi i synuar mbi Implementimin e Standardeve të FATF për Asetet Virtuale/VASP, FATF, Paris, Francë. <https://www.fatf-gafi.org/content/fatf-gafi/en/publications/Fatfrecommendations/targeted-update-virtualassets-vasps-2023.html>
- FATF (2021), Udhëzimi i përditësuar për Qasjen e Bazuar në Rrezik të Pasurive Virtuale dhe Ofruesve të Shërbimit të Pasurive Virtuale, FATF, Paris, www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/Updated-Guidance-RBA-VA-VASP.html
- FATF (2020), Treguesit e Dyshimtë për Pastrim Parash dhe Financim Terrorizmi lidhur me Pasuritë Virtuale, FATF, Paris, Francë. www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/Virtual-Assets-Red-Flag-Indicators.html
- FATF (2020), Raporti i FATF-së për G20-n, FATF, Francë, www.fatf-gafi.org/publications/virtualassets/documents/report-g20-so-called-stablecoins-june-2020.html
- FATF (qershor 2014) Përkufizimet Kyç të Monedhave Virtuale dhe Rreziqet e Mundshme për PP/FT, FATF, Paris, Francë.
- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- EUROPOL SPOTLIGHT – KRIPTOMONEDHAT: GJURMIMI I EVOLUCIONIT TË FINANCAVE KRIMINALE.

3.

Përdorimi i sektorit bankar

Sektori bankar përdoret gjerësisht për qëllime të ligjshme dhe luan rol thelbësor në ekonominë moderne. Megjithatë, kriminelët përfitojnë nga përfitimet që ofron sistemi bankar dhe i keqpërdorin ato. Përdorimi i sistemit bankar për pastrim parash ka dy objektiva të drejtpërdrejta:

- Qarkullimin e fondeve.
- Injektimin fillestar të tyre.

Në sistemin bankar, transfertat elektronike janë metoda më e përdorur për kanalizimin e fondeve dhe përdoren gjerësisht në fazën e fshehjes së pastrimit të parave për shkak të shpejtësisë, sigurisë dhe kostos së ulët.

Ndonjëherë, transaksionet komplekse përfshijnë shumë transfertat bankare midis pjesëmarrësve në transaksion, të cilat duken të panevojshme dhe kushtojnë shumë më tepër se transaksionet e zakonshme të nevojshme për arritjen e të njëjtit objektivi ose rezultat. Këto transaksione përdoren për të fshehur produktet e paligjshme që kanë hyrë më parë në sistemin financiar.

Përdorimi i sistemeve financiare ndërkombëtare ka qenë thelbësor për lehtësimin e skemave të mëdha të pastrimit të parave. Të gjitha skemat me shtresëzim kompleks përfshijnë zakonisht qarkullimin e fondeve në shumta të mëdha nëpërmjet disa llogarish bankare, në juridiksione të ndryshme, të hapura në emër të shoqërive guaskë. Këto skema të mirëstrukturuara nuk para vihen re nga bankat, edhe kur përfshihet një i brendshëm.

Organet hetuese kanë arritur t'i dallojnë modelet duke u nisur nga zgjedhja e disa juridiksioneve dhe bankave të caktuara për qarkullimin e produkteve të paligjshme nga pastruesit e parave. Për shembull, disa kriminelë rreken të përdorin banka që operojnë në mjedise rregullatore të shkujdesura ose që njihen për mospërbushje të rregulloreve kundër PP-së/FT-së.

Të brendshmit në banka zakonisht nuk e raportojnë hapur veprimtarinë e tyre kriminale dhe mund të përfitojnë nga statusi i të brendshmit për të fshehur veprimtarinë e tyre të parregullta. Kjo mund ta vështirësojë gjurmimin dhe ndjekjen penale të sjelljes kriminale nga profesionistët bashkëpunëtorë të shërbimeve financiare. Disa punonjës të institucioneve financiare (nga punonjësit e kasës deri te niveli i lartë drejtues) shfaqin më tepër vulnerabilitet se të tjerët, gjë që mund të përdoret nga pastruesit e parave, por edhe punonjësit e nivelit të lartë, që ndihmojnë me vetëdije në pastrimin e parave, dhe mund të shkaktojnë dëme të mëtejshme.

Punonjësit bankarë bashkëpunëtorë mund të kryejnë funksione si:

- Të hartojnë çeqe të falsifikuara;
- Të monitorojnë (ose të mos monitorojnë si duhet) flukset e parave midis llogarive të kontrolluara nga bashkëkomplotistët;
- Të koordinojnë transaksionet financiare për të shmangur RTD-në;
- Të pranojnë dokumentet të rreme që u japin klientët si bazë për transaksione, pa bërë pyetje shtesë; dhe
- Të kryejnë “transaksione virtuale” në llogaritë e klientëve të tyre - kryhen disa transaksione pa ndryshim thelbësor të bilancit neto në fillim dhe në fund të ditës së punës.

Këshilltarët e bankave private mund të jenë pastrues profesionistë parash dhe të ofrojnë shërbime për të fshehur natyrën, burimin, pronësinë dhe kontrollin e fondeve me qëllim mbulimin e kontrollit real mbi to, duke përdorur teknika të ndryshme, përfshirë:

- Transferimin e parave drejt dhe nga llogari bankare në emër të personave ose subjekteve offshore, të cilët nuk janë pronarët përfitues të llogarive;
- Dhënien e deklaratave të rreme në dokumentet bankare që banka i kërkon për identifikimin e klientëve dhe zbulimin e pronarëve të vërtetë përfitues të llogarive;
- Krijimin në dukje të ligjshmërisë së transfertave elektronike duke përdorur marrëveshjet e “shërbimeve të konsulencës” ose kontrata të tjera të ngjashme;
- Mbajtjen dhe përdorimin e disa llogarive në të njëjtën bankë, në mënyrë që transferimet e fondeve midis këtyre llogarive të bëhen së brendshmi, pa iu drejtuar mekanizmave ndërkombëtarë të kontrollit, që janë më të identifikueshme nga organet ligjzbatuese;
- Hapjen e disa llogarive bankare në emër të shoqërive me emra të ngjashëm në institucione të njëjta ose të ndryshme, në mënyrë që të mos duket se transfertat janë bërë nga palë të treta.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta janë faktorë të ndryshëm rreziku që përfshihen në raportin e ABE-s⁸ në varësi të veprimtarive të ndryshme bankare (veprimtari bankare korrespondente, veprimtari bankare me klientë individë, biznesi i menaxhimit të pasurive, veprimtari bankare për financimin e tregtisë, veprimtari bankare për investime ose financa të korporatave). Këta faktorë ndahen në katër grupe të mëdha: faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit; faktorë të rrezikut të klientit; faktorë të rrezikut të vendit ose gjeografikë; dhe faktorë të rrezikut të kanalit të shpërndarjes.

Veprimtaria me bankat korrespondente

Faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit

- Llogaria mund të përdoret nga bankat e tjera respondente që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me respondetin, por jo me korrespondentin (“folezimi” ose “pastrimi nga lart-poshtë”), gjë që do të thotë se korrespondeti përfshihet tërthorazi në ofrimin e shërbimeve për banka të tjera që nuk janë respondente.

8. RAPORTI I ABE-s EBA/GL/2021/2 - RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR UDHËZIMET MBI KUJDESIN E DUHUR TË KLIENTIT DHE FAKTORËT QË INSTITUCIONET KREDITORE DHE FINANCAIRE DUHET TË MARRIN PARASYSH GJATË VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË DYFISHTË PP/FT LIDHUR ME MARRËDHËNIET INDIVIDUALE TË BIZNESIT DHE TRANSAKSIONE RASTËSORE.

- Llogaria mund të përdoret nga subjekte të tjera brenda grupit të respondentëve që nuk u janë nënshtruar kujdesit të duhur të korrespondentit.
- Shërbimi përfshin hapjen e një llogarie vetëm për pagesa, që i lejon klientët e respondentit të kryejnë transaksione drejtpërsëdrejti në llogarinë e respondentit.

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Politikat e respondentit kundër PP-së/FT-së dhe sistemet dhe kontrollet që respondentit përdor për zbatimin e tyre nuk i arrijnë standardet e kërkuara nga Direktiva e BE-së 2015/849 (BE).
- Respondenti nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes së duhur kundër PP-së/FT-së.
- Respondenti, banka mëmë ose firma që i përket të njëjtit grup me respondentin u janë nënshtruar kohët e fundit ekzekutimit ligjor për politika dhe/ose procedura të papërshtatshme kundër PP-së/FT-së dhe/ose shkelje të detyrimeve kundër PP-së/FT-së.
- Respondenti bën biznes në sektorë ku ka nivele më të larta rreziku për PP/FT, për shembull respondentit kryen veprimtari të konsiderueshme tregtare me remitancat, ose kryen veprimtari në emër të dërguesve të caktuar të remitancave ose pikave të këmbimit, të cilat nuk ndodhen në vendin e respondentit ose përdorin valutë të ndryshme nga ajo e vendit ku ndodhen.
- Drejtuesit ose pronarët e respondentit përfshijnë PEP (Personat e Ekspozuar Politikisht), sidomos PEP-ë që mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse te respondentit, ku reputacioni, integriteti dhe qëndrueshmëria e PEP-it si anëtar i bordit drejtues, ose si titullar i një pozicioni kyç, mund të përbëjë shqetësim, ose PEP-ë nga juridiksione me rrezik më të lartë për PP/FT. Firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre juridiksioneve ku korrupsioni perceptohet si sistemik ose i gjithëpërhapur.
- Historia e marrëdhënies së biznesit me respondentin përbën shqetësim, për shembull shuma e transaksioneve nuk është në përputhje me shumën që pret korrespondenti, bazuar te njohuritë që ka për natyrën dhe madhësinë e respondentit.
- Refuzimi i respondentit për të ofruar informacionin e kërkuar nga korrespondenti për qëllimet e KDK-së dhe Kujdesit të Duhur të Shtuar (KDSH) dhe informacionin për pagesin dhe të paguarin që kërkohet sipas Rregullores 2015/847 (BE). Për këtë qëllim, korrespondenti duhet të marrë në konsideratë kriteret sasiore dhe cilësore të përcaktuara në Udhëzimet e Përbashkëta JC/GL/20.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografikë

- Respondenti e ka bazën në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë. Firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë këtyre juridiksioneve:
 - juridiksioneve të identifikuar si vende të treta me rrezik të lartë sipas Nenit 9(2) të Direktivës 2015/849 (BE);
 - juridiksioneve me nivele të larta korrupsioni dhe/ose vepra penale mëmë që lidhen me pastrimin e parave;
 - juridiksioneve pa kapacitetin e duhur juridik dhe sistem gjyqësor joefikas për ndjekjen penale të këtyre veprave penale;
 - juridiksioneve me nivele të larta të veprimtarive të financimit të terrorizmit ose veprimtarive terroriste;
 - juridiksioneve pa mbikëqyrje efikase kundër PP-së/FT-së.
- Respondenti kryen biznes me klientë që ndodhen në juridiksione ku rreziku për PP/FT është më i lartë.
- Banka mëmë e bankës respondente e ka selinë ose është themeluar në juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë.

Veprimtaria bankare me klientë individë

Faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit

- Veçoritë e produktit favorizojnë anonimitetin;
- Produkti lejon pagesa nga palë të treta që as nuk lidhen me produktin as nuk identifikohen paraprakisht dhe këto pagesa nuk priten, për shembull pagesa hipoteke ose huaje;
- Produkti nuk përcakton kufizime për xhiron, transaksionet ndërkufitare ose veçori të tjera të ngjashme;
- Produkti i ri dhe praktikat e reja të biznesit përfshijnë mekanizma të rinj dërgesash dhe përdorimin e teknologjive të reja dhe në zhvillim e sipër, si për produktet e reja, ashtu edhe për ato ekzistuese, kur këto të fundit nuk kuptohen ende mirë;
- Huadhënia (përfshi hipotekat) e siguruar kundrejt vlerës së pasurive në juridiksione të tjera, veçanërisht në vende ku është e vështirë të verifikohet nëse klienti ka titull të ligjshëm për kolateralin, ose ku është e vështirë të verifikohen identitetet e palëve që garantojnë huanë;
- Volum i lartë ose vlerë e lartë e pazakontë transaksionesh.

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Natyra e klientit, për shembull:
 - Klienti është sipërmarrje që xhiron shumë para fizike (fiat).
 - Klienti është sipërmarrje që lidhet me rrezik më të lartë për pastrim parash, për shembull, disa shërbime për dërgimin e remitancave dhe biznese të lojërave të fatit.
 - Klienti është sipërmarrje që lidhet me rrezik më të lartë korrupsioni, për shembull e ushtron veprimtarinë e vet në industrinë nxjerrëse ose në tregtinë e armëve.
 - Klienti është organizatë jofitimprurëse që mbështet juridiksione ku ka rrezik më të lartë FT-je.
 - Klienti është sipërmarrje e re pa profil ose historik të qartë biznesi.
 - Klienti nuk e ka selinë në vendin ku operon. Bankat duhet të vërejnë se Neni 16 i Direktivës 2014/92/BE u jep të drejtë konsumatorëve që janë banorë të ligjshëm të Bashkimit Evropian të hapin llogari bankare të thjeshtë, ndonëse e drejta për të hapur dhe përdorur llogari të thjeshtë për pagesa zbatohet vetëm për sa kohë që bankat mund t'i përmbushin detyrimet e tyre kundër PP-së/FT-së dhe nuk i përjashton bankat nga detyrimi i tyre për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun e PP-së/FT-së, përfshirë rrezikun që lidhet me klientin që nuk është banor i Vendit Anëtar ku banka ka selinë.
 - Pronari përfitues i klientit nuk mund të identifikohet lehtë, për shembull sepse struktura e pronësisë së klientit është e pazakontë, e ndërlikuar ose e paqartë, ose sepse klienti u jep titullarëve aksione.
- Sjellja e klientit, për shembull:
 - Klienti ngurron të japë informacione për KDK-në ose duket se shmang qëllimisht kontaktin ballë për ballë.
 - Dokumentet e identitetit të klientit nuk janë në formatin standard dhe nuk ka arsye të qartë për këtë.
 - Sjellja e klientit ose volumi i transaksioneve nuk është në përputhje me atë që pritet nga kategoria e klientit të cilës i përkasin, ose nuk pritet bazuar në informacionin që klienti ka dhënë në momentin e hapjes së llogarisë.
 - Sjellja e klientit është e pazakontë, për shembull klienti ka përsheptuar kalendarin e shlyerjes së kësteve në mënyrë të beftë dhe pa shpjegim të arsyeshëm nëpërmjet shlyerjes me një këst të vetëm, ose nëpërmjet zgjidhjes së parakohshme; depoziton ose kërkon tërheqje me prerje të mëdha pa arsye të dukshme; rrit veprimtarinë pas një periudhe pasive; ose kryen transaksione që duket se nuk kanë arsyetim ekonomik.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- Fondet e klientit rrjedhin nga lidhje personale ose biznesi me juridiksione ku rreziku për PP/FT është më i lartë.
- I paguari ndodhet në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë. Firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve që dihet se ofrojnë financime ose mbështetje për aktet terroriste, ose ku dihet se veprojnë grupe që kryejnë vepra penale terroriste, dhe juridiksioneve që u nënshtrohen sanksioneve financiare, embargove ose masave kundër financimit të terrorizmit, terrorizmit ose përhapjes së armëve.

Faktorët e rrezikut të kanalit të shpërndarjes

- Marrëdhëniet e biznesit në distancë pa garanci të mjaftueshme shtesë, si për shembull nënshkrim elektronik, mjete të identifikimit elektronik në përputhje me Rregulloren 910/2014 BE dhe kontrolle kundër mashtrimeve nëpërmjet identitetit të rremë;
- Mbështetja te masat e një pale të tretë për KDK-në në situata ku banka nuk ka marrëdhënie afatgjatë me palën e tretë referuese;
- Kanale të reja dërgimi që nuk janë verifikuar ende.

Bizneset e administrimit të pasurisë**Faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit**

- Klientë që kërkojnë shuma të mëdha parash fizike ose sende me vlerë si metale të çmuara;
- Transaksione të shumave tepër të larta;
- Marrëveshje financiare në juridiksione ku rreziku për PP/FT është më i lartë (firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë vendeve që kanë si kulturë fshehtësinë bankare, ose që nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare të transparencës tatimore);
- Huadhënia (përfshi hipotekat) e siguruar kundrejt vlerës së pasurive në juridiksione të tjera, veçanërisht në vende ku është e vështirë të verifikohet nëse klienti ka titull të ligjshëm për kolateralin, ose ku është e vështirë të verifikohen identitetet e palëve që garantojnë huanë;
- Përdorimi i strukturave komplekse të biznesit si trustet dhe mjetet e investimeve private, sidomos kur identiteti i pronarit përfitues fundor mund të jetë i paqartë;
- Biznesi zhvillohet në disa vendndodhje, veçanërisht kur përfshihen disa ofrues të shërbimeve financiare;
- Marrëveshjet ndërkufitare ku pasuritë e depozituara apo menaxhuara në një tjetër institucion financiar, ose i të njëjtit grup financiar, ose jashtë grupit, veçanërisht kur institucioni tjetër financiar e ka bazën në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë. Firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve ku niveli i veprave penale mëmë është më i lartë, si dhe kur regjimi kundër PP-së/FT-së ose standardet e transparencës tatimore janë më të dobëta.

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Klientët me të ardhura dhe/ose pasuri nga sektorë me rrezik të lartë si tregtia e armëve, industria nxjerrëse, ndërtimi, lojërat e fatit ose shoqëritë ushtarake private.
- Klientët për të cilët ka akuza të besueshme se kanë kryer shkelje.
- Klientët që kërkojnë nivele të larta të pazakonta konfidencialiteti ose fshehtësie.
- Klientët, sjellja shpenzuese ose transaksionale e të cilëve e vështirëson krijimin e modeleve "normale" ose të pritshme të sjelljes.
- Klientë shumë të pasur dhe me ndikim, përfshi klientë me profil tepër të lartë publik, klientë jorezidentë dhe PEP. Kur klienti, ose pronari përfitues i një klienti është PEP, firmat duhet të zbatojnë gjithmonë KDP-në, në përputhje me Nenet 18-22 të Direktivës 2015/849 (BE).

- Klienti kërkon që firma ta lehtësojë atë duke ia ofruar produktin ose shërbimin nëpërmjet një pale të tretë, pa arsye të qartë biznesi apo ekonomike.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- Biznesi zhvillohet në vende që praktikojnë fshehtësinë bankare ose nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare të transparencës tatimore.
- Klienti jeton ose klientit i burojnë fondet nga veprimtaria në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë.

Veprimtaria bankare për financimin e tregtisë

Faktorët e rrezikut të transaksionit

- Shuma e transaksionit është jashtëzakonisht e lartë, duke marrë parasysh linjën e mëparshme të biznesit dhe veprimtarinë tregtare të klientit.
- Transaksioni është tepër i strukturuar, fragmentuar ose kompleks, përfshin disa palë dhe nuk ka arsytim të dukshëm të ligjshëm.
- Përdoren kopje të dokumenteve në situata kur pritet të përdoren origjinalët, pa shpjegim të arsyeshëm.
- Ka mospërputhje të mëdha në dokumentacion, për shembull midis përshkrimit të llojit, sasisë ose cilësisë së mallrave në dokumente kyç (p.sh. fatura, dokumente sigurimi dhe transporti) dhe mallrave faktike të shitura, kur ky informacion është i disponueshëm.
- Lloji, sasia dhe vlera e mallrave nuk përkon me informacionin bankar për biznesin e blerësit.
- Transaksionet e mallrave paraqesin rrezik të lartë për pastrim parash, për shembull, për disa mallra çmimet e të cilave mund të ndryshojnë ndjeshëm, gjë që e vështirëson identifikimin e çmimeve të rreme.
- Vlera e mallrave ose dërgesave për të cilat është rënë dakord është e mbisiguruar apo e nënsiguruar, ose përdoren disa sigurime, kur ky informacion është i disponueshëm.
- Transaksionet e mallrave kërkojnë licensa eksporti, si autorizime të veçanta eksporti për objektet me përdorim të dyfishtë, që janë mallra, programe dhe teknologji për përdorime civile dhe ushtarake.
- Dokumentacioni tregtar nuk është në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi.
- Çmimi për njësi, bazuar në informacionet e bankës rreth mallrave dhe tregtisë, është i pazakontë.
- Transaksioni është i pazakontë, p.sh. LK-të ndryshohen shpesh pa arsye të qartë ose mallrat transportohen nëpërmjet një juridiksioni tjetër pa arsye të dukshme tregtare.
- Mallrat e tregtuara synojnë ose mbështesin një palë ose vend ndaj të cilit është vendosur sanksion, embargo ose një masë e ngjashme nga Bashkimi Evropian ose Kombet e Bashkuara, për shembull.

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Transaksioni dhe/ose palët e përfshira nuk përputhen me informacionet e bankës rreth veprimtarive të mëparshme ose profilit të biznesit të klientit (p.sh. mallrat që transportohen, volumet e dërgesave nuk janë në përputhje me informacionet rreth biznesit të importuesit ose eksportuesit).
- Ka tregues se blerësi dhe shitësi kanë bashkëpunim të fshehtë, për shembull:
 - blerësi dhe shitësi kontrollohen nga i njëjti person;
 - transaksionet e biznesit kanë të njëjtën adresë, deklarojnë vetëm adresën e regjistruar të agentit, ose adresa ka parregullsi të tjera;
 - blerësi është i gatshëm ose i prirur të pranojë ose të mos mbajë përgjegjësi për mospërputhjet në dokumentacion.

- Klienti nuk është në gjendje ose ngurron të vërë në dispozicion dokumentacionin përkatës për ta mbështetur këtë transaksion.
- Klienti e ka të vështirë ta arsyetojë të gjithë procesin e eksportit ose nuk është në gjendje ta shpjegojë përmbajtjen dhe kuptimin e dokumenteve të Letrës së Kredisë dhe KB.
- Struktura ligjore e blerësit nuk e lejon identifikimin e pronarëve të vet ose përdor agjentë apo palë të treta për të përfaqësuar të drejtat dhe interesat e blerësit.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- Vendi ku kryhet transaksioni (përfshi vendin e origjinës, destinacionit ose tranzitit të mallrave, ose vendin ku e ka selinë secila prej palëve të transaksionit) nuk ka kontrole për këmbimet valutore. Kjo rrit rrezikun që qëllimi i vërtetë i transaksionit është eksporti i valutave në shkelje të legjislacionit vendas.
- Vendi ku kryhen transaksionet ka nivele më të larta të veprës penale mëmë (p.sh. ato që lidhen me tregtinë e lëndëve narkotike, kontrabandën, ose falsifikimin) ose zona të tregtisë së lirë.
- Transaksioni ekzekutohet nën kujdesin e organizatave apo fondacioneve qeveritare ose ndërkombëtare, që mbështesin viktimat e fatkeqësive natyrore, ose personat e prekur nga lufta apo trazirat civile.

Veprimtaria bankare e investimit

Faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit

- Shumat e transaksioneve janë jashtëzakonisht të larta, duke marrë parasysh profilin e klientit;
- marrëveshjet e përmbylljes së transaksioneve nuk janë standarde ose duken të parregullta;
- tregtia ose transaksionet e kopjuara përfshijnë letra me vlerë që përdoren për këmbime valutore në dukje të pazakonta ose që nuk kanë qëllime të dukshme biznesi apo ekonomike;
- Produkti ose shërbimi strukturohet në mënyrë të tillë që të mund të vështirësojë identifikimin e klientëve; mund të ketë edhe pagesa ndaj palëve të treta.

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Sjellja e klientit, për shembull:
 - arsyetimi për investimin nuk ka qëllim të qartë ekonomik;
 - klienti kërkon të riblejë ose reklamojë një investim afatgjatë brenda një periudhe të shkurtër pas investimit fillestar ose përpara datës së pagesës pa arsyetim të qartë, veçanërisht kur kjo sjell humbje financiare ose tarifa më të larta transaksionesh;
 - klienti kërkon në mënyrë të përsëritur blerjen dhe shitjen e aksioneve brenda një periudhe të shkurtër kohe pa strategji ose arsyetim të qartë ekonomik.
 - mungesë gatishmërie për të dhënë informacione KDK rreth klientit dhe pronarit përfitues;
 - ndryshime të shpeshta të informacioneve KDK ose hollësive të pagesës;
 - klienti transferon më shumë fonde nga sa kërkohen për investimin dhe kërkon që tepricat të rimbursohen;
 - rrethanat në të cilat klienti përdor “periudhën e pritjes” shkaktojnë dyshime;
 - përdorimi i disa llogarive pa njoftim paraprak, sidomos kur këto llogari mbahen në disa juridiksione me rrezik të lartë;
 - klienti dëshiron ta strukturojë marrëdhënien në mënyrë të tillë që të përdoren shumë palë në juridiksione të ndryshme, për shembull shoqëritë e nominuara, veçanërisht kur këto juridiksione paraqesin rrezik më të madh për PP/FT.

- Natyra e klientit, për shembull:
 - klienti është shoqëri, trust ose ka formë tjetër ligjore me strukturë dhe funksione të ngjashme me trustin, themeluar në juridiksion me rrezik më të lartë për PP/FT (firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje atyre juridiksioneve që nuk i respektojnë me efikasitet standardet ndërkombëtare tatimore dhe të transparencës lidhur me dhënien e informacionit);
 - klienti është mjet investimi që tregon pak ose aspak kujdes të duhur ndaj klientëve të vet; klienti është mjet investimi që vepron si palë e tretë e parregulluar;
 - pronësia dhe struktura e kontrollit e klientit është e mjegullt;
 - klienti ose pronari përfitues është PEP ose mban një tjetër pozicion të rëndësishëm që i mundëson të abuzojë me pozicionin për fitime private;
 - klienti është shoqëri e parregulluar e nominuar me palë interesi të panjohura.
- Biznesi i klientit, për shembull fondet e klientit rrjedhin nga biznese në sektorë ku ka rrezik më të madh për krim financiar, si ndërtimi, farmaceutika dhe kujdesi shëndetësor, tregtia e armëve dhe mbrojtja, industria nxjerrëse ose prokurimi publik.

Faktorët e rrezikut të kanalit të shpërndarjes

- Komplexiteti i zinxhirit të marrjes dhe transmetimit të urdhrave;
- Komplexiteti i zinxhirit të shpërndarjes së produkteve të investimit;
- Platforma e tregtisë ka anëtarë ose pjesëmarrës që ndodhen në juridiksione me rrezik të lartë.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- Investitori ose përfaqësuesi i tij e ka selinë në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë.
- Fondet vijnë nga juridiksione me rrezik më të lartë për PP/FT.

Financat e korporatave

Faktorët e rrezikut të klientit dhe përfituesit

- Pronësia e klientit është e paqartë dhe nuk ka asnjë arsye të dukshme tregtare dhe ligjore. Për shembull, kur pronësia ose kontrolli i jepet subjekteve të tjera si trusteve ose Subjekteve për Qëllime të Veçanta Sigurizimi (SSPE), sikurse përcaktohet në Nenin 2(2) të Rregullores 2017/2402 (BE) (SSPE);
- Strukturat ose transaksionet e korporatave janë të ndërlikuara, si për shembull zinxhir i gjatë mbajtës ku përdoren shoqëri fasadë, ose ka mungesë transparence, pa pasur një qëllim të arsyeshëm biznesi;
- kur nuk ka prova që klienti ka marrë autorizimin ose miratimin e një drejtuesi të lartë për ta përmbyllur kontratën;
- ka pak mjete të pavarura për verifikimin e identitetit të klientit;
- shkelje si mashtrime me letrat me vlerë ose dyshohet për tregti me të brendshëm.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- klienti dhe pronari përfitues e kanë selinë ose lidhen me juridiksione ku rreziku për PP/FT është më i lartë. Firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve me nivele të larta korrupsioni.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 5⁹

Një FIU evropiane mori dy raportime nga dy banka të ndryshme. Marvini, një shtetas i huaj, kishte paraqitur pesë çeqe bankare për depozitim në llogarinë e tij të sapohapur bankare. Ai u tha bankave se 1.600.000 dollarët amerikanë buronin nga shitja e një toke në një shtet afrikan që kishte blerë shoqëria e tij e pronave të paluajtshme.

Bankat i raportuan FIU-t kombëtar për nivelin e transaksioneve dhe mungesën e të dhënave mbështetëse nga ana e Marvinit.

Hetimet e FIU-t zbuluan lidhje interesante me babin e Marvinit. Babai i tij ishte dënuar me burgim në një shtet tjetër për mashtrim, spiunazh, korrupsion dhe veprimtari të tjera kriminale. Babai i Marvinit kishte marrë dënim me dymbëdhjetë vjet burgim pas falimentimit të një banke për shkak të një mashtrimi të madh që ai kishte bërë.

Pak pas deklaratës fillestare, Marvini telefonoi bankierët për t'u kërkuar të mblidheshin që të diskutonin për investimet e mëtejshme të shoqërisë dhe të dy institucionet i raportuan menjëherë FIU-t për ta paralajmëruar për mbledhjet e ardhshme.

FIU kontaktoi policinë vendase, e cila filloi ta mbikëqyrte Marvinin sapo hyri në vend. Rrjedhimisht, Marvini u akuzua dhe u arrestua për pastrim parash.

Shkëmbimi i informacioneve me vendin e huaj e lehtësoi përgatitjen e procedimit penal kundër Marvinit, akuzuar për komplot, pastrim parash dhe mashtrim.

Autoritetet e huaja informuan FIU-n se babai i Marvinit kishte grumbulluar pasuri të konsiderueshme. Ai i kishte riinvestuar paratë në shoqëri të pronave të paluajtshme dhe sipërmarrje financiare të regjistruara në emër të tij, Marvinit dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Rasti 6¹⁰

Tre miq, Briani, Jozefi dhe Riçardi, blenë shoqërinë 'Red Ltd' që nuk kishte seli në Evropën Perëndimore me anë të një ndërmjetësi. Si objekt biznesi të shoqërisë Red Ltd ata regjistruan importimin e tapeteve nga një vend tjetër i Evropës Perëndimore.

Për të lehtësuar tregtinë, ata kërkuar që ndërmjetësi, i cili ishte firmë avokatie, të hapte për ta një llogari bankare në emër të Red Ltd. Kjo gjë u bë pa u vënë në diskutim dhe në përputhje me udhëzimet e mëtejshme, nënshkrues ishin vetëm punonjësit kyç të firmës ligjore.

Pikërisht këtë kishin dashur edhe ortakët, sepse nuk donin të kishin lidhje zyrtare me shoqërinë.

Pak ditë pas hapjes së llogarisë bankare, Briani i telefonoi bankës për të negociuar lëshimin e një letër kredie. Ai pretendoi se kjo letër kredie i duhej për të blerë njëzet rrotulla tapeti që do t'i furnizoheshin një firme të madhe katalogësh. Briani u shpreh se blerja ishte provë për të parë se si do të ecte biznesi dhe

9. Marrë nga Raporti i Grupit Egmont FIU-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont

10. Marrë nga Raporti i Grupit Egmont NJIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont

nëse do të kishte sukses, dhe se marrëveshja e ardhshme do të ishte dhjetë fish më e madhe. Megjithatë, dukej se Briani nuk dinte shumë rreth letër-kredive dhe bankës iu desh t'ia shpjegonte procedurën hap pas hapi. Punonjësve të bankës iu duk e çuditshme mungesa e njohurive të Brianit, pasi ai ishte biznesmen që pretendonte se kishte operuar në treg për disa vjet; ata i shënuan shqetësimet e tyre në dosje.

Briani i tha bankës se letra e kredisë duhej në shumën 40.000 Dollarë amerikanë. Ai i kërkoi bankës që ta kontaktonte sapo shuma të ishte transferuar në vendin eksportues, ku Jozefi dhe Riçardi po organizonin tregtinë. Briani tha se Jozefi dhe Riçardi do t'i dërgonin një certifikatë bankës, pasi të kishin inspektuar mallin përpara se dërgonin.

Bankës do t'i dërgohej edhe një dokument dërgese. Atëherë bankës do t'i duhej ta jepte pagesën brenda tre javësh nga data e dërgesës, që do të përcaktohej në dokumentin e dërgesës. Llogaria e përfituesit, në emër të Black Ltd, ndodhej në një bankë në vendin eksportues.

Letra e kredisë u lëshua një javë më vonë pas marrjes së fondeve të depozitës nga një pikë këmbimi valutë. Pas dhjetë ditësh, mbërriti certifikata dhe dokumentacioni i dërgesës. Ajo që e shqetësoi bankën ishte se adresa e Red Ltd që përcaktohej në dokumentin e dërgesës ishte në fakt adresa e një njësie industriale në një shtet tjetër.

Për më tepër, vlera e tapetave ishte shënuar vetëm 5.500 Dollarë amerikanë dhe jo 40.000 sikurse ishte pretenduar. Pavarësisht këtyre mospërrthjeve, banka e autorizoi transfertën dhjetë ditë më vonë.

Brenda fare pak kohësh, Briani e kontaktoi bankën për të konfirmuar se çdo gjë shkonte mirë dhe se ishte në fazat e para të organizimit të një importi tjetër tapetash. Këtë radhë, letër kredia do të ishte rreth 625.000 Dollarë amerikanë. Banka e shënoi këtë në dosje dhe qëndroi në pritje të udhëzimeve të mëtejshme.

Dhjetë muaj më vonë, punonjësit e doganës shkuan në institucion për një vizitë rutinë dhe banka ua parashtrroi çështjen në formë deklarate zyrtare, duke theksuar dyshimet e vazhdueshme për Red Ltd. Informacioni i bankës ishte vërtetë mjaft i dobishëm. Briani, Jozefi dhe Riçardi ishin arrestuar tetë muaj më parë në bordin e një jahti të vogël, në përpjekje e sipër për të futur njëqind kilogramë rrëshirë kanabisi kontrabandë. Dokumentacioni i gjetur gjatë kontrollit të banesës tregonte se ata po e bënin këtë "punë të vogël" për të financiar importimin e një sasive më të madhe heroine. Kishte të ngjarë që ta kishin importuar tashmë një sasi të vogël heroine duke e fshehur në rrotullat e tapetave nëpërmjet tregtisë së Red Ltd-së dhe nëse nuk do të ishin arrestuar, do të kishin vijuar ta përdornin shoqërinë për qëllime importi dhe pastrimi parash.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- FATF (2018), Pastrimi Profesional i Parave, FATF, Paris, Francë www.fatf-gafi.org/publications/methodandtrends/documents/professional-money-laundering.html
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>
- Raporti Huluntues MONEYVAL (2013) *Shtyrja e transaksioneve financiare dhe monitorimi i llogarive bankare.*
- Raporti i abe-s eba/gl/2021/2 - raporti përfundimtar për udhëzimet mbi kujdesin e duhur të klientit dhe faktorët që institucionet kreditore dhe financiare duhet të marrin parasysh gjatë vlerësimit të rrezikut të dyfishtë pp/ft lidhur me marrëdhëniet individuale të biznesit dhe transaksione rastësore.
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont *NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont.*
- Raportet vjetore 2011, 2012, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 publikuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>

4.

Pastrimi i Parave Nëpërmjet Tregtisë (PPNT)

Pastrimi i Parave Nëpërmjet Tregtisë (PPNT) përkufizohet nga FATF-ja si “procesi i fshehjes së produkteve të veprës penale dhe zhvendosjes së vlerës nëpërmjet përdorimit të transaksioneve tregtare në përpjekje për të legjitimuar origjinën e tyre të paligjshme ose financuar veprimtaritë e tyre”.

Objektivi parësor i çdo skeme PPNT është qarkullimi i qëllimshëm i fitimeve të paligjshme nëpërmjet shfrytëzimit të transaksioneve tregtare. Kështu, kriminelët mund të kryejnë një seri veprimtarish të paligjshme, si përgatitje faturash të rreme, keqpërdorim pasurish për të shmangur kontrollet dhe kryer shkelje të tjera doganore e tatimore.

Por, qëllimi i PPNT-së, ndryshe nga veprat penale mëmë, si evazioni fiskal ose kontrabandimi i mallrave, nuk është qarkullimi i mallrave, por qarkullimi i parave, gjë që lehtëson transaksionet e biznesit.

Një tjetër tipar dallues themelor i skemave PPNT është përfshirja e pastruesve profesionistë të parave. Kriminelët që kryejnë vepra penale mëmë lidhur me tregtinë janë zakonisht përfituesit fundorë të këtyre produkteve të paligjshme, ndërsa pastruesit profesionistë të parave ofrojnë ekspertizë të specializuar duke përdorur një sërë teknikash PP-je për të diversifikuar rrezikun e ekspozimit.

Këta profesionistë i marrin produktet e krimit në emër të OK-së dhe i transferojnë ose i konvertojnë ato produkte, përfshi edhe nëpërmjet PPT-së, përpara se t’ua kthejnë OK-ve, duke zbritur pagesën e tarifës ose komisionin.

FATF-ja ka identifikuar në raportet e tyre disa teknika PPNT për pastrimin e parave të paligjshme:

- **Mbifaturimi dhe nënfaturimi i mallrave dhe shërbimeve:** Elementi kryesor i kësaj teknike është keqdeklarimi i çmimit të mallit ose shërbimit për të transferuar vlerën. Në këtë lloj veprimtarie, aspekti favorizues kritik është se importuesi dhe eksportuesi janë bashkëfajtorë në keqdeklarim.
- **Mbifaturimi dhe nënfaturimi i mallrave dhe shërbimeve:** Sa më lart, kjo përfshin keqdeklarimin e sasisë së mallrave ose shërbimeve, përfshi këtu edhe “dërgesat fantazmë”, ku nuk ka fare qarkullim produkti. Edhe kjo praktikë mbështetet te bashkëpunimi i fshehtë midis importuesit dhe eksportuesit.
- **Faturimi i shumëfishtë i mallrave dhe shërbimeve:** Nuk përfshin keqdeklarim të çmimit, por ka në thelb ripërdorimin e dokumentacionit ekzistues për të justifikuar pagesat e shumëfishta për të njëjtën dërgesë mallrash dhe ofrim shërbimesh. Kriminelët ose financuesit e terroristëve e shfrytëzojnë

më tej këtë duke i ripërdorur këto dokumente në disa Institucione Financiare, gjë që vështirëson identifikimin e tyre nga institucioni.

- **Mallra dhe shërbime me përshkrim të rremë:** Përfshin keqdeklarimin e cilësisë ose llojit të mallit ose shërbimit, si dërgesat e mallrave relativisht të lirë, që përshkruhen si mallra më të shtrenjtë, ose si një mall krejtësisht tjetër, për të justifikuar qarkullimin e vlerës.

Në të vërtetë, këto teknika përdoren së bashku, gjë që e ndërlikon skemën e PP-së. Për shembull, rrjetet më të sofistikuara të PP-së mund t'i përdorin dërgesat fantazmë së bashku me faturat e shumëfishta. Dërgesa mund të përfshijë qarkullimin e mallrave realë për të krijuar legjitimitet në dukje, ose për të testuar proceset e përputhshmërisë së doganave, dhe tregtia mund të përdorë fatura të shumëfishta për dërgesa fantazmë, duke i shërbyer mbulimit të transferimit të fondeve.

Një lloj tjetër tradicional i PPNT-së është Këmbimi i Pesos në Tregun e Zi, që përdoret nga kartelet e drogës së Amerikës Qendrore dhe Jugore për të pastruar paratë e drogës të gjeneruara në Shtetet e Bashkuara. Një prej arsyeve të kësaj skeme është kufizimi i valutës, gjë që kufizon aftësinë e shoqërive legjitime për të blerë mallra nga furnizues të jashtëm. Për shkak të këtyre kufizimeve, bizneset duhet të mbështeten te këmbyesit bashkëpunëtorë të parave për këmbimin e monedhave të ligjshme vendase në dollarë amerikanë. Kartelet e drogës e përdorin këtë zinxhir për të qarkulluar dollarë amerikanë nga një juridiksion në tjetrin.

Zakonisht, në skemat e këmbimit të pesos në tregun e zi, ndërmjetësi i merr dollarët nga rrjeti i përgjegjësve për paratë në kartelin e drogës dhe i përdor ato për të paguar furnizuesin në SHBA. Në varësi të kompleksitetit të skemës, ndërmjetësi mund ta paguajë ofruesin drejtpërdrejt ose mund t'i depozitojë paratë në llogari të ndryshme bankare duke përdorur depozita të strukturuar dhe më pas ua përcjell këto fonde ofruesve nëpërmjet transfertave elektronike. Më pas, furnizuesi në SHBA ua eksporton mallrat shoqërive në vendin e Amerikës Qendrore ose Jugore, të cilat ua transferojnë shumën e parave në valutën vendase ndërmjetësve vendas të parave. Pas kësaj, ndërmjetësi i parave ia kalon shumën e parave kartelit të drogës në valutën vendase, duke zbritur komisionin. Kjo skemë bën që midis juridiksioneve të mos qarkullojnë para fizike, ku mund të identifikohen dhe përgjohen nga ALZ-të.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku janë marrë nga raporti i FATF-së¹¹ dhe ndahen në katër kategori kryesore:

Treguesit strukturorë të rrezikut

- Struktura korporative e një subjekti tregtar duket jashtëzakonisht komplekse dhe jologjike, si përfshirja e shoqërive guaskë ose shoqërive të regjistruara në juridiksione me rrezik të lartë.
- Subjekti tregtar është regjistruar ose i ka zyrat në një juridiksion me përputhshmëri të ulët me PP-në/FT-në.
- Subjekti tregtar është regjistruar në një adresë që mund të jetë adresë e përgjithshme p.sh. godina rezidenciale me densitet të lartë, adresa postare, godina tregtare ose komplekse industriale, sidomos kur referohet një njësi specifike.
- Veprimtaria e punës së një subjekti tregtar duket e papërshtatshme për adresën e deklaruar p.sh. një subjekt tregtar duket se përdor prona rezidenciale, që nuk kanë hapësirë tregtare ose industriale, pa shpjegim të arsyeshëm.

11. Raporti i FATF-së për *Pastrimin e Parave Nëpërmjet Tregtisë*: Treguesit e Rrezikut.

- Një subjekt tregtar nuk ka prani në internet ose prania në internet tregon se veprimtaria e biznesit nuk përputhet me profilin e deklaruar të biznesit p.sh faqja e internetit të subjektit tregtar përmban kryesisht tekste të kopjuara nga faqe të tjera interneti, ose faqja e internetit tregon se ka mungesë njohurish për produktin ose industrinë e caktuar ku subjekti po bën tregti.
- Subjekti tregtar shfaq mungesë të theksuar të veprimtarive tipike të biznesit p.sh. mungojnë transaksionet e rregullta të listëpagesave në përputhje me numrin e deklaruar të punonjësve, transaksionet që lidhen me kostot e operimit, taksat për remitancat.
- Pronarët ose drejtuesit e lartë të subjektit tregtar duket se janë emëruar për të fshehur pronarët e vërtetë përfitues p.sh. nuk kanë përvojë në menaxhimin e biznesit ose nuk kanë njohuri për detajet e transaksioneve, ose menaxhojnë disa shoqëri njëherësh.
- Subjekti tregtar ose drejtuesit e lartë janë përfshirë në vepra penale p.sh. skemat e pastrimit të parave, mashtrime, evazion fiskal, veprimtari të tjera kriminale, hetime, ose kanë qenë më parë apo janë të dënuar aktualisht.
- Subjekti tregtar mban një numër minimal punonjësish, gjë që nuk përputhet me volumin e mallrave të tregtuara.
- Emri i subjektit tregtar është kopja e emrit të një korporate të njohur ose e një korporate të ngjashme me të. Kjo mund të jetë një përpjekje për t'u dukur sikur subjekti është pjesë e korporatës, ndonëse faktikisht nuk lidhet me të.
- Subjekti tregtar ka periudha të pashpjegueshme pasiviteti.
- Subjekti nuk i përmbush detyrimet e zakonshme të biznesit, si p.sh. dorëzimi i deklaratave të TVSH-së.

Treguesit e rrezikut të veprimtarisë tregtare

- Veprimtaria tregtare nuk është në përputhje me profilin e biznesit të subjekteve të përfshira p.sh. një tregtar makinash eksporton veshje ose një tregtar metalesh të çmuara importon produkte deti.
- Subjekti tregtar angazhohet në marrëveshje tregtare komplekse që përfshijnë shumë palë të treta si ndërmjetës në profile biznesi të papajtueshme.
- Subjekti tregtar bën transaksione dhe përdor mënyra apo metoda transporti që nuk janë në përputhje me praktikat standarde të biznesit.
- Subjekti tregtar i përdor produktet financiare në mënyrë të pazakontë ose tejet komplekse p.sh. përdor letra-kredie për periudha jashtëzakonisht të gjata ose periudha zakonisht të zgjatura pa ndonjë arsye të dukshme, duke përzier lloje të ndryshme të produkteve të financave tregtare për segmente të ndryshme të transaksioneve tregtare.
- Subjekti tregtar paraqet vazhdimisht dhe në mënyrë të paarsyeshme marzhe të ulëta fitimi.5 në transaksione tregtare p.sh. importon mallra me shumicë me ose mbi vlerë tregu, ose rishet mallra me të njëjtin çmim ose me çmim më të ulët.
- Subjekti tregtar blen mallra, me llogarinë e vet, por blerjet i tejkalojnë qartas kapacitetet ekonomike të subjektit p.sh. transaksionet financohen përmes flukseve të befta me anë të depozitave në para fizike ose transfertave të palëve të treta në llogaritë e subjektit.
- Subjekti tregtar i sapoformuar ose i riaktivizuar së fundmi që angazhohet në veprimtari tregtare me volum dhe vlerë të lartë p.sh një subjekt i panjohur shfaqet papritur dhe angazhohet në veprimtari biznesi në sektorë ku hyrja në treg ka pengesa të mëdha.

Treguesit e rrezikut lidhur me dokumentet e tregtisë dhe mallrave:

- Mospërputhje midis kontratave, faturave dhe dokumenteve të tjera të tregtisë p.sh. mospërputhje midis emrit të subjektit eksportues dhe emrit të marrësit të pagesës; çmime faturash të ndryshme

nga çmimet në kontrata; ose mospërputhje midis sasisë, cilësisë, volumit ose vlerës së mallrave faktike dhe përshkrimeve të tyre.

- Kontratat, faturat ose dokumentet e tjera tregtare paraqesin tarifa ose çmime që nuk duket se janë në të njëjtën linjë me aspektet tregtare, nuk përputhen me vlerën e tregut, ose luhaten ndjeshëm nga transaksionet e mëparshme të krahasueshme.
- Kontratat, faturat ose dokumentet e tjera tregtare kanë përshkrime të vakëta të mallrave të tregtuara p.sh. subjekti i kontratës përshkruhet në terma të përgjithshëm dhe jo në mënyrë specifike.
- Dokumentet tregtare ose doganore që mbështesin transaksionet mungojnë, janë të falsifikuara, përfshijnë informacione të rreme ose çorientuese, janë ridorëzime të dokumenteve të mëparshme të cilat janë refuzuar, ose modifikohen dhe ndryshohen shpesh.
- Kontratat që mbështesin transaksione komplekse ose të rregullta tregtare duken jashtëzakonisht të thjeshta p.sh. kanë strukturën e një "kontrate tip" që mund të gjendet në internet.
- Vlera e importeve të regjistruara të një subjekti ka mospërputhje të mëdha me volumet e transfertave bankare të subjektit për importe. Edhe vlera e eksporteve të regjistruara ka mospërputhje të mëdha me transfertat hyrëse nga bankat e huaja.
- Mallrat që importohen në vend në kuadër të importeve të përkohshme dhe regjimit të përpunimit të brendshëm eksportohen me dokumente të falsifikuara.
- Dërgesat e mallrave kalojnë nëpër disa juridiksione pa arsye ekonomike apo tregtare.

Treguesit e rrezikut lidhur me llogarinë dhe veprimtarinë transaksionale

- Subjekti tregtar i ndryshon modalitetet e pagesës për transaksionin në çastin e fundit p.sh. subjekti ia ridrejton pagesën një subjekti të panjohur më parë në çastin e fundit, ose subjekti kërkon që të ndryshohet data ose shuma e pagesës.
- Llogaria paraqet një numër jashtëzakonisht të lartë transaksionesh që nuk përkohet me veprimtarinë e deklaruar të biznesit të klientit.
- Llogaria e një subjekti tregtar duket se është llogari "për kalim pagesash" ose "tranziti", ku kryhen transaksione të shpejta dhe në shuma të mëdha, dhe në fund të ditës mbetet një bilanc pa arsye të qartë biznesi, duke përfshirë:
 - Në llogari depozitohen shpesh para fizike nga persona ose subjekte që operojnë në zonat e tregtisë së lirë ose juridiksione offshore, pa pasur marrëdhënie biznesi me titullarin e llogarisë;
 - Transfertat elektronike që hyjnë në një llogari tregtare ndahen dhe i dërgohen disa llogarive jo të lidhura me njëra-tjetrën që kryejnë pak ose aspak veprimtari tregtare.;
- Pagesa për mallrat e importuara bëhet nga një subjekt që nuk është marrësi i mallrave dhe nuk ka arsye të qartë ekonomike për këtë p.sh. bëhet nga një shoqëri guaskë, ose shoqëri fasadë që nuk është përfshirë në transaksionin tregtar.
- Depozitat e parave ose transaksionet e tjera të një subjekti tregtar janë vazhdimisht nën pragjet e raportimit.
- Veprimtaria transaksionale e subjektit tregtar pëson rritje të shpejta dhe të ndjeshme në volum dhe më pas bie në pasivitet për një periudhë të shkurtër kohore.
- Pagesat dërgohen ose merren në shuma të mëdha të rrumbullakosura për tregti në sektorë ku kjo gjë konsiderohet e pazakontë.
- Pagesat ndjekin një itinerar qarkor - fondet dërgohen nga një vend dhe merren mbrapsht po në të njëjtin vend, pasi kanë kaluar nëpër vende të tjera.

2. RASTE STUDIMORE


Rasti 7¹²

Autoritetet belge vërejtën për disa vjet radhazi se shtetasit brazilianë ose portugezë po krijojnë ose blinin shoqëri belge në industrinë e ndërtimit ose pastrimit.

Këto shoqëri përdoren zakonisht për të mbuluar punësimin e punëtorëve të padeklaruar në Belgjikë dhe veprojnë si pjesë e një rrjeti të përbërë nga shoqëri të ndryshme, të gjitha me të njëjtin profil, të cilat krijohen dhe ekzistojnë për një periudhë të caktuar kohore, kryesisht për të kryer transaksione të veçanta.

Ato mund të zëvendësohen mjaft shpejt dhe efektshëm nga shoqëri të reja, me menaxherë të rinj, për ta rifreskuar sistemin. Këto shoqëri i marrin paratë fizike që burojnë nga veprimtaritë kriminale të rrjeteve të tjera kriminale dhe i japin një "lustër legjitimiteti", duke i faturuar për shërbime mirëmbajtjeje të godinave.

Fondet u transferohen më pas shitësve me shumicë në Azi. Shitësit me shumicë udhëzohen t'i blejnë mallrat në emër të shitësve belge me pakicë, të cilat importohen dhe shiten më pas si pjesë e skemës PPNT.



Rasti 8¹³

Autoritetet e SHBA-së kishin informacion se Banka P në Liban ishte përdorur në masë nga një sindikatë ndërkombëtare e trafikut të drogës, kontrolluar nga individi Q për qarkullimin e produkteve nga shitja e lëndëve narkotike nëpërmjet PPNT-së në mbarë botën.

12. Raporti i FATF-së për *Pastrimin e Parave Nëpërmjet Tregtisë: Tendencat dhe Zhvillimet*.

13. Marrë nga Raporti i APG-së *Tipologjia për Pastrimin e Parave Nëpërmjet Tregtisë*.

Sindikata fuste lëndë narkotike kontrabandë nga Amerika e Jugut në Evropë dhe Lindjen e Mesme nëpërmjet Afrikës Perëndimore.

Kreu i sindikatës, individi Q, organizoi dërgesën e 100 tonë kokainë nga Amerika e Jugut dhe pastroi produkte deri në 200 milionë dollarë amerikanë në muaj, fituar nga shitja e kokainës në Evropë dhe Lindjen e Mesme.


Produktet e trafikut të drogës u qarkulluan dhe pastruan nëpërmjet tre sistemeve:

1. kontrabandimit të shumave të mëdha të parave fizike (korrierët e parave fizike);
2. përdorimi i pikave të këmbimit, përfshi një në pronësi të individit Q.
3. përdorimi i llogarive të familjarëve të individit "Q" në disa degë të bankës P;

Depozitimet e shumave të mëdha të parave u bënë nga individi Q dhe ortakët e tij në pikat e këmbimit, të cilat nga ana tjetër depozitonin para në disa llogari në bankën P. Në fakt, individi Q kishte në pronësi dhe kontrollonte një prej pikave të këmbimit që ndodhej në të njëjtën godinë me degën e bankës P. Disa punonjës të bankës P bashkëpunonin me individin Q.

Sindikata përdori këtë skemë PPNT-je për të qarkulluar dhe pastruar fondet e paligjshme nëpërmjet tregtisë:

- Transfertat elektronike dërgoheshin nga Banka P drejt bankave në SHBA për blerjen e makinave të përdorura në SHBA.
- Tregtia e makinave bëhej nga individë që ishin hetuar më parë, secili më vete, për vepra penale të lidhura me drogën.
- Përfituesit e këtyre fondeve blinin makina në Shtetet e Bashkuara, të cilat dërgoheshin më pas në vende si Afrika Perëndimore dhe të tjera.
- Produktet e gjeneruara nga shitja e makinave të përdorura ktheheshin në fund sërish në Liban.
- Kështu, paratë e gjeneruara nga tregtia e paligjshme e drogës futeshin në sistemin financiar nëpërmjet skemës PPNT që përfshinte tregtinë e makinave të përdorura.



3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- FATF – Grupi Egmont (2020), Pastrimi i Parave Nëpërmjet Tregtisë: Tendencat dhe Zhvillimet, FATF, Paris, Francë. www.fatf-gafi.org/publications/methodandtrends/documents/trade-based-money-laundering-trends-anddevelopments.html
- FATF – Grupi Egmont (2020), Pastrimi i Parave Nëpërmjet Tregtisë: Treguesit e Rrezikut, FATF, Paris, Francë. www.fatf-gafi.org/publications/methodandtrends/documents/trade-based-money-laundering-risk-indicators.html
- APG (Azia e Paqësorit për Pastrimin e Parave) Raporti i APG-së për Tipologjinë e Pastrimit të Parave Nëpërmjet Tregtisë 20-07-2012.
- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>

5.

Shfrytëzimi i sektorit të pasurive të paluajtshme

Sektori i pasurive të paluajtshme është destinacion më se i zakonshëm i fondeve që burojnë nga veprimtaritë kriminale. Për sa i përket pastrimit të parave, ky sektor përfaqëson fazën e "integritimit", ose kthimin e pasurive "në dukje të ligjshme" organizatës kriminale. Por sektori i pasurive të paluajtshme, ose tregu i pronave, nuk është vetëm destinacioni përfundimtar i fitimeve të gjeneruara nga kriminelët, por u lejon atyre të pastrojnë para edhe në fazat e "vendosjes" dhe "shtresëzimit".

Kriminelët përdorin një sërë metodash për keqpërdorimin e sektorit privat. Disa prej këtyre metodave përbëjnë vepra penale në vetvete. Megjithatë, ndonjëherë, format e përdorura nga shkelësit e ligjit në këtë sektor janë më se të ligjshme, për sa kohë që nuk krijohet asnjë lidhje me "paratë e pista" që burojnë nga veprimtaria kriminale.

Më poshtë gjeni disa prej metodave dhe teknikave bazë financiare më të përdorura nga kriminelët:

- Përdorimi i financimit kompleks nëpërmjet huave ose kredisë. Huatë janë kthyer në mjet të zakonshëm për sigurimin e fondeve në sektorin e pronave të paluajtshme, gjë e ditur tashmë dhe e përdorur nga kriminelët për të përfituar. Kjo gjë diskutohet më me detaje në një tipologji tjetër.
- Përdorimi i profesionistëve jofinanciarë. Zakonisht, kriminelët kërkojnë këshillim dhe ndihmë nga profesionistët, avokatët, këshilltarët tatimorë, kontabilistët, noterët, regjistruarit e pronave dhe këshilltarët financiarë. Këta profesionistë veprojnë si "portierë", u japin kriminelëve qasje në sistemin financiar dhe i ndihmojnë të "bëjnë biznes". Kjo gjë diskutohet më me detaje në një tipologji tjetër.
- Përdorimi i mjeteve korporative. Ndonjëherë, kriminelët përdorin të gjitha llojet e subjekteve ose marrëveshjeve ligjore për të fshehur pronësinë, qëllimin, veprimtarinë dhe burimin e fondeve lidhur me veprimtarinë e tyre në këtë sektor. Kjo gjë diskutohet më me detaje në një tipologji tjetër.
- Manipulimi i vlerësimit të pronës. Vlerësimi i pronës është i vështirë dhe kjo gjë shfrytëzohet nga kriminelët për ta manipuluar vlerën, duke e mbivlerësuar ose nënvlerësuar pronën, ndjekur nga një seri shitjesh dhe blerjesh.
- Përdorimi i mjeteve monetare. Blerja e pronave me vlerë të lartë me para fizike është mënyrë e mirë për të integruar shuma të mëdha parash në sistemin ligjor financiar. Mjete të tjera monetare që përdorin kriminelët në veprimtaritë e tyre lidhur me pasuritë e paluajtshme janë çeqet dhe transfertat elektronike nëpërmjet llogarive në banka korrespondente.
- Përdorimi i skemave hipotekore. Këto konsiderohen si produkte me "rrezik të ulët" nga bankat dhe përdoren shpeshherë nga kriminelët si pjesë e skemave të krijuara për kryerjen e veprimtarive kriminale.

- Përdorimi i skemave të investimit dhe institucioneve financiare. Organizatat kriminale mund të veprojnë si partnerë të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, apo si bashkinvestitorë ose menaxherë në fondet e investimit në pasuri të paluajtshme, duke kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi vendimet e investimeve që merr fondi i investimeve në pasuri të paluajtshme.
- Përdorimi i pasurive të paluajtshme për të fshehur paratë e gjeneruara nga veprimtaritë ligjore. Përdorimi i pasurive të paluajtshme për pastrimin e parave duket se u ofron organizatave kriminale një avantazh të trefishtë, pasi i lejon ata të fusin fonde të paligjshme në sistem, duke marrë përfitime, madje edhe taksa shtesë (si zbritjet, subvencionet etj.).

Në raportet e FATF¹⁴-së përshkruhen teknika të ndryshme FT-je lidhur me këtë çështje:

- Investimi i produkteve të krimit në pasuri të paluajtshme: Disa kriminelë do të kërkojnë t'i investojnë produktet e krimit të tyre në pasuri të paluajtshme pa u përpjekur fare ta fshehin pronësinë e tyre. Prandaj, kriminelët do të vijojnë ta përdorin blerjen e pasurive të paluajtshme si mënyrë për injektimin e parave fizike të gjeneruara nga veprimtaria kriminale. Kjo është vërejtur gjithnjë e më shumë në procesin e shtresëzimit, ku fondet janë akumuluar në një ose disa llogari bankare dhe blerja e pronës financohet krejtësisht ose kryesisht nëpërmjet mjeteve private dhe jo hipotekave ose huave.
- Transferimi i vlerës me shitje të njëpasnjëshme: Shitjet e shpejta dhe të njëpasnjëshme të pronës, me ose pa hipotekë, u lejon kriminelëve ta "fryjnë" vlerën e pronës, duke justifikuar kështu injektimin e fondeve të mëtejshme në zinxhirin e blerjes dhe duke mundësuar transferimin e vlerës drejt pjesëve të tjera të grupit të krimit të organizuar ose riinvestimin brenda grupit. Për më tepër, ndryshimet e shpeshta të pronësisë mund ta vështirësonin punën e organeve ligjzbatuese për gjurmimin e fondeve dhe lidhjen e pasurive me veprën penale mëmë.
- Fshehja e pronësisë duke përdorur emër të rremë: Kriminelët që kërkojnë t'i mbajnë përfitimet nga produktet e krimit mund ta fshehin pronësinë duke përdorur identitete të rreme. Profesionistët ligjorë mund të jenë bashkëpunëtorë në këto transaksione, por ka më tepër gjasë që të marrin pjesë pa vetëdije, sidomos nëse kriminelë ka bërë falsifikime cilësore të dokumenteve të identitetit. Përdorimi i dokumenteve të rreme ose të falsifikuara mund të jetë sinjal rreziku për legjitimitetin e individit dhe veprimin që synon të kryejë.
- Fshehja e pronësisë duke blerë prona private nëpërmjet ndërmjetësve. Një tjetër mundësi për fshehjen e pronësisë duke ruajtur kontrollin mbi të është regjistrimi i pronës në emër të familjarëve, miqve ose ortakëve të biznesit, të cilët veprojnë si persona fasadë ose të emëruar.
- Fshehja e pronës nëpërmjet një shoqërie ose trusti: Edhe blerja e pronës së paluajtshme nëpërmjet një shoqërie ose trusti është identifikuar si teknikë që përdoret për të fshehur pronën dhe penguar veprimtarinë e organeve ligjzbatuese që ndjekin produktet e krimeve.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku janë marrë nga raporti i OECD-së¹⁵ dhe ndahen në gjashtë kategori kryesore:

Palë të pazakonta

- Përfshirja e një pale joprofesioniste është e pazakontë (shumë e madhe, e specializuar dhe/ose me rreziqe të mëdha).
- Pala i përket rrjetit shoqëror të një kriminelë.
- Nuk ka transparencë për pronësinë e subjektit ligjor.

14. Raporti i FATF-së për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë

15. Raporti i OECD-së, *Doracaku i Ndërgjegjësimin të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit.*

Posedim i pazakontë

- Pronësi jotransparente (p.sh aksione të paregjistruara, subjekt ligjor i panjohur nga administrata tatimore).
- Mungesë të ardhurash lidhur me çmimin e blerjes.
- Persona me precedentë ose historik penal.
- Rrjet shoqëror i një kriminel.
- Portofol me rritje të shpejtë.

Transaksione të pazakonta

- Çmime të pazakonta transaksionesh (p.sh. nuk përputhen me çmimin e transaksioneve të mëparshme, çmimin ose vlerën kërkuar të tregut).
- Rezultate të pazakonta transaksionesh (fitime të mëdha gjatë një periudhe të shkurtër pronësie).

Financim i pazakontë

- Origjinë e pazakontë fondesh.
- Huadhënës i pazakontë.
- Huamarrës i pazakontë.
- Marrëveshje e pazakontë huaje.
- Rezultate të pazakonta financimi.

Posedues ose përdorues i pazakontë

- Mungesa e të ardhurave lidhur me vlerën e drejtë të qirasë në treg.
- Persona (ose individë të lidhur me persona) me precedentë ose historik penal.

Deklarata të pazakonta

- Deklarata tepër të pagjasa, të paverifikueshme ose të padokumentuara.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 9¹⁶

Një shembull abuzimi në sektorin luksoz të pronave të paluajtshme është skandali i Zëvendës Presidentit të Venezuelas, Tareck El Aissami, dhe përfaqësuesit të tij Samark Lopez Bello. Zyra e Kontrollit të Pasurive të Huaja e Departamentit të Thesarit të SHBA-së (OFAC) e identifikoi EL Aissami-n në ligjin për Identifikimin e Bosëve të Trafikut Ndërkombëtar të Lëndëve Narkotike si person me rol të konsiderueshëm në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

16. Marrë nga Paratjëmërimi i FinCEN FIN-2017-A003, *Paratjëmërim për Institucionet Financiare dhe Firmat dhe Profesionistët e Pasurive të Paluajtshme*.


Lopez Bello u identifikua si person që ofronte asistencë materiale, mbështetje financiare ose mallra apo shërbime në mbështetje të veprimtarive të trafikimit të lëndëve narkotike dhe që vepronte në emër të El Aissami-t.

El Aissami u zgjodh si Zëvendës President i Venezuelës në janar të vitit 2017. Ai kishte shërbyer gjatë periudhës 2012-2017 si guvernator i shtetit Aragua të Venezuelës dhe si Ministër i Brendshëm dhe Ministër Drejtësie që nga viti 2008. Ai lehtësoi dërgesat e lëndëve narkotike nga Venezuela, duke kontrolluar avionët që ngriheshin nga baza ajrore venezuelane dhe rrugët e trafikut të drogës nëpërmjet porteve në Venezuelë. Në pozicionet e tij të mëparshme, ai mbikëqyri ose kishte pronësi të pjeshme mbi disa dërgesa nga Venezuela prej më shumë se 1.000 kilogramë, përfshirë edhe dërgesa me destinacion përfundimtar Meksikën dhe Shtetet e Bashkuara.

Ai lehtësoi, koordinoi dhe mbrojti trafikues të tjerë të lëndëve narkotike që vepronin në Venezuelë. El Aissami përfitoi disa pagesa për lehtësimin e ngarkesave të drogës që i përkisnin bosit venezuelan të drogës Walid Makled Garcia. El Aissami lidhet edhe me dërgesat e koordinuara të ngarkesave të drogës për llogari të Los Zetas, një kartel i dhunshëm meksikan droge, si dhe për mbrojtjen e bosit kolumbian të drogës, Daniel Barrera Barrera, dhe trafikantit venezuelan të drogës, Hermagoras Gonzalez Polanco. Los Zetas, Daniel Barrera Barrera dhe Hermagoras Gonzalez Polanco ishin shpallur nga Presidenti ose Sekretari i Thesarit si Trafikantë të Identifikuar të Lëndëve Narkotike, në përputhje me ligjin për bosët e trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, përkatësisht në prill të vitit 2009, mars të vitit 2010 dhe maj të vitit 2008.

**EL AISSAMI & LOPEZ BELLO Network
February 2017**

Tarek Zaidan EL AISSAMI MADDAH
a.k.a. Tarek EL AISSAMI
DOB 12 Nov 1974
POB El Vigía, Mérida, Venezuela
Citizen Venezuela
Identification Number 12.354.211 (Venezuela)



Frontman




**U.S. Department of the Treasury
Office of Foreign Assets Control**
Foreign Narcotics Kingpin
Designation Act

Samark Jose LOPEZ BELLO
a.k.a. Samark LOPEZ DELGADO
DOB 27 Jul 1974
POB Venezuela
Citizen Venezuela
Identification Number 11.208.888 (Venezuela)

Designated foreign entities linked to LOPEZ BELLO



Blocked U.S. entities linked to LOPEZ BELLO



Lopez Bello ishte përfaqësuesi kryesor i El Aissami-t dhe pastronte produktet e drogës pikërisht në cilësinë e përfaqësuesit. Lopez Bello përdorej nga El Aissami për blerjen e disa pasurive të caktuara. Ai menaxhonte edhe marrëveshjet e biznesit dhe çështjet financiare të El Aissami-t, duke gjeneruar fitime të mëdha nga veprimtaria e paligjshme prej së cilës përfitonte El Aissami.

Lopez Bello mbikëqyrte rrjetin ndërkombëtar të naftës, shpërndarjes, inxhenerisë, telekomunikacionit dhe shoqërive për mbajtjen e pasurive: Alfa One, C.A. (Venezuelë), Grupo Sahect, C.A. (Venezuelë), MFAA Holdings Limited (Ishujt e Virgjër Britanikë), Profit Corporation, C.A. (Venezuelë), Servicios Tecnológicos Industriales, C.A. (Venezuelë), SMT Tecnologia, C.A. (Venezuelë), dhe Yakima Trading Corporation (Panama). Një subjekt tjetër, Yakima Oil Trading, LLP (Mbretëri e Bashkuar), zotërohet, kontrollohet dhe drejtohet nga ose në emër të korporatës Yakima Trading (Panama). Profit Corporation, C.A. dhe SMT Tecnologia, C.A. kanë lidhur kontrata me qeverinë venezuelane. Gjatë periudhës 2009-2010, Grupo Sahect C.A. i ofroi agjencisë së qeverisë venezuelane Productora y Distribuidora de Alimentos, S.A (PDVAL), shërbime magazinimi dhe transporti.

Në kuadër të aksionit të sotëm, janë bllokuar edhe pesë shoqëri amerikane të zotëruara dhe kontrolluara nga Lopez Bello dhe/ose MFAA Holdings Limited, të regjistruara në Florida, që vijojnë si më poshtë: 1425 Brickell Ave 63-F LLC; 1425 Brickell Avenue Unit 46B, LLC; 1425 Brickell Avenue 64E, LLC; Augusta Grand I LLC; dhe 200G PSA Holdings LLC. Krahas këtyre, është identifikuar si pronë e bllokuar, e zotëruar ose kontrolluar nga 200G PSA Holdings LLC, edhe një avion i regjistruar në SHBA me numër identifikimi bishti N200VR.

Si rezultat i këtij aksioni, janë bllokuar prona të paluajtshme dhe pasuri të tjera të konsiderueshme që lidhen me Lopez Bello edhe në Majami, Florida.

Rasti 10¹⁷

Familja Jameson, një familje kriminelësh që vepron në një vend evropian, vendosi ta pastronte pasurinë duke blerë një pronë në Evropën Juglindore me vlerë afro 1.500.000 Dollarë amerikanë.

Ata financuan një investim me hua bankare për të cilën ofruan si siguri dy polica sigurimi jete, me vlerë totale më të madhe se 200.000 dollarë amerikanë. Kontratat e sigurimit u paguan nëpërmjet çeqeve të tërhequra te noteri dhe në një pikë evropiane e këmbimit valutor, por jo nga individët e përfshirë.

Duke qenë se shoqëria e sigurimit mendoi se ky transaksion ishte i pazakontë, vendosi të njoftonte FIU-n kombëtar. Pas marrjes së raportit, FIU nisi një hetim financiar, dhe analistët financiarë që u caktuan për rastin zbuluan se, paratë që fshiheshin pas çeqeve që mbështesnin policën e sigurimit, ishin depozituar në para fizike në të njëjtën ditë në dy vende të tjera evropiane. Për më tepër, individë që depozitoi paratë njihesh nga policia e njërit prej vendeve për lidhjet me një kriminel të burgosur për pastrim parash në emër të një organizate kriminale evropiane që merrej me trafik droge.

Gjatë hetimit, analistët zbuluan edhe se familja Jameson kishte kryer një sërë investimesh në pasuri të paluajtshme gjatë viteve të fundit, me një shumë totale më të madhe se 17.000.000 dollarë amerikanë, përfshirë edhe një kështjellë dhe disa objekte të tjera në të njëjtën zonë të Evropës Jugore. Këto investime nuk u financuan nga banka por nga 'Speedy Inc', një shoqëri e kontrolluar nga familja Anderson, që banonte në të njëjtin shtet me familjen Jameson. Familja Jameson kishte plane të regjistruara me

17. Marrë nga Raporti i Grupit Egmont *NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont*

autoritetet vendore për hapjen e një kazinoje brenda në kështjellë. Kostoja e ndërtimit të kësaj kazinoje llogaritej rreth 3.500.000 Dollarë amerikanë.

Një prej pjesëtarëve të familjes Jameson përfaqësonte një shoqëri me seli në Shtetet e Bashkuara, që merrej me riblerjen e borxheve të siguruara të pronave në zonën e Evropës Juglindore.

Familja Anderson kishte blerë së fundmi në Francë dy motobarka të shpejta me vlerë rreth 17.000.000 Dollarë amerikanë nga një kantier detar i kontrolluar nga një pjesëtar i familjes Jameson. Ky kantier anijesh kishte hapur së fundmi një filial në zonën e Evropës Juglindore për të cilën një bankë vendase kishte raportuar transaksion të dyshimtë në FIU-n kombëtar lidhur me transaksionet e mëdha në para fizike që bëheshin midis llogarive të shoqërisë.

Analistët identifikuan një tjetër aspekt interesant: stili i jetesës së familjes Jameson nuk përputhej me shumën e deklaruar të investimeve në Evropë. Dukej se ata kishin të ardhura të pakta dhe jetonin në shtëpi joluksoze që financohej thuajse tërësisht nga hipoteka.

Për më tepër, sipas agjencive vendase të antidrogës, familja kishte lidhje me një kriminel që dihej se ishte i përfshirë në trafikun e drogës.

Gjithë ky informacion, i ndërthurur me informacionin e marrë nga dy FIU të tjera i ndihmoi analistët të dilnin në përfundimin se kishin të bënin me transaksione financiare të një organizate të madhe kriminale dhe për pasojë vendosën t'ia kalonin çështjen prokurorit, sikurse bënë edhe dy FIU-t e tjera në vendet përkatëse.

Prokurori hapi procedimin penal me akuzën e pastrimit të parave. Gjatë hetimeve të agjencive ligjzbatuese, u zbulua se familja Jameson njihej për kontrabandimin e makinave luksoze të vjedhura në fillim të viteve nëntëdhjetë. Nëpërmjet kësaj veprimtarie mund ta kishin grumbulluar kapitalin bazë për pasurinë aktuale dhe veprimtaritë kriminale.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- Paralajmërimi i FinCEN FIN-2017-A003, *Paralajmërim për Institucionet Financiare dhe Firmat dhe Profesionistët e Pasurive të Paluajtshme*.
- Shoqata Kombëtare e SHBA-ve për Relatorët Udhëzuesit Vullnetarë kundër Pastrimit të Parave për Profesionistët e Pasurive të Paluajtshme 16/02/2021. <https://www.narfocuse.com/billdatabase/clientfiles/172/4/1695.pdf>
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont.
- Raportet vjetore 2016, 2018, 2020, 2021 publikuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>

6.

Sistemet informale të transferimit të vlerës

Kanalet informale janë mekanizma thelbësorë që operojnë tërësisht ose pjesërisht jashtë kanaleve tradicionale të veprimtarisë bankare. Disa prej tyre lidhen me zona të veçanta gjeografike dhe grupe etnike ose emigrante që jetojnë në vendet evropiane. Në ditët e sotme, sistemet e dërgesave të parave në shumë vende, në varësi të zonës ose grupit etnik që i përdor ato, njihen me emra të ndryshëm: "hawala" (Lindje e Mesme, Afganistan dhe Pakistan), "hundi" (India), "feich'ien" ose "chop" (Kinë), "Phoekuan" (Tailandë).

Disa prej këtyre sistemeve, si hawala, bazohen në besë dhe përdoren nga individë, biznese, madje edhe qeveri të ndryshme për të dërguar fonde brenda e jashtë territorit të tyre kombëtar. Disa komunitete emigrantësh që jetojnë në vendet perëndimore i përdorin këto sisteme për t'u dërguar para të afërmeve në atdhe.

Për të kuptuar se si funksionojnë këta mekanizma, mund të shohim se si funksion hawala, një metodë informale e përdorur gjerësisht për transferimin e vlerave. Hawala në gjuhën arabe do të thotë "transfertë" dhe është sistem i cili funksion duke transferuar para pa qenë e nevojshme që ato të lëvizin fizikisht.

Hawala përdoret nga hawaladar-i (ose "ndërmjetësi") i cili dorëzon para nga rezerva ose llogaria e tij e parave fizike me kërkesë të hawaladar-it homolog në një vend tjetër në rolin e klientit.


Në vendin A, klienti i dorëzon një shumë të caktuar parash hawaladar-it dhe kërkon që shuma barsvlerëse (zakonisht në valutën të vendit pritës) t'i dërgohet marrësit të caktuar në vendin B.

Hawaladar-i dërgues ia përcjell të gjithë informacionin e nevojshëm rreth transaksionit një hawaladar-i homolog në vendin B, ose nëpërmjet telefonit ose me email. Në këtë fazë të procesit, dy hawaladar-ët bien dakord për "kodin" ose provën e marrjes.

Hawaladar-i në vendin A ia komunikon këtë kod klientit, i cili, nga ana tjetër, ia përcjell atë marrësit të caktuar në vendin B. Hawaladar-i në vendin B ia dorëzon këto para marrësit pasi ky i fundit të ketë paraqitur provën.

Nëse klienti dërgues është njëkohësisht edhe marrësi, ai/ajo duhet t'i paraqesë provën hawaladar-it homolog, pasi të ketë mbërritur në vendin B, përpara se t'i dorëzohen paratë.

Së fundi, hawaladar-ët mund t'i shlyejnë llogaritë me disa mënyra, si p.sh. nëpërmjet pagesave kompensuese (p.sh kur dikush dërgon para nga vendi B në vendin A), transfertave bankare, çeqeve, lëvizjeve fizike të parave (korrierët e parave) ose manipulimit të faturave tregtare (mbifaturimi).



Shumë transaksione hawala e kanë origjinën ose të paktën kalojnë nëpërmjet qendrave financiare si Dubai ose Jemeni. Disa vende, si Emiratet e Bashkuara Arabe (UAE), i kanë rregulluar veprimtaritë e operatorëve hawala dhe kërkojnë regjistrim dhe mbledhje informacioni për identitetin e dërguesve dhe marrësve në formate të veçanta që i duhen dorëzuar periodikisht Bankës Qendrore. Operatorët janë të detyruar të raportojnë transaksionet e dyshimta.

Gjatë hetimit, administrimi i operatorëve hawala dhe rrjeteve të tyre është sfidë e madhe për organet ligjzbatuese për disa arsye:

- Mungesës së dokumenteve provë të standardizuara.
- Mungesës së dokumenteve provë të NjKT-së.
- Përzjerjes së shpeshtë të hawala-s me biznese të tjera.
- Pengesave gjuhësore dhe kulturore.
- Ekzistencës së ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme në rang ndërkombëtar.

Librat hawala janë zakonisht jo gjithëpërfshirëse, ndonjëherë shënimet mbahen në gjuhë të huaj, ose përdoren iniciale apo kode të vështira për t'u deshifruar pa bashkëpunuar me ata që i kanë krijuar, ose pa marrë informacione të shumta për deshifrimin e tyre.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku merren nga raporti i FATF-së¹⁸, lidhur me modelet e transaksionit:

- Përdorimi i gjerë i llogarive kolektive. Këto mund të identifikohen nga institucionet raportuese vetëm nëse në llogaritë bankare të individëve depozitohen shuma të mëdha llogarish bankare (që zakonisht e përcaktojnë emrin në rreshtin e referencës), ose nëse depozitohen sasi të mëdha parash në intervale të rregullta kohore përpara se transfertat që përmbledhin të gjitha shumat më të vogla të llogarisë të kalojnë në llogari të huaja. Treguesit e këtyre llogarive kolektive mund të jenë individë të organizuar, mundësisht nën mbrojtjen e një shoqate kulturore që mbledh para nëpërmjet sistemit bankar, ose

18. RAPORTI I FATF-SË (2013) ROLI I HAWALA-S DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË TJERA TË NGJASHME NË PASTRIMIN E PARAVE DHE FINANCIJIMIN E TERRORIZMIT.

një apo më shumë individë që bëjnë një transfertë të agreguar të një shume të madhe parash në një bankë ose shërbim dërgese të remitancave që ndodhet jashtë vendit.

- Paratë që transferohen në intervale të rregullta kohore në vendndodhje ndërkombëtare si Dubai. Dubai është "shtëpi" e madhe ndërkombëtare për pastrimin e dërgesave të parave dhe transfertave të tjera me vlerë. Paratë e shumë shoqërive tregtare/kriminale kalojnë nga Dubai drejt destinacioneve të tjera, nëpërmjet kanaleve hawala. Pjesa më e madhe e transaksioneve hawala kalojnë nëpër destinacione të mëdha ndërkombëtare si Dubai.
- Përdoret një llogari si depozitë e përkohshme dhe fondet transferohen menjëherë në drejtim të dhe jashtë llogarisë.
- Përdorimi i llogarive të palëve të treta për të fshehur ose shmangur gjurmimin nga autoritetet. Zakonisht, këto llogari të palëve të treta nuk kanë lidhje biznesi me hawaladar-in ose dërguesin.
- Transferta elektronike të shpeshta nga një llogari në vendin e dërgimit drejt një llogarie të një banke ndërkombëtare.
- Transferta elektronike të shpeshta që tregtarët dërgojnë drejt vendeve të tjera, të cilat duket se nuk kanë asnjë lidhje biznesi me vendet e destinacionit.
- Dërguesit ose ndërmjetësit e parave kryejnë transaksione që janë nën pragjet raportuese të identifikimit, RTD-së ose Raportit të Transaksioneve të Monedhës (RTM).
- Llogaritë e biznesit përdoren për të marrë ose disbursuar shuma të mëdha parash por nuk tregojnë asnjë veprimtari përkatëse biznesi si pagesat e listë pagesave, faturave etj.
- Depozita të shpeshta të çeqeve dhe mandateve për depozitim parash nga palë të treta në llogari biznesi ose personale.
- Transferta të shpeshta elektronike ndërkombëtare nga llogari bankare që nuk janë në përputhje me veprimtarinë e deklaruar të biznesit.
- Depozita të shpeshta nga individë të shumtë në një llogari të vetme bankare, ndjekur nga transfertat elektronike ndërkombëtare dhe/ose tërheqje ndërkombëtare nëpërmjet bankomateve.
- Ndryshime të befta të modelit të transaksioneve financiare nga transfertat ndërkombëtare të fondeve me vlerë të ulët nga një shërbim i dërgimit të parave.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 11¹⁹

Zoti X, një shtetas pakistanez që jeton në Kanada, operonte një shërbim për transfertat parash biznesi në Montreal, Kanada, për të transferuar para jashtë shtetit nëpërmjet sistemit informal të transferimit të parave të quajtur "hawala", duke përdorur një rrjet personash dhe/ose shërbimesh për transferimin e parave përtej kufijve kombëtarë, në drejtim të kufijve ndërkombëtarë, pa u mbështetur te sistemet dhe rregulloret bankare.

Një dëshmitar bashkëpunëtor, që vepronte nën drejtimin e organeve ligjzbatuese, u shtir, përpara Z. X dhe ortakëve të tij, se ishte i përfshirë në trafik ndërkombëtar droge dhe në kontrabandimin ndërkombëtar të cigareve të falsifikuara.

Gjatë 23 muajve, Z. X e ndihmoi të bashkëpunëtorin Z. Y në 10 transfertat hawala, shuma totale e të cilave arrinte deri në 828.000 Dollarë amerikanë të ofruara nga dëshmitari bashkëpunëtor. Dëshmitari bashkëpunëtor tha se paratë që do të transferoheshin ishin produkte të trafikut të drogës dhe Z. X i kishte pastruar këto fonde duke besuar se do të përdroreshin për të mbështetur ato veprimtari.

19. Marrë nga raporti i FAFT-së (qershor 2010) Pastrimi i parave nëpërmjet Dërgesave të Parave dhe Ofruesve të Shkëmbimeve Valutore.

Rasti 12²⁰

Pesë individë dyshoheshin se ishin përfshirë në transferta hawala për shkak të xhirove të mëdha, transaksioneve të strukturuar dhe transaksioneve me palë homologe jo të lidhura me njëra-tjetrën. Disa prej këtyre individëve po hetoheshin tashmë nga agjencitë ligjzbatuese.

Bankat dhanë disa RTD kundër një individi, Z. W, për shkak të volumit/frekuencës së lartë të transaksioneve të kryera në llogarinë e tij dhe transaksioneve me palë jo të lidhura me njëra-tjetrën. Pas analizës dhe kërkimit në bazën e të dhënave, u zbulua se disa individë/biznese ishin të lidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet disa faktorëve, si adresa/vendndodhje gjeografike të ngjashme, numra kontakti, transaksione nga/drejt llogarive të mbajtura nga këta individë dhe bizneseve me natyrë të ngjashme. Këta individë ishin Z. P, Z. C, Z. A dhe Z. B, kundër të cilëve u raportuan disa RTD nga banka të ndryshme.

Detajet e llogarive të këtyre individëve u kërkuan nga disa banka. Individët mbanin kryesisht llogari pronësore në emër të disa bizneseve. Shumica e llogarive të tyre ishte aktive. Nëpër këto llogari kishin kaluar volume të mëdha fondesh dhe ishin vërejtur shuma të mëdha parash. Transaksionet në llogari ishin kryer me individë/subjekte të ndryshme të angazhuara me biznese të ndryshme dhe jo të lidhura me njëra-tjetrën, në rajone të ndryshme. Individët u deklaruan si pronarë të bizneseve të ndryshme që merreshin me tregtinë e frutave të thata dhe orizit. Individët e zhvillonin biznesin dhe i kishin hapur llogaritë kryesisht në qytetin AK, që ndodhet afër kufirit.

Nga baza e të dhënave e publikimeve, u zbulua se tre raporte të inteligjencës financiare lidheshin me individët në fjalë dhe se ortakët e tyre ishin të njohur tashmë për agjencitë kombëtare të hetimit pasi dyshonin se ishin përfshirë në veprën penale të hawala-s.

Për më tepër informacion, u aksesua baza e të dhënave tatimore për pesë individë dhe u arrit në përfundimin se të pestë individët ishin regjistruar pranë autoriteteve tatimore dhe individët kishin përmendur biznese të ndryshme në profilet e tyre tatimore. Individët i paguan autoriteteve tatimore një shumë nominale të tatimit mbi të ardhurat, krahasuar me miliardat e Rupive që qarkullonin në llogaritë e tyre.

Duke u nisur nga veprimtaria e llogarive dhe bizneseve që ndodheshin në zonë me rrezik të lartë, inteligjenca financiare iu vu në dispozicion agjencisë kombëtare të hetimit për ta këqyrur më tej për çështjen.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- *RAPORTI I FATF-SË (2013) ROLI I HAWALA-S DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË TJERA TË NGJASHME NË PASTRIMIN E PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT*
- Raporti Paralajmërues i FinCEN, Botimi 33 *Sistemet Informale të Transferimit të Vlerave*.
- Raporti i FATF-së (qershor 2010) *Pastrimi i parave nëpërmjet Dërgesave të Parave dhe Ofruesve të Shkëmbimeve Valutore*.
- Raporti APG *Raporti Vjetor i Tipologjive 2022*.
- Europol (2023), *Vlerësimi i Kërcënimeve të Krimit Financiar dhe Ekonomik Evropian 2023 - Ana tjetër e medaljes: Një analizë e krimit financiar dhe ekonomik, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, Luksemburg*.

20. Marrë nga raporti APG *Raporti Vjetor i Tipologjive 2022*.

7.

Përdorimi i profesionistëve ligjorë

Profesionistët ligjorë nuk janë grup homogjen, por ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, madje edhe brenda vendit. Titujt që u janë dhënë profesionistëve të ndryshëm ligjorë ndryshojnë sipas vendeve dhe i njëjti titull nuk ka të njëjtin kuptim ose objekt përgjegjësie nga vendi në vend.

Që prej rishikimit të rekomandimeve në vitin 2013, rekomandimet e FATF-së u kërkojnë shprehimisht profesionistëve ligjorë që të kryejnë KDK dhe dorëzojnë RTD. Që prej asaj kohe, autoriteteve kompetente u është kërkuar të sigurojnë mbikëqyrjen e profesionistëve ligjorë për qëllimet e PP/FT-së, por zbatimi i plotë i këtyre rekomandimeve të veçanta nuk ka qenë universal.

E drejta e klientit për të pasur këshillim dhe përfaqësim juridik, që të jetë i sigurt me këshilltarin e tij ligjor dhe të mos ketë frikë se bisedat me të do të përdoren kundër tij, njihet si një prej aspekteve më themelore të së drejtës për qasje në drejtësi, të njohur nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Termat “konfidencialitet”, “privilegj profesional juridik” dhe “sekret profesional” përdoren ndërkëmbështet me njëri-tjetrin për të përshkruar mbrojtjen që parashikon kjo e drejtë.

Kriminelët duan t'i përfshijnë profesionistët ligjorë në skemat e pastrimit të parave, pasi me raste u kërkojnë të përmbyllin transaksione të caktuara, por edhe për të pasur qasje në aftësi dhe shërbime të specializuara ligjore dhe noteriale që do t'i ndihmonin të pastronin produktet e krimit.

Këto janë metodat kryesore të PP-së për të cilat kanë zakonisht nevojë për shërbimet e profesionistëve ligjorë:

- Përdorimi i llogarive të klientëve: Përdorimi i llogarive të klientëve është pjesë e shumë transaksioneve të ligjshme që kryejnë profesionistët ligjorë, gjë që i josh kriminelët t'i përdorin si pjesë të hapit të parë të konvertimit të produkteve në para fizike që burojnë nga veprimtaria kriminale në pasuri më pak të dyshimta. Kjo siguron qasje në sisteme financiare ku kriminelët mund të jenë të dyshimtë ose të padëshiruar nga një institucion financiar si klientë, shërben për të ndihmuar në fshehjen e pronësisë së fondeve ose pasurive të tjera që burojnë nga veprimtaria kriminale dhe lehtëson skemat e pastrimit të parave si blerjen e pasurive të paluajtshme, krijimin e shoqërive guaskë dhe transferimin e produkteve të krimit.
- Blerja e pasurive të paluajtshme: Investimet në pasuri të paluajtshme mbeten mjaft tërheqëse si për kriminelët, ashtu edhe për personat e tjerë. Rrjedhimisht, blerja e pasurive të paluajtshme është metodë që përdoret gjerësisht për produktet e krimit.

- Pasuritë e paluajtshme janë në përgjithësi pasuri me vlerë, shitja e të cilave mund të përbëjë arsye të ligjshme për gjenerimin e fondeve. Në shumë vende, ligji kërkon që transferimi i pronave të realizohet nga profesionistë ligjorë, ndërsa në vende të tjera shihet më tepër si çështje zakoni dhe praktike, por roli i veçantë i profesionistëve ligjorë në transaksionet e pasurive të paluajtshme ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend. Edhe nëse paratë nuk menaxhohen nga profesionisti ligjor, ai/ ajo ka informacion për detajet dhe në shumë raste është në pozitë që të bëjë pyetje të mëtejshme rreth blerjes ose shitjes.
- Krijimi i trusteve dhe shoqërive: Zakonisht, kriminelët kërkojnë mundësi kontrolli mbi pasuritë që burojnë nga veprimtaria kriminale duke pënguar kështu aftësinë e agjencive ligjzbatuese për të gjurmuar origjinën dhe pronësinë e pasurive. Kriminelët i shohin korporatat dhe trustet si mjete të dobishme për arritjen e këtij rezultati.
- Administrimi i trusteve dhe shoqërive - Duke qenë se krijimi i shoqërive dhe trusteve është një prej fushave më thelbësore ku përfshihen profesionistët ligjorë, kriminelët kërkojnë zakonisht t'i përfshijnë ata në menaxhimin e këtyre shoqërive dhe trusteve për të pasur siguri më të madhe, por edhe për të garantuar përputhshmërinë dhe legjitimitetin e subjektit dhe veprimtarive të tij.
- Krijimi dhe administrimi i organizatave të bamirësisë - Profesionistët ligjorë mund të përfshihen në krijimin e organizatave të bamirësisë ose organizatave të tjera jofitimprurëse, duke vepruar si person i besuar dhe duke ofruar këshillim për çështje ligjore që lidhen me bamirësinë, përfshirë edhe këshillim për hetime të brendshme.

Ndonëse në ofrimin e këtyre shërbimeve të ligjshme, të cilat mund të keqpërdoren nga kriminelët, nuk marrin pjesë të gjithë profesionistët ligjorë, ata mund të përdoren si "lustër e jashtme" për përputhshmërinë e veprimtarisë së klientit, gjë që e bën qasjen e profesionistëve ligjorë në llogaritë e klientëve tërheqëse për kriminelët.


Mes kriminelëve mbizotëron një lloj perceptimi se privilegji profesional ligjor/sekreti profesional e vonon, pengon ose parandalon hetimin apo ndjekjen penale të autoriteteve nëse përdorin shërbimet e profesionistit ligjor.

Pesë veprat kryesore penale mëmë që lidhen me RTD-në nga profesionistët ligjorë janë:

- korrupsioni dhe mitëmarrja/mitëdhënia,
- mashtrimi,
- krimet tatimore,
- trafiku i lëndëve narkotike dhe psikotrope,
- vepra penale të paqarta, por nivele të pashpjegueshme të parave fizike ose financimeve private.

Krimineli mund ta kërkojë përdorimin e profesionistit ligjor sepse ka nevojë për këshillimin e një eksperti për të ndërtuar skemat e komplikuara të pastrimit të shumave të mëdha të parave dhe do të përdorë profesionist ligjor të korruptuar, ose do të gjejë dikë të gatshëm ta ndihmojë.

Përfshirja e një profesionist ligjor në pastrimin e parave mund të përshkruhet si vijon:



Burimi: Raporti i FATF-së për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku janë marrë nga raporti i OECD-së²¹ dhe ndahen në katër kategori kryesore:

- Shërbime të pazakonta që ofrohen nga ofruesi i shërbimit profesional:
 - Ofrimi i shërbimit nuk është pjesë e punës së përditshme.
 - Përdorimi i llogarive “escrow” për transaksione që nuk lidhen me punën.
- Zgjedhja e një ofruesi të pazakontë shërbimesh profesionale:
 - Largësia gjeografike midis klientit dhe ofruesit të shërbimit profesional është shumë e madhe.
 - Shërbimet e kërkuara e tejkalojnë volumnin e shërbimeve që ofron zakonisht ofruesi i shërbimit profesional.
- Shpërblim i pazakontë i ofruesit të shërbimit profesional:
 - Shpërblime të larta, të pazakonta për shërbimet.
 - Shpërblimi ka natyrë të pazakontë.
- Transaksione, të ardhura ose pasuri të pazakonta të ofruesit të shërbimit:
 - Transaksione që nuk janë tipike për veprimtaritë e përditshme, të ardhurat e rregullta, pasuritë ose modelet e shpenzimit.
 - Transaksione private ose shtim i pazakontë i pasurisë.

21. Raporti i OECD-së, *Doracaku i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit*.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 13²²

Personi A bleu dy prona të paluajtshme në vitin 2007 me çmim të kombinuar prej 150 000 eurosh. Po të njëjtat prona iu shitën në vitin 2010 personit B me një çmim të kombinuar prej 413 600 eurosh. Noteri kërkoi të shihte detajet e pagesave midis shitësit dhe blerësit, përpara se ta noterizonte shitjen. Atij iu dhanë disa prova që tregonin se të gjitha depozitat e parave gjatë dy muajve të fundit ishin nën pragun e raportimit prej 100 000 eurosh.

Personi B njihej publikisht për mashtrime në sektorin e mjeteve automobilistike. Noteri dorëzoi një RTD.

Rasti 14²³

Tracfin-it (FIU francez) i tërhoqi vëmendjen fluksi jotipik financiar lidhur me blerjet e pasurive të paluajtshme që ishin bërë në rajonet Midi-Pyrénées, Languedoc-Roussillon dhe Provence-Alpes-Côte d'Azur.

Analiza zbuloi një rrjet të mundshëm të organizuar kriminal ku merrnin pjesë persona që ishin ose kishin qenë anëtarë të Legjionit të Huaj. Rekrutët kishin kryesisht shtetësi të huaj të njëjtë dhe ishin anëtarë të një shoqërie civile të pasurive të paluajtshme (skemë investimesh në prona).

Gjatë dy viteve, një noteri regjistroi 28 akte transferimi të pronave të paluajtshme për këtë grup. Të gjitha shitjet, përveç njëjës, ishin zyrtarizuar në të njëjtën noteri. Ishin renditur si blerës dymbëdhjetë individë dhe gjashtë shoqëri civile pasurish të paluajtshme (shoqëri jotregtare), ndërsa si shitës të pronave ishin renditur shtatë individë dhe pesë shoqëri.

Nga 28 akte, 16 prej tyre me shumë 1,925 milionë euro ishin paguar plotësisht, gjashtë ishin financuar nëpërmjet huave me shumë totale prej 841.149 eurosh, ndërsa burimi i financimit nuk ishte identifikuar për pesë prona me vlerë 308.200 euro.

Nëntë prej transaksioneve me vlerë 1,152 milionë euro ishin paguar plotësisht nga individët, shumë kjo mjaft e konsiderueshme duke marrë parasysh profesionin e klientëve.

Pronat ishin rishitur brenda periudhave relativisht të shkurtra. Për shembull, një prej pronave në Castres u rishit çdo vit me rritje të konsiderueshme të çmimit të shitjes. Të gjitha shitjet u regjistruan në të njëjtën noteri. Shoqëria e pasurive të paluajtshme e kishte gjashtëfishuar kështu çmimin e rishitjes së kësaj prone.

Në disa raste, shitësit pretenduan se vlera e pronës ishte rritur për shkak të punimeve në pronë (që në fakt, nuk ishin kryer). Noteri regjistroi dy transaksione të tjera në vitin 2011 të cilat u shlyen në para fizike dhe u kryen në largësi të konsiderueshme nga noteria.

22. Marrë nga Raporti i FATF-së (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.

23. Marrë nga Raporti i FATF-së (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- FATF (2018), Pastrimi Profesional i Parave, FATF, Paris, Francë www.fatf-gafi.org/publications/methodandtrends/documents/professional-money-laundering.html
- FATF (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.
- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjesimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>
- Raportet vjetore 2016, 2017 Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>

8.

Përdorimi i mjeteve korporative ndërkombëtare komplekse

Për të fshehur pronësinë reale të pasurive të paligjshme, përdoret gjerësisht krijimi i strukturave komplekse, zakonisht duke përfshirë përdorimin e territoreve jobashkëpunuese dhe veçanërisht të mjeteve korporative të mjegullta, si përdorimi i trusteve.

Për krijimin e këtyre strukturave komplekse, nevojitet përfshirja e profesionsitëve. Në këtë drejtim, roli kryesor luhet nga konsulencat profesioniste dhe bankat offshore, nëpërmjet të cilave fshihen flukset monetare. Të dyja u ofrojnë klientëve të tyre personalizim të të gjitha llojeve të mjeteve korporative.

Në këto raste, fondet e paligjshme dërgohen në një juridiksion offshore për pastrim, përpara se të integrohen në sistemin e ligjshëm. Për këtë, fondet sillen në sistemin financiar ose në para fizike nëpërmjet çeqeve për depozitim në llogaritë pritëse, të cilat përdoren si llogari të hapura dhe mund të jenë llogari të veçanta ose llogari të mbajtura nga një shoqëri e nominuar ose trust jorezident. Metoda më e thjeshtë është transferimi i fondeve nga banka pritëse, duke përdorur llogaritë në banka korrespondente offshore, drejt bankave filiale në parajsat fiskale. Fondet kalohen më pas në llogaritë e kreditimit në emër të strukturave të trustit (shoqëri offshore dhe truste).

Të ardhurat e padeklaruara mund të kalojnë drejtpërsëdrejti edhe në llogari offshore. Fondet mund të transferohen mbrapsht nga banka marrëse drejt vendit të rezidencës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive. Sa më shumë llogari ndërmjetëse të përdoren për kanalizimin e fondeve, aq më shumë vështirësohet gjurmimi i tyre.

Nëse nuk ka marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis bankës dërguese ose bankës pritëse fundore dhe bankës offshore, fondet duhet të transferohen duke përdorur llogaritë e bankave të huaja korrespondente. Ndonjëherë, informacioni për transfertat e fondeve, që dërgohet zakonisht me SWIFT, nuk i përmban të dhënat e nevojshme për identifikimin e përfituesve fundorë.

Fondet mund të kalohen fillimisht në llogari bankare që ndodhen jashtë vendit ku janë gjeneruar produktet, sepse produktet janë përftuar jashtë vendit, ose sepse fondet janë dërguar jashtë vendit nëpërmjet parave fizike ose çeqeve.

Për sa u përket skemave për fshehjen e pronarit përfitues të pasurive në vendin ku banon krimineli, përdoren gjerësisht shoqëritë e strukturuar ndërkombëtare offshore. Për shembull, këto shoqëri

mbajtëse zotërojnë thuajse 100% të aksioneve dhe aksionarët e nominuar mund të jenë përfaqësues, ose persona të besuar (anëtarë të konsulencave profesioniste ose bankave offshore).

Një pronar plotësisht i identifikueshëm ka aksione me vlerë 1%. Ky pronar mund të jetë i nominuar ose profesionist ligjor në vendin e rezidencës së pronarit përfitues. Këshilltari profesionist ideon operacionet për klientët: themelon shoqërinë rezidente ose e blen nga një agjent i specializuar në themelimin e shoqërive, i organizon klientit themelimin ose blerjen e shoqërisë offshore, administron formalisht shoqërinë rezidente ose emëron të nominuarit. Shoqëria rezidente dhe offshore zakonisht përfaqësohen nga disa avokatë profesionistë që merren me transaksionet dhe veprimtaritë e shoqërisë.

Prona blihet nga shoqëria rezidente, por fondet e nevojshme ofrohen nga shoqëria offshore nëpërmjet investimeve të shoqërisë jorezidente në kapitalin rezident ose nëpërmjet huave jorezidente. Fondet e shoqërisë offshore mund të jenë marrë më parë nga vendi i rezidencës ose mund të jenë tashmë në parajsë fiskale, ose mund të jenë mbajtur në llogari bankare në vendin e shoqërive rezidente, por në shoqëri offshore. Llogaritë bankare të konsulencave profesionale përdoren zakonisht për kanalizimin e fondeve që do të investohen në shoqërinë rezidente, duke e bërë gjurmimin dhe zbulimin më të vështirë.

Gjatë transferimit të pronësisë, shoqëria offshore i shet aksionet e shoqërisë rezidente duke i regjistruar me vlerë nominale shumë më të ulët se vlera e tregut. Fitimi i gjeneruar depozitohet në shoqërinë offshore, ku fondet mund të dërgohen duke përdorur llogarinë e konsulentit profesionist.

Nëse shoqëria offshore mban aksione vetëm në shoqërinë rezidente që zotëron pronën, transfertat e pronësisë mund të bëhet nëpërmjet shoqërisë mbajtëse dhe jo shoqërisë rezidente.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku janë marrë nga raporti i FATF-së:²⁴

- Transaksione që kërkojnë përdorimin e subjekteve dhe marrëveshjeve ligjore komplekse dhe të mjegullta;
- Pagesa e "tarifave të konsulencës" pranë shoqërive guaskë të themeluara në juridiksione të huaja ose juridiksione të njohura për themelimin e shoqërive të shumta guaskë;
- Transfertat e fondeve në formën e "huave" drejt individëve nga trustet dhe shoqëritë guaskë jobankare. Këto "hua" të pazakonta lehtësojnë sistemin e transfertave të rregullta kundrejt këtyre mjeteve korporative nga huamarrësit në formën e "kësteve të huasë";
- Rastet e korrupsionit kur shoqëria që jep mitën për të siguruar kontratën, ose personi që ndërmjetëson kontratën kërkon të ketë rezultat të suksesshëm duke përdorur një ofrues për operimin e trustit me fonde që mbahen në depozitë në përfitim të personit që miraton kontratën;
- Përdorimi i ofruesve në juridiksione që nuk u kërkojnë ofruesve të sigurojnë, mbajnë ose t'i dorëzojnë autoriteteve kompetente informacion për pronësinë përfituese të strukturave korporative të themeluara prej tyre;
- Përdorimi i personave dhe marrëveshjeve ligjore në juridiksione pa legjislacion PP/FT dhe/ose dokumentacion të dobët për mbikëqyrjen dhe monitorimin e ofruesve;
- Përdorimi i personave dhe marrëveshjeve ligjore që operojnë në juridiksione ku ka në fuqi legjislacion për fshehtësinë;

24. Raporti i FATF-së *Pastrimi i Parave duke përdorur Trustet dhe Ofruesit e Shërbimeve për Shoqëritë*.

- Përdorimi i marrëveshjeve të nominimit nga klientët e mundshëm për të fshehur pronësinë përfituese të shoqërive kliente;
- Transaksionet e disa huave midis shoqërive dhe/ose transfertat elektronike shumë juridiksionale që nuk kanë qëllim ligjor ose tregtar;
- Klientë që kërkojnë përdorimin e shoqërive guaskë të themeluara paraprakisht në juridiksione që lejojnë përdorimin e tyre, por nuk kërkojnë përditësim të informacionit për pronësinë; dhe
- Ofrues që e reklamojnë veten dhe/ose juridiksionet e tyre si lehtësues të anonimitetit dhe pronësisë së fshehtë të pasurive.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 15²⁵

H-ja, punonjës i një zyre avokatie, ishte administratori i 300 shoqërive të themeluara pranë zyrës së avokatisë në emër të klientëve të tij, shumë prej të cilëve njiheshin si të përfshirë në organizata kriminale ndërkombëtare.

Shumica e shoqërive ishin shoqëri guaskë të themeluara në shtetin amerikan, megjithëse disa shoqëri ishin themeluar në Spanjë me qëllim që të përdroreshin në skemat e pastrimit të parave nëpërmjet tregut të pasurive të paluajtshme.

Shoqëritë spanjolle ishin në pronësinë e korporatave guaskë të regjistruara në shtetin amerikan dhe këto shoqëri të themeluara paraprakisht ishin themeluar duke përdorur emrin e agjentit, zakonisht të një avokati.

Dokumentet e themelimit të këtyre shoqërive mbetën joaktive në duart e agjentit, deri kur shoqëria u ble nga një klient. Në momentin e blerjes, shoqëria u bë aktive.

Bordi i këtyre shoqërive të themeluara paraprakisht në momentin e regjistrimit fillestar, do të përfshinte agjentin dhe ortakët e tij, të cilët nuk kishin lidhje me pronarët e vërtetë që kishin blerë shoqërinë guaskë.

Rasti 16²⁶

Një klient i huaj iu afrua dy profesionistëve ligjorë për të blerë dy prona: njëra në Alpes-Maritimes (Jugu i Francës) dhe tjetra në Paris, me vlerë 11 milionë euro.

Çmimi i blerjes finançohej plotësisht nga blerësi (nuk kishte hipotekë) dhe fondet u dërguan nëpërmjet bankës në një juridiksion offshore.

Në prag të nënshkrimit të kontratës, pati një ndryshim të udhëzimeve dhe blerësi u zëvendësua me një shoqëri të investimeve në prona. Aksionarë të shoqërisë ishin dy fëmijët e mitur të klientit.

25. Raporti i FATF-së *Pastrimi i Parave duke përdorur Trustet dhe Ofruesit e Shërbimeve për Shoqëritë*.

26. Marrë nga Raporti i FATF-së (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.

Klienti i huaj kishte funksion të rëndësishëm politik në vendin e tij dhe kishte informacion publik të disponueshëm rreth përfshirjes së tij në shkelje financiare.

Rasti 17²⁷

Një kriminel që bënte kontrabandë në Mbretërinë e Bashkuar kishte krijuar një trust për pastrimin e produkteve të veprave të tij, me ndihmën e Këshilltarit të Pavarur Financiar (IFA) dhe avokatit, i cili duket se ishte në dijeni të faktit se individi ishte kriminel. Trusti ishte diskrecionar dhe rrjedhimisht tagri i administrimit i kishte kaluar personave të besuar, më konkretisht kriminelit, bashkëshortes së tij dhe IFA-së.

Krimineli kishte blerë një garazh, i cili i ishte transferuar drejtpërdrejt vajzës së tij (e cila ishte edhe një nga përfitueset e trustit). Ajo nga ana tjetër ia kishte dhënë garazhin me qira një shoqërie. Garazhi i ishte shitur shoqërisë dhe blerja ishte financuar nga një hua që kishte dhënë Trusti. Rrjedhimisht, shoqëria i kishte paguar zyrtarisht Trustit, dhe praktikisht kriminelit, këste prej mijëra paundësh në muaj.

Kështu, krimineli që kishte qenë pronari fillestar i garazhit, e kishte me shumë gjasë edhe këtë në kontroll, pavarësisht pronësisë së vajzës. Nëpërmjet kontrollit të trustit, ai ishte në gjendje t'ia kanalizonte fondet mbrapsht vetes nëpërmjet huave nga trusti dhe të merrte pagesa për atë hua.

Rasti 18²⁸

Një profesionisti në Spanjë iu kërkua të themelonte disa shoqëri për klientët me qëllim blerjen e pasurive të paluajtshme.

Disa shoqëri ishin themeluar në Spanjë, por zotëroheshin nga shoqëri të cilat profesionistët ligjorë i kishin themeluar edhe në një shtet amerikan. Bordi i drejtorëve të shoqërive të themeluara në Amerikë përbëhej nga profesionistët ligjorë dhe punonjësit e tjerë të firmës ligjore. Më vonë, ata ia shitën këto shoqëri klientëve të tyre.

Profesionistët ligjorë themeluan mbi 300 shoqëri për klientët e firmës ligjore dhe vijuan t'i administronin këto shoqëri për klientët e tyre. Shumë klientë njiheshin se ishin të përfshirë në organizata kriminale ndërkombëtare.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- Raporti i FATF-së *Pastrimi i Parave duke përdorur Trustet dhe Ofruesit e Shërbimeve për Shoqëritë*.
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>
- FATF (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.
- Raportet vjetore 2012, 2013, 2017, 2019 publikuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>

27. Marrë nga Raporti i FATF-së (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.

28. Marrë nga Raporti i FATF-së (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.

9.

Përdorimi i shërbimeve të transferimit të parave

Shërbimet e transferimit të parave përkufizohen si shërbime financiare që pranojnë para fizike, çeqe, mjete të tjera monetare dhe objekte të tjera me vlerë në një vendndodhje të caktuar dhe ia paguajnë shumën korresponduese përfituesit në para fizike ose në një formë tjetër në një vendndodhje tjetër, duke përdorur komunikimin, mesazhet, transfertat ose rrjetin e pastrimit të cilit i përket shërbimi i transfertave.

Transaksionet që kryhen nga këto shërbime mund të përfshijnë një ose më shumë ndërmjetës dhe një palë të tretë që bën pagesën përfundimtare. Këto shërbime lidhen me dukurinë e rritjes së emigracionit, pasi janë zakonisht emigrantët ata që e përdorin këtë sistem për të dërguar para në atdhe.

Karakteristikat më të zakonshme të këtyre sistemeve janë:

- Dërgesat bëhen zakonisht midis personave fizikë.
- Shpejtësia. Është një prej mënyrave më të shpejta për të dërguar dhe marrë para kudo në botë.
- Besueshmëria. Transaksionet janë të mbrojtura. Kur dërgohen para, duhet shuma e saktë e parave që do të marrë përfituesi.
- Rrjet i gjerë. Këto shoqëri kanë rrjet të gjerë agjentësh ku operojnë; i lejon paratë të transferohen në vende me prani të paktë bankare.
- Thjeshtësia. Janë sisteme miqësore me përdoruesin.

Këto shërbime ofrojnë mundësi të konsiderueshme për kriminelët që duan të fshehin ose mbulojnë origjinën e fondeve nga veprimtaritë e paligjshme. Qarqet e transfertave bankare kanë qenë historikisht mënyrë e mirë për të pastruar fonde duke dërguar shuma të mëdha parash nëpërmjet strukturimit.

Për më tepër, këto shërbime ofrohen zakonisht nëpërmjet agjentëve që fitojnë një nivel të lartë autonomie. Kjo do të thotë se agjentët kanë aftësinë t'i ndryshojnë ose manipulojnë informacionet që u përcjellin shoqërive të tyre partnere dhe rrjedhimisht organizatat kriminale përpiqen t'i korruptojnë këta agjentë dhe t'i bëjnë të punojnë për ta.

Katër janë profilet e keqpërdorimit të këtyre shoqërive për qëllime të paligjshme:

- Ushtrimi i parregullt i veprimtarisë së transferimit të parave. Kjo veprimtari kryhet nga persona fizikë ose juridikë të paautorizuar. Këta persona nuk deklarojnë (ndonëse me raste e bëjnë), duke vëshirësuar

gjurmimin e kësaj sjelljeje. Gjasat janë që përdorimi i këtij sistemi të bëhet vetëm nëpërmjet rekomandimit personal ose nga persona që e kanë përdorur më parë shërbimin dhe kanë mbetur të kënaqur.

- Klientët e këtij sistemi bëjnë transferta në llogari bankare të hapura në emër të personit që e ofron shërbimin; kjo është mënyra se si e mbushin llogarinë dhe fluksi kryesor i fondeve që del nga kjo llogari përbëhet nga transfertat drejt llogarive të tjera, të hapura nga po i njëjti person ose ortak, duke qenë kështu llogaria e fundit ku janë transferuar fondet, këtë herë jashtë vendit, në përfitim të shoqërive me veprimtari specifike në transfertat e parave.
- Përdorimi i këtyre shërbimeve dhe i agjentëve të tyre për qëllime kriminale. Në këtë rast, organizata kriminale i pastron paratë e paligjshme duke përdorur shoqëri të ligjshme, të rregulluara dhe të regjistruara. Për këtë qëllim, kriminelët përdorin “mjete” për t’i anashkaluar masat parandaluese që zbatohen nga rregulloret kundër pastrimit të parave, si identitete të rreme, ndërmjetës, ose strukturim.
- Integrimi i agjentit të shoqërisë në strukturën kriminale. Në këtë rast, personat e lidhur ose të integruar në organizatë kriminale veprojnë si agjentë të shoqërisë së dërgesave të parave. Këta persona kryejnë veprimtari reale, duke menaxhuar transfertat e klientëve që u dërgojnë para të afërmeve në vendet e tyre të origjinës. Megjithatë, kjo vështirë se e mbulon objektivin real: injektimin e parave të paligjshme në sistemin financiar të ligjshëm (kontrolluar nga vetë organizata) dhe transferimin e tyre jashtë vendit.
- Së fundi, mund të ndodhë që shoqëria që bën transferimin e parave të jetë plotësisht nën kontrollin e organizatës kriminale, e cila i fut paratë e paligjshme të organizatës në sistem, pa bërë asnjë lloj kontrolli dhe duke penguar origjinën e parave.

Për t’i integruar paratë e paligjshme në sistem, atyre u duhen disa persona që “ofrojnë identitetet e tyre” për justifikimin e transaksioneve fiktive që nuk porositen në të vërtetë nga këta persona (në shumë raste këto identitete vidhen dhe personat nuk e dinë që dikush po transferon fonde duke përdorur identitetin e tyre). Kriminelët mund ta bëjnë këtë duke përdorur identitet të rremë dhe, në të gjitha rastet, duke i ndarë shumat e transferuara që të mos ngjallin dyshime.

1. TREGUESIT E RREZIKUT (ALARMET)

Këta tregues rreziku për veprimtaritë të parave janë marrë nga raporti i ABE-së²⁹ dhe ndahen në katër kategori kryesore:

Faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit

- Produkti lejon transaksione me vlerë të lartë ose me vlerë të pakufizuar;
- Produkti ose shërbimi ka shtrirje botërore;
- Transaksioni bëhet me para fizike ose financohet me para elektronike anonime, përfshirë paratë elektronike të përfituara nga përjashtimi sipas Nenit 12 të Direktivës 2015/849 (BE);
- Transfertat bëhen nga një ose disa pages në vende të ndryshme ndaj një personi vendas.

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Veprimtaria e biznesit të klientit:

²⁹ Marrë nga RAPORTI I ABE-SË EBA/GL/2021/2 - RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR UDHËZIMET MBI KUJDESIN E DUHUR TË KLIENIT DHE FAKTORËT QË INSTITUCIONET KREDITORE DHE FINANCAIRE DUHET TË MARRIN PARASYSH GJATË VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË DYFISHTË PP/FT LIDHUR ME MARRËDHËNIET INDIVIDUALE TË BIZNESIT DHE TRANSAKSIONE RASTËSORE.

- Klienti zotëron ose ushtron biznes që administron shuma të mëdha parash.
 - Biznesi i klientit ka strukturë pronësie të ndërlikuar.
 - Veprimtaria e klientit mund të lidhet me FT-në sepse njihet publikisht si simpatizant i ekstremizmit ose dihet se është i lidhur me grupe të krimit të organizuar.
- Sjellja e klientit:
 - Nevojat e klientit mund të shërbejnë më mirë gjetkë, për shembull sepse dërguesi i parave nuk ndodhet në vendin ku klienti banon ose ushtron veprimtarinë.
 - Klienti duket se vepron për dikë tjetër, për shembull, klienti mbikëqyret nga të tjerë, në vendin ku kryhet transaksioni ka persona të tjerë të pranishëm, ose klienti lexon udhëzime të shkruara.
 - Sjellja e klientit nuk ka kuptim ekonomik të qartë, për shembull, klienti pranon një kurs këmbimi me normë të ulët ose të lartë pa e vënë fare në diskutim, kërkon transaksion në valutë që nuk është zyrtare ose nuk përdoret gjerësisht brenda juridiksionit ku ndodhet klienti dhe/ose marrësi, ose kërkon apo ofron shuma të mëdha në prerje të vogla ose të mëdha.
 - Transaksionet e klientit janë gjithmonë fare pak nën pragun e zbatueshëm, përfshirë edhe pragun e KDK-së për transaksionet rastësore në Nenin 11(b) të Direktivës 2015/849 (BE) dhe pragut prej 1 000 euro të përcaktuar në Nenin 5(2) të Rregullores 2015/847 (BE). Firmat duhet të vërejnë se pragu në Nenin 5(2) të Rregullores 2015/847 (BE) zbatohet vetëm për transaksione që nuk financohen me para fizike ose para elektronike.
 - Përdorimi i shërbimit nga klienti është i pazakontë, për shembull dërgojnë ose marrin para nga vetja ose dërgojnë para menjëherë pasi i kanë marrë.
 - Klienti duket se di pak ose ngurron të japë informacion rreth palës së paguar.
 - Disa klientë të firmës ia transferojnë fondet të njëjtës pale të paguar ose duket se kanë të njëjtin informacion identifikues, për shembull të njëjtën adresë ose numër telefoni.
 - Transaksioni hyrës nuk shoqërohet me informacionin e kërkuar për palën pagueuse ose palën e paguar.
 - Shuma e marrë ose e dërguar nuk përkon me të ardhurat e klientit (nëse dihen).
 - Rritja e volumit ose numrit të transaksioneve nuk ndjek model të zakonshëm si p.sh. për pagat ose pagesat në rast festash kulturore.
 - Klienti jep gjeneralitete jokonsistente ose paraqet dokumente identifikimi që përmbajnë informacione jokonsistente.

Faktorët e rrezikut të kanalit të shpërndarjes

- Nuk ka kufizime të instrumentit të financimit, për shembull në përdorimin e parave fizike ose pagesave me produktet e parave elektronike që përfitojnë nga përjashtimi i Nenit 12 të Direktivës 2015/849 (BE), transfertat elektronike ose çeqet.
- Kanali i shpërndarjes ofron një lloj autonomie.
- I gjithë shërbimi ofrohet online pa mbrojtjet e duhura.
- Shërbimi i remitançave të parave ofrohet nga agjentë që:
 - përfaqësojnë më shumë se një principal;
 - paraqesin modele të pazakonta të xhiros krahasuar me agjentë të tjerë në vendndodhje të ngjashme, për shembull transaksione të pazakonta në shuma të mëdha ose të vogla, ose numër të madh transaksionesh që bien nën pragun e KDK-së, ose punojnë jashtë orëve normale të punës;
 - një pjesë të mirë të biznesit e bëjnë me palë pagueuse ose palë të paguara që ndodhen në juridiksione ku rreziku për PP/FT është më i madh;
 - duket se janë të pasigurt ose jokonsistentë me zbatimin e politikave kundër PP-së/FT-së në nivel mbarë grupi; ose

- nuk janë nga sektori financiar dhe kanë një tjetër biznes si biznes kryesor.
- Shërbimi i dërgesave të parave ofrohet nëpërmjet një rrjeti të madh agjentësh në juridiksione të ndryshme.
- Shërbimi i dërgesave të parave ofrohet nëpërmjet një zinxhiri tepër kompleks pagesash, për shembull me një numër të madh ndërmjetësish, që operojnë në juridiksione të ndryshme ose që lejojnë sisteme të pagjurmueshme pagesash (formale dhe joformale).

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- Pala paguese ose pala e paguar ndodhet, ose transaksioni ekzekutohet nga një adresë IP-je, në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i madh. Firmat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve që dihet se ofrojnë financime ose mbështetje për aktet terroriste, ose ku dihet se veprojnë grupe që kryejnë vepra penale terroriste, dhe juridiksioneve që u nënshtrohen sanksioneve financiare, embargove ose masave kundër financimit të terrorizmit, terrorizmit ose përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.
- Pala e paguar ndodhet në një juridiksion ku sektori bankar nuk ekziston ose është pak i zhvilluar, çka do të thotë se për pagesat mund të përdoren shërbimet informale të dërgesave të parave, si hawala.
- Homologu i firmës ndodhet në një vend të tretë ku rreziku i PP-së/FT-së është më i madh.
- Pala paguese ose pala e paguar ndodhet në një vend të tretë me rrezik të lartë.

Edhe faktorët e rrezikut që lidhen me pikat e këmbimit valutor janë marrë nga raporti i ABE-së, dhe paraqiten si më poshtë:

Faktorë të rrezikut të prodhimit, shërbimit dhe transaksionit

- Shuma e transaksionit është jashtëzakonisht e madhe në terma absolutë ose krahasuar me profilin e klientit;
- Transaksioni nuk ka qëllim të dukshëm ekonomik ose financiar;

Faktorë të tjerë të rrezikut të klientit

- Sjellja e klientit:
 - transaksionet e klientit janë nën pragun e zbatueshëm për KDK-në, veçanërisht kur këto janë të zakonshme ose kryhen brenda një periudhe të shkurtër kohore;
 - klienti nuk mund ose nuk ofron informacion rreth origjinës së fondeve;
 - klienti kërkon këmbimin e shumave të mëdha në valutë të huaj që nuk është e këmbueshme dhe nuk përdoret gjerësisht;
 - klienti këmben sasi të mëdha të prerjeve të vogla të një valute me prerje më të mëdha në valutë tjetër, ose anasjelltas.
 - Sjellja e klientit nuk ka kuptim ekonomik.
 - Klienti viziton shumë ambiente të së njëjtës firmë në të njëjtën ditë (ambiente të njohura nga firma);
 - Klienti pyet për pragun e identifikimit dhe/ose refuzon t'u përgjigjet pyetjeve rastësore ose rutinë;
 - Klienti i këmben fondet nga një valutë në një valutë tjetër;
 - Këmbimi i shumave të mëdha ose këmbimeve të shpeshta që nuk lidhen me biznesin e klientëve;

- Valuta e shitur nga klienti nuk përkon me atë të vendit të shtetësisë ose qëndrimit;
 - Klienti blen valutë nga një vendndodhje e pazakontë krahasuar me vendndodhjen e tij/saj, pa shpjegim logjik.
 - Klienti blen valutë që nuk përkon me atë që dihet rreth vendit të destinacionit të klientit;
 - Klienti blen ose shet sasi të mëdha valute nga një juridiksion që lidhet me nivele të larta të veprës penale mëmë të PP-së ose veprimtarisë terroriste;
- Veprimtaria e biznesit të klientit:
 - Biznesi i klientit lidhet me rrezik më të lartë për PP/FT, për shembull ka kazino, merret me blerje/shitje të metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar, është tregtar skrapit.

Faktorët e rrezikut të kanalit të shpërndarjes

- I gjithë shërbimi ofrohet online pa mbrojtjet e duhura;
- Ofrimi i shërbimeve kryhet nëpërmjet një rrjeti agjentësh.

Faktorët e rrezikut të vendit ose gjeografik

- Biznesi i këmbimit valutor ndodhet në një juridiksion ku rreziku për PP/FT është më i lartë.

2. RASTE STUDIMORE

Rasti 19³⁰

Hetimi afatgjatë spanjoll për trafikun e drogës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit sollti dënimin e një gruaje në krye të një rrjeti të organizuar që pastronte të paktën 6 milionë euro (një pjesë e të cilave përfunduan në duart e FARC-së).

Gruaja, një ekuadoriane 39 vjeçare me kombësi spanjolle, kishte ngritur një perandori të pastrimit të parave në Madrid, për të paktën gjashtë organizata të trafikut të drogës në Kolumbi dhe Ekuador.

Këtë biznes fitimprurës ajo e nisi në vitin 2007. Në fazën e parë ajo u takua me mbledhësit e parave që vinin nga droga për t'i marrë paratë fizike. Paratë dërgoheshin më pas duke përdorur Biznesin e Shërbimit të Parave (BSHP). Duke qenë se nuk i dërgonte dot të gjitha paratë menjëherë pa ngjallur dyshime, ajo organizoi një rrjet. Transfertat duhet të dukeshin si dërgesa tipike remitancash nga emigrantët në atdhe, prandaj në përgjithësi shumat nuk e tejkalonin kurrë shumën prej 1.000 euro (mesatarisht 898 euro).

Ajo dhe ortakët e saj kërkonin kolumbianë dhe ekuadorianë që ishin të gatshëm të hiqnin dorë nga identiteti i tyre për të hapur llogari për transferimin e parave me shoqëritë BSHP. Këta njerëz dorëzonin pasaportat e tyre dhe, dhe në këmbim të një komisioni prej 200 eurosh, e lejonin grupin të depozitonte lirisht dhe të tërhiqte para sipas nevojës për bandat e drogës.

30. Marrë nga raporti i EUROPOL-it PËRSE PARAJA FIZIKE MBIZOTËRON ENDE?


Përgjimet zbuluan se disa degë BSHP-je të parapëlqyera, të përdorura nga rrjeti, ishin të vetëdijshme për veprimtaritë e saj dhe e dinin se ajo përdorte llogari të ndryshme në emra të ndryshëm për të pastruar para. Madje, ato e këshilluan të bënte transferta që të mos dukeshin të dyshimta dhe të mos bllokoheshin në Kolumbi. “A e keni ndezur makinën larëse?”, “A ka shumë rroba të papastra në Madrid?”, “A janë këto nga karteli kolumbian?” ishin disa prej shprehjeve të përdorura midis saj dhe agjentëve të BSHP-së, pa e ditur se policia po përgjonte.

Rasti 20³¹

Disa individë dhe shoqëri bullgare dhanë dhe morën një numër të madh dërgesash parash nga persona dhe në destinacione të ndryshme (zakonisht në disa vende të huaja) gjatë një periudhe të shkurtër kohe.

Më pas ata i pezulluan veprimtaritë për pak kohë dhe pas një periudhe të shkurtër filluan sërish të kryenin transferta. Më këtë skemë, shumat e mëdha ndaheshin në shuma më të vogla, i dërgoheshin një numri të madh personash në vende të ndryshme dhe në fund u ktheheshin sërish personave fillestarë. Shuma totale e marrë dhe dërgesat e parave ishin thuajse të barabarta dhe personat deklaruan se i njihnin personat që ishin përfitues të transfertave të porositura prej tyre. Transfertat kryheshin duke përdorur disa valuta, ku këmbimet nga një valutë në tjetrën midis transfertave nuk kishin asnjë shpjegim të arsyeshëm.

Hetimi zbuloi se shumë të huaj të përfshirë në skemë kishin të shkuar kriminale ose ishin dënuar për trafik droge, prostitucion, etj.



31. Marrë nga raporti i FAFT-së (qershor 2010) *Pastrimi i parave nëpërmjet Dërgesave të Parave dhe Ofruesve të Shkëmbimeve Valutare*.

Rasti 21³²

Njësia financiare e inteligjencës kishte marrë disa raportime nga banka postare lidhur me dërgesat e parave nëpërmjet një transmetuesi të njohur parash, të dërguara nga disa subjekte që në dukje nuk kishin lidhje midis tyre, nga vendi A drejt disa vendeve të Amerikës Jugore.

Analiza e informacionit zbuloi se numri i transaksioneve të dërguara jashtë shtetit ishte ndarë në shuma të vogla.

Transfertat vinin nga degë të ndryshme të bankës postare, të cilat ndodheshin të gjitha në të njëjtin rajon gjeografik në vendin A, me disa përfitues që ndodheshin në vende të ndryshme të Amerikës Jugore, të cilat konsideroheshin si vende ku rreziku për prodhimin e drogës ishte i lartë. Subjektet që bënë dërgesa parash nuk kishin precedentë penalë ose të shkuar hetimore dhe ishin zakonisht të rinj me të ardhura të ulëta dhe pa prona. Kështu, lindën dyshime se ata po përdorshin si fasadë.

U zbulua një lidhje midis një prej personave të përfshirë dhe një organizate të madhe kriminale që dihej se merrej me trafik droge. Bashkëpunimi me një prej FIU-ve zbuloi se një prej përfituesve ishte në burg për trafik droge.

3. INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- RAPORTI I EUROPOLIT (2015) PËRSE PARAJA FIZIKE MBRETËRON ENDE?
- RAPORTI I ABE-së EBA/GL/2021/2 - RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR UDHËZIMET MBI KUJDESIN E DUHUR TË KLIENTIT DHE FAKTORËT QË INSTITUCIONET KREDITORE DHE FINANCAIRE DUHET TË MARRIN PARASYSH GJATË VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË DYFISHTË PP/FT LIDHUR ME MARRËDHËNIET INDIVIDUALE TË BIZNESIT DHE TRANSAKSIONET RASTËSORE.
- Raporti i FATF-së (qershor 2010) *Pastrimi i parave nëpërmjet Dërgesave të Parave dhe Ofruesve të Shkëmbimeve Valutore*.

32. Marrë nga raporti i FAFT-së (qershor 2010) *Pastrimi i parave nëpërmjet Dërgesave të Parave dhe Ofruesve të Shkëmbimeve Valutore*

10.

Tipologji të tjera

Ky seksion i përkushtohet tipologjive të tjera të pastrimit të fitimeve të paligjshme të përdorura gjerësisht, duke përcaktuar alarmet e tyre dhe informacionet e mëtejshme.

1. PËRDORIMI I “MUSHKAVE” TË PARAVE

“Mushkat” e parave janë individë që përdoren për të transferuar vlera. Ata mund të jenë pjesëmarrës të vetëdijshëm në këto veprime, që zakonisht rekrutohen nga kriminelët nëpërmjet reklamimit të pozicioneve të punës si “menaxherë transaksionesh” ose nëpërmjet ndërveprimeve në media sociale. Rekrutuesit e transportuesve të parave njihen si “kujdestarë”.

Transportuesit e parave mund të bashkëpunojnë në pastrimin e fondeve me ose pa vetëdije, ose nga neglizhenca, në emër të një OK-je. Kriminelët online i përshtatin teknikat e tyre të rekrutimit në varësi të motiveve të transportuesit të mundshëm të parave. Për shembull, këta kriminelë ofrojnë pagesa jozyrtare në para fizike dhe udhëtime falas për të nxitur dhe rekrutuar transportues “të vetëdijshëm” parash që motivohen nga paratë e fituara lehtë dhe udhëtimet falas.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden këto dokumente:

- US-CERT *Të kuptoni dhe mbroni veten nga Skemat e Transportimit të Parave*
- Isle of Man, Njësia e Inteligjencës Financiare (2020) *Tipologjitë e Transportimit të Parave*.

Informacione të mëtejshme

- FATF (2018), Pastrimi Profesional i Parave, FATF, Paris, Francë www.fatf-gafi.org/publications/methodandtrends/documents/professional-money-laundering.html
- US-CERT *Të kuptoni dhe mbroni veten nga Skemat e Transportimit të Parave*
- QENDRA AUSTRALIANE E TEKNOLOGJISË SË LARTË - *Transportuesit e parave*.
- Ishulli i Mani, Njësia e Inteligjencës Financiare (2020) *Tipologjitë e Transportimit të Parave*.
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont.

2. PËRDORIMI I BIZNESEVE QË PËRDORIN INTENSIVISHT PARANË FIZIKE (FIAT)

Përdorimi si mbulim i bizneseve të ligjshme, që gjenerojnë përgjithësisht para fizike, është një prej metodave më të shpeshta për injektimin e fondeve të fituara në mënyrë të paligjshme në sistemin financiar. Këto biznese janë: tregjet, baret, restorantet dhe marketet në përgjithësi, ku klientët paguajnë për produktet ose shërbimet me para fizike.

Ndonjëherë, këto biznese kanë pak punë dhe menaxherët janë hetuar nga policia ose kanë precedentë penalë. Prandaj, hetimi lehtësohet kur krijohet lidhja midis parave të injektuara në sistemin bankar dhe origjinës së paligjshme. Në raste të tjera, procesi i dallimit të fondeve të ligjshme nga fondet e paligjshme është shumë më i ndërlikuar për shkak se pikat e pakicës punojnë normalisht si çdo biznes tjetër brenda së njëjtës industri.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden nga këto dokumente:

- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP)

Informacione të mëtejshme

- RAPORTI I EUROPOLIT (2015) *PËRSE PARAJA FIZIKE MBRETËRON ENDE?*
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont.
- Raportet vjetore 2012, 2016, 2020 publikuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>

3. PËRDORIMI I HUAVE

Strukturat e huave përdoren gjerësisht për të pastruar fondet e gjeneruara nga veprimtaria kriminale duke fshehur origjinën kriminale të fondeve. Paratë e fshehura të gjeneruara nga veprimtaria kriminale ose produktet e trafikut të drogës mund të përdoren për të financuar pasuritë e paluajtshme ose ushtrimin e një biznesi.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden në këto dokumente:

- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris.

Informacione të mëtejshme

- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjësimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont.
- Raportet vjetore 2012, 2021 publikuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) <https://fiu.gov.al/sq/raportet-vjetore/>

4. SEKTORI I LOJËRAVE TË FATIT

Ky sektor përfshin një sërë veprimtarish që mund të përdoren për pastrimin e produkteve të paligjshme, si kazinotë, makinat e lojërave elektronike, lotaritë dhe bastet sportive apo kazinotë dhe pikat online të lojërave të fatit.

Kazinotë janë biznese që përdorin intensivisht paratë fizike që, në disa raste, qëndrojnë të hapura 24 orë në ditë dhe ofrojnë shërbime financiare shtesë si dërgesa parash, kasaforta për depozita të sigurta dhe këmbim valutor. Në shumë juridiksione, ky sektor nuk është i rregulluar apo i mbikëqyrur nga pikëpamja e pastrimit të parave, ndonëse ka rrezik serioz që mund të përdoret për këto qëllime të paligjshme.

Lojërat online të fatit përfshijnë bastet virtuale dhe lojërat e fatit nëpërmjet faqeve të ndryshme të internetit dhe për pastruesit e parave ka të njëjtin potencial, në mos më të madh, si kazinotë fizike për pastruesit e parave, pasi ofron shkallë më të lartë anonimiteti dhe më pak kontroll, sidomos sot, pasi pranon pagesa në kriptomoneda.

Lotaritë përdoren gjerësisht për pastrimin e fondeve të gjeneruara në mënyrë të paligjshme dhe zakonisht përfshijnë blerjen e një bilete ku rezultati i numrave dhe sportit mund të zgjidhet, gjë që në disa raste sjell kthime të mëdha të parave fizike nëse fiton numri i zgjedhur.

Qendrat e basteve sportive mund të gjenden në shumë juridiksione. Këtu, bastet mund të vendosen për veprimtari të ndryshme sportive deri në një kufi të caktuar dhe çmimet fituese merren në para fizike ose hidhen në një kartë që lëshohet nga ofruesi i shërbimit. Normalisht, ato vendosen nën kontroll juridiksional dhe i nënshtrohen tatimit.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden në këto dokumente:

- Raporti i FATF-së (2009) *Cenueshmëritë e Kazinove dhe Sektorit të Lojërave të Fatit*
- Raporti i Vlerësimit të GIABA-s (2021), *Rreziqet e Pastrimit të Parave në Kazino dhe Sektorin e Lojërave të Fatit në Afrikën Perëndimore*, GIABA, Dakar, Senegal.

Informacione të mëtejshme

- Raporti i FATF-së (2009) *Cenueshmëritë e Kazinove dhe Sektorit të Lojërave të Fatit* <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Vulnerabilities%20of%20Casinos%20and%20Gaming%20Sector.pdf>
- Raporti i Vlerësimit të GIABA-s (2021), *Rreziqet e Pastrimit të Parave në Kazino dhe Sektorin e Lojërave të Fatit në Afrikën Perëndimore*, GIABA, Dakar, Senegal.
- Raporti Kërkimor i MONEYVAL-it (2013) *Përdorimi i lojërave online të fatit për pastrim parash dhe financim të qëllimeve të terrorizmit*.
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont *NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont*
- Raporti APG *Raporti Vjetor i Tipologjive 2022*.

5. BLERJA E VEPRAVE TË ARTIT, STOLIVE DHE OBJEKTEVE ME VLERË

Në këtë tipologji, tjetërsimi i aseteve ka të bëjë thjesht me blerjen e mallrave. Paratë e paligjshme tjetërsohen në mallra të tjera, si diamante, ar, automjete të cilat mund të shiten ose transportohen. Pastruesit e parave në përgjithësi parapëlqejnë të blejnë objekte me vlerë që të jenë të vogla dhe të lehta për t'u shitur, fshehur dhe transportuar në një vend tjetër, në vend të objekteve antike dhe veprave të shtrenjta të artit, që janë të mëdha dhe të rënda, gjë që i bën të vështira për t'u fshehur e transportuar dhe të lehta për t'u gjurmuar. Zakonisht, mallrat blihen në emër të palës së tretë për të shmangur dyshimet.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden në këto dokumente:

- FATF – Raporti i Grupit Egmont (2013), PASTRIMI I PARAVE DHE FINANCIMI I TERRORIZMIT NËPËRMJET TREGTISË SË DIAMANTEVE

Informacione të mëtejshme

- FATF (2023), *Money Laundering and Terrorist Financing in the Art and Antiquities Market*, FATF, Paris, France. <https://www.fatf-gafi.org/publications/Methodsandtrends/Money-Laundering-Terrorist-Financing-ArtAntiquities-Market.html>
- FATF – Raporti i Grupit Egmont (2013), PASTRIMI I PARAVE DHE FINANCIMI I TERRORIZMIT NËPËRMJET TREGTISË SË DIAMANTEVE
- RAPORTI I EUROPOL-IT (2015) *PËRSE PARAJA FIZIKE MBIZOTËRON ENDE?*
- Qeveria Australiane - RAPORTI AUSTRAC *Tregtarët e Lingotave të Arit në Australi*
- Marrë nga Raporti i Grupit Egmont *NjIF-të në aksion: 100 raste nga Grupi Egmont*

6. PËRDORIMI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE OSE TË BAMIRËSISË

Termi organizatë jofitimprurëse ose OJF i referohet një subjekti juridik ose organizate që ka si objekt parësor mbledhjen ose disbursimin e fondeve për qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore, sociale dhe vëllazërore, ose kryerjen e “punëve të tjera të mira”. Ato mund të marrin forma të ndryshme ligjore,

në varësi të juridiksionit dhe sistemit ligjor. Organizatat kriminale mund t'i përdorin këto organizata për të mbuluar pastrimin e produkteve të veprimtarisë kriminale. Në këtë mënyrë, shkelësit e ligjit japin "para të pista" dhe marrin "para të pastra". Shkelësit e ligjit tregojnë kujdes gjatë përdorimit të këtij sektori për nxjerrjen e parave të pastra, pasi dihet që mund të përdoret për pastrim parash dhe financim terrorizmi në plan afatmesëm.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden në këto dokumente:

- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjesimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris.

Informacione të mëtejshme

- FATF (2013) për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit-Cenueshmëritë e Profesionistëve Ligjorë.
- Qeveria Australiane, Tendencat & Problematikat lidhur me Krimin dhe Drejtësinë Penale Nr. 424 (shtator 2011) *Keqpërdorimi i sektorit jofitimprurës për pastrim parash dhe financim terrorizmi*.
- OECD (2019), Doracaku i Ndërgjegjesimit të Kontrollorëve dhe Audituesve Tatimorë për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, OECD, Paris. www.oecd.org/tax/crime/money-laundering-and-terrorist-financing-awareness-handbook-for-tax-examiners-and-taxauditors.pdf.
- Këshilli i Kontrollit të Institucioneve Financiare Federale (FFIEC), Ligji për Fshehtësinë e Bankave (BSA) /Manuali për Kontrollin kundër Pastrimit të Parave (PP) <https://bsaaml.ffiec.gov/manual>

7. PËRDORIMI I SEKTORIT TË FUTBOLLIT

Si çdo biznes tjetër, futbolla mund të përdoret nga shkelësit e ligjit për të pastruar produktet e krimit ose për të kryer veprimtari të paligjshme për qëllime fitimi. Ndryshe nga bizneset e tjera, nuk janë fitimet ato që e bëjnë sektorin e futbollit tërheqës për shkelësit e ligjit. Kriminelët përpiqen të krijojnë lidhje me sportin jo vetëm nga dëshira për të bërë para, por edhe për shkak të prestigjit. Shkelësit e ligjit e shohin futbollin si mundësi për t'u kthyer në "personalitete" duke u shoqëruar me njerëz të famshëm dhe duke u bërë pjesë e rrethëve të pushtetshme të shoqërisë.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden në këto dokumente:

- Raporti i FATF-së (2009) *Pastrimi i Parave nëpërmjet Sektorit të Futbollit*.

Informacione të mëtejshme

- Raporti i FATF-së (2009) *Pastrimi i Parave nëpërmjet Sektorit të Futbollit*.

8. PËRDORIMI I SEKTORIT TË SIGURIMEVE

Sektori i sigurimeve mund të jetë tërheqës për pastruesit e parave që kërkojnë t'i vendosin paratë në produkte financiare që japin kthime të sigurta dhe të pastra të investimeve. Pastruesi i parave arrin t'i bëjë pastrojë paratë duke paguar për produkte sigurimi dhe marrë pagesat përkatëse nga shoqëria e sigurimit.

Treguesit e rrezikut (alarmet)

Treguesit e rrezikut mund të gjenden në këto dokumente:

- FATF (2018), *Udhëzime për Qasjen e Bazuar në Rrezik për Sektorin e Sigurimit të Jetës*, FATF, Paris, www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/rba-life-insurance.html

Informacione të mëtejshme

- FATF (2018), *Udhëzime për Qasjen e Bazuar në Rrezik për Sektorin e Sigurimit të Jetës*, FATF, Paris, www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/rba-life-insurance.html
- Raporti i FATF-së (2009) *Udhëzime për Sektorin e Sigurimit të Jetës*.
- Raporti FinCEN (2008) *Raporti i Veprimtarive të Dyshimta në Industrinë e Sigurimeve*.

SHTOJCA III

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: PARAQITJE E KONVENTAVE NË TABELË

1. KONVENTAT E KËSHILLIT TË EVROPËS

	Konventa Evropiane për Ekstradhimin (ETS Nr. 024)	Konventa Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokoll Shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimit (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990
Objekti	Vendet nënshkruese dhe që e kanë ratifikuar Konventën https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=024	Neni 1 i NNJ 1959 ka gamën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike gjatë procedimit të shkeljeve, dënimi për të cilat në momentin e kërkesës për ndihmë, është në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese Nënshkrimet dhe ratifikimet e NNJ 1959 https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=030 Nënshkrimet dhe ratifikimet e Protokollit të 2-të https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=099	Vendet nënshkruese dhe që e kanë ratifikuar Konventën https://www.coe.int/en/web/impact-convention-human-rights/council-of-europe-convention-on-laundry-search-seizure-and-confiscation-of-the-proceeds-from-crime-and-on-the-financing-of-terrorism#/ Bashkëpunimi ndërkufitar ka për qëllim hetimet dhe procedimet që synojnë sekuestrimin e mjeteve dhe produkteve	Vendet nënshkruese dhe që e kanë ratifikuar Konventën Numri i CETS / Titulli i shkurtuar që njihet - Zyra e Traktateve (coe.int) Bashkëpunimi ndërkufitar ka të bëjë me hetimet dhe procedimet që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave. Kjo konventë është e zbatueshme vetëm për vendet që nuk e kanë ratifikuar ende Konventën e Varshavës.
NNJ (çdo kërkesë që nuk përcaktohet më poshtë: dëshmi, kërkesë për dokumentacion...)	Neni 2 i NNJ-së 1959 Shkaqet për refuzim Neni / (protokoll i 2-të) shtyrja e ekzekutimit të kërkesave Neni 12 kthimi i sendeve Neni 14 i NNJ-së 1959. Procedura Neni 16, 17 i NNJ-së 1959 rregullat për bashkëlidhjen e dokumenteve Neni 19 i NNJ-së 1959 argumentimi i detyrueshëm i shkaqeve për refuzim Neni 24 (Protokoll i 2-të) Masat e ndërmjetme	Kapitulli IV Neni 16 Detyrimi për të ndihmuar Neni 28 Shkaqet për refuzim Neni 29 shtyrjet Neni 30 Konsultimi përpara miratimit të pjesëshëm ose me kushte të kërkesës	Neni 8 Detyrimi për të ndihmuar Neni 18 shkaqet për refuzim (referencat e veçanta lidhur me kërkesën për konfiskim)	Neni 8 Detyrimi për të ndihmuar Neni 18 shkaqet për refuzim (referencat e veçanta lidhur me kërkesën për konfiskim)

	Konventa Evropiane për Ekstradhimin (ETS Nr. 024)	Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimin (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990
Sekuestrimi dhe konfiskimi asetet		Neni 5 (NNJ 1959) Përmes një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, çdo Palë nënshkruese, kur nënshkruan këtë Konventë ose deponizon instrumentin e vet të ratifikimit ose anëtarësisë, mund të rezervojë të drejtën të ekzekutojë letër porositë për kërkimin dhe sekuestrimin e pronës në varësi të një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme: në rastet kur shkelja në bazë të letër porosisë është e ndëshkueshme edhe sipas legjislacionit të Palës kërkuese, edhe sipas atij të Palës që i drejtohet kërkesa; b) në rastet kur shkelja në bazë të letër porosisë është shkelje për të cilën zbatohet ekstradhim në vendin ku drejtohet kërkesa; c) në rastet kur zbatimi i letër porosisë është në përputhje me legjislacionin e Palës së cilës i drejtohet kërkesa. 2 Në rastet kur një Palë Kontraktuese bën deklaratë në përputhje me pikën 1 të këtij neni, çdo Palë tjetër mund të zbatojë parimin e reciprocitetit. (rezervimi është bërë nga Shqipëria më 4 prill 2000; Ekzekutimi i letërve porosi për kërkim dhe sekuestrim të pronës varet nga kushtet e përcaktuara në Nenin 5, pika 1, germat "a" dhe "c".)	Neni 21, 22 Masat e ndërmjetme: sekuestrimi ose konfiskimi Neni 23 deri 27 konfiskimi Neni 28.4 shkaqet për refuzimin e kërkesës për konfiskim Neni 37.2 dhe 3. Citime dhe materiale të veçanta që duhet të përfshihen në këto kërkesa (p.sh. urdhër konfiskimi)	Neni 11, 12 masat e ndërmjetme (përfshijnë sekuestrimin dhe konfiskimin) Neni 13 deri 16 konfiskimi Art. 15: Çdo pronë e konfiskuar nga Pala e kërkuar do të disponohet nga ajo Palë në në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe nga palët e interesuara.
Hetimet financiare			Neni 17 Kërkesa për informacion mbi llogaritë bankare Neni 18 Kërkesë për informacion mbi veprimet bankare Neni 19 Kërkesë për monitorimin e veprimeve bankare	
Informacion spontan	Neni 11 (protokolli i 2-të)		Neni 20	Neni 10

	<p>Konventa Evropiane për Ekstradimin (ETS Nr. 024)</p>	<p>Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.</p>	<p>Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës</p>	<p>Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimin (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990</p>
<p>Formalitetet (legjislacioni në fuqi, konsultimet, etj.).</p>		<p>Art. 3 Konv. 1959: Ekzekutimi sipas legjislacionit të palës së kërkuar. Neni 8 (protokolli 2) Pavarësisht dispozitave të Nenet 3 të Konventës, në rastet kur kërkesat përcaktojnë formalitete ose procedura të cilat janë të nevojshme në kuadër të legjislacionit të Palës kërkuese, edhe nëse këto janë të panjohura nga Pala së cilës i drejtohet kërkesa, kjo e fundit vepron në përputhje me këto kërkesa për sa kohë veprimi i kërkuar nuk është në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit të saj, për sa kohë nuk përcaktohet ndryshe në këtë Protokolll</p>	<p>Ekzekutimi sipas legjislacionit të palës së cilës i drejtohet kërkesa ose palës kërkuese kur është në përputhje me legjislacionin vendas (neni 15.3)</p>	<p>Neni 9 Sipas legjislacionit të palës së cilës i drejtohet kërkesa</p>
<p>Njoftimi i dokumenteve</p>		<p>Neni 16 (Protokolli 2) Autoritetet gjyqësore kompetente të cilësdo Palë mund t'i drejtojnë drejtpërdrejt, me postë, dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore, personave që janë në territorin e cilësdo Pale tjetër. 2 Materialet procedurale dhe vendimet gjyqësore shoqërohen me një raport që deklaron se personit të cilit i drejtohen dokumentet mund të marrë informacion nga autoriteti i identifikuar në raport lidhur me të drejtat dhe detyrimet e veta sa i përket dorëzimit të materialeve procedurale. Dispozitat e pikës 3 të Nenet 15 më lart gjejnë zbatim për këtë raport. 3 Dispozitat e Neneve 8, 9 dhe 12 të Konventës gjejnë zbatim mutatis mutandis për shërbimin postar. 4 Dispozitat e pikave 1, 2 dhe 3 të Nenet 15 më lart zbatohen edhe për shërbimin postar.</p>	<p>Neni 31 Është e lejueshme që materialet procedurale të dërgohen drejtpërdrejt ose përmes autoriteteve konsullore (përveç rasteve kur deklarohet ndryshe) Detyrim për përcaktimin e masave ligjore në vendin kërkuës në rastin e masave të ndërmjetme ose në rastin e konfiskimit</p>	<p>Neni 21 Është e lejueshme që materialet procedurale të dërgohen drejtpërdrejt ose përmes autoriteteve konsullore (përveç rasteve kur deklarohet ndryshe) Detyrim për përcaktimin e masave ligjore në vendin kërkuës në rastin e masave të ndërmjetme ose në rastin e konfiskimit Shqipëria nuk ka bërë asnjë Rezervim/Deklaratë</p>

	Konventa Evropiane për Ekstraditim (ETS Nr. 024)	Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Financimin e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimit (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990
Njohja e Vendimeve të huaja			Neni 33.2: Si rregull i përgjithshëm, çdo vendim gjyqësor i huaj do të njihet, përveç rasteve kur ka shkaqe të përcaktuara për refuzim	Neni 22: Si rregull i përgjithshëm, çdo vendim gjyqësor i huaj njihet, përveç rasteve kur ka shkaqe të përcaktuara për refuzim
Transmetimi		Autoriteti Qendror Shqiptar: Ministria e Drejtësisë (sipas Deklaratave të Shqipërisë) Neni 15 Konv (1959, ndryshuar nga protokollin 2-të): e rëndësishme Kombinon transmetimin përmes Autoriteteve Qendrore me transmetimin e drejtpërdrejtë të kërkesave. Interpoli në raste urgjence	Neni 33, 34 Nga autoriteti qendror (ose Interpol) Lejohet komunikim i drejtpërdrejtë për: • Raste urgjente • NNJ-në sipas seksionit 2 pa masa shtrënguese (hetimet financiare)	Autoriteti Qendror është Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë (Deklarata e bërë më 27.10.2016) Nenet 23, 24 Nga autoriteti qendror (ose Interpol-i) Lejohet komunikim i drejtpërdrejtë për: • Raste urgjente • NNJ-në sipas seksionit 2 pa masa shtrënguese (hetimet financiare)

	Konventa Evropiane për Ekstradimin (ETS Nr. 024)	Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimit (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990
Formati i kërkesës dhe gjuhët	Neni 16.2 Konv. 1959: Çdo palë kontraktuese mund, kur nënshkruan ose deponon instrumentin e tij të ratifikimit ose pranimit, me anë të një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të rezervojë të drejtën për të përcaktuar që kërkesat dhe dokumentet e aneksuara do t'i drejtohen të shoqëruara nga një përkthim në gjuhën e vet ose në njërin prej gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës ose në një nga gjuhët e përcaktuara prej saj. Palët e tjera Kontraktuese mund të zbatojnë reciprocitetin. Neni 15 (Protokolli 2) 1. Materialet procedurale dhe vendimet gjyqësore transmetohen në të gjitha rastet në gjuhën ose në gjuhët origjinale. 3 Pavarësisht dispozitave të Nenit 16 të Konventës, nëse autoriteti që ka lëshuar dokumentacionin është në dijeni ose ka arsye të besojë se personi të cilit i dërgohet ky dokumentacion kupton vetëm një gjuhë tjetër, dokumentacioni në fjalë, ose të paktën pjesët e tij të rëndësishme shoqërohen me përkthim në atë gjuhë. 4 Pavarësisht dispozitave të Nenit 16 të Konventës, materiali procedural dhe vendimet gjyqësore shoqërohen, për të mirën e autoriteteve të Palës së cilës i dërgohet kërkesa, nga një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së tyre e përkthyer në gjuhën, ose në një prej gjuhëve të Palës në fjalë	Neni 35 Mënyra e shkruarit Transmetohet elektronikisht ose me çdo mënyrë tjetër komunikimi, me kusht që shteti pritës të jetë i përgatitur. Nuk ka nevojë të sigurohen dokumente mbështetëse Nuk ka detyrim për përkthim, por varet nga kërkesat e mëtejshme të bëhen me Deklaratë	Neni 25 Mënyra e shkruarit Transmetuar me "mjete moderne komunikimi" si telefaks Nuk ka referenca sa i përket bashkëlidhjeve ose dokumenteve mbështetëse Nuk ka detyrim për përkthim, por varet nga kërkesat e mëtejshme të vendit që bëhen me Deklaratë	

	Konventa Evropiane për Ekstraditim (ETS Nr. 024)	Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimit e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës	Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimin (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990
Parimi i kërkesave të veçanta			Neni 42 Pala të cilës i drejtohet kërkesa mund t'i zbatohet deklarata zyrtare (Shqipëria nuk e ka bërë këtë) ose në dokumentacionin e ekzekutimit të kërkesës.	Neni 32 Pala të cilës i drejtohet kërkesa mund t'i zbatohet deklarata zyrtare (Shqipëria nuk e ka bërë këtë) ose në dokumentacionin e ekzekutimit të kërkesës.
Konfidencialiteti		Neni 25 Protokollin e 2-të Pala kërkuar mund të kërkojë që Pala së cilës i drejtohet kërkesa të mbajë të fshehtë faktin dhe përmbajtjen e kërkesës, përveç sa është e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës. Nëse Pala së cilës i drejtohet kërkesa nuk mund të përmbushë kërkesën e konfidencialitetit, ajo njofton menjëherë Palën kërkuar.	Neni 43: Është Rregulli i përgjithshëm edhe kur nuk përcaktohet nga vendi kërkuar. Në rastin e informacionit spontan, autoriteti që merr informacionin duhet të zbatohet kërkesat e konfidencialitetit të kërkesës.	Neni 33 Konfidencialiteti gjatë ekzekutimit me kërkesë të palës kërkuar Pala kërkuar ruan fshehtësinë e rezultatit të kërkesës, përveç përmbajtjes së hetimit Në rastin e informacionit spontan, autoriteti që merr informacionin duhet të zbatohet kërkesat e konfidencialitetit

	<p>Konventa Evropiane për Ekstraditim (ETS Nr. 024)</p>	<p>Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978 *Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.</p>	<p>Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimin e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës</p>	<p>Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimin (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990</p>
<p>Referenca për rezervimet dhe Deklaratat</p>	<p>Rezervimet e bëra nga Shqipëria https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=024&codeNature=2&codePays=ALB Deklaratat e bëra nga Shqipëria https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=024&codeNature=10&codePays=ALB</p>	<p>Rezervimet dhe Deklaratat https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=030&codeNature=0 Rezervimet dhe Deklaratat për Protokollin e 2-të (Shqipëria nuk ka) https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=099&codeNature=0 Relacioni shpjegues i Konv. 1959 https://rm.coe.int/16800c92bd Relacioni Shpjegues i Protokollit të 2-të https://rm.coe.int/16800c96ef</p>	<p>https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=198&codeNature=0 Shqipëria ka përcaktuar Ministrinë e Drejtësisë si Autoritet Qendror dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare si autoritet për kërkesat në kuadër të Kapitullit V (bashkëpunimi ndërmjet FIU-ve)</p>	<p>https://www.coe.int/en/web/conventions/cets-number/-/abridged-title-known?module=declarations-by-treaty&numSte=141&codeNature= Për qëllimet e Nenit 23 (Autoriteti qendror) të Konventës, autoriteti përgjegjës për Shqipërinë është Drejtoria për Koordinimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave.</p>
<p>Masat e veçanta</p>		<p>Neni 9 Pprotokolli i 2-të Video Konferencë Neni 10 Protokolli 2-të konferencë telefonike Neni 13 Transferim i përkohshëm i personave të ndaluar palës së cilës i është bërë kërkesa Neni 17 Protokolli i 2-të vëzhgimet ndërkufitare Neni 18Protokolli i 2-t) dorëzimet e kontrolluara Neni 19 Hetimet në mbulim Neni 20 Skuadra të Përbashkëta Hetimore</p>		

	<p>Konventa Evropiane për Ekstradimin (ETS Nr. 024)</p>	<p>Konventa Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS Nr. 30) Protokolli Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale, Strasbourg, 17.III.1978</p> <p>*Nenet e zëvendësuara me Protokollin e Dytë janë në fuqi për vendet që nuk e kanë ratifikuar atë.</p>	<p>Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Financimit e Terrorizmit (Nr. 198) Konventa e Varshavës</p>	<p>Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produktit të Krimin (ETS Nr. 141), Strasbourg, 1990</p>
<p>Kostot</p>	<p>Neni 20 (ndryshuar nga Protokollin 2): 1. Palët nuk i kërkojnë njëra-tjetrës rimbursimin e kostove që lindin nga zbatimi i kësaj Konvente apo Protokolleve të saj, përveç:</p> <p>a) kostove të hasura në lidhje me qëndrimin e ekspertëve në territorin e Palës së cilës i është drejtuar kërkesa;</p> <p>b) kostot e hasura lidhur me transferimin e një personi të ndaluar, kryer në përputhje me Nenin 13 ose Nenin 14 të Protokollit të Dytë Shtesë të kësaj Konvente, ose me Nenin 11 të kësaj Konvente;</p> <p>c) kosto të një natyre të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme.</p> <p>2 Megjithatë, kostot për vendosjen e një lidhjeje me video ose telefonike, kostot që lidhen me shërbimin e një lidhjeje video ose telefonike në Palën të cilës i është drejtuar kërkesa, pagesa e interpretëve të ofruar prej saj, dhe kompensimi i dëshmitarëve dhe shpenzimeve të tyre të udhëtimit në Palën të cilës i është drejtuar kërkesa i rimbursohen Palës së cilës i është drejtuar kërkesa nga Pala kërkuese, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe.</p> <p>3. Palët konsultohen me njëra-tjetrën me qëllim organizimin e pagesave të kostove që mund të pretendohen bazuar në pikën 1.c më lart.</p> <p>4. Dispozitat e këtij neni zbatohen pa paragjykim lidhur me dispozitat e Nenit 10, pika 3 e kësaj Konvente.</p>	<p>Neni 20 (ndryshuar nga Protokollin 2): 1. Palët nuk i kërkojnë njëra-tjetrës rimbursimin e kostove që lindin nga zbatimi i kësaj Konvente apo Protokolleve të saj, përveç:</p> <p>a) kostove të hasura në lidhje me qëndrimin e ekspertëve në territorin e Palës së cilës i është drejtuar kërkesa;</p> <p>b) kostot e hasura lidhur me transferimin e një personi të ndaluar, kryer në përputhje me Nenin 13 ose Nenin 14 të Protokollit të Dytë Shtesë të kësaj Konvente, ose me Nenin 11 të kësaj Konvente;</p> <p>c) kosto të një natyre të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme.</p> <p>2 Megjithatë, kostot për vendosjen e një lidhjeje me video ose telefonike, kostot që lidhen me shërbimin e një lidhjeje video ose telefonike në Palën të cilës i është drejtuar kërkesa, pagesa e interpretëve të ofruar prej saj, dhe kompensimi i dëshmitarëve dhe shpenzimeve të tyre të udhëtimit në Palën të cilës i është drejtuar kërkesa i rimbursohen Palës së cilës i është drejtuar kërkesa nga Pala kërkuese, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe.</p> <p>3. Palët konsultohen me njëra-tjetrën me qëllim organizimin e pagesave të kostove që mund të pretendohen bazuar në pikën 1.c më lart.</p> <p>4. Dispozitat e këtij neni zbatohen pa paragjykim lidhur me dispozitat e Nenit 10, pika 3 e kësaj Konvente.</p>	<p>Neni 44: Kostot e zakonshme të përmbushjes së kërkesës mbulohe nga Pala së cilës i drejtohet kërkesa. Në rastet kur për përmbushjen e kërkesës janë të nevojshme kosto të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme, Palët konsultohen dhe arrijnë marrëveshje për kushtet e zbatimit të kërkesës dhe për mbulimin e kostove.</p>	<p>Neni 34 – Kostot e zakonshme të përmbushjes së kërkesës mbulohe nga Pala së cilës i drejtohet kërkesa. Në rastet kur për përmbushjen e kërkesës janë të nevojshme kosto të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme, Palët konsultohen dhe arrijnë marrëveshje për kushtet e zbatimit të kërkesës dhe për mbulimin e kostove</p>

2. TRAKTATET E KOMBEVE TË BASHKUARA/LEGJISLACIONI I BRENDSHËM

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimet të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (NNJ)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Objekti	Veprat transnacionale që përfshijnë organizatat e krimet të organizuar, lidhur me veprat e përcaktuara në nenet 5, 6, 8 dhe 23 dhe krimet e rënda të përcaktuara në nenin 2 (nenin 3) Statusi i ratifikimit https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&rmdsg_no=XVIII-12&chapter=18&clang=en	Parandalimi, hetimi dhe ndjekja penale e korrupsionit dhe ngrija, sekuestrimi, konfiskimi dhe kthimi i produktit të veprave të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë (neni 3) Statusi i ratifikimit https://www.unodc.org/unodc/en/corruption/ratification-status.html	KPP-Neni 10 marrëdhëniet me autoritetet e huaja rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të miratuara nga Shqipëria + parimet ndërkombëtare + dispozitat e kodit të procedurës penale	Ligji synon të përcaktojë rregullat procedurale shtesë lidhur me kërkesat ndërkombëtare, por nuk është i zbatueshëm kur parashikohet ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë a) Procedimet në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkes ose të Shqipërisë; b) Për procedimet në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është i njohur nga Shqipëria. Rregullohen kërkesa me Letër Porosi (Kreu II), Ekstradimi (Kreu III), Njohja dhe ekzekutimi i gjyqimeve penale (Kreu IV)

<p>NNJ (çdo kërkesë që nuk përcaktohet më poshtë: dëshmi, kërkesë për dokumentacion...)</p>	<p>Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermos)</p>	<p>Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar</p>	<p>Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (INNJ)</p>	<p>LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)</p>
	<p>Neni 18 Ndhimja e Ndërsjellë Juridike, Neni 18.7: Pikat 9 deri 29 zbatohen nëse nuk ka traktat ose kur shtetet palë vendosin të zbatojnë këtë nen në vend të Traktatit ekzistues. Neni 18.8 sekretit bankar nuk është shkak për refuzimin e ndihmës Neni 18.9 Mungesa e kriminalitetit i dyfishtë si shkak për refuzim Neni 18.21 Shkaqet për refuzim. Neni 18.22: Çështjet fiskale nuk përbëjnë shkak për refuzim Neni 18.25 Shkaqet për shtyrjen e ekzekutimit të NNJ-së Neni 18.26 Konsultimet (për refuzimin dhe shtyrjen e ekzekutimit)</p>	<p>Neni 46: Ndhimja e Ndërsjellë Juridike Neni 46.7 rregullat për zbatimin e dispozitivave të NNJ-së në rast shtrëngimi ose jo sipas një traktati tjetër: pikat 9 deri 29 zbatohen nëse nuk ka traktat ose kur shtetet palë vendosin të zbatojnë këtë nen në vend të Traktatit Neni 46.8 sekretit bankar nuk është shkak për refuzimin e ndihmës Neni 46.9: Mungesa e kriminalitetit të dyfishtë si bazë fakultative për refuzim. Neni 46.21: Arsye për refuzim. Neni 46.22: Çështjet fiskale nuk janë arsye për refuzim. Neni 46.25: Arsye për shtyrjen e ekzekutimit të MLA-së. Neni 46.26: Konsultimet (për refuzimin dhe shtyrjen e ekzekutimit) Neni 45: Transferimi i personave të dënuar</p>	<p>Kapitulli II, seksioni I (bashkëpunimi pasiv) nenet 505 - 508 Neni 505. Kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me letër porositë: Shkaqet për refuzim... Neni 506: Letër Porosia duhet të pranohet nga një gjykatë përpara ekzekutimit nga gjykata ose Prokuroria përkatëse</p>	<p>Neni 8: Refuzimi. Mund të bëhet nga Ministria e Drejtësisë ose autoritetet ekzekutive Nuk refuzohen letër porositë për krimet kundër njerëzimit mbi bazën se janë vepra politike Neni 13: Lista e NNJ-ve të pranueshme duke përfshirë kërkesat administrative me kusht që vendimi të mund të apelohej në një gjykatë me juridiksion penal Neni 14.2: Ekzekutimi. Prokurori përgjegjës i dorëzon gjykatës kërkesën për ekzekutimin e letër porositë përmes një vendimi, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Ky rregull nuk zbatohet kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Neni 21 transferimi i personave të ndaluar Neni 24 shtyrja e vendimit</p>

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (NNJ)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Ngrirja dhe konfiskimi Shitja e pasurive	Neni 13 bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllimet e konfiskimit Neni 14 Shitja e pasurive. Rregulli i përgjithshëm është të shiten sipas legjislacionit të brendshëm, megjithëse pasuritë t'i kthehen shtetit kërkues për kompensimin e viktimave ose t'u kthehen pronarëve. Rregullat e ndarjes me marrëveshje	Nenet 54-55: Rregullat për lëshimin dhe ekzekutimin e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim. Neni 57: Kthimi dhe shitja e pasurive: kthimi ose shitja sipas legjislacionit të brendshëm. Dispozita të veçanta: në rast të përvetësimit të fondeve publike, pasuritë i kthehen palës kërkuese; në rastet e tjera, pasuritë kthehen kur pala kërkuese vërteton pronësinë e tyre ose kur pala së cilës i drejtohet kërkesa i pranon dëmin palës kërkuese. Kapitulli V (nenet 51-59) i kushtohet Rekuperimit të Aseteve.	Neni 517 Sekuestrimi. Prokurori i drejton kërkesën për sekuestrim gjykatës.	Art. 22: Kontrolli dhe sekuestrimi i objekteve Art. 23: Dorëzimi i sendeve të sekuestruara

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (NNJ)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Ekstradimi	Neni 16. Konventa konsiderohet si Traktat për ekstradimin, përveç rasteve kur bëhet deklarata kundërtën	Neni 44 Konventa konsiderohet si Traktat për ekstradimin, përveç rasteve kur bëhet deklarata për të kundërtën	Kreu I (nenet 488 - 504)	Kreu III Seksioni I: Ekstradim jashtë vendit (pra) (nenet 31 deri 47) Roli i MD-së: mund të refuzojë kërkesën për Ekstradim (neni 23), të presë urdhrin ndërkombëtar për ndalim, neni 35, dhe merr vendimin përfundimtar për ekstradim (neni 40) Neni 38. Refuzimi i dorëzimit të shtetasve shqiptarë Seksioni II ekstradimi brenda vendit (ekstradimi aktiv Neni 48-52)
Ekzekutimi i dënimeve të huaja			Neni 518 Është formulim i përgjithshëm që i referohet ose dënimeve me burgim ose ekzekutimit të konfiskimeve. Nuk ka referencë për nivel minimal për ekzekutimin Seksioni II, Bashkëpunimi aktiv: nenet 519-523 rregullojnë për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave shqiptare jashtë vendit	Kapitulli IV Seksioni I: Zbatimi dënimeve të huaja (Nenet 53-61)
Hetimet financiare				
Informacion spontan	Neni 18.4	Neni 46.4		Neni 27

SHTOJCA III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: PARAQITJE E KONVENTAVE NË TABELË

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimet të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (NNJ)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Formalitetet (legjislacioni i zbatueshëm, konsultimet, etj.).	Neni 18.17. Ekzekutim sipas legjislacionit të palës së cilës i drejtohet kërkesa dhe kur kërkesa dhe kur është e mundur, në përputhje me procedurat e përcaktuara në kërkesë.	Neni 46.17 Ekzekutim sipas legjislacionit të palës së cilës i drejtohet kërkesa dhe kur është e mundur, në përputhje me procedurat e përcaktuara në kërkesë.		Neni 17. Ekzekutimi i kërkesës pasive të NNJ sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kërkesë me kusht që të mos bien ndesh me parimet themelore të rendit publik të Republikës së Shqipërisë.
Njoftimi i dokumenteve	Neni 18.3b) Nuk ka dispozita të veçanta.	Neni 46.3 b) Nuk ka dispozita të veçanta.		Neni 13.1. a) dhe b) Nuk ka dispozita të veçanta
Transmetimi	Neni 18.13 Njëpërmjet autoritetit qendror dhe kanalit diplomatik/ Interpoli në raste urgjente. Nuk mundësohet komunikim i drejtpërdrejtë	Neni 46.13 Njëpërmjet autoritetit qendror dhe kanalit diplomatik. Interpoli në raste urgjente. Nuk mundësohet komunikim i drejtpërdrejtë		Neni 6 dhe 15 Letër Porositë transmetohen (bashkëpunimi aktiv) përmes Autoriteteve Qendrore, përveç rasteve urgjente kur pranohet komunikimi i drejtpërdrejtë (në këtë rast një njoftim duhet t'i dërgohet MD). Ato priten (bashkëpunimi pasiv) përmes Autoriteteve Qendrore "përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin e brendshëm". Njoftimet e ekzekutimit ose shtyrjes duhet të bëhen përmes MD-së

<p>Formati i kërkesës dhe gjuhët</p>	<p>Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)</p>	<p>Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar</p>	<p>Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (INN)</p>	<p>LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)</p>
<p>Formati i kërkesës dhe gjuhët</p>	<p>Neni 18.14 Formular me shkrim ose që mund të regjistrohet Përcaktimet sa i përket përkthimit varen nga vendi Neni 18.15 përmbajtja e kërkesës</p>	<p>Neni 46.14 Formular me shkrim ose që mund të regjistrohet. Përcaktimet sa i përket përkthimit varen nga vendi Neni 46.15 përmbajtja e kërkesës</p>	<p>Neni 5 Formulari me shkrim Kërkesat e lëshuara nga autoritetet gjyqësore shqiptare do të përkthehen në gjuhën e vendit të kërkuar ose në ndonjë nga gjuhët e pranuar, në rast urgjence. Përkthimi bëhet nga Ministria e Drejtësisë. Në raste urgjente, përkthimi mund të bëhet edhe nga përkthyes zyrtarë të prokurorisë apo gjykatave.</p>	<p>Neni 5 Formulari me shkrim Kërkesat e lëshuara nga autoritetet gjyqësore shqiptare do të përkthehen në gjuhën e vendit të kërkuar ose në ndonjë nga gjuhët e pranuar, në rast urgjence. Përkthimi bëhet nga Ministria e Drejtësisë. Në raste urgjente, përkthimi mund të bëhet edhe nga përkthyes zyrtarë të prokurorisë apo gjykatave.</p>

SHTOJCA III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: PARAQITJE E KONVENTAVE NË TABELË

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (NNJ)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Formati i kërkesës dhe gjuhët				<p>Roli i MD-së: pikë hyrje për dërgimin dhe prirjen e NNJ-ve dhe rezolutave të ndërmjetme.</p> <p>Ajo nuk kontrollon vetëm formalitetet por edhe përmbajtjen e kërkesës në rastet aktive/pasive: kontrollon përmbushjen e kërkesave të nenit 5 në rastin e lëshimit të NNJ-ve, refuzon NNJ-në (neni 8), mund të njohë kërkesa për NNJ edhe në mungesë reciprociteti (neni 9), trajton njoftimet e ndërmjetme (neni 10) ka kompetencën t'i kërkojë autoritetit kërkuar të plotësojë kërkesën pa ia kaluar atë autoriteteve ekzekutive (neni 11), dërgon pa kërkesë informacion mbi dënimin/ndjekjen penale të të huajve (neni 28), verifikon historikun penal të "shtetasve të dënuar jashtë vendit" (neni 29) MD-ja përkthen kërkesën në gjuhën e vendeve ku drejtohet kërkesa. Në raste urgjente mund të përkthehet nga përkthyes zyrtar nga prokuroria/gjykata</p>

Parimi i kërkesave të veçanta	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (INN)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
	<p>Neni 18.19 Shteti Palë kërkes nuk transmeton ose përdor informacionin ose provat e ofruara nga Shteti Palë i kërkuar për hetime, ndjekje penale ose procedime gjyqësore të ndryshme nga ato të deklaruara në kërkesë pa pëlqimin në kërkesë pa pëlqimin paraprak të Shtetit Palë të kërkuar. Asgjë në këtë paragraf nuk pengon Shtetin Palë të akuzuar. Në rastin e fundit, Shteti Palë kërkes njofton Shtetin Palë të kërkuar përpara zbulimit dhe, nëse kërkohet, konsultohet me Shtetin Palë të kërkuar. Nëse, në rast të jashtëzakonshëm, njoftimi paraprak nuk është i mundur, Shteti Palë kërkes informon Shtetin Palë të kërkuar për zbulimin pa vonesë.</p>	<p>Neni 46.19 Shteti Palë kërkes nuk transmeton ose përdor informacionin ose provat e ofruara nga Shteti Palë i kërkuar për hetime, ndjekje penale ose procedime gjyqësore të ndryshme nga ato të deklaruara në kërkesë pa pëlqimin paraprak të Shtetit Palë të kërkuar. Asgjë në këtë pikë nuk pengon Shtetin Palë kërkes të zbulojë në procedurat e tij informacionin ose provat që janë shfaqësuese për një person të akuzuar. Në rastin e fundit, Shteti Palë kërkes njofton Shtetin Palë të kërkuar përpara zbulimit dhe, nëse kërkohet, konsultohet me Shtetin Palë të kërkuar. Nëse, në rast të jashtëzakonshëm, njoftimi paraprak nuk është i mundur, Shteti Palë kërkes informon Shtetin Palë të kërkuar për zbulimin pa vonesë.</p>		

SHTOJCA III. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: PARAQITJE E KONVENTAVE NË TABELË

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (INNJ)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Konfidencialiteti	Neni 18.20 Shteti Palë kërkes mund të kërkojë që Shteti Palë të kërkuar të ruajë fshehtësinë e faktit dhe të kërkesës, me përjashtim të masës së nevojshme për të ekzekutuar kërkesën. Nëse Shteti Palë i kërkuar nuk mund të përmbushë kërkesat e konfidencialitetit, ai informon menjëherë Shtetin Palë kërkes.	Neni 46.20 Shteti Palë kërkes mund të kërkojë që Shteti Palë i kërkuar të ruajë fshehtësinë e faktit dhe thelbit të kërkesës, me përjashtim të masës së nevojshme për të ekzekutuar kërkesën. Nëse Shteti Palë i kërkuar nuk mund të përmbushë kërkesat e konfidencialitetit, ai informon menjëherë Shtetin Palë kërkes.		Neni 12 MD-ja dhe autoriteti ekzekutues ruajnë konfidencialitetin sipas legjislacionit në fuqi, përveç rasteve kur kjo nuk është e mundur dhe për këtë informon autoritetin kërkes
Referenca për rezervimet dhe Deklaratat	https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12&chapter=18&clang=en#EndDec	https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=IND&mtdsg_no=XVIII-14&chapter=18&clang=en#EndDec		

	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Konventa e Palermo)	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (Konventa e Meridas) në fuqi më 14.12.2005 Kapitulli IV Bashkëpunimi ndërkombëtar	Kodi i Procedurës Penale Kodi Penal i miratuar me LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar Ndryshuar për herë të fundit me Ligjin Nr. 35/2017 Neni 505 dhe vijues (INN)	LIGJI Nr. 10 193, datë 3.12.2009 PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE (Ndryshuar me Ligjet Nr. 100/2013, datë 18.3.2013, Nr. 97/2021 datë 7.7.2021)
Masat e veçanta	Neni 18.18 Video Konferencë Neni 19: JIT-et Neni 20: Teknikat e veçanta të hetimit (kontrolli i dorëzimit, agjentë nën mbulim, vëzhgime...) Neni 21: Transferimi i procedimeve penale Neni 27 Bashkëpunimi ndërkombëtar i agjencive të zbatimit të ligjit	Art 46.18: Video Konferencat Neni 47: Transferimi i procedimeve penale Neni 48: Bashkëpunimi ndërkombëtar i agjencive të zbatimit të ligjit Neni 49: JIT-et Neni 50: Teknikat e veçanta të hetimit (kontrolli i dorëzimit, agjentët nën mbulim, vëzhgime...)		Neni 16: Pprania e autoriteteve të huaja gjatë ekzekutimit të kërkesës Neni 20 Video Konferencat dhe konferencat telefonike Nenet 75/1=75/6: JIT
Kostot	Neni 18.28 Kostot mbulohe nga shteti të cilin i drejtohet kërkesa, përveç rasteve kur ka marrëveshje ndryshe. Në rast se ka marrëveshje ndryshe. Në rast se ka marrëveshje ndryshe. Në rast se ka marrëveshje konsultime dhe arrihet marrëveshje	Neni 46.28 Kostot mbulohe nga shteti të cilin i drejtohet kërkesa, përveç rasteve kur ka marrëveshje ndryshe. Në rast se ka marrëveshje konsultime dhe arrihet marrëveshje		Neni 25: Kkostat paguhen nga autoriteti kërkuar. MD-ja mund të heqë dorë nga rimbursimi i kostove prej autoriteteve kërkuar. Në kërkesat aktive të NNJ-ve, duhet të përfshihen kostot që i paguhen autoriteteve të cilave u janë drejtuar kërkesat Nga ky rregull bëhen disa përjashtime.



Funded by
the European Union

